# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

# “MBI PËRPUTHSHMËRINË”

# NË

# OPERATORIN E SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE GROUP SH.A

**Korrik, 2023**

| Nr. | Përmbajtja | Faqe |
|---|---|---|
| **I.** | **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE** | **3-18** |
| 1 | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit. | 3 |
| 2. | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | 3-17 |
| 3. | Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 17-18 |
| **II.** | **HYRJA** | **19-23** |
| 1. | Titulli | 19 |
| 2. | Marrësi | 19 |
| 3. | Objektivat dhe qëllimi | 19-20 |
| 4 | Identifikimi i çështjes | 20 |
| 5 | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | 20 |
| 6 | Përgjegjësitë e audituesve | 20 |
| 7 | Kriteret e vlerësimit. | 21-22 |
| 8 | Standardet e auditimit. | 22 |
| 9 | Metoda e auditimit | 22-23 |
| 10 | Dokumentimi i auditimit | 23 |
| **III.** | **PËRSHRIMI I AUDITIMIT** | **24-233** |
| 1. | Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim. | 24-25 |
| 2. | Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit. | 25-233 |
| 2.1 | Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre. | 25-30 |
| 2.2 | Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomiko-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij | 30-53 |
| 2.3 | Mbi zbatimin e strukturës organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, dhënien e pagave dhe shpërblimeve gjatë periudhës që auditohet | 54-60 |
| 2.4 | Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj). | 60-66 |
| 2.5 | Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë; analiza e debitorëve e kreditorëve; arkëtimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit. | 66-83 |
| 2.6 | Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave. | 83-193 |
| 2.7 | Mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike. | 193-229 |
| 2.8 | Mbi zbatimi i dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale. | 229-230 |
| 2.9 | Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit. | 230-232 |
| 2.10 | Mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm | 232-233 |
| 2.11 | Auditim në njësitë e varësisë së OSHEE sh.a | 233 |
| **IV.** | **GJETJE DHE REKOMANDIME** | **234-271** |
| **V.** | **ANEKSE** | **272-283** |

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

## I.1 Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

KLSH ka kryer auditimin e përputhshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare OSHEE GROUP sh.a për aktivitetin nga data 01.07.2020 deri më 31.12.2022, duke u përqëndruar kryesisht në çështjet e zbatimit të ligjshmërisë nga organeve drejtuese; hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomiko-financiare; administrimit të marrëdhënieve të punës; auditimin e shpenzimeve; mbajtjen e evidencës kontabile; ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike dhe zbatimin e kontratave; zbatimit të rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike; funksionimit të auditit të brendshëm e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit etj.

Grupi i auditimit të KLSH-së shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion, me zgjedhje, për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit të përputhshmërisë të KLSH, Rregullorja funksionimit oragnizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kritereve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase si verifikimi i transaksioneve, intervistomi, raporte dhe informacione, verifikime në terren, etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, të shpërblimeve të dëmit dhe të mungesës së përdorimit me efektivitet të fondeve publike, i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të OSHEE GROUP sh.a, për periudhën nga data 01.07.2020 deri më datë 31.12.2022, grupi i auditimit me një siguri të arsyeshme ka dhënë opinion të kualifikuar, për veprimtarinë ekonomike dhe financiare të këtij subjekti.

## I.2 Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

| GJETJA NR. | PËRMBLEDHJE E GJETJES | REFERENCA ME RAPORTIN PËRFUNDIMTAR | RËNDËSIA | REKOMANDIMI |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2MẀ, miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor (dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a (FTL sh.a) dhe sipas treguesve të programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet | Pika 2.7 | E lartë | - Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), si institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për "Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike", të ushtrojnë në mënyrë të menjëhershme kontrollin fizik dhe teknik të secilit stacion fotovoltaik, duke evidentuar të gjitha shkeljet e lejeve dhe licencave për prodhimin e energjisë deri në 2 MẀ, nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, në drejtim të fuqisë së instaluar dhe sasisë së prodhuar e shitur, si dhe evidentimin |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | këto centrale e prodhimit të operatorit ekonomik, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2MẀ, gjithsej në sasinë 23,568,327kŵh, me vlerë **2,356,730 Euro**, përkatësisht nga: Subjekti "S" shpk në shumën 264,486 Euro; R shpk për 247,776 Euro, "A" shpk për 308,653 Euro; "A S" shpk për 213,639 Euro; "SS" shpk për 200,818Euro; "SS" shpk për 222,965 Euro; "S S" shpk për 245,284 Euro; "S ŵ" shpk 175,985 Euro; "L" 202,136 Euro dhe "A S." shpk 274,988 Euro. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar dhe me kushtet kontraktore përcaktuar me kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjekteve PPE. | | | e shkaqeve për lëvrimin e një sasie prodhimi më të madhe se ajo e licencuar.<br>-Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), pas përcaktimit të shkaqeve të përfitimit më tepër, nga secili subjekt i licencuar, pasojë e ndërtimit dhe instalimit të një fuqie prodhuese më të madhe se ajo e lejuar/miratuar e licencuar (2MẀ), të marrë masa të menjëhershme ndaj tyre, duke i propozuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përjashtimin e subjekteve nga lista e Prodhuesve me Përparësi të Energjisë, si dhe aplikimin e sanksioneve ligjore përkatëse, subjekte për të cilët OSHEE GROUP sh.a me shkresën nr. 8410/3, datë 30.05.2023, pas kontrolleve të ushtruara dhe verifikimit në terren të sistemeve të matjes të këtyre centraleve prodhuese, ka saktësuar se nuk ka parregullsi në matjen dhe regjistrimin e energjisë së livruar nga këto centrale fotovoltaike.<br>-Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit për rezultatet e kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të kushteve kontraktore nga subjektet që kanë ndërtuar centrale fotovoltaike dhe masat e marra për zgjidhjen e problematikës. |
| 2 | Nga auditimi konstatohet se, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar lidhur me shpërblimin e punonjësve, ndërkohë që shoqëria rezulton me humbje të konsiderueshme dhe me kapital negativ, kështu: Me vendimin nr. 5, datë 22.02.2021 është miratuar dhënia e një page shpërblim për punonjësit e angazhuar në kuadër të planit të gatishmërisë së shoqërisë OSSH sh.a.<br>-Me vendimin qarkullues nr. 22, datë 29.12.2021 është miratuar dhënia e një shpërblim të veçantë mbi pagë për punonjësit e OSHEE GROUP sh.a, OSSH sh.a, FTL sh.a dhe FSHU sh.a, në masën 20,000 lekë, me propozim të vetë Këshillit Mbikëqyrës, e kjo bazuar në performancën e shoqërisë në një kohë që shoqëria prej disa vitesh radhazi paraqitet me humbje e me kapital negativ.<br>- Për periudhën objekt auditimi konstatohet se, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar, vendimmarrje e cila nuk respekton rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve | Pika 2.1 | E lartë | -Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE GROUP sh.a, në të ardhmen t'i kushtojë vëmendje të shtuar vendimmarrjeve të veçanta me efekte financiare për shoqërinë, referencës së tyre ligjore dhe bazuar në raporte e analiza të hollësishme mbi situatën financiare të shoqërisë<br>-Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa, të rishqyrtojë dhe rishikojë vendimet e marra për ngritjen e strukturave paralele të kontrollit të energjisë (të organizuara si njësi Task-Forcë), të cilësuar si të pabazuara dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe që nuk respektojnë rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë, si dhe ka marrë vendime të cilat nuk gjejnë mbështetje në legjislacionin për shoqëritë tregtare”, konkretisht:<br>**1.** Me vendimin nr. 27, datë 30.09.2022 është miratuar një ndryshim në strukturën organizative të shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, ku në pikë 1, ka zvogëluar numrin e punonjësve në Departamentin e Kontrollit e Rikuperimit të Humbjeve më 83 punonjës dhe në Pikën 2 përcakton: “ Në varësi të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë “OSHEE GROUP sh.a, krijohet Task Forca e Energjisë”.<br>**2.** Me vendimin qarkullues nr. 30, datë 13.10.2022, në Pikën 2 ka miratuar pagat e strukturës së Task Forcës së Energjisë, ... *“brenda kufijve të fondit të miratuar të pagave të shoqërisë OSSH sh.a”*, kjo në kundërshtim dhe me legjislacionin për përcaktimin e pagave dhe VKM nr. 574, datë 03.08.2016 “Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA”. Kjo vendimmarrje mbështetet dhe në Aktin Normativ nr. 14, datë 5.10.2022 “Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin e energjisë elektrike” ku në nenin 3, pika 2 përcaktohet: “Task-Forca e Energjisë” është struktura e posaçme e ngritur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE Group, sh.a”. Ndërsa në Rregulloret e këtaj strukture të miratuar nga Aksionari me nr. 8201, datë 27.10.2022, në nenin 1 përcaktohet se është e pavarur nga OSHEE GROUP sh.a dhe raporton direkt te Këshilli Mbikëqyrës; Në nenin 4, pika 7 dhe nenin 10 pika 10.5 përcaktohet se emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të Task Forcës bëhet nga Administratori i OSSH sh.a me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Task Forcës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, nenet 135 deri 153, nenet 154 deri 165 dhe nenet 166 deri 167; ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 dhe VKM nr. 574, datë 03.08.2016 “Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA”. | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 3 | Nga auditimi konstatohet se, rezultat financiar i shoqërisë OSSH sh.a., për periudhën 2021 shënoi një humbje prej 2,672 milion lekë. Megjithë përmirësimet në drejtim të reduktimit të mëtejshëm të humbjeve, të rritjes së nivelit të arkëtimeve në krahasim me atë të planifikuar, si dhe mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme, rezultati financiar ishte negativ kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë, rrjedhojë e rritjes së çmimit në treg sikurse u parashikua në rishikimin e planit financiar të shoqërisë. Si rrjedhojë e mungesës së furnizimit të plotë të energjisë nga HEC-et private për vitin 2021, OSSH sh.a u furnizua për mbulimin e humbjeve për një sasi prej rreth 215.46 Gwh në tregun e parregulluar. Rritja e çmimit të energjisë në tregun e parregulluar mesatarisht prej rreth 20.75 Lekë/Kwh për nga 8.05 Lekë/Kwh që ishte parashikuar në fillim të vitit, rriti shpenzimet e blerjes së energjisë për OSSH sh.a, duke ulur performancën financiare dhe vendosur në pozitë të vështirë likuiditetet e shoqërisë. Me VKM nr. 584, datë 8.10.2021 "Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike", u vendos që OSSH sh.a të ndërpriste investimet e parashikuara për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, me përjashtim të atyre të domosdoshme për furnizimin me energji të konsumatorëve.<br>Realizimi i të ardhurave nga energjia është pothuajse i barabartë me planifikimin e të ardhurave, e arrin në vlerën prej 26,875 milion lekë. Ulja e humbjeve në rrjet në nivelin e 20.62 % bëri të mundur që të ulen efektet e kostos së blerjes së energjisë së vitit.<br>Shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetim u realizuan në shumën 15.9 miliard lekë, me një rritje prej 1%, për shkak të rritjes së çmimit në tregun e lirë, si dhe të ndryshimit të strukturës së blerjes së energjisë. Të ardhura të tjera rezultuan me një ulje prej 8% , në krahasim me ato të planifikuara pas faturimit të penaliteteve, për mosplotësim të planit të furnizimit me energji elektrike për vitin 2021 sipas kushteve të kontraktimit. Shpenzimet operative për 2021 ishin 14 % më të ulëta se ato të planifikuara, ose 1,653 milion lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan sipas planifikimit, me përjashtim të | Pika 2.5 | E lartë | Strukturat drejtuese të shoqërisë duke analizuar me kujdes situatën debitore të shoqërive, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave, si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | penaliteteve. Humbjet në rrjet në vitin 2021 ishin rreth 20.62 % ose rreth 0.12% më të ulta se ato të planifikuara prej 20.49%. Plani i investimeve për vitin 2021 për rreth 13.4 miliard lekë është realizuar në vlerën 11 miliard lekë, pavarësisht se nga OSSH sh.a prej muajit Tetor me vendim të Qeverisë së Shqipërisë, investimet në rrjet u ndërprenë. | | | |
| 4 | Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e OSHEE GROUP sh.a., nuk ka miratuar pasqyrat financiare të periudhave 2020 dhe 2021, me arsyetimin e mos aprovimit nga refuzimi i dhënies së opinionit nga audituesit ligjorë, duke vendosur ri auditim nga auditues të tjerë për verifikimin e mos përputhjeve të gjetura në refuzimin e opinionit.<br>Me datë 28.06.2021, audituesit ligjor në raportin e tyre janë shprehur për "Refuzim opinioni", bazuar në konstatimet se shoqëria nuk ka finalizuar regjistrin e aseteve si dhe nuk ka marrë titujt e pronësisë për pronat e paluajtshme që ka në përdorim.<br>Më datë 14.04.2022, drejtimi i shoqërisë OSHEE i ka kërkuar Aksionarit të shoqërisë, emërimin e audituesve ligjor për "Auditimin e pasqyrës së veçantë dhe të konsoliduar të lëvizjes së aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë OSHEE Group sh.a.".<br>Më datë 13.05.2022, Aksionari i shoqërisë, me shkresën nr. 3235/1 ka vendosur për caktimin e audituesve ligjor LK, E H, I D dhe V Ç për dhënien e opinionit të auditimit për pasqyrat financiare të konsolidurara për vitin e mbyllur më 31.12.2020, pas regjistrimit të rezultateve të inventarizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale në këto pasqyra, për shoqërinë OSHEE Group sh.a.<br>Vendim-marrja e Asamblesë së Ortakëve për një ri-auditim të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore 2020, pasi të ishin reflektuar *rezultatet e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, rivlerësimi i tyre dhe sistemimi i diferencave* për të mos pasur mbartje në vitin 2021 me refuzim opinioni nuk ka mbështetje në ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009, "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", i ndryshuar si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Nëse refuzimi i ekspertëve të mëparshëm kishte lidhje me inventarizimin dhe | Pika 2.5 | E lartë | Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që, në të ardhmen aprovimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrit rregullator përkatës dhe që kanë si objektiv dhënien e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, e që janë të dobishme për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish, përveç anës formale të jetë i orientuar në pjesën thelbësore të problematikave dhe zgjidhjen e tyre. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale dhe sistemimin e diferencave, nuk kishte arsye për dhënie opinioni përsëri për pjesët e tjera të pasqyrave financiare. Organet drejtuese të shoqërisë të merrnin masa për korrigjimin e situatës dhe diferencat të reflektoheshin në periudhën pasardhëse.<br>Veprimet e Asamblesë së Ortakëve kanë sjellë vonesa jo të justifikuara duke kërkuar auditim sërish për pasqyrat financiare të OSHEE Group sh.a. | | | |
| 5 | OSHEE Group sh.a. nuk ka kryer inventarizimin e plotë të detyrimeve për periudhat 2021 e 2022, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike, si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, si të detyrimeve dhe të drejtave e dokumentacionit mbështetës përkatës. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, "nventari i aktiveve dhe detyrimeve". Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.<br>- Shoqëria OSSH sh.a nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër.<br>-Nga auditimi i kontabilizimeve të aktiveve të blera u konstatua se emërtimet me të cilat regjistrohej në sistemin SIP, sistemi që përdor financa, emërtimi nuk përfshinte markën, shpjegime më të qarta duke e bërë të vështirë identifikimin në periudhat e mëpasshme për inventarizimet periodike. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.<br>Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. | Pika 2.5 | E lartë | Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues, për të ulur riskun e zvogëlimit të aseteve së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre, duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të plotë të detyrimeve për periudhat, vitet 2021 dhe 2022, duke kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës, procedura rakordimi dhe dakordësimi për saldot vjetore, shoqëruar me relacionet përkatëse.<br><br>-Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre. |
| 6 | Shoqëria OSHEE GROUP sh.a nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të iniciuara me | Pika 2.5 | E lartë | Nga drejtimi i shoqërive të merren masa që në të ardhmen, të ndiqet me përgjegjshmëri përfundimi i procesit të kalimit të pronësisë nga Inventari i |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.”. Shoqëria nuk ka zbatuar plotësisht VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.” pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” , i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45. VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 “Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.” pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” , i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45.<br>Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta. | | | pronave të paluajtshme shtetërore, në shoqërinë OSHEE sh.a, ose në tre shoqëritë bija sipas raporteve respektive të ndarjes. |
| 7 | -Gjatë procesit të inventarizimit fizik të vlerave materiale në magazinat e OSSH-së, nga komisionet përkatëse, për periudhën 2021, në relacionin përfundimtar në zbatim të Urdhrit nr. 13037 prot., datë 06.12.2021, u evidentuan artikuj me qarkullim të ngadalshëm në këto magazina, **me vlerë totale në 257,303,138 lekë**, artikuj të bërë hyrje në periudha të mëparshme dhe në ato të fundit.<br>Në relacionin teknik drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për nevojat e shoqërisë për bazë materiale për mirëmbajtje, nga Divizionit të Shpërndarjes, janë hartuar dhe përllogaritur në Planin e Mirëmbajtjes, sasitë vjetore të parashikuara. Nga kjo drejtori nuk janë kryer me saktësi llogaritjet për sasitë e artikujve të kërkuar për buxhetin e viteve 2020, 2021, duke krijuar materiale stok, që përveç se ka impenjuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të | Pika 2.5 | E lartë | Nga administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, strukturat e ngarkuara për planifikimin e bazës materiale për mirëmbajtje, të kryejnë kërkesat e tyre të bazuara në raporte të mirë argumentuara, të specifikuara dhe të detajuara, për shmangien e krijimit të materialeve stok dhe një menaxhim me efektivitet dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | shoqërisë.<br>Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Përllogaritja jo e saktë e sasive të artikujve të kërkuar për tu blerë, sjell riskun e krijimit të materialit stok, që përveç se impenjon fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë.<br><br>-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2021 u konstatua se, shoqëria ka gjendje pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 197,492,859 lekë.<br>Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin, si dhe ka miratuar vlerën e inventarit 108,7843,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar.<br>Shoqëria, deri në përfundim të datës së auditimit, nuk ka iniciuar procedurat për hapjen e ankandit publik veprime që ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë.<br>-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar asetin për vlerën kontabël të mbetur konform kërkesave të Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.<br>Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike", i ndryshuar. Mos kryerja në kohë e ankandit sjell vështirësi logjistike, duke bllokuar hapësira magazinuese si dhe rrit rriskun për dëmtime dhe | | | -Administratori i shoqërisë të marrë masa për vlerësimin e gjendjes aktuale të materialeve skrap, testimin real të tregut, hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve dhe duke proceduar më pas në vijimësi sipas situatës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | zhvlerësime të mëtejshme të vlerës së aktiveve të vendosura për tu shitur. | | | |
| 8 | Situata debitore e OSHEE Group në fund të periudhës 2022 është përkeqësuar në krahasim me vitin 2020, **duke u rritur me 13,997,171 mijë lekë dhe që arrin në një total prej 139,653,687 mijë lekë.** Në strukturën e detyrimeve që ka shoqëria, një pjesë e madhe përbëhet nga detyrimet ndaj Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. për blerje energjie, hua dhe interesa dhe për periudhën 2021-2022, janë rritur në vlerën 4,387,945 mijë lekë, dhe detyrimi total është në vlerën 65,743,270 mijë lekë. Mes shoqërive është rënë dakord për balancën e detyrimeve që OSHEE ka ndaj KESH më datë 31.12.2020, vlera 48,910,915 mijë lekë. Kjo vlerë do të paguhet me këste, duke filluar në vitin 2021 deri në vitin 2046. Detyrimet e OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, hua dhe interesa për periudhën 2021-2022, ku OSHEE i detyrohet OST detyrime në vlerën 15.268,646 mijë lekë deri në 31.12.2022, detyrimet e OSHEE ndaj OST deri në vitin 2022 janë rritur me vlerën 3,557,129 mijë lekë. OSHEE ka lidhur një marrëveshje me OST datë 15.04.2021 për pagesën e detyrimeve të prapambetura. Shoqëria ka rritje të detyrimit për energji elektrike ndaj HEC-eve në vlerën 2,746,462 mijë lekë si dhe ka ulur me 8,961,484 mijë lekë detyrimin për energji elektrike nga importi.<br>Gjatë periudhës 2022 janë rritur huatë afatgjata me 6,026,538 mijë lekë, me pjesën më të madhe në 5,497,318 mijë lekë nga EBRD. Huatë ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) përbëhen nga: - Hua afatgjatë të financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, miratuar me ligjin nr. 170/2014, datë 11.12.2014. Për zbatimin e projektit, Shoqëria dhe MFE kanë nënshkruar marrëveshjen e nënhuasë më 31.12.2014, të ndryshuar më 19.01.2018, me vlerë 69,679 mijë Euro. - Huatë buxhetore nga MFE, detyrimi i përket huasë afatgjatë në vlerën 1.5 miliard lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017 me interes 0.25% për tu ripaguar brenda vitit 2019 dhe huasë afat shkurtër në vlerën 1 miliard lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017 me interes 0.25 % për tu ripaguar | Pika 2.5 | E lartë | Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa në përmirësimin e situatës debitore të shoqërisë duke rritur të ardhurat kryesore, mbledhjen e llogarive të pagueshme nga klientët, uljen e kostove, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit si dhe shtimin e kapitalit të shoqërisë. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | brenda vitit 2018, por që mbetet në detyrimet e shoqërisë.<br>Në periudhën e fundvitit 2021 dhe në 2022, shoqëria ka rritur borxhin afatshkurtër në vlerën 17,060,882 mijë lekë, duke pasur një rritje në 9,579,154 mijë lek në hua afatshkurtra (Owerdrafte) nga bankat e nivelit të dytë.<br>Detyrimet ndaj Tatimeve janë ulur në vlerën 1,151,068 mijë lekë dhe vlera e fund vitit 2022 5,279,056 mijë lekë përbëhet nga detyrimet për tatimin mbi fitimin kur 1,146,452 mijë lekë është principal, 2,805,637 mijë lekë gjoba dhe 1,269,529 mijë lekë janë interesa.<br>Vështirësitë e shkaktuara në sistemin energjetik për arsye klimaterike, mungesa e reshjeve gjatë viteve 2017 dhe 2019 si dhe rritja e pa parashikuar e çmimeve në import në 6-mujorin e dytë të 2021, dhe në vitin 2022, detyroi OSHEE të blinte energji elektrike në tregun e jashtëm me çmime jo të favorshme, duke kërkuar një pjesë e rëndësishme e arkëtimeve të shoqërisë. OSHEE ka hasur vështirësi me likuiditetin gjë që shkaktoi rritjen e detyrimeve për blerjen e materialeve për investimet me kontrata të lidhura në proces. Rritja e detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata shton barrën financiare, duke kufizuar aftësitë e shoqërisë për investime të mëtejshme. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pika 2, neni 12. | | | |
| 9 | Nga auditimi i procedurave të prokurimit është konstatuar se:<br>- Nga auditimi i 11 procedurave të prokurimit "Punë dhe Mallra", në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike me objekt: *1-"Rikonstruksion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore"; 2-" Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III "*, 3- "*Blerja e PDA dhe tablet, si dhe monitorimi i punonjësve", 4- "Fiderat e rinj 20 KV të Nënstacionit Vorë*", *5- "Bazë materiale për nyjet kritike", 6- "Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II", 7- "Ndërtim i disa kabinave te reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabull me vetëpërmbajtje ABC në kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 të N/St Gramsh", 8- "Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III", 9- "Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë -* | Pika 2.6 | E lartë | AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.<br><br>AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s'kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Bilisht", 10- "Rikonstruksion dhe ndërtim kabinash muraturë në Korçë", 11- "Rikonstruksione të rrjetit TM, TU në zonat e përgjegjësisë në agjencinë Bilisht. Rikonstruksion kabinash tip murature në Agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr 6 N/St Bilisht. Rikonstruksion rrjeti TM 10kV fideri 8 ndërtim kabine BOX"*, janë konstatuar se në mënyrë të gabuar nga ana e njësive të prokurimit, jo të gjithë kriteret e pjesëmarrjes janë argumentuar teknikisht në një procesverbal në referim të grafikut, volumeve, natyrës së punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter. Janë konstatuar mangësi në kategori licencash, mangësi në stafin drejtues, mangësi përcaktimin e specialistëve, mangësi në makineri e pajisje, mangësi përcaktimet e kushteve të bashkimit të operatorëve, mangësi në certifikatat dhe standarde, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61. Janë konstatuar shkelje të nenin 46, të LPP. Kriteret kualifikuese nuk kanë nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe nuk është stimuluar pjesëmarrjen e tyre<br>- Nga auditimi i 2(dy) procedurave të prokurimit "Punë dhe Mallra", në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave si më poshtë:<br>Në procedurën e prokurimit me objekt "*Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të N/stacioneve elektrike të shpërndarjes",* dhe në procedurën e prokurimit *"Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacione",* nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimit të ofertave konstatohet se operatori fitues "E", ka disa mangësi në plotësimin e Dokumenteve të tenderit. Kontratat Individuale të Punës, me Ing. Mekanik dhe Ing. Elektronik, nuk janë në përputhje me Kodin e Punës i RSH, neni 21, pika 3. Disa nga Test raportet e lëshuar nga prodhuesit, janë përkthyer nga punonjësja e operatorit fitues e cila nuk është në listën e përkthyesve të njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe vërtetimi i përkthimit është i pavlefshëm.<br>- Në procedurën e prokurimit: "*F.V dhe Instalim të sistemit të Matjes* | | | përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Inteligjente në Kabinat Elektrike të OSSH sh.a, softŵare-t dhe integrimet e tyre në platformën MDMS (Mater data mangement system)"* nuk janë kërkuar kapacitete teknike për realizimin dhe përgatitjen e infrastrukturës për LV Smart Grid (Rrjetin inteligjent në TU) dhe të gjitha modulet për operacionet e saj. Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 01.09.2022 për F.V dhe Instalimin e sistemit të Matjes Inteligjente, në DST dhe relacion teknik pika 2.3.4, nuk është *kërkuar Inxh. Elektronikë, Inxh. Mekatronik apo Inxh. Informatike,* që autoriteti kontraktor të sigurohet për realizimin e sofŵarëve apo Upgradimin i sistemit HES. Në dokumentet e hedhura në tender nuk kërkohet asnjë kontratë me specialist të fushës së programimeve apo kompani për bashkëpunim për mirëmbajtje programesh në lidhje me specifikimet e projektit, sipas nenit 39 "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike" të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Pika 2, Pika 4. dhe *nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*". Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, ku operatori fitues disponon vetëm 26 punonjës kryesisht elektricistë, 4 Inxh elektrik, 1 Inxh elektroenergjitik dhe 1 Inxhinier Ndërtimi. Referuar zërave të ofertës fituese Upgrade i sistemit HES në vlerën 45,000,000 lekë, Training Packege në vlerën 8,500,000 lekë, Test dhe Inspektimi në vlerën 3,350,000 lekë, Komisionim dhe operimi në vlerën 3,350,000 lekë, në total prej 60,200,000 lekë pa TVSH, nga AK OSHEE sh.a, *realizimi i tyre paraqitet me risk bazuar në kapacitetit teknik të OE fitues.*<br>- Në procedurën e prokurimit: "*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht"* është konstatuar pasaktësi në përllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës. Përllogaritja e fondit limit është bërë e përgjithshme për punimet që do të realizohen, por në dokumentet e tenderit preventivi është konceptuar | | | Nga AK, të merren masa që në të ardhmen të bëhen analiza kosto përfitim për kontratat e parashikuara. Projekt zbatimi dhe preventivi i punimeve duhen realizuar para hapjes së procedurës së prokurimit, duke stimuluar konkurrencën e operatorëve ekonomikë. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | me çelësa në dorë. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë *subjekt i aprovimit nga Investitorit*. Investitori ka të drejtën ti kërkoje kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontratës. Ofertuesi duhet të ofroje sasitë në përputhje me formularin e çmimeve. *Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara ne projekt idenë paraprake.* Verifikimi i sasive nga Drejtoria e Tensionit të Lartë do të bëhej gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe janë subjekt i miratimit nga Investitorit. Kontraktori duhet të vendose sasitë e nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. *Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës prej 249,996,339 lekë pa TVSH.* Parashikimi i projektimit për realizim nga kontraktori, si dhe përcaktimi kontratë me çelësa në dorë ndërkohë që projektimi duhet të prokurohej nga autoriteti kontraktor, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 1.b. Në preventivin e punimeve është përfshirë pagesë për realizimin e projektit të zbatimit. Nga ana e Kontraktorit është parashikuar për projektimin vlera 9,650,000 lekë pa TVSH, duke i sjellë efekt negativ shoqërisë. | | | |
| 10 | Nga verifikimi i punimeve të ndërtimi në zbatimin e 13 kontratave ë lidhura me opratorët ekonomikë u konstuan punime të pakryera si dh veprime në kundërshtim me legjislacionin për disiplinimin e punimeve të ndërtimit, duke i shkaktuar shoqërisë një dëm në shumën 9.831.919 lekë. mbi zbatimin e kontratave të ndërtimit janë konstatuar mangësi.<br>Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15, germat b) dhe c) "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*" dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), të nxirren aktet administrative përkatëse | Pika 2.6 | E lartë | Nga Titullari i njësisë publike (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit ***në vlerën 9,831,919 lekë.*** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësish, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit ***në vlerën 9,831,919 lekë .*** | | | |
| 11 | Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2MẆ, miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor (dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a (FTL sh.a) dhe sipas treguesve të programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihen këto centrale e prodhimit të operatorëve ekonomike, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2MẆ, përcaktuar në kushtet kontraktore, gjithsej në sasinë 23,568,327kŵh, me efekte financiare për shoqërinë në shumën 2,356,730 Euro, përkatësisht nga: Subjekti “S” shpk në shumën 264,486 Euro; R shpk për 247,776 Euro, “A” shpk për 308,653 Euro; “A S” shpk për 213,639 Euro; “S S” shpk për 200,818 Euro; “S S” shpk për 222,965 Euro; “S S” shpk për 245,284Euro; “S ŵ” shpk 175,985 Euro; “L” 202,136 Euro dhe “A S” shpk 274,988 Euro. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 822, datë 7.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, i ndryshuar dhe me kushtet kontraktore përcaktuar me kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjekteve PPE. | Pika 2.7 | E lartë | OSHEE GROUP sh.a/FTL sh.a në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për “Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike”, të ndjekin me korrektësi zbatimin e kushteve kontraktore në drejtim të prodhimit të energjisë elektrike jo vetëm nga këto centrale fotovoltaike që aktualisht janë në prodhim, por dhe të tjerë të tillë që do të hyjnë në shfrytëzim në të ardhmen. |
| 12 | Nga auditimi janë konstatuar mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore e nënligjore, në dhënien e shpërblimeve punonjësve, dhënien e shpërblimeve në natyrë, në shpenzime gjyqësore për punonjësit e larguar nga puna, etj, duke i shkaktuar efekte negative buxhetit të | Pikat: 2.1,2.6,2.8 | E lartë | Administratori i shoqërisë të marrë në analizë situatën e krijuar, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masat përkatëse për eliminimin në të ardhmen të situatave të tilla. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | shoqërisë në shumën 1,032,901 mijë lekë. | | | |

## I.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group (OSHEE) sh.a për periudhën 01.07.2020 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti të ligjeve, vendimeve rregullave dhe rregulloreve, udhëzimeve politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, nëpërmjet: a) auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret; b) auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik; c) auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, d) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t'u bërë publike.

**Opinion i kualifikuar mbi përputhshmërinë[1]**

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e subjektit OSHEE GROUP sh.a janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar", e shprehur kjo në bazën për opinion.

**Baza për opinionin e kualifikuar:**

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI 100; ISSAI 400-499; ISSAI 4000-4899).

Auditimi ynë përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit, mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë të ushtruar nga subjekti i audituar. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit, duke marrë në konsideratë vlerësimin e riskut dhe materialitetit për subjektin e audituar. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për dhënien e këtij opinioni.

Nga evidencat e marra për veprimtarinë e OSHEE GROUP sh.a rezultuan:

-Mangësi në vendimmarrjen e Këshillit Mbikëqyrës dhe të strukturave drejtuese të shoqërisë, me efekte negative financiare për shoqërinë, gjithsej në shumën 1,033,051 mijë lekë;

- Mos respektim të detyrime kontraktore në zbatimin punimeve të ndërtimit, duke shkaktuar dëm ekonomik për shoqërinë në shumen 9,832 mijë lekë;

- Mangësi në mbajtjen e evidencës kontable dhe auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, si dhe mangësi në administrimin e aseteve.

1 **Opinion i modifikuar/ kualifikuar** *Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar: kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku,* ***janë materiale por jo të përhapura****.*

**<u>Përgjegjësitë e Drejtuesve të OSHEE GROUP SH.A:</u>**
Strukturat drejtuese të OSHEE GROUP sh.a, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet.

**<u>Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:</u>**
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara ligjore, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 826/1 prot., datë 12.10.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.09.2022 deri më datë 10.03.2023, në subjektin: "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" (OSHEE) sha., për periudhën nga 01.07.2020 deri më 31.12.2022 u krye auditimi "Mbi përputhshmërinë" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. S B, Përgjegjës grupi
2. A T, Auditues
3. B Sh, Auditues
4. A K, Auditues,
5. I B, Audituese,
6. E M, Ekspert.

**1. Titulli:** Raport Auditimi mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të OSHEE GROUP SHA për periudhën e aktivitetit nga data 01.07.2020 deri më 31.12.2022.
Projekt-Raporti i auditimit është i strukturuar në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë të hyrjes janë trajtuar çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj. Në vijim është përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 12 drejtimeve të auditimit. Në kreun e tretë jepet konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit, bazuar në rezultatet e auditimit. Gjetjet dhe rekomandimet të strukturuara sipas llojit të tyre janë vendosur në kreun e katërt. Projekt-Raporti ka kreun e pestë anekse dhe mbyllet me kreun VI-Lista e dokumenteve të auditimit.

**2. Marrësi:** Projekt Raporti i dërgohet Administratorit të subjektit të audituar “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” Group SHA.

**3. Objektivat dhe qëllimi:** Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator.
Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.
Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga ana e subjektit të audituar.
Në funksion të përmbushjes së misionit/angazhimit, objektivat kryesore të veprimtarisë audituese janë:

- Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;
- Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, menaxhimit të riskut dhe proceseve të drejtimit;
- Dhënia e një sigurie të arsyeshme nëse;
- Informacionet e rëndësishme financiare, të drejtimit dhe operacioneve janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;
- Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Asetet janë ruajtur dhe mirë administruar;
- Veprimtaria e shoqërisë është në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara për këtë qëllim;
- Kërkesat nga organet ligjvënëse, agjencitë financuese ose organizatat donatore janë respektuar sipas kushteve të marrëveshjeve të financimit;
- Vlerësim mbi shkallën e zbatimit të legjislacionit dhe rregullave përkatëse të prokurimit publik, si dhe zbatimi i detyrimeve kontraktore;
- Shkalla e realizimit të objektivat kryesore të përcaktuar në programet ekonomike dhe financiare;
- Dhënia e Opinionit dhe rekomandimeve për marrjen e masave për përmirësimin e veprimtarisë së OSHEE.

**4. Identifikimi i çështjes:** Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të OSHEE GROUP sh.a të periudhës 01.07.2020 – 31.12.2022 ka identifikuar sipas

kritereve të specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fuSHAve në vijim:
- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e këshilli mbikëqyrës dhe administratorit;
- Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin si dhe realizimin e programit ekonomiko-financiare;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë në kryerjen e shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave;
- Zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike;
- Zbatimi i dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.
- Organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;
- Organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm të OSHEE GROUP sh.a.

**5. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese :** Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.
Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efiçencë.

**6. Përgjegjësitë e audituesve:** Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara, e shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikes me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e këtij opinioni.
Audituesit e KLSH kanë përgjegjësi në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet etj;
- njëherësh aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kritereve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik);
- promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

**7. Kriteret e vlerësimit**: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit:
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Ligji nr. 8417 datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- Ligji 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike";
- Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar;
- Ligji nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare";
- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar";

- Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar’;
- Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 “Për arkivat”;
- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar;
- Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar”,
- Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar;
- Ligji nr. 8116, datë 29.03.1996 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar”; etj.
- VKM nr.570, datë 3.10.2018 “Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore”;
- VKM Nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”;
- VKM nr. 338, datë 19.3.2008 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar;
- VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit" i ndryshuar;
- VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”;
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar;
- VKM nr. 864, date 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”;
-VKM Nr. 171 “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”;
-VKM Nr. 317, datë 27.04.2016 “Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike”;
- VKM Nr. 449 datë 15.6.2016 “Për miratimin e kushteve dhe të procedurave për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike”; VKM Nr. 5192 datë 13.7.2016 “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”; VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore“ etj.
- Vendime të ERE që ndikojnë veprimtarinë e OSHEE sh.a.
- Udhëzimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”; Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektroniken”, i ndryshuar; Udhëzimi i APP nr. 4, datë 09.01.2018’“Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin me mjete elektronike”; Udhëzimi i APP nr. 2, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës me negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe zhvillimit të saj me mjete elektronike”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar; akti i themelimit; statuti dhe rregullorja e brendshme e shoqërisë etj.
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që kanë rezultuar të nevojshëm gjatë auditimit.

**8. Standardet e auditimit:** Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt

Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:
- Ligjin nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400- Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
- ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";
- ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- ISSAI 1530 (ISA 530)- Objektivi i audituesit është të kryeje procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi;
- Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve IFAC;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë";
- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

**9. Metodat e auditimit:** Metaodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.
Nisur nga veçoritë e subjektit të audituar: shoqëri publike me rëndësi strategjike, kompleksiteti i veprimtarisë kryesore në blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve fundorë; periudha tre vjeçare e aktivitetit; periudha dhe koha e zhvillimit të auditimit, në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdirur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:
a. *Verifikimi i transaksioneve* - duke marrë informacion për një rrethanë ose transaksion nga një burim i caktuar, dhe krahasimin me një informacion të marrë për të njëjtat transaksione, por me origjinë nga një burim tjetër;
b. *Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse;
c. *Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht drejtimeve të auditimit;
d. *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm* - duke marrë informacionet e funksionimit të sistemit së kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar të subjektit;
g. *Modelimet e thjeshta statistikore* – në lidhje me përzgjedhjen sa më përfaqësuese të shembullit për shqyrtim në çështje të caktuara të auditimit;
h. *Verifikimi në sistem dhe në terren*- me përzgjedhje i çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;
g. *Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.
Audituesit e KLSH janë përpjekur në çdo rast në përzgjedhjen e arsyeshme dhe të mjaftueshme të metodave dhe teknikave veçmas dhe/ose të kombinuara, si dhe shtrirjen e tyre për të dhënë siguri të arsyeshme në arritjen e konkluzioneve të auditimit.

**10. Dokumentimi i auditimit:** Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion dhe intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e OSHEE SHA, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin

e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e Projekt-Raportit dhe të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

## III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

"Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group" (OSHEE) sh.a është një nga tre shoqëritë publike të sistemit energjetik, e regjistruar 100% në pronësi të shtetit shqiptar, me autoritet publik përfaqësimi Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, sipas VKM nr. 317, datë 27.04.2016 "Për përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive të sektorit të energjisë elektrike".

OSHEE GROUP SHA është person juridik që funksionon si shoqëri aksionare, në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, si dhe vepron sipas ligjeve specifike të fushës si: ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ligjit nr. 124/2015 "Për efiçencën e energjisë", etj.

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike, me Vendimin nr. 96 dhe 97 datë 27.10.2014 ka licencuar OSHEE sh.a për ushtrimin e aktivitetit të shpërndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë.

Objekti kryesor i aktivitetit të Shoqërisë është të ofrojë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes për fushat e mëposhtme:

**a.** Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, me tarifa të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar;

**b.** Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejtë të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

-ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve;

-lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike; dhe

-instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike.

**c.** Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar në ndryshimet rajonale apo territoriale të kërkesës;

d. Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), nenit 72 të ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, të Urdhërit të Asamblesë së Përgjithshme/ Ministrisë e Industrisë dhe Energjisë Nr. 157 Prot, datë 12.02.2018, "Mbi krijimin e tre shoqërive të kontrolluara nga OSHEE Sh.A", të Statutit të "OSHEE", shoqëria "OSHEE", në cilësinë e Aksionarit themelues, shoqërisë mëmë, ka themeluar tri shoqëritë e reja aksionare të kontrolluara, me një nivel administrimi, si më poshtë vijon:

-**"Furnizuesi i Shërbimit Universal" Sh.A**, **(FSHU),** me objekt aktiviteti në: furnizimin me energji elektrike të klientevë fundorë që veprojnë në treg të rregulluar të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, ofrimin dhe sigurimin e cilësisë tregtare të shërbimit, etj.
-**"Furnizuesi i Tregut të Lirë" Sh.A**, **(FTL),** me objekt aktiviteti në blerjen dhe menaxhimin e energjisë dhe operimin në tregun e lirë, etj.
-**"Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A**, **(OSSH),** me objekt aktiviteti shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj.
Organet drejtuese të OSHEE GROUP sh.a janë Asambleja e Përgjithshme, Këshilli Mbikëqyrës, dhe Administratori, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre organeve (sistemi me dy nivele).
Ndërsa drejtimi i tre shoqërive të kontrolluara nga OSHEE sh.a është i organizuar me një nivel: Këshilli Drejtues dhe Administratori, si dhe Asambleja e Përgjithshme që në këtë rast është Administratori i OSHEE GROUP sha (shoqëria mëmë).

**2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:**

**2.1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e organeve drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.**

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni:
-Vendimmarja e Këshillit Mbikëqyrës
-Relacionet e administratorit paraqitur në Këshillin Mbikëqyrës;
-Procesverbalet e mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës;
- Vendimmarrjet apo urdhërat e nxjerra nga Administratori;
-Dokumentacion mbështetës për veprimtarinë e Administratorit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua:

**I. Mbi veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës:**

Emërimi i këshillit mbikëqyrës, është kryer në referencë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 155, pika 2 e cila përcakton midis të tjerave se afati i emërimit është ai i përcaktuar në statut, por që nuk mund të jetë më i gjatë se 3 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.
Numri i anëtarëve të këshillit mbikëqyrës është 6, në përputhje me kërkesat e pikës 1, shkronja "b" të VKM nr.570, datë 3.10.2018 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore".
Këshilli mbikëqyrës ka zbatuar kërkesat e VKM nr. 570, datë 3.10.2018 duke u mbledhur jo më pak se katër herë në vit, si dhe ka raportuar vazhdimisht për veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë, institucionit administrativ të linjës dhe përfaqësuesit të pronarit, për pronën shtetërore, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
Gjatë veprimtarisë së tij në periudhën e auditimit, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë 114 vendime, nga të cilët 39 qarkulluese. Këto vendime janë marrë në bazë të relacioneve përkatëse të përgatitura dhe të dërguara nga OSHEE GROUP sha dhe në disa raste dhe të inicuara nga vetë Këshilli Mbikëqyrës. Vendimmarrja është e lidhur me aktivitetin e shoqërisë, lidhje marrëveshje me këste për detyrimet e prapambetura të klientëve familjarë dhe jo familjarë, për rialokim fondesh, miratim të strukturave organizative të OSHEE GROUP sha dhe të shoqërive bija, miratim plane strategjike e vjetore të AB e raporte vjetore të drejtorisë së auditimit, dhënie shpërblimi të veçantë mbi pagën në fund të vitit për punonjësit, mbulim shpenzimesh për punonjës të aksidentuar, hapje limit

overdraft, miratimin e projekt-programit të zhvillimit ekonomik, apo të rishikimit të tij, miratim lidhje marrëveshje overdrafti, miratim të ndarjes së aktiveve të OSHEE nëpërmjet transferimit në tre shoqëritë e reja të krijuara; miratim të rezultateve të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale e jo materiale dhe sistemimi i diferencave; miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2020, etj. Vendim-marrja e mësipërme është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 154, pikat 1, shkronjat "b" deri në "g" dhe 2 të këtij neni.
Vendimmarrja e Këshillit Mbikëqyrës është miratuar rast pas rasti nga Asambleja e Përgjthshme e Aksionarit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenin 135.

**II.** Gjatë periudhës së auditimit 01.07.2020 deri më 31.12.2022, administrator i shoqërisë është riemëruar z. A. Ç., me vendimin qarkullues të këshillit mbikëqyrës nr.12, datë 19.06.2020 pas plotësimit të afatit 3 vjeçar. Emërimet e kryera nga këshilli mbikëqyrës janë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 154, pika 1 germa "f", si dhe të Statutit të shoqërisë, neni 16, pika 16.3, germa "j".
Administratori i shoqërisë e ka zhvilluar veprimtarinë e tij në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 158, pika 3, me të drejtën dhe detyrimin të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë; kujdesjen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; kryerjen e regjistrimet e publikimeve të detyrueshme të të dhënave të shoqërisë etj., si dhe në bazë të statutit të shoqërisë, neni 20 - Kompetencat e administratorit, lidhur me administrimin e shoqërisë duke zbatuar politikat e saj, përfaqësimin me palët e treta, përgatitjen e pasqyrave financiare dhe raportin e performancës, krijimin e një sistemi monitorimi, raportimin në këshillin mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit, etj.
Në veprimtarinë e tij Administratori ka nxjerrë një numër të konsiderueshëm të urdhrave të ndryshëm në procedurat e prokurimit si: për ngritjen e komisioneve për përcaktimin e fondit limit dhe të specifikimeve, fillimin e procedurave të prokurimit, njësitë e prokurimit, komisionet e vlerësimit të ofertave, miratimin e raporteve në procedurat e prokurimit, krijim komisionit të blerjes me vlerë të vogël, caktimin e administratorit të kontratave të shërbimit përmbarimor, për caktim kolaudatori, etj.; urdhra të brendshëm për ngritjen e grupeve të posaçme të punës, për kryerjen e veprimeve të ndryshme, procedurat e përzgjedhjes dhe të emërimit të drejtuesve të Drejtorive Rajonale, për dorëzim objekti të marrë me qira, autorizime të ndryshme për çështje të prokurimeve, miratim i raporteve të ndryshme, për miratimin e anëtarëve dhe sekretariatit të këshillit teknik, ngritje komision inventarizimi, trajtimit të ankesave të qytetarëve, për administrimin e riskut në OSHEE, zbatimin e masave te rekomanduara nga auditi i brendshëm, zbatimin e masave anticovid, miratim të vendimmarrjeve të Këshillave Drejtuese të tre shoqërive të kontrolluara prej OSHEE sh.a, etj.
Grupit të auditimit të KLSH i janë vënë në dispozicion 84 dokumente të nxjerra nga administratori që kanë të bëjnë me urdhra të brendshëm, autorizime dhe për çështje të tjera, krahas dokumentacionit të shqyrtuar në procedurat e prokurimit, emërime apo lirime nga detyra, si dhe në relacionet dhe raportet e përgatitura për këshillin mbikëqyrës.
Ngritja e grupeve të punës për çështje të ndryshme është shoqëruara dhe me raportet përkatëse të veprimtarisë së tyre, si dhe relacione për zbatimin e urdhrave dhe të vendimeve të këshillit mbikëqyrës.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar lidhur me shpërblimin e punonjësve, ndërkohë që shoqëria rezulton me humbje të konsiderueshme dhe me kapital negativ. |
| **Situata 1:** | Nga auditimi konstatohet se nga Këshilli Mbikëqyrës: Me vendimin nr. 5, datë 22.02.2021 është miratuar dhënia e një page shpërblim për punonjësit e angazhuar në kuadër të planit të gadishmërisë së shoqërisë OSSH sh.a.<br>-Me vendimin qarkullues nr. 22, datë 29.12.2021 është miratuar dhënia e një shpërblim të veçantë mbi pagë për punonjësit e OSHEE GROUP sh.a, OSSH sh.a, FTL sh.a dhe FSHU sh.a , në masën 20,000 lekë, me propozim të vetë Këshillit Mbikëqyrës, e kjo bazuar në përformancën e shoqërisë në një kohë që shoqëria prej disa vitesh radhazi paraqitet me humbje e me kapital negativ. Dhënia e këtij shpërblimi, pavarësisht së është miratuar dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6 "Kompetencat e organeve kolegjiale", Pika 2 ku përcaktohet se: *"Për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje, ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton, me akte të veçanta, nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve të tyre"*. |
| **Kriteri:** | - Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6, Pika 2. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Rritje të shpenzimeve nga akordimi i shpërblimeve ndaj punonjësve. |
| **Shkaku:** | Vendimmarrje e Këshillit mbikëqyrës jo në përputhje me legjislacionin. |
| **Rëndësia:** | I lartë. |
| **Rekomandime:** | Këshilli mbikëqyrës, në të ardhmen t'i kushtojë vëmendje të veçantë vendim-marrjeve të veçanta me efekte financiare për shoqërinë, referencës së tyre ligjore dhe bazuar në raporte e analiza të hollësishme mbi situatën financiare të shoqërisë. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Këshilli mbikëqyrës ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar vendimmarrje e cila nuk respekton rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë. |
| **Situata 2:** | Këshilli Mbikëqyrës dhe Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve ka marrë vendime të cilat nuk gjejnë mbështetje në ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenet 135 deri 153, nenet 154 deri 165 dhe nenet 166 deri 167, konkretisht:<br>1. Me vendimin nr. 27, datë 30.09.2022 është miratuar një ndryshim në strukturën organizative të shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, ku në pikë 1, ka zvogëluar numrin e punonjësve në Departamentin e Kontrollit e Rikuperimit të Humbjeve më 83 punonjës dhe në Pikën 2 përcakton: " Në varësi të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "OSHEE GROUP sh.a, krijohet Task Forca e Energjisë".<br>Ky vendim është në vijim të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 6859, datë 14.09.2022, i cili ka miratuar një ndryshim në |

| | |
|---|---|
| | Statutin e shoqërisë, nenin 13.2, duke shtuar një pikë më përmbajtjen: " Me qëllim mbarëvajtjen dhe arritjen e objektivave të shoqërisë, të ketë në varësi të drejtpërdrejtë dhe në drejtimin e saj struktura të caktuara të shoqërisë OSHEE GROUP sh.a.".<br>2. Me vendimin qarkullues nr. 30, datë 13.10.2022, në Pikën 2 ka miratuar pagat e strukturës së Task Forcës së Energjisë, ... *"brenda kufinjve të fondit të miratuar të pagave të shoqërisë OSSH sh.a"*, kjo në kundërshim dhe me legjislacionin për përcaktimin e pagave dhe VKM nr.574, datë 03.08.2016 "Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA".<br>Kjo vendimarrje mbështetet dhe në Aktin Normativ nr. 14, datë 5.10.2022 "Për marrjen e masave të vecanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin e energjisë elektrike" ku në nenin 3, pika 2 përcaktohet: "Task-Forca e Energjisë" është struktura e posaçme e ngritur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE Group, sh.a". Ndërsa në Rregulloret e këtaj strukture të miratuar nga Aksionari me nr. 8201, datë 27.10.2022, në nenin 1 përcaktohet se është e pavarur nga OSHEE GROUP sh.a dhe raporton direkt te Këshilli Mbikëqyrës; Në nenin 4 , pika 7 dhe nenin 10 pika 10.5 pëcaktohet se emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të Task Forcës bëhet nga Administratori i OSSH sh.a me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Task Forcës.<br>*Nga sa më lart konstatojmë se kjo vendimmarrje nuk respekton rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë.* |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenet 135 deri 153, nenet 154 deei 165 dhe nenet 166 deri 167;<br>- Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6;<br>- VKM nr. 574, datë 03.08.2016 "Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA". |
| **Ndikimi/Efekti**: | Krijimi i strukturave të veçanta organizative duke krijuar paralelizëm me strukturat ekzistuese dhe pa mbështetje ligjore e nënligjore. |
| **Shkaku:** | Mangësi në ushtrimin e kompetencave në veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës. |
| **Rëndësia:** | I Lartë. |
| **Rekomandime:** | Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa, të rishqyrtojë dhe rishikoje vendimet e marra të cilësuar jo në përputhje me legjislacionin dhe që nuk respektojnë rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Marrja e vendimeve qarkulluese, pa u diskutuar dhe votuar, për çështje me rëndësi jetike për ecurinë e OSHE SHA. |
| **Situata 3:** | Nga auditimi është konstatua edhe se: Gjatë veprimtarisë së tij në periudhë gjashtëmujori i dytë 2020 – 31.12.2022, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë 39 |

| | |
|---|---|
| | vendime qarkulluese ose 34 % e nivelit të vendim-marrjes, për çështje me rëndësi jetike për veprimtarinë e OSHEE, si ato miratim të rinovimit të limitit të linjës së kredisë- 2020; për miratim të ndryshimeve të investime në planin e konsoliduar financiar 2021; për miratimin e kredive të reja, owerdraft-2021-2022; ndryshime në strukturat organizative të shoqërive, apo të emërimit të administratorëve, etj., pa u diskutuar, shqyrtuar, analizuar dhe votuar në mbledhje nga ana e këshillit mbikëqyrës. Një veprimtari e tillë është në kundërshtim me VKM nr.570, datë 3.10.2018 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore", pika 9 pasi Këshilli Mbikëqyrës e zhvillon veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve dhe jo me vendime qarkulluese pa u mbledhur.<br>Për më tepër, referuar Statutit të shoqërisë, në nenin 18 është përcaktuar procesi vendim-marrës i këshillit mbikëqyrës, me vendin e zhvillimit të mbledhjeve, mënyrën e thirrjes me çështjet kryesore të rendit te ditës, si dhe procesverbalet e mbledhjeve.<br>Gjithashtu, marrja e vendimeve qarkulluese e këshillit mbikëqyrës pa u mbledhur, është në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", i cili përcakton: *Organi kolegjial merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes,...*si dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës (neni 14, pika 1). |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", neni 8;<br>-VKMnr.570, datë 3.10.2018 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore", pika 9.<br>- Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 154, pika 1, germa "dh";<br>- Ligji nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 23, pika 1;<br>- Statuti i shoqërisë, neni 18. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mangësi me efekt në ecurinë e konsoliduar të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të OSHEE GROUP SHA. |
| **Shkaku:** | Mungesë vëmendjeje të shtuar nga këshilli mbikëqyrës lidhur me çështje ekonomike dhe financiare të një rëndësie të veçantë për ecurinë e OSHEE SHA, si dhe në zbatimin tërësor të detyrave të tij. |
| **Rëndësia:** | I Lartë. |
| **Rekomandime:** | Këshilli mbikëqyrës të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim që të konsolidohet ecuria e shoqërisë. |

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Këshilli Mbikëqyrës***

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 8410/3 Prot., datë 30.05.2023, "Observacione mbi Projekt Raportin" ardhur në KLSH me shkresë nr. 826/7, datë 31.05.2023, nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës z. I. B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***Pretendimet e subjektit:***

*Subjekti ka paraqitur objeksione lidhur me marrjen e 39 vendimeve qarkulluese, ose 34% e totalit te vendimeve të marra për periudhën objekt auditimi dhe bazën ligjore në të cilën është bazuar vendim-marrja e këshillit mbikëqyrës, duke theksuar midis të tjerave se, në asnjë nga dispozitat ligjore e nënlidgjore të cituara nuk shprehen dhe nuk parashikon asnjë kufizim për vendimmarrjet nëpërmjet vendimeve qarkulluese. Lidhur me shpërblimet e dhëna punonjësve të shoqërisë OSSH sh.a, subjekti argumenton se ato janë dhënë në kushtet e një situate ekstreme moti, ku punonjësit ishin në gadishmëri 24 në 24 dhe se shpërblimi për të gjithë punonjësit e OSHEE GROUP sh.a është dhënë në bazë të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës dhe i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme brenda tagrave ligjore dhe bazuar në përformancën e shoqërisë. Subjekti ka paraqitur sqarime lidhur me vendimmarrjen për krijimin dhe funksionimin e Task Forcës së Energjisë, duke argumentuar me kushtet e situatës së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, si dhe faktin që Qeveria ka miratuar Aktin Normativ nr. 14, datë 05.10.2022. dhe se në kushtet e emergjencës kërkohen masa të veçanta.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Grupi i auditimit të KLSH, konstaton se shpjegimet e subjektit janë të njëjta me ato të sjella me shkresën nr.5842/38 prot., datë 20.03.2023, ardhur në KLSH me datë 23.03.2023 dhe nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

**2.2. Hartimi, shqyrtimi dhe miratimi i programit ekonomiko-financiare në organet drejtuese të shoqërisë dhe në institucionet eprore, si dhe realizimi i tij.**

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i dërguar për mbledhjen e të dhënave.
Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e programeve ekonomikë.
Dokumente të tjera.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

**Për shoqërinë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), janë marrë këto vendime lidhur me programin financiar të shoqërisë.**

Periudha 2021

-Vendimi Nr. 23, datë 28.12.2020 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., “Për miratimin e programit financiar të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SH.A., për vitin 2021”, është miratuar me Vendimin Nr. 25, datë 28.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “OSSH” Sh.A., “Për miratimin e programit financiar të shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes SH.A., për vitin 2021”.

-Vendimi Nr. 6, datë 01.03.2021 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., “Mbi disa ndryshime në planin e investimeve të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A., për vitin 2021”, miratuar me Vendimin Nr. 6, datë 01.03.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “OSSH” Sh.A., “Mbi disa ndryshime në planin e investimeve të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A., për vitin 2021”.

-Vendimi Nr. 10, datë 15.06.2021 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., “Mbi disa ndryshime në programin financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A., për vitin 2021” SH.A, miratuar me Vendimin Nr. 10, datë 16.06.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “OSSH” Sh.A., “Mbi disa ndryshime në

programin financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A., për vitin 2021”.
-Vendimi Nr. 12, datë 26.08.2021 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., “Mbi disa ndryshime në programin financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A., për vitin 2021”, miratuar me Vendimin Nr. 12, datë 27.08.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “OSSH” Sh.A., “Mbi disa ndryshime në programin financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A, për vitin 2021”.
Periudha 2022
-Vendimi Nr. 2, datë 28.02.2022 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., “Mbi planifikimin financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A., për vitin 2022”, miratuar me Vendimin Nr. 2, datë 28.02.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “OSSH” Sh.A., “Mbi planifikimin financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” SH.A., për vitin 2022”.
-Vendimi Nr. 8, datë 24.06.2022 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., “Mbi miratimin e rishikimit të programit financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për vitin 2022”, miratuar me Vendimin Nr. 8, datë 24.06.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “OSSH” Sh.A., “Mbi miratimin e rishikimit të programit financiar të shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a., për vitin 2022”,
-Vendimi Nr. 12, datë 13.10.2022 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” Sh.A., “*Mbi rishikimin e programit financiar te Shoqërisë OSSH sh.a., për vitin 2022*”, miratuar me Vendimin Nr. 11, datë 13.10.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “OSSH” Sh.A., “*Mbi rishikimin e programit financiar te Shoqerise OSSH sh.a., per vitin 2022*”;

**Për shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë, janë marrë këto vendime lidhur me programin financiar të shoqërisë.**
Periudha 2021
-Vendimi Nr. 24, datë 28.12.2020 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., për vitin 2021”, miratuar me Vendimin Nr. 27, datë 28.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., për vitin 2021.”.
-Vendimi Nr. 5, datë 09.06.2021 të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., “Mbi disa ndryshime në programin financiar të shoqërisë FTL SH.A. për vitin 2021”, miratuar me Vendimin Nr. 5, datë 11.06.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., “Mbi disa ndryshime në programin financiar të shoqërisë FTL SH.A. për vitin 2021”,
-Vendimi Nr. 13, datë 03.12.2021 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. “Mbi miratimin e programit financiar të rishikuar të shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A., për vitin 2021.” miratuar me Vendimin Nr. 13, datë 06.12.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., “Mbi miratimin e programit financiar të rishikuar të shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A., për vitin 2021.
Periudha 2022
-Vendimi Nr. 1, datë 04.02.2022 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. për vitin 2022” miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 07.02.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A., “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. për vitin 2022”.

-Vendimi Nr. 6, datë 16.06.2022 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A., "Për miratimin e programit financiar të rishikuar për vitin 2022 të shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A." miratuar me Vendimin Nr. 6, datë 21.06.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A., "Për miratimin e programit financiar të rishikuar për vitin 2022 të shoqërisë Furnizuesi i Tregut të Lirë SH.A."

**Për shoqërinë Furnizuesi i Shërbimit Universal, janë marrë këto vendime lidhur me programin financiar të shoqërisë.**

Periudha 2021

-Vendimi Nr. 23, datë 28.12.2020 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., "Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A., për vitin 2021." miratuar me Vendimin Nr. 26, datë 28.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A. "Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A., për vitin 2021".

-Vendimi Nr. 7, datë 09.06.2021 të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., 2021 "Mbi disa ndryshime në programin financiar të shoqërisë FSHU SH.A. për vitin 2021" miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 11.06.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A. 2021 "Mbi disa ndryshime në programin financiar të shoqërisë FSHU SH.A. për vitin 2021".

-Vendimi Nr. 17, datë 03.12.2021 të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., 2021 2021 "Mbi miratimin e programit financiar të rishikuar të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., për vitin 2021" miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 06.12.2021 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A. "Mbi miratimin e programit financiar të rishikuar të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., për vitin 2021".

Periudha 2022

-Vendimi Nr. 1, datë 04.02.2022 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., "Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A., për vitin 2022" miratuar me Vendimin Nr. 1, datë 07.02.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., "Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A., për vitin 2022.

-Vendimi Nr. 7, datë 16.06.2022 i Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., "Mbi miratimin e programit financiar të rishikuar për vitin 2022 të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A." miratuar me Vendimin Nr. 7, datë 23.06.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SH.A., "Mbi miratimin e programit financiar të rishikuar për vitin 2022 të shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal SH.A".

**Për Grupin Financiar, Operatori i Shërbimit të Energjisë Elektrike, janë marrë këto vendime lidhur me programin financiar të shoqërisë.**

Periudha 2021.

-Vendimi Nr. 42 dt. 30.12.2020, "Mbi miratimin e Planit Financiar te Oshee Group sh.a. per vitin 2021, të Këshillit Mbikëqyrës, miratuar me Vendimin Nr. 9239/1 dt. 05.01.2021, të Asamblesë së Përgjithshme.

-Vendimi Qarkullues nr. 6 dt. 02.03.21, të Këshillit Mbikëqyrës, "Mbi miratimin e ndryshimeve në Planin e konsoliduar financiar për zërin investime të OSHEE Group për vitin 2021, miratuar

me Vendimin nr. 2249/1, dt. 02.03.2021, të Asamblesë së Përgjithshme.
-Vendimi Nr. 8 dt. 24.06.21, të Këshillit Mbikëqyrës, "Mbi Miratimin e disa ndryshimeve në Planin e konsoliduar financiar të OSHEE Group për vitin 2021, miratuar me Vendimin Nr. 5279/1 dt. 15.07.2021, të Asamblesë së Përgjithshme.
-Vendimi e Këshillit Mbikëqyrës Nr. 11 dt. 01.09.2021 "Mbi miratimin e disa ndryshimeve në Planin Financiar të Shoqërisë Oshee Group për vitin 2021", miratuar me Vendimin Nr. 6558/1 dt. 04.10.2021, të Asamblesë së Përgjithshme.

Periudha 2022.
-Vendimi Nr. 2, datë 07.03.2022 të Këshillit Mbikëqyrës, "Mbi miratimin e planit të konsoliduar financiar të shoqërisë OSHEE Group Sh.A për vitin 2022", miratuar me Vendimin Nr. 2289/5 date 08.07.2022, të Asamblesë së Përgjithshme.
-Vendimi Nr. 17, datë 29.06.2022, të Këshillit Mbikëqyrës "Mbi miratimin e rishikimit të Programit Financiar të OSHEE GROUP të konsoliduar për vitin 2022", miratuar me Vendimin Nr. 5275/3 dt. 01.08.2022, të Asamblesë së Përgjithshme.

| **Titulli i Gjetjes** | Vonesa në miratimin e programeve financiare. |
|---|---|
| **Situata 1:** | -Në lidhje me afatet e aprovimeve konstatohet se miratimi final i programeve financiare nga Asambleja e Ortakëve bëhet me vonesë, pra pasi ka filluar viti ushtrimor, si dhe shoqërohet me ndryshime të mëtejshme përgjatë vitit. |
| **Kriteri:** | Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 13, të Statutit të Shoqërisë OSHEE, miratuar me Vendimin nr. 7551/1, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, datë 01.12.2020, ku përcaktohet se: *Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtme të shoqërisë: b. Miratimin e strategjisë dhe planeve financiare të shoqërisë, si dhe të çdo ndryshimi të tyre., nenin 16, pika c, ku citohet: "Këshilli Mbikëqyrës është kompetent të miratojë programin financiar vjetor dhe atë të konsoliduar të shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe e paraqet për miratim në Asamblenë e Përgjithshme"* dhe nenin 20, pika 7, *Administratori raporton pranë Këshillit Mbikëqyrës në lidhje me zbatimin e politikave të biznesit.* |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos hartimi në kohë nga administratorët, dhe aprovimet nga Këshillat Mbikëqyrës si dhe Asambleja e Ortakëve, vështirëson zhvillimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë, mos arritjen e objektivave të vendosura, realizimin e investimeve strategjike. |
| **Shkaku:** | Vlerësimi jo i duhur i dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Drejtimi i shoqërisë të marrë masa për hartimin dhe aprovimet para vitit ushtrimor të programit financiar, si një mjet për arritjen e objektivave të vendosura, si dhe ndjekjen efektive të tyre. |

| **Titulli i Gjetjes** | Mos miratimi i Planit të Investimeve në ERE |
|---|---|
| **Situata 2:** | -Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nuk ka dërguar për miratim në Entin Rregullator të Energjisë planet e investimeve kryen shoqëria, për periudhat 2021 dhe 2022. |

| | |
|---|---|
| **Kriteri:** | Ky veprim është në kundërshtim me nenet 20 germa "e"; 60 pika 9 dhe 75 pika 8 të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", dhe Rregulloren "Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", të miratuar nga ERRE me Vendimin nr. 135, datë 06.09.2017. Neni 7, ku citohet: "*Përgjegjësitë e operatorëve 1. OST dhe OSSH duhet të përgatisin planet e investimeve sipas periudhave të rregullimit dhe për çdo vit pasardhës në përputhje me Ligjin. ERE do të pranojë shtesa të planit të investimeve që janë paraqitur deri në gjashtë muaj pas paraqitjes së aplikimit të planit të investimeve, në mënyrë që të zvogëlojë barrën mbi OST dhe OSSH. Planet e investimeve do të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili do të përfshijë edhe paraqitjen tabelore dhe grafike të të dhënave referuese dhe një plan kohor zbatimi. 2. Operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë elektrike do të paraqesin në ERE raportin vjetor të zbatimit të planeve të investimeve të vitit paraardhës duke treguar ecurinë e investimeve të planifikuara dhe duke siguruar shpjegim për çdo përfundimit të periudhës në të cilën zbatohet plani i investimeve.*" |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos paraqitja në kohë e planeve ndikon në vlerësimin dhe analizën e kritereve të aplikueshme dhe miratimin e tyre (ose rishikimin) nga ERE, për të siguruar që planet e investimit të jenë në përputhje me parimet e planifikimit me kosto më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit si dhe kërkesat e ENTSO-E lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit. |
| **Shkaku:** | Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Nga drejtimi i OSSH sh.a., të merren masa për të paraqitur në afatet e kërkuara planet e investimeve në ERRE, për të bërë të mundur analizën e kritereve të aplikueshme dhe për të siguruar që planet e investimeve janë në përputhje me parimet e planifikimit dhe kosto sa më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit si dhe kërkesat e ENTSO-E lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit. |

Për sa më sipër mban përgjegjësi ish administratori i OSSH-së, P L.
Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 826/7, datë 31.05.2023 në KLSH dhe me shkresë nr. 8410/3 Prot. datë 30.05.2023, "Observacione mbi Projekt Raportin", nga ish administratori i OSSH sh.a., z. P L, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**<u>Pretendimi i subjektit:</u>**

*...Në kushtet kur:*
*1. Këshilli i Ministrave nxori VKM me Nr. 243, date 24.3.2020 duke vendosur "Për shpalljen e gjendjes se fatkeqësisë natyrore ne te gjithë Republikën e Shqipërisë për shkak te epidemisë se shkaktuar nga COVID-19.*

| |
|---|
| *ERE me shkresën Nr 604 Prot Tirane. me: 30.03.2020 me subjekt Lidhur me mbarëvajtjen e punës dhe përpilimin e zbatimin e planit te masave ne përputhje me shpalljen e fatkeqësisë natyrore te Covid 19 me te sajën e sipërcituar shprehej qe:*<br>*• Ne kuptim te Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" aktivitetet e prodhimit, transmetimit. shpërndarjes, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike ushtrohen si aktivitete të licencuara nga ana e ERE-s.*<br>*• Për funksionimin e sigurt dhe cilësor të shërbimit të furnizimit te energjisë elektrike, në përputhje me detyrimet e shërbimit publik, kërkohet që operatoret e rrjetit dhe shoqëritë e licencuara te zhvillojnë planet e masave për vazhdimësinë dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, për të garantuar vazhdimësinë dhe sigurinë e furnizimit.*<br>*iii. Kodi i shpërndarjes pika 1.7 Periudhat e emergjencave shprehet qe Kodi i Shpërndarjes ose pjesë të veçanta të tij, dot e trajtohen si përkohësisht të pezulluara për aq kohë sa zgjat emergjenca.*<br>*IV. VKM 584 dt 08.10.2021 në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "10", të pikës I, te nenit 90, te ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" shpall "Gjendjen e emergjencës ne furnizimin me energji elektrike".*<br>*Shoqëritë "KESH" sh.a., "OST" sh.a. dhe "OSHEE Group" sh.a., të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Këto shoqëri të koordinojnë ushtrimin e aktivitetit, në përputhje me udhëzimet e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë me qëllim garantimin e pandërprerë të energjisë elektrike.*<br>*v. VKM Nr. 256, date 29.4.2022 ku gjendja e emergjencës ne furnizimin me energji elektrike i shtrin efektet deri me 31 dhjetor 2022.".*<br>*( https://www.ere.gov.al/sg/legjislacioni/akte-te-tjera)*<br>*vi. VKM nr 650, date 10.10.2022 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 584, date 8.10.2021, të Këshillit te Ministrave, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës ne furnizimin me energji elektrike", është vendosur shtyrja e gjendjes se emergjencës se furnizimit me energji elektrike deri me 30 qershor 2023.*<br>*z. L. ka shtuar dhe pjesë të Raportit vjetor të ERRE 2022 lidhur me veprimtarinë e OSSH.* |

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**
Observacioni merret pjesërisht në konsideratë për sa në lidhje me pretendimet e subjektit për situatën emergjente që ka filluar me Covid 19, në periudhën 2020 dhe me rritjen e çmimeve të energjisë elektrike në fund të vitit 2021.

| **Titulli i Gjetjes** | Rezultate financiare me humbje në OSSH dhe FSHU |
|---|---|
| **Situata 3:** | -Rezultat financiar i shoqërisë OSSH sh.a., për periudhën 2021 shënoi një humbje prej 2,672 milion lekë. Megjithë përmirësimet në drejtim të reduktimit të mëtejshëm të humbjeve, të rritjes së nivelit të arkëtimeve në krahasim me atë të planifikuar si dhe mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme, rezultati financiar ishte negativ kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë rrjedhojë e rritjes së çmimit në treg sikurse u parashikua në rishikimin e planit financiar të shoqërisë. Si rrjedhojë e mungesës së furnizimit të plotë të energjisë nga HEC-et private për vitin 2021 OSSH u furnizua për mbulimin e humbjeve për një sasi prej rreth 215.46 Gwh në tregun e parregulluar. Rritja e çmimit të energjisë në tregun e parregulluar mesatarisht prej rreth 20.75 Lekë/Kwh për nga 8.05 |

| | |
|---|---|
| | Lekë/Kwh që ishte parashikuar në fillim të vitit rriti shpenzimet e blerjes së energjisë për OSSH duke ulur performancën financiare dhe vendosur në pozitë të vështirë likuiditetet e shoqërisë. Me VKM nr. Nr. 584, datë 8.10.2021 " Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike, u vendos që OSSH të ndërpriste investimet e parashikuara për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes me përjashtim të atyre të domosdoshme për furnizimin me energji të konsumatorëve. Realizimi i të ardhurave nga energjia është pothuajse i barabartë me planifikimin e të ardhurave, e arrin në vlerën prej 26,875 milion lekë. Ulja e humbjeve në rrjet në nivelin e 20.62 % bëri të mundur që të ulen efektet e kostos së blerjes së energjisë së vitit. Shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetim u realizuan me një rritje prej 1% për shkak të rritjes së çmimit në tregun e lirë si dhe të ndryshimit të strukturës së blerjes së energjisë shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetimin të cilat u realizuan 15.9 miliard lekë. Të ardhura të tjera rezultuan me një ulje prej 8% në krahasim me ato të planifikuara pas faturimit të penaliteteve për mosplotësim të planit të furnizimit me energji elektrike për vitin 2021 sipas kushteve të kontraktimit. Shpenzimet operative për 2021 ishin 14 % më të ulëta se ato të planifikuara ose 1,653 milion Lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan sipas parashikimit të planifikuar me përjashtim të penaliteteve. Humbjet në rrjet në vitin 2021 ishin rreth 20.62 % ose rreth 0.12% më të ulta se ato të planifikuara prej 20.49%. Plani i investimeve për vitin 2021 i planifikuar për rreth 13.4 miliard është realizuar në vlerën 11 miliard Lekë pavarësisht se OSSH prej muajit Tetor me vendim të Qeverisë së Shqipërisë, investimet në rrjet u ndërprenë.<br><br>-Rezultati financiar i shoqërisë FSHU, për periudhën 2021 shënoi një humbje prej 11,367 milion lekë. Megjithë përpjekjet dhe përmirësimet e punës operacionale në drejtim të arritjes së arkëtimeve, mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit, performanca negative është rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve për blerjen e energjisë si pasojë e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë së blerë në Tregun e Lirë. Kështu të ardhurat nga shitja e energjisë ishin rreth 1% më të ulta ku pjesa me e madhe e uljes vjen nga konsumatorët privatë ose rreth 1.2 miliard lekë më pak. Të Ardhurat nga konsumatorët familjarë janë 2% më të larta në krahasim me planifikimin e vitit 2021 shkak të rritjes së sasisë së energjisë së blerë. Të ardhurat nga kamatëvonesat ishin 6.7% më të ulta se ato të planifikuara të vitit 2021 ose rreth 66 milion lekë për shkak të fillimit të përmirësimit të pasojave të situatës pandemike e Covid-19 dhe ndikimit të saj në ekonominë e vendit. Shpenzimet në vitin 2021 u rritën 8 % ose rreth 4.8 miliard lekë në krahasim me ato të planifikuara në 2021 kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë si rezultat i rritjes së çmimit të blerjes në tregun e lirë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Rritje të shpenzimeve kishte edhe në zërin shpenzime operative ku rritjen më të madhe e ka penalitete, gjoba e dëmshpërblime si dhe në shpenzimet financiare. Në 6-mujorin e dytë të vitit 2021 kur sasia e energjisë së furnizuar nga KESH ishte 21% më e ulët se ajo e 6-mujorit të parë të vitit, sasia e energjisë së blerë në |

| | |
|---|---|
| | tregun e lirë ishte rreth 897 Gwh e cila për shkak të rritjes së çmimi u ble me çmim mesatar prej rreth 26.03 Lekë/kwh me një kosto totale prej rreth 23.4 miliard lekë nga 2.03 miliard lekë që ishin shpenzuar në vitit 2020 për të njëjtën periudhë të 6-mujorit të dytë. Shpenzimet për Tarifën e Shpërndarjes dhe transmetimit si rezultati i rritjes së energjisë së shitur ishin 10% më të larta se ato të planifikuara e vitit 2021 ose respektivisht 1.9 dhe 0.8 miliard lekë më të larta se sa ato të planifikuarat e vitit 2021. Po kështu edhe shpenzimet për energjinë reaktive të cilat u rritën 11% në krahasim me planifikimin e vitit 2021. Shpenzimet për disbalancat pavarësisht se sasia e disbalancuar ishte brenda normave të planifikuara për më pak se 2% të sasisë së energjisë, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë u rritën 96% duke qenë 359 milion lekë më të larta se sa planifikimi i vitit 2021. Shpenzimet Operative u rritën 7% ose 242 milion lekë në krahasim me ato të planifikuar të vitit 2021. Rritja e ndjeshme e shpenzimeve operative lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve për penalitete, gjoba dhe dëmshpërblime të cilat janë rritur me 816 milion lekë në krahasim me planifikimin e vitit 2021. Shpenzimet për të Punësuarit, Postare, Konsulenca dhe Auditim dhe të tjera janë më të ulta se ato të parashikuara në planin financiar ndonëse janë më të larta se ato të realizuara në vitin 2020. Shpenzime financiare janë rritur me rreth 41 milion lekë në krahasim me planifikimin e 2021. Rritja e këtyre shpenzimeve është rrjedhojë e kostove të interesave të kredive të reja të marra në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare për kalimin e krizës së likuiditetit në kushte e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në tregun e energjisë. |
| **Kriteri:** | Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 2. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Marrja e kredive afatshkurtra nga bankat e nivelit të dytë, ka përkeqësuar situatën financiare të shoqërive të OSHEE Group sh.a. Rritja e detyrimeve financiare afatshkurtra dhe afatgjata rrit kostot e shoqërive, si dhe cënon investimet për rritjen e performancës dhe uljet e humbjeve në rrjet. |
| **Shkaku:** | Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Strukturat drejtuese të shoqërisë duke analizuar me kujdes situatën debitore të shoqërive, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive. |

Procesi i ndarjes së OSHEE dhe krijimi i OSHEE grup, i cili filloi në vitin 2018 dhe përfundoi në fund të vitit 2020 ndryshoi tërësisht objektin e veprimtarisë së OSHEE (shoqëria mëmë) e cila kryen tashmë rolin e ofrimit të shërbimeve të specializuara për shoqëritë e grupit. Aktivitetet e shpërndarjes dhe shitjes së energjisë të cilat ishin ushtruar përkohësisht prej vitit 2018 nga OSHEE (Shoqëria mëmë) sipas vendimeve të ERE, ju kaluan përfundimisht shoqërive të reja të krijuara OSSH dhe FSHU në zbatim të ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".
Sipas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:
"a) Kryerja e veprimtarive të shërbimeve ekonomike dhe financiare;
b) kryerja e veprimtarive të shërbimeve ligjore;

c) kryerja e veprimtarive të shërbimeve të burimeve njerëzore;
d) kryerja e veprimtarive të shërbimeve të teknologjisë së informacionit;
e) kryerja e veprimtarive të shërbimeve mbështetëse;
f) kryerja e veprimtarive të shërbimeve në funksion të zhvillimit të politikave dhe strategjive të biznesit;
g) kryerja e veprimtarive të dhënies me qira të aseteve, pajisjeve, softweare-ve, etj, në pronësi të saj;
gj) si dhe çdo veprimtari tjetër ne funksion te realizimit te këtyre shërbimeve.
Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe licencat e shoqërive të kontrolluara nga Shoqëria, kjo e fundit 2 mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura me sipër. Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari dhe shërbim si për shembull: veprimtari tregtare, financiare, arsimore, marketingu, qiradhënie apo hipotekimi, që mund të konsiderohen të dobishme, të nevojshme, për realizimin e objektit të aktivitetit të Shoqërisë."
Në përputhje me objektin e ri të liçensuar të aktivitetit OSHEE lidhi kontratat e shërbimit me shoqëritë e tjera të OSHEE Grup (OSSH, FSHU dhe FTL) për shërbime

1. Shërbime të Burimeve Njerëzore
2. Shërbime Ligjore
3. Shërbime të Medias
4. Shërbimeve Mbështetëse
5. Shërbime IT
6. Shërbimet Ekonomike
7. Shërbime të Zhvillimit të Biznesit

Një metodologji e përllogaritjes së çmimeve të shërbimit është si pjesë kontratave të shërbimit. Qëllimi i metodologjisë është që:
Të llogarisë çmimin për secilin nga shërbimet e ofruara për secilën kompani të Grupit OSHEE GROUP SH.A. për të mbuluar kostot e bëra për secilin prej shërbimeve në përputhje me kriteret e vendosura për natyrën e kostove të përfshira, llogaritjen mujore, rregullimin vjetor dhe transparencën për palët e interesit përfshirë.
Të parandalojë ndër-subvencionimin midis kompanive të ndryshme duke pasur një metodologji që mund të vlerësohet dhe rishikohet nga të gjitha palët.
Kostot do të alokohen sipas një metodologjie transparente e cila mund të rishikohet dhe përmirësohet më tej në konsultim me ERE dhe palët e interesit të përfshira.

**OSSH sh.a.**

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) është person juridik që funksionon si shoqëri aksionare, organizimi i së cilës bëhet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar).
OSSH është një shoqëri që ushtron aktivitet në fushën e shpërndarjes së energjisë elektrike e cila si një aktivitet i rregulluar, veprimtaria e së cilit rregullohet nga Ligji 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" në përputhje me politikat rregullatore në sektorin e energjisë elektrike sipas përcaktimeve ligjore të cilat udhëhiqen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE).
Shoqëria është krijuar më datë 28 Mars 2018 nga Shoqëria mëmë - Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Sh.A. (OSSH) si pjesë e OSHEE Grup në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e

lirë të energjisë elektrike. Për këtë, bazuar në vendimin e Asamblesë së OSHEE ShA nr.458 dt. 15.2.2017 "Për aprovimin e modelit të korporatës," Ministri i MIE, me urdhrin nr. 157 dt. 12.2.2018, urdhëroi krijimin e tre shoqërive, ndër ta, krijimin e shoqërisë Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a.

Me vendimin nr.216 dt. 11.10.2018, ERE vendosi transferimin e liçencës së Operimit e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të OSHEE tek OSSH, por duke vlerësuar ecurinë e procesit të ndarjes së aktivitetit të shoqërisë OSHEE Sh.a. e të konsolidimit të shoqërive të krijuara, si dhe plotësimin e nevojshëm me aktet ligjore e nënligjore, me propozim të aksionerit, ERE me vendimin nr. 264 dt. 20.12.2018 dhe nr. 211 dt. 18.12.2019, vendosi që liçensa të bëhet efektive pas një periudhe tranzitore prej 24 muaj, duke saktësuar se gjatë kësaj periudhe, veprimtaria e shpërndarjes së energjisë elektrike vazhdoi të kryhet nga OSHEE ShA. Duke filluar nga data 1 Janar 2020, shoqëria filloi të ushtrojë normalisht aktivitetin me të gjitha të drejtat operacionale dhe kontraktore si subjekt juridik, sipas liçensimit dhe akteve ligjore në fuqi.

**-Objekti i veprimtarisë dhe programi i përputhshmërisë**

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes Sh.a (OSSH sh.a) me ofertë private, me objekt aktiviteti shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve, lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike etj., si dhe çdo aktivitet tjetër fitimprurës me interes për shoqërinë; Për më tepër Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitetet tjetër i cili është i lejuar për formën juridike dhe nuk është i ndaluar nga ligji në fuqi. Shoqëria do te kryejë çdo lloj aktiviteti në raport me objektin dhe për të favorizuar atë.

Ndër objektivat më të detajuara të aktivitetit mund të përmendim:

- Të shpërndajë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes tek konsumatorët fundorë sipas kontratave të lidhura me FSHU dhe shoqëritë e tjera të furnizimit të licencuara.
- Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejta të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin furnizimit me energji elektrike.
- Lidhjen e klientëve dhe përdoruesve të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe instalimin dhe shërbimet e matjes së energjisë elektrike.
- Zhvillimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike në përputhje me perspektivat e zhvillimit ekonomik dhe bazuar në ndryshimet rajonale apo territoriale të kërkesës.
- Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe licencat e Shoqërisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, Shoqëria mund të kryeje çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër.
- Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari dhe shërbim si për shembull veprimtari tregtare, financiare, arsimore, marketingu, qiradhënie apo hipotekimi, që mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për realizimin e objektit të aktivitetit të Shoqërisë.

Në kryerjen e aktivitetit ekonomik në kushte të rregulluara shoqëria OSSH është e detyruar të zbatojë rregulla të tregut të kontrolluar nga ERE dhe jo ato të tregut të lirë. Të rregulluara janë gjithashtu vlerat e pranuara në llogaritjen e tarifave të shpenzimeve operative dhe kapitale të shoqërisë, në kushte të përllogaritjes të fitimit të lejuar nga ERE, e cila kontrollon dhe vendos për

tarifa të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe çmimet e shitjes me pakicë të energjisë për klientët në tregun e rregulluar.

Në fillim të vitit 2020 shoqëria aprovoi me vendim të veçantë “Programin e Përputhshmërisë i cili synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të OSSH sh.a. ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike, si dhe ofron mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e tij. Zbatimi i këtij programi siguron që shoqëria:

a) të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.
**b)** të hartojë dhe të depozitojë në ERE nje program vjetor, i cili përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe realizimin e objektivave kryesore të shoqërisë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetin ekonomik e financiar te saj, përfshirë edhe mekanizmat për mbikqyrjen e zbatimit të tyre;

**Treguesit kryesorë të aktivitetit**

Treguesit e paraqitur në tabelën më poshtë tregojnë rezultatin e aktivitetit të OSSH gjatë vitit 2021 janë krahasuar me Planin Finaciar 2021:

| 000/Leke | Pershkrimi | Janar-Dhjetor 2021 | Plani Janar-Dhjetor 2021 | Diferenca | % |
|---|---|---|---|---|---|
| Te ardhurat | Te ardhura nga Shpërndarja | 26,875,977 | 26,937,732 | ↑ (61,755) | 100% |
| | Te ardhura nga Shperndarja (Lidhje te reja) | 1,479,440 | 1,616,205 | ↑ (136,765) | 92% |
| | Te tjera | 10,005 | 8,466 | ↓ 1,539 | 118% |
| | **Gjithsej** | **28,365,422** | **28,562,403** | **↓ (196,981)** | **99%** |
| Shpenzimet | Shpenzime Energji dhe Transmetim | 15,997,592 | 15,862,285 | ↓ 135,307 | 101% |
| | Shpenzime Operative | 10,057,976 | 11,711,840 | ↑ (1,653,864) | 86% |
| | Provizione | 1,363,606 | 207,300 | ↓ 1,156,306 | 658% |
| | **EBITDA** | **946,248** | **780,978** | **↑ 165,270** | **121%** |
| | Amortizimi | 3,401,481 | 3,651,000 | ↑ (249,519) | 93% |
| | Shpenzime Financiare | 62,574 | 385,290 | ↑ (322,716) | 16% |
| | Tatim Fitimi | 154,088 | - | ↓ 154,088 | |
| | **Gjithsej** | **31,037,317** | **31,817,715** | **↑ (780,399)** | **98%** |
| **REZULTATI I AKTIVITETIT** | | **(2,671,895)** | **(3,255,312)** | **↑ 583,418** | **82%** |

| ENERGJI (MWH) | | 2021 | Plani 2021 | Diferenca |
|---|---|---|---|---|
| | Energji në rrjetin e OSHEE | 7,552,369 | 7,492,243 | 60,126 |
| | Energji e Humbur ne rrjetin e OSHEE | 1,556,931 | 1,535,362 | 21,569 |
| **Humbje %** | | **20.62%** | **20.49%** | **0.12%** |

Një analizë e shkurtër lidhur me Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të OSSH gjatë vitit 2021 krahasuar me Planin Financiar:

➢ *Rezultat financiar i 2021 shënoi një humbje prej 2,672 milion lekë:* Megjithë përmirësimet në drejtim të a) reduktimit të mëtejshëm të humbjeve, b) rritjes së nivelit të arkëtimeve në krahasim me atë të planifikuar si dhe c) mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme, rezultati financiar ishte negativ kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë rrjedhojë e rritjes së çmimit në treg sikurse u parashikua në rishikimin e planit financiar të shoqërisë.

Megjithatë si rezultat i masave të marra rezultati financiar ishte rreth 583 milion lekë më i përmirësuar se ai i parashikuar në planin financiar të rishikuar.

➢ *Realizimi i të Ardhurave nga Energjia:* Realizimi në kufijtë pothuajse të barabartë me planifikimin e të ardhurave arrin në vlerën prej 26,875 milion lekë.

- ➢ *Ulja e Humbjeve në rrjet në nivelin e 20.62 %* bëri të mundur që të ulen efektet e kostos së blerjes së energjisë së vitit.
- ➢ *Rritje e shpenzimeve për energji dhe transmetim:* Shpenzimet për Blerjen e Energjisë u realizuan me një rritje prej 1% për shkak të rritjes së çmimit në tregun e lirë si dhe të ndryshimit të strukturës së blerjes së energjisë shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetimin të cilat u realizuan 15.9 miliard lekë:
- ➢ *Të ardhura të tjera* rezultuan me një ulje prej 8% në krahasim me ato të planifikuara pas faturimit të penaliteteve për mosplotësim të planit të furnizimit me energji elektrike për vitin 2021 sipas kushteve të kontraktimit.
- ➢ *Shpenzimet operative* për 2021 ishin 14 % më të ulëta se ato të planifikuara ose 1,653 milion lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan sipas parashikimit të planifikuar me përjashtim të penaliteteve.
- ➢ ***Humbjet në rrjet*** në vitin 2021 janë rreth **20.62 %** ose rreth **0.12%** më të ulta se ato të planifikuara prej **20.49%**

| **Investime të vitit 2021 krahasuar me 2017 – 2020 *(000 Lekë)*** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Investime 2017** | **Investime 2018** | **Investime 2019** | **Investime 2020** | **Investime 2021** |
| **11,961,797** | **6,996,001** | **8,878,437** | **5,945,727** | **11,097,147** |

Plani i investimeve për vitin 2021 i planifikuar për rreth 13.4 miliard lekë është realizuar deri në fund të vitit për rreth 11 miliard lekë, pavarësisht se OSSH prej muajit Tetor me vendim të Qeverisë së Shqipërisë, investimet në rrjet u ndërprenë duke u lejuar vetëm një pjesë e investimeve të domosdoshme që lidheshin me furnizimin e pandërprerë me energji si dhe ato investime në vazhdim ndërprerja e të cilave krijonte humbje të mëdha për shoqërinë për shkak të kontratave të lidhura.
Masat e marra nga Qeveria e Shqipërisë e cila me VKM nr. Nr. 584, datë 8.10.2021 “ Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike, zgjidhën problemet e shoqërisë me problemet e likuiditetit. Në këto masa (pika 3 e këtij vendimi) u vendos gjithashtu që OSSH të ndërpriste investimet e parashikuara për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes me përjashtim të atyre të domosdoshme për furnizimin me energji të konsumatorëve

Përdoruesit e Rrjetit Shpërndarës të OSSH janë këto kategori:
- Konsumatorët Fundorë (FSHU),
- Furnizuesit e Licencuar (për konsumatorët në Treg të Liberalizuar),
- Prodhuesit me Përparësi të Energjisë Elektrike.

OSSH aktualisht furnizohet me energji nga FTL , kjo e fundit ka kontrate per blerjen e energjisë me 205 Prodhues me Përparësi të Energjisë Elektrike. Nga të cilët 139 janë HEC-et dhe 10 Fotovoltaik si dhe 16 kompani te importit.
Rezultatet e vitit 2020 nuk arritën treguesit e performancës së planifikuar në fillim të periudhës si rezultat i rritjes së shpenzimeve të blerjes së energjisë, e cila u ndikua nga ndryshimi i strukturës së blerjes. Sasia e furnizuar nga burimet hidrike vendase në vitin 2020 ishte sa 80.15% e sasisë së planifikuar ku sasia e furnizuar nga KESH ishte sa 75.8% e sasisë së planifikuar dhe ajo e furnizuar nga HEC-et private sa 90.7% e sasisë së planifikuar.
Në zbatim të planit të masave për të reduktuar abuzimet në rrjet të cilat ulin në mënyrë të drejtpërdrejtë humbjet jo teknike u punua në mënyrë të vazhdueshme për:
- Verifikimin e sistemeve të matjes.
- Sistemimin e kabinave.

- Instalimin e matësve.
- U kryen kontrolle të vazhdueshme në terren në bashkëpunim me policinë.
- U kryen kontrolle të planifikuara për rastet e veçanta të evidentuara.

Krahasuar me vitin 2020 energjia e blerë gjatë 2021 është 2% më e lartë, ndërsa u shit 3% më shumë.

Rritja e sasisë së blerë u ndikua nga kushtet e motit dhe ulja e humbjeve në rrjet të cilat kompensuan rritjen e konsumit. Rritja e sasisë së shitur është pasojë e:

- Rritjes së kontrolleve në terren për reduktimin e abuzimit me energjinë
- Rritjen normale të konsumit si pasojë e rritjes ekonomike të vendit
- Përmirësimin e kontrollit të brendshëm me qëllim realizimin në kohë të leximeve dhe saktësisë së tyre nga stafi i zonave të shërbimit
- Efekti i investimeve

Ulja e humbjeve në shitjen e energjisë elektrike në krahasim me vitet e mëparshme paraqitet në tabelën që vijon:




Mungesa e likuiditetit për shkak të rritjes së shpenzimeve për blerjen e energjisë detyroi OSSH të ulë ritmin e investimeve në krahasim me ato të planifikuara me një realizim prej vetëm 80%.

Megjithë investimet e jashtëzakonshme të 4 viteve të fundit aktiviteti i shpërndarjes përballet akoma me problematika që lidhen kryesisht me:

- Vjetërsinë e pajisjeve dhe të rrjetit elektrik i cili ka nevojë urgjente për t‘u investuar.
- Shfrytëzimin e një pjese të konsiderueshme të rrjetit në rregjim të mbingarkuar gjë që çon në rrënim të mëtejshëm të rrjetit.

Duhet theksuar se në fund të vitit 2014 shoqëria gjendej në kushtet e rrjetit gati tërësisht të rrënuar dhe i kishte akoma të paqarta përparësitë në investimet afatgjata. Për vite me rradhë ishte punuar në kushtet e emergjencës dhe pa një plan të qartë investimesh. Tashmë janë përfunduar planet e investimeve afatmesme dhe afatgjata, një pjesë e të cilave është tashmë në vazhdim. Me synim uljen e humbjeve dhe rritjen e cilësisë së transmetimit sipas studimeve të Divizionit të Shpërndarjes është e domosdoshme që:

- Të vazhdohet zëvendësimi i rrjetit 6/10 kV me rrjetin me tension 20 kV.
- Zëvendësimi i rrjetave TU me përcjellës ajror të zhveshur me përcjellës ajror të izoluar që kanë sistemin ABC.
- Ndërtimi i nënstacioneve elektrike 110/20 kV.

Si rrjedhojë e investimeve dhe përmirësimit të administrimit të rrjetit në fund të vitit 2021 është arritur që humbjet teknike në rrjet të ulen në 15.6%.

- *Treguesit e cilësisë së shërbimit*

Investimet në përmirësimin e treguesve në TM/TU të lidhur me rritjen e efiçencës së rrjetit dhe cilësinë e shërbimit u drejtuan në:

- përmirësimin e sistemit të shpërndarjes nën-transmetim duke përmirësuar riparimin në kohë të defekteve.
- investime në rrjetin e tensionit të mesëm (6-20 kV) që përfshijnë linjat kabllore TM dhe kabinaTM/ TU të shpërndarjes, si dhe sistemin e matjes në kabina.

Treguesit e furnizimit në rrjet në vitin 2021 rezultojnë të përmirësuar ndjeshëm, më poshtë ata janë krahasuar me vitin 2015 si vit i fillimit të reformimit:
- SAIDI - Nr.i orëve të ndërprerjeve gjithsej/Nr. Konsumatorëve Total – përmirësuar 57%.
- SAIFI - Nr. i konsumatorëve të prekur nga ndërprerjet/Nr. Kons.Total – përmirësuar 45%.

- *Rritja e investimeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike*

Shtesa e vlerës së aseteve (investime) në vitet 2012 – 2021 paraqiten në tabelën që vijon:




## Pasqyra e performancës

| OSSH PASH (000 / ALL) | | OSSH | | **Plan OSSH** | **Diference** | **%** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| **TE ARDHURA** | | **28,365,422** | | **28,562,403** | **(196,981)** | **99%** |
| Të Ardhura Kryesore | | 28,355,417 | | 28,553,937 | (198,520) | 99% |
| ***Të ardhura nga SHPERNDARJA*** | | **26,875,977** | | **26,937,732** | ***(61,755)*** | ***100%*** |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes FSHU | | 26,140,782 | | 26,159,773 | (18,993) | 100% |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes 35 kv | | 97,376 | | 120,180 | (22,804) | 81% |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes 20/10/6 kv | | - | | - | | |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes 04 kv | | 637,821 | | 657,779 | (19,958) | 97% |
| Energji Reaktive | | 402,747 | | 417,797 | (15,050) | 96% |
| Dëmi ekonomik | | 347,775 | | 415,372 | (67,597) | 84% |
| Lidhjet e reja | | 728,918 | | 783,036 | (54,117) | 93% |
| **Të Ardhura të Tjera** | | **10,005** | | **8,466** | **1,539** | **118%** |
| | | | | | | |
| **SHPENZIMET** | | **(30,820,655)** | | **(31,432,425)** | **611,770** | **98%** |
| **Shpenzime Energjie** | | **(15,997,592)** | | **(15,862,285)** | **(135,307)** | **101%** |
| ***Energji e Blerë*** | | ***(14,963,675)*** | | ***(14,845,833)*** | *(117,842)* | *101%* |
| Blerë në Tregun e Lirë | | (4,470,019) | | (4,488,619) | 18,600 | 100% |
| Blerje nga HEC | | (9,994,443) | | (9,829,956) | (164,488) | 102% |
| Blerje nga Bur. Rinov. | | (499,213) | | (527,258) | 28,045 | 95% |
| **Tarifa e Transmetimit** | | ***(791,248)*** | | **(821,522)** | **30,274** | **96%** |
| **Energji Reaktive** | | | | - | | |
| **Disbalancat** | | *(242,669)* | | *(194,930)* | (47,739) | 124% |
| | | | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Marzhi Bruto** | **10,878,385** | **11,075,447** | **(197,062)** | 98% |
| **Marzhi Bruto %** | **35%** | **44%** | **6%** | 86% |
| **Shpenzime Operative** | **(10,057,976)** | **(11,711,840)** | 1,653,864 | 86% |
| Lëndet e Para dhe të konsumueshme | (196,704) | (255,800) | 59,096 | 77% |
| Përfitime dhe Shpenzime për të Punësuarit | (4,926,577) | (5,050,122) | 123,545 | 98% |
| Mirëmbajtje | (992,660) | (1,676,504) | 683,998 | 59% |
| Penalitete, gjoba e dëmshperblime | (2,191,249) | (2,050,000) | (530,533) | 107% |
| Shërbime Korporate (SLA) | (907,498) | (1,458,335) | 291,671 | 62% |
| Marrëdhënie me Publikun | (4,201) | (6,000) | 1,799 | 70% |
| Qera | (183,413) | (231,849) | 48,436 | 79% |
| Shërbimet Postare | (1,042) | (15,146) | 14,104 | 7% |
| Shpenzime të IT | (16,464) | (30,000) | 13,536 | 55% |
| Shpenzime Ligjore | (7,764) | (1,000) | 920 | 776% |
| Konsulencë dhe Auditim | (24,102) | (50,000) | 25,898 | 48% |
| Të tjera | (606,301) | (887,085) | 280,783 | 68% |
| | | | | |
| **Dëmtime dhe Provigjone** | **(1,363,606)** | **(207,300)** | **(1,156,306)** | **658%** |
| **EBITDA** | **946,248** | **780,978** | 165,270 | 121% |
| Zhvlerësimi dhe amortizimi | (3,401,481) | **(3,651,000)** | **249,519** | 93% |
| **Fitim / Humbje Operative (EBIT)** | **(2,455,233)** | **(2,870,022)** | 414,789 | 86% |
| **Shpenzime Financiare - neto** | **(62,574)** | **(385,290)** | 322,716 | 16% |
| Të ardhura financiare | 570,420 | 185,004 | 385,416 | 308% |
| Shpenzime financiare | (632,994) | (570,294) | (62,699) | 111% |
| | - | | | |
| **Fitim / Humbja perpara Taksave** | **(2,517,807)** | **(3,255,312)** | 737,506 | 77% |
| Shpenzime Tatim Fitimi | (154,088) | | (154,088) | |
| Fitim / Humbja e Periudhës | **(2,671,895)** | **(3,255,312)** | **583,418** | **82%** |

*Rezultati financiar i vitit 2021 shënoi një humbje prej 2,672 milion Lekë:* Megjithë përmirësimet e ndjeshme në drejtim të a) reduktimit të mëtejshëm të humbjeve, b) rritjes së nivelit të arkëtimeve në krahasim me atë të planifikuar si dhe c) mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme, rezultati financiar ishte negativ kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë rrjedhojë e rritjes së çmimit në treg sikurse u parashikua në rishikimin e planit financiar të shoqërisë.

Megjithatë si rezultat i masave të marra rezultati financiar ishte rreth 583 milion Lekë më i përmirësuar se ai i parashikuar në planin financiar të rishikuar.

Si rrjedhojë e mungesës së furnizimit të plotë të energjisë nga HEC-et private për vitin 2021 OSSH u furnizua për mbulimin e humbjeve për një sasi prej rreth 215.46 Gwh në tregun e parregulluar. Rritja e çmimit të energjisë në tregun e parregulluar mesatarisht prej rreth 20.75 Lekë/Kwh për nga 8.05 Lekë/Kwh që ishte parashikuar në fillim të vitit rriti shpenzimet e blerjes së energjisë për OSSH duke ulur performancën financiare dhe vendosur në pozitë të vështirë likuiditetet e shoqërisë.

Masat e marra nga Qeveria e Shqipërisë e cila me VKM nr. Nr. 584, datë 8.10.2021 " Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike, zgjidhën problemet e shoqërisë me problemet e likuiditetit.

Në këto masa (pika 3 e këtij vendimi) u vendos gjithashtu që OSSH të ndërpriste investimet e parashikuara për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes me përjashtim të atyre të domosdoshme për furnizimin me energji të konsumatorëve.

**Të Ardhura nga Aktiviteti Kryesor (Shpërndarja e Energjisë)**
Tabela e mëposhtme tregon bilancin sasior të shitjes dhe shpërndarjes së energjisë elektrike në vitin 2021 në MWh si dhe krahasimin e sasisë së faturuar me totalin e vitit 2020:

*Bilanci sasior i energjisë:*

| **Në Mwh** | **VITI** | | **Diferenca** |
|---|---|---|---|
| | **2021** | **2020** | **2021-2020** |
| Energji e në Rrjet | 7,552,369 | 6,785,136 | 767,233 |
| Energji e Shpërndarë | 5,995,438 | 5,327,396 | 668,042 |
| Humbje në MWh | 1,556,931 | 1,457,740 | 99,191 |
| **Humbje %** | **20.62%** | **21.48%** | **-0.9%** |

Krahasimi i të ardhurave te realizuara 2021 me Planin Financiar e 2021 paraqitet në tabelën me poshtë:

| **OSSH (000 / Lekë)** | **Realizimi Fakt 2021** | | **Plan 2021 OSSH** | **Diference** | **%** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| **TË ARDHURA** | **28,365,422** | | **28,562,403** | **(196,981)** | **99%** |
| **Të Ardhura Kryesore** | **28,355,417** | | **28,553,937** | **(198,520)** | **99%** |
| ***Të Ardhura nga Shpërndarja*** | ***26,875,977*** | | **26,937,732** | **(61,755)** | ***100%*** |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes FSHU | 26,140,782 | | 26,159,773 | (18,993) | 100% |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes 35 kv | 97,376 | | 120,180 | (22,804) | 81% |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes 20/10/6 kv | | | | | |
| Tarifë e shërbimit të Shpërndarjes 04 kv | 637,821 | | 657,779 | (19,958) | 97% |
| Energji Reaktive | 402,747 | | 417,797 | (15,050) | 96% |
| Dëmi ekonomik | 347,775 | | 415,372 | (67,597) | 84% |
| **Lidhjet e reja** | 728,918 | | 783,036 | (54,117) | 93% |
| **Të Ardhura të Tjera** | **10,005** | | **8,466** | **1,539** | **118%** |

Për OSSH Të Ardhurat nga Shpërndarja e Energjisë janë realizuar pothuajse 100% sa ato të planifikuara, nga e cila 9% ulje ka ardhur si rezultat i Tarifës së shërbimit të Shpërndarjes 35 kv, Të ardhurat për lidhjet e reja janë ulur me 7%.

**Të Ardhura të Tjera (Tarifa e Shpërndarjes, Lidhje të Reja dhe Të tjera)**
Në *Të ardhurat të tjera* përfshihen*:*
Ndërrim emri Azhurnim/Leje ndërtimi, Spostim matësi, Ndërkreje e energjisë elektrike, Transferim pike lidhje, Kolaudim Matësi / Verifikim matësi ne laborator, Të ardhura nga Qiratë Penalitete e Gjoba të Arkëtuara/Faturuara, të ardhura nga shërbime të tjera, % përfituese nga mbledhja e tarifës shërbimit etj.
Ky grup të ardhurash rezultuan më të larta me 18 % në krahasim me Planin Financiar 2021, rritje e cila lidhet kryesisht me rritjen e zhvillimit t ekonomik të vendit.

**Shpenzimet.**
Shpenzime për blerje Energjie dhe Transmetim
Tabela më poshtë tregon krahasimin e shpenzimeve të energjisë dhe transmetimit për vitin 2021 krahasuar me Planin Financiar 2021:

| **OSSH PASH (000 / Lekë)** | **Realizimi Fakt 2021** | | **Plan 2021** | **Diference** | **%** |
|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| **Shpenzime Energjie** | **15,997,592** | | **15,862,285** | **135,307** | 101% |
| *Energjia e Blerë* | ***14,963,675*** | | ***14,845,833*** | **117,842** | **101%** |
| E Importuar | 4,470,019 | | 4,488,619 | (18,600) | 100% |
| Blerje Lokale HEC | 9,994,443 | | 9,829,956 | 164,488 | 102% |
| Blerje nga Burime te Rinovueshme | 499,213 | | 527,258 | (28,045) | 95% |
| ***Tarifa e Transmetimit*** | 791,248 | | 821,522 | (30,274) | 96% |
| ***Disbalancat*** | 242,669 | | 94,930 | 47,739 | 124% |

Gjatë vitit 2021 shpenzimet për blerje dhe transmetim energjie rezultuan pothuajse të barabarta me planin ose 1% më të larta se ato të planifikuara në fillim të vitit dhe çmimi mesatar i blerjes së energjisë ishte 9.7 lekë/Gwh nga 4.79 Lekë/KWh i planifikuar. Faktorët që ndikuan në rritjen e kostos së blerjes së energjisë ishin:

- *Energjia e furnizuar nga HEC më e lartë se planifikimi i rishikuar*

Sasia e energjisë së blerë nga HEC-et private për vitin 2021 ishte 2% më e lartë se ajo e planifikuar, ose 164 mijë lekë. Kjo sasi u plotësua me blerjen e energjisë në tregun e lirë me çmim mesatar 8.5 Lekë/Gwh.

**Shpenzime Operative dhe Amortizimi.**

Të dhënat për Shpenzimet Operative, Provigjonet dhe Amortizimin paraqiten në tabelën që vijon:

| OSSH PASH (000 / Lekë) | Fakt 2021 | Plan 2021 | Diferenca | Diferenca ne % |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **Shpenzimet Operative** | **10,057,976** | **11,711,840** | **(1,653,864)** | **86%** |
| Lëndët e Para dhe të konsumueshme | 196,704 | 255,800 | (59,096) | 77% |
| Shpenzime për të Punësuarit | 4,926,577 | 5,050,122 | (123,545) | 98% |
| Mirëmbajtje | 992,660 | 1,676,504 | (683,843) | 59% |
| Penalitete, gjoba e dëmshpërblime | 2,191,249 | 2,050,000 | 141,249 | 107% |
| Shërbime Korporate (SLA) | 907,498 | 1,458,335 | (550,838) | 62% |
| Marrëdhënie me Publikun | 4,201 | 6,000 | (1,799) | 70% |
| Qera | 183,413 | 231,849 | (48,436) | 79% |
| Shërbime Postare | 1,042 | 15,146 | (14,104) | 7% |
| Shpenzime të IT | 16,464 | 30,000 | (13,536) | 55% |
| Shpenzime Ligjore | 7,764 | 1,000 | 6,764 | 776% |
| Konsulencë dhe Auditim | 24,102 | 50,000 | (25,898) | 48% |
| Të tjera | 606,301 | 887,085 | (280,783) | 68% |
| **Demtime dhe Provigjone** | **1,363,606** | **207,300** | **1,156,306** | **658%** |
| **Zhvlerësimi dhe amortizimi** | **3,401,481** | **3,651,000** | **(249,519)** | **93%** |

Shpenzimet operative për 2021 ishin 14% më të ulta se ato të planifikuara ose 1,654 milion lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan me ulje në krahasim me planin e rishikuar, me përjashtim të penaliteteve për çështje ligjore të cilat rezultuan më të larta se ato të planifikuara.

**<u>FSHU sh.a.</u>**

Furnizimi i Shërbimit Universal sh.a ka objekt kryesor të aktivitetit furnizimin me energji elektrike të klientëve fundorë që veprojnë në tregun e rregulluar. Ndër objektivat më të detajuara të aktivitetit mund të përmendim:

- Të ofrojë energji elektrike për klientët e përfshirë në skemat e furnizimit me tarifa të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë (klientët tariforë).
- Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen

e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë, me çmime të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe liçencën e akorduar.

- Shërbime të tjera për klientët, që janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ndaj tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Gjithashtu, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe liçensat e Shoqërisë të lëshuara nga autoritetet kompetente, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi, apo që ndërvaret ose lidhet me aktivitetet e renditura më sipër.
- Për arritjen e qëllimit të mësipërm, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari dhe shërbim si për shembull veprimtari tregtare, financiare, arsimore, marketingu, qiradhënie apo hipotekimi, që mund të konsiderohen të dobishme apo të nevojshme për realizimin e objektit të aktivitetit të Shoqërisë.

Në kryerjen e aktivitetit ekonomik në kushte të rregulluara shoqëria FSHU është e detyruar të zbatojë rregulla të tregut të kontrolluar nga ERE dhe jo ato të tregut të lirë. Të rregulluara janë gjithashtu vlerat e pranuara në llogaritjen e tarifave të shpenzimeve operative dhe kapitale të shoqërisë, në kushte të përllogaritjes të fitimit të lejuar nga ERE, e cila kontrollon dhe vendos për çmimet e shitjes me pakicë të energjisë për klientët në tregun e rregulluar.
FSHU me miratim të ERE kryen gjithashtu furnizim me energji elektrike për klientët e dalë në tregun e lirë por që akoma nuk kanë gjetur një furnizues tjetër në kushtet e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit mbështetur në aktet ligjore dhe vendimet përkatëse të ERE.

Në fillim të vitit 2020 shoqëria aprovoi me vendim të veçantë "Programin e Përputhshmërisë", i cili synon shmangien e sjelljeve diskriminuese të FSHU sh.a. ndaj pjesëmarrësve të tjerë në tregun e energjisë elektrike, si dhe ofron mekanizmat për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e tij. Zbatimi i këtij programi siguron që shoqëria:

c) të ketë të drejta të plota vendimmarrëse, të pavarura nga shoqëria e integruar për të siguruar funksionimin, mirëmbajtjen apo zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes.
d) të hartojë dhe të depozitojë në ERE një program vjetor, i cili përcakton masat që do të merren për të siguruar ndalimin e veprimeve diskriminuese, si dhe realizimin e objektivave kryesore të shoqërisë, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në aktivitetin ekonomik e financiar te saj, përfshirë edhe mekanizmat për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

Treguesit kryesorë të performancës së FSHU të vitit 2021 krahasuar me atë të planifikuar të rishikuar, paraqiten në tabelën më poshtë:

| 000/Lekë | Përshkrimi | 2021 | Plan 2021 | Diferenca 2021-Plan 2021 | % |
|---|---|---|---|---|---|
| Të Ardhurat | Të ardhura nga Shitja e energjisë | 60,514,966 | 60,758,897 | (243,930) | 99.6% |
| | Të ardhura nga kamatëvonesat | 920,941 | 987,180 | (66,239) | 93.3% |
| | Të tjera | 156,508 | 33,379 | 123,129 | 468.9% |
| | **Gjithsej** | **61,592,415** | **61,779,455** | **(187,040)** | **99.7%** |
| Shpenzimet | Shpenzime Energji dhe Transmetim | 65,423,299 | 60,625,431 | 4,797,868 | 107.9% |
| | Shpenzime Operative | 3,580,247 | 3,338,580 | 241,667 | 107.2% |
| | Provizione | 3,590,797 | 3,592,928 | (2,131) | 99.9% |
| | **EBITDA** | **(11,001,928)** | **(5,777,484)** | **(5,224,444)** | **190.4%** |
| | Amortizimi | 135,746 | 43,115 | 92,631 | 314.8% |
| | Shpenzime Financiare | 229,673 | 188,757 | 40,916 | 121.7% |
| | Tatim Fitimi | - | - | - | |
| | **Gjithsej** | **72,959,762** | **67,788,812** | **5,170,950** | **107.6%** |
| **REZULTATI I PERIUDHES** | | **(11,367,347)** | **(6,009,357)** | **(5,357,990)** | **189.2%** |

Një analizë e shkurtër lidhur me Treguesit kryesorë të Rezultatit Financiar të FSHU gjatë vitit 2021 krahasuar me Planifikimin Financiar paraqitet më poshtë:

- *Rezultati financiar i 2021 shënoi një humbje prej 11,367 milion lekë,* megjithë përpjekjet dhe përmirësimet e punës operacionale në drejtim të a) rritjes së arkëtimeve, b) mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme c) përmirësimit të cilësisë së shërbimit rritja e jashtëzakonshme e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike ishte faktori kryesor në performancën negative të vitit 2021.
- *Të Ardhurave nga Shitja e energjisë:* Të Ardhurat nga Shitja e Energjisë rezultojnë rreth 244 milion lekë më të ulta në krahasim me ato të planifikuarin për 2021 përafërsisht sa planifikimi për vitin 2021.
- *Të ardhurat nga kamatëvonesat* ishin 6.7 % më të ulta se ato të planifikuara për 2021 ose rreth 66 milion lekë .
- *Shpenzimet për Blerjen e Energjisë the Transmetimit.* Shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetimit, si pasojë e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në pjesën e dytë të vitit 2021 u rriten me 4.8 miliardë lekë, ose 7.9 % me shume ne krahasime me planifikimin e vitit 2021 dhe përkeqësuan ndjeshëm performancën financiare të vitit 2021.
- *Shpenzimet Operative* janë rreth 7.2% më të larta se ato të planifikuara për 2021 ku Penalitete, gjoba e dëmshpërblime zënë peshën kryesore të rritjes së shpenzimeve operative prej rreth 241.6 milion lekë. Uje të ndjeshme në krahasim me planin 2021 ka patur në shpenzimet për te Punësuarit, Qera dhe Shpenzimet Postare.
- *Shpenzime financiare* janë rritur me rreth 41 milion lekë. Rritja e këtyre shpenzimeve është rrjedhojë e kostove të interesave të kredive të reja të marra në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare për kalimin e krizës së likuiditetit në kushte e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në tregun e energjisë.

Më poshtë tabela e performancës së vitit 2021 për shoqërinë FSHU krahasuar me Planin e 2021:

| FSHU PASH (000 / ALL) | Fakt 2021 | Plan 2021 | Difference Plan-Fakt | % |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **TE ARDHURA** | **61,592,415** | **61,779,455** | **(187,040)** | **99.7%** |
| **Të Ardhura Kryesore** | **61,435,908** | **61,746,076** | **(310,169)** | **99%** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Të adhura nga SHITJA** | **61,435,908** | **61,746,076** | **(310,169)** | **99%** |
| Konsumatorët Familjare | 29,712,166 | 29,037,536 | 674,630 | 102% |
| Konsumatorët Private | 22,533,121 | 23,692,804 | (1,159,684) | 95% |
| Konsumatorët Buxhetore | 3,576,846 | 3,308,137 | 268,709 | 108% |
| Konsumatorët Jo Buxhetore | 4,299,825 | 4,333,456 | (33,631) | 99% |
| Klient Privatë- 35Kv "FMF" | 32,533 | 32,066 | 466 | 101% |
| JoBuxhetorë- 35Kv "FMF" | 360,475 | 354,896 | 5,579 | 102% |
| ***-Të ardhura nga Kamatëvonesat*** | **920,941** | **987,180** | **(66,239)** | **93%** |
| ***Të Ardhura të Tjera*** | **156,508** | **33,379** | **123,129** | **469%** |
| | | | | |
| **SHPENZIMET** | **(72,730,089)** | **(67,600,055)** | **(5,130,035)** | **108%** |
| **Shpenzime Energjie** | **(65,423,299)** | **(60,625,431)** | **(4,797,868)** | **108%** |
| ***Energji e Blerë*** | ***(33,436,411)*** | ***(32,377,802)*** | ***(1,058,609)*** | ***103%*** |
| Blerë në Tregun e Lirë | (23,418,065) | (23,008,344) | (409,721) | 102% |
| Blerje nga KESH | (6,217,056) | (6,228,639) | 11,583 | 100% |
| Blerje nga HEC | (3,801,290) | (3,140,820) | (660,470) | 121% |
| Blerje nga Bur. Rinov. | | - | - | |
| **Tarifa e mirëmbajtjes 0 kwh** | (637,821) | - | (637,821) | |
| **Tarifa e Shperndarjes** | (26,113,876) | (24,211,073) | (1,902,803) | 108% |
| ***Tarifa e Transmetimit*** | (4,101,416) | (3,300,919) | (800,498) | 124% |
| **Energji Reaktive** | (402,747) | (363,423) | (39,324) | 111% |
| ***Disbalancat*** | (731,027) | (372,214) | (358,813) | 196% |
| **Marzhi Bruto** | **(4,908,332)** | **133,466** | **(5,041,798)** | **-3678%** |
| **Marzhi Bruto %** | **-8%** | **0%** | **-8%** | **-3692%** |
| **Shpenzime Operative** | **(3,580,247)** | **(3,338,580)** | **(241,667)** | **107%** |
| Lëndet e Para dhe të konsumueshme | (23,959) | (79,800) | 55,841 | 30% |
| Përfitime dhe Shpenzime për të Punësuarit | (818,614) | (999,285) | 180,671 | 82% |
| Mirëmbajtje | (92) | (30,197) | 30,105 | 0% |
| Penalitete,gjoba e dëmshperblime | (952,971) | (136,635) | (816,336) | 697% |
| Shërbime Korporate (SLA) | (510,804) | (413,872) | (96,931) | 123% |
| Marrëdhënie me Publikun | (28,000) | (36,000) | 8,000 | 78% |
| Qera | (1,614) | (133,092) | 131,478 | 1% |
| Shërbimet Postare | (858,544) | (961,282) | 102,738 | 89% |
| Shpenzime të IT | - | (5,262) | 5,262 | 0% |
| Shpenzime Ligjore | (813) | (3,526) | 2,714 | 23% |
| Konsulencë dhe Auditim | (24,393) | (30,000) | 5,607 | 81% |
| Të tjera | (360,444) | (509,628) | 149,184 | 71% |
| | | | - | |
| **Dëmtime dhe Provigjone** | **(3,590,797)** | **(3,592,928)** | **2,131** | **100%** |
| **EBITDA** | **(11,001,928)** | **(5,777,484)** | **(5,224,444)** | **190%** |
| **Zhvlerësimi dhe amortizimi** | **(135,746)** | **(43,115)** | **(92,631)** | **315%** |
| **Fitim / Humbje Operative (EBIT)** | **(11,137,674)** | **(5,820,599)** | **(5,317,075)** | **191%** |
| **Shpenzime Financiare - neto** | **(229,673)** | **(188,757)** | **(40,916)** | **122%** |
| Të ardhura financiare | 412,360 | 25,929 | 386,430 | 1590% |
| Shpenzime financiare | (642,033) | (214,687) | (427,346) | 299% |
| **Fitim / Humbja perpara Taksave** | **(11,367,347)** | **(6,009,357)** | **(5,357,990)** | **189%** |
| Shpenzime Tatim Fitimi | | - | - | |
| **Fitim / Humbja e Periudhës** | **(11,367,347)** | **(6,009,357)** | **(5,357,990)** | **189%** |

Rezultati financiar i 2021 shënoi një humbje prej 11,367 milion Lekë. Megjithë përpjekjet dhe përmirësimet e punës operacionale në drejtim të arritjes së arkëtimeve, mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit, performanca negative është rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve për blerjen e energjisë si pasojë e rritjes së

jashtëzakonshme të çmimit të energjisë së blerë në Tregun e Lirë. Çmimi i mesatar i blerjes së energjisë në tregun e lirë për vitin 2021 ishte 26.03 lekë/Kwh.

Të ardhurat në krahasim me ato të planifikuarin e vitit 2021 janë 187 milion Lekë me pak.
Të ardhurat e detajuara për vitin 2021 në krahasim me planifikimin e 2021 pasqyrohen në tabelën më poshtë:

| FSHU (000 / ALL) | Fakt 2021 | Plan 2021 | Diference Plan-Fakt | % |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **TE ARDHURA** | **61,592,415** | **61,779,455** | **(187,040)** | **99.7%** |
| **Të Ardhura Kryesore** | **61,435,908** | **61,746,076** | **(310,169)** | **99%** |
| **Të adhura nga SHITJA** | **61,435,908** | **61,746,076** | **(310,169)** | **99%** |
| Konsumatorët Familjare | 29,712,166 | 29,037,536 | 674,630 | 102% |
| Konsumatorët Private | 22,533,121 | 23,692,804 | (1,159,684) | 95% |
| Konsumatorët Buxhetore | 3,576,846 | 3,308,137 | 268,709 | 108% |
| Konsumatorët Jo Buxhetore | 4,299,825 | 4,333,456 | (33,631) | 99% |
| Klient Privatë- 35Kv "FMF" | 32,533 | 32,066 | 466 | 101% |
| JoBuxhetorë- 35Kv "FMF" | 360,475 | 354,896 | 5,579 | 102% |
| ***-Të ardhura nga Kamatëvonesat*** | **920,941** | **987,180** | **(66,239)** | **93%** |
| ***Të Ardhura të Tjera*** | **156,508** | **33,379** | **123,129** | **469%** |

Kështu të ardhurat nga shitja e energjisë ishin rreth 1% më të ulta ku pjesa me e madhe e uljes vjen nga konsumatorët privatë ose rreth 1.2 miliard lekë më pak. Të Ardhurat nga konsumatorët familjarë janë 2% më të larta në krahasim me planifikimin e vitit 2021 shkak të rritjes së sasisë së energjisë së blerë.
Të ardhurat nga Kamatëvonesat ishin 6.7% më të ulta se ato të planifikuara të vitit 2021 ose rreth 66 milion lekë për shkak të fillimit të përmirësimit të pasojave të situatës pandemike e Covid-19 dhe ndikimit të saj në ekonominë e vendit.
Shpenzimet në vitin 2021 u rritën 8 % ose rreth 4.8 miliard lekë në krahasim me ato të planifikuarën 2021 kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë si rezultat i rritjes së çmimit të blerjes në tregun e lirë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Rritje të shpenzimeve kishte edhe në zërin shpenzime operative ku rritjen më të madhe e ka penalitete, gjoba e dëmshpërblime si dhe në shpenzimet financiare.

## Shpenzime të blerjes së energjisë

| FSHU (000 / ALL) | Fakt 2021 | Plan 2021 | Difference Plan-Fakt | % |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **Shpenzime Energjie** | **(65,423,299)** | **(60,625,431)** | **(4,797,868)** | **108%** |
| ***Energji e Blerë*** | ***(33,436,411)*** | ***(32,377,802)*** | ***(1,058,609)*** | ***103%*** |
| Blerë në Tregun e Lirë | (23,418,065) | (23,008,344) | (409,721) | 102% |
| Blerje nga KESH | (6,217,056) | (6,228,639) | 11,583 | 100% |
| Blerje nga HEC | (3,801,290) | (3,140,820) | (660,470) | 121% |
| Blerje nga Bur. Rinov. | | - | - | |
| **Tarifa e mirëmbajtjes 0 kwh** | (637,821) | - | (637,821) | |
| **Tarifa e Shperndarjes** | (26,113,876) | (24,211,073) | (1,902,803) | 108% |
| ***Tarifa e Transmetimit*** | (4,101,416) | (3,300,919) | (800,498) | 124% |
| **Energji Reaktive** | (402,747) | (363,423) | (39,324) | 111% |
| ***Disbalancat*** | (731,027) | (372,214) | (358,813) | 196% |

Shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetimit, si pasojë e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në pjesën e dytë të vitit 2021 u rriten me 4.8 miliardë lekë ose 8 % me shume ne krahasime me planifikimin e vitit 2021 dhe përkeqësuan ndjeshëm performancën financiare të vitit 2021.
Në 6-mujorin e dytë të vitit 2021 kur sasia e energjisë së furnizuar nga KESH ishte 21% më e ulët se ajo e 6-mujorit të parë të vitit, sasia e energjisë së blerë në tregun e lirë ishte rreth 897 Gwh e cila për shkak të rritjes së çmimi u ble me çmim mesatar prej rreth 26.03 lekë/kwh me një kosto totale prej rreth 23.4 miliard lekë nga 2.03 miliard Lekë që ishin shpenzuar në vitit 2020 për të njëjtën periudhë të 6-mujorit të dytë.

**Shpenzimet për Tarifën e Shpërndarjes, Transmetimit, Mirëmbajtjes dhe Dis-balancave**

Shpenzimet për Tarifën e Shpërndarjes dhe transmetimit si rezultati i rritjes së energjisë së shitur ishin 10% më të larta se ato të planifikuara e vitit 2021 ose respektivisht 1.9 dhe 0.8 miliard lekë më të larta se sa ato të planifikuarat e vitit 2021. Po kështu edhe shpenzimet për energjinë reaktive të cilat u rritën 11% në krahasim me planifikimin e vitit 2021.
Shpenzimet për disbalancat pavarësisht se sasia e disbalancuar ishte brenda normave të planifikuara për më pak se 2% të sasisë së energjisë, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë u rritën 96% duke qenë 359 milion lekë më të larta se sa planifikimi i vitit 2021.

**Shpenzime Operative, Provigjone, Amortizimi dhe Financiare**

| **FSHU (000 / ALL)** | **Fakt 2021** | **Plan 2021** | **Difference Plan-Fakt** | **%** |
|---|---|---|---|---|
| **Shpenzime Operative** | **(3,580,247)** | **(3,338,580)** | **(241,667)** | **107%** |
| Lëndet e Para dhe të konsumueshme | (23,959) | (79,800) | 55,841 | 30% |
| Përfitime dhe Shpenzime për të Punësuarit | (818,614) | (999,285) | 180,671 | 82% |
| Mirëmbajtje | (92) | (30,197) | 30,105 | 0% |
| Penalitete,gjoba e dëmshpërblime | (952,971) | (136,635) | (816,336) | 697% |
| Shërbime Korporate (SLA) | (510,804) | (413,872) | (96,931) | 123% |
| Marrëdhënie me Publikun | (28,000) | (36,000) | 8,000 | 78% |
| Qera | (1,614) | (133,092) | 131,478 | 1% |
| Shërbimet Postare | (858,544) | (961,282) | 102,738 | 89% |
| Shpenzime të IT | - | (5,262) | 5,262 | 0% |
| Shpenzime Ligjore | (813) | (3,526) | 2,714 | 23% |
| Konsulencë dhe Auditim | (24,393) | (30,000) | 5,607 | 81% |
| Të tjera | (360,444) | (509,628) | 149,184 | 71% |
| **Dëmtime dhe Provigjone** | **(3,590,797)** | **(3,592,928)** | **2,131** | **100%** |
| **EBITDA** | **(11,001,928)** | **(5,777,484)** | **(5,224,444)** | **190%** |
| **Zhvlerësimi dhe amortizimi** | **(135,746)** | **(43,115)** | **(92,631)** | **315%** |
| **Fitim / Humbje Operative (EBIT)** | **(11,137,674)** | **(5,820,599)** | **(5,317,075)** | **191%** |
| **Shpenzime Financiare - neto** | **(229,673)** | **(188,757)** | **(40,916)** | **122%** |
| Të ardhura financiare | 412,360 | 25,929 | 386,430 | 1590% |
| Shpenzime financiare | (642,033) | (214,687) | (427,346) | 299% |
| Të ardhura të jashtëzakonshme | - | - | - | |
| Shpenzime të jashtëzakonshme | - | - | - | |
| **Fitim / Humbja perpara Taksave** | **(11,367,347)** | **(6,009,357)** | **(5,357,990)** | **189%** |
| Shpenzime Tatim Fitimi | - | - | - | |
| **Fitim / Humbja e Periudhës** | **(11,367,347)** | **(6,009,357)** | **(5,357,990)** | **189%** |

Shpenzimet Operative u rritën 7% ose 242 milion lekë në krahasim me ato të planifikuar të vitit 2021.
Rritja e ndjeshme e shpenzimeve operative lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve për

penalitete, gjoba dhe dëmshpërblime të cilat janë rritur me 816 milion lekë në krahasim me planifikimin e vitit 2021. Bazuar në ndarjen e detyrimeve të mbetura në OSHEE mëmë dhe ristrukturimin e tyre.

Shpenzimet për të Punësuarit, Postare, Konsulenca dhe Auditim dhe Të tjera janë më të ulta se ato të parashikuara në planin financiar ndonëse janë më të larta se ato të realizuara në vitin 2020.

Shpenzime financiare janë rritur me rreth 41 milion lekë në krahasim me planifikimin e 2021. Rritja e këtyre shpenzimeve është rrjedhojë e kostove të interesave të kredive të reja të marra në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare për kalimin e krizës së likujditetit në kushte e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në tregun e energjisë.

Gjatë vitit 2021 nuk kishte rritje të vlerës së aseteve të shoqërisë dhe vlera e shpenzimeve të amortizimit ishe thuajse e njëjtë me atë të vitit 2020.

Pasqyra e pozicionit financiar 2021 krahasuar me 2020 paraqitet në tabelën më poshtë:

| **FSHU BILANCI (000 / ALL)** | **Dhjetor '20** | **Dhjetor '21** | **Ndryshimi '21-'20** |
|---|---|---|---|
| **AKTIVE** | | | |
| **Aktive Afatgjata** | **208,920** | **207,050** | **(1,870)** |
| Aktive Afatgjata Materiale | 75,263 | 74,057 | (1,206) |
| Aktive Afatgjata Jo - Materiale | 17,246 | 13,288 | (3,958) |
| Aktive me qera | 116,146 | 119,505 | 3,359 |
| Aktive Financiare | 265 | 200 | (65) |
| | | | |
| **Aktive Afatshkurtra** | **23,252,402** | **25,525,833** | 2,273,431 |
| Inventaret | 15,146 | 9,404 | (5,741) |
| Llogari të Arkëtueshme neto | **14,491,261** | **22,602,766** | **8,111,505** |
| Llogari të Arkëtueshme të tjera neto | ***7,945,388*** | ***2,123,939*** | ***(5,821,450)*** |
| Parapagimet për tatim fitimin | | | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalente | *800,607* | 789,724 | (10,883) |
| **Total Aktive** | **23,461,322** | **25,732,883** | **2,271,561** |
| **KAPITALI** | | | |
| **Kapitali dhe Rezerva** | **(6,980,117)** | **(18,347,465)** | (11,367,347) |
| Kapitali aksionar | 3,500 | 3,500 | - |
| Rezerva të tjera | 22,387 | 22,387 | - |
| Rezerva rivlerësim asetesh | 687,970 | 687,970 | - |
| Humbje të akumuluara | (9,129,276) | (7,693,974) | 1,435,302 |
| Të ardhura neto vjetore | 1,435,302 | (11,367,347) | (12,802,650) |
| | | | - |
| **DETYRIMET** | | | - |
| **Detyrimet Totale** | **30,441,439** | **44,080,348** | **13,638,909** |
| **Detyrimet Afatgjata** | **44,776** | **122,180** | **77,404** |
| Hua Të tjera | 44,775.95 | 122,180.25 | 77,404.29 |
| **Detyrimet Afatshkurtra** | **30,396,663** | **43,958,167** | **13,561,504** |
| Llogaritë e Pagueshme Tregtare | 24,432,360 | 29,488,742 | 5,056,383 |
| Detyrimet për taksa dhe sigurime shoqërore | 28,262 | 206,915 | 178,653 |
| Tatimi mbi fitimin | 1,038,710 | 388,710 | (650,000) |
| Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata | - | - | - |
| Detyrime për qera afatshkurtëra | 72,826 | | (72,826) |
| Provizione | - | 2,804 | 2,804 |
| Huate afatshkurtra (Overdraft) | 1,443,298 | 12,180,743 | 10,737,445 |
| Detyrime të tjera afatshkurtra | 3,381,207 | 1,690,252 | (1,690,955) |
| **Total Kapitali dhe Detyrimet** | **23,461,322** | **25,732,883** | **2,271,561** |

Përgjatë vitit 2021 si rezultat i performancës negative të shoqërisë për shkak të rritjes së shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike, kapitali i shoqërisë u përkeqësua në 11.3 miliard lekë, ndërsa detyrimet u rriten në 13.6 miliard lekë ne krahasim me vitin 2020.

***Aktivet afatgjata*** u ulën për rreth 1.9 milion lekë. Gjatë kësaj periudhë nuk u planifikuan dhe nuk u kryen investime të reja dhe vlera e aktiveve afatgjata nuk u rrit. Zvogëlimi i vlerës neto të aktiveve afatgjata është rrjedhojë e amortizimit të aseteve.

***Aktivet afatshkurtra*** u rritën për rreth 2.3 miliard lekë.

| **FSHU BILANCI (000 / ALL)** | **Dhjetor '20** | **Dhjetor '21** | **Ndryshimi '21-'20** |
|---|---|---|---|
| **AKTIVE** | | | |
| **Aktive Afatgjata** | **208,920** | **207,050** | **(1,870)** |
| Aktive Afatgjata Materiale | 75,263 | 74,057 | (1,206) |
| Aktive Afatgjata Jo - Materiale | 17,246 | 13,288 | (3,958) |
| Aktive me qera | 116,146 | 119,505 | 3,359 |
| Aktive Financiare | 265 | 200 | (65) |
| | | | |
| **Aktive Afatshkurtra** | **23,252,402** | **25,525,833** | 2,273,431 |
| Inventaret | 15,146 | 9,404 | (5,741) |
| Llogari të Arkëtueshme neto | **14,491,261** | **22,602,766** | **8,111,505** |
| Llogari të Arkëtueshme të tjera neto | ***7,945,388*** | ***2,123,939*** | ***(5,821,450)*** |
| Parapagimet për tatim fitimin | | | - |
| Mjete monetare dhe ekuivalente | *800,607* | 789,724 | (10,883) |
| **Total Aktive** | **23,461,322** | **25,732,883** | **2,271,561** |

***Detyrimet afatshkurtra*** kryesisht si rrjedhojë e uljes së marrjes së kredive për përballimin e rritjes së çmimeve të energjisë në tregun e lirë u rritën me 13.5 miliard lekë.

Ndryshimet në detyrimet afatshkurtra të FSHU në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 paraqiten në tabelën si më poshtë:

| **FSHU BILANCI (000 / ALL)** | **Dhjetor '20** | **Dhjetor '21** | **Ndryshimi '21-'20** |
|---|---|---|---|
| **DETYRIMET** | | | - |
| **Detyrimet Totale** | **30,441,439** | **44,080,348** | **13,638,909** |
| **Detyrimet Afatgjata** | **44,776** | **122,180** | **77,404** |
| Huatë afatgjata neto | - | - | - |
| Detyrime pë qera financiare | - | - | - |
| Hua Të tjera | 44,775.95 | 122,180.25 | 77,404.29 |
| Provizione | - | - | - |
| **Detyrimet Afatshkurtra** | **30,396,663** | **43,958,167** | **13,561,504** |
| Llogaritë e Pagueshme Tregtare | 24,432,360 | 29,488,742 | 5,056,383 |
| Detyrimet për taksa dhe sigurime shoqërore | 28,262 | 206,915 | 178,653 |
| Tatimi mbi fitimin | 1,038,710 | 388,710 | (650,000) |
| Pjesa afatshkurtër e huave afatgjata | - | - | - |
| Detyrime për qera afatshkurtëra | 72,826 | | (72,826) |
| Provizione | - | 2,804 | 2,804 |
| Huate afatshkurtra (Overdraft) | 1,443,298 | 12,180,743 | 10,737,445 |
| Detyrime të tjera afatshkurtra | 3,381,207 | 1,690,252 | (1,690,955) |
| **Total Kapitali dhe Detyrimet** | **23,461,322** | **25,732,883** | **2,271,561** |

**2.3. Mbi zbatimin e strukturës organizative, administrimin e marrëdhënieve të punës, dhënien e pagave dhe shpërblimeve gjatë periudhës që auditohet.**

Në zbatim të kësaj piketë programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1) Struktura organizative
2) Dosjet e personelit
3) Rregullorja e brendshme
4) Rregullorja për përcaktimin e e kritereve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës
5) Kontrata kolektive dhe ato individuale të punës
6) Procedurat e rekrutimit dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës
7) Procedurat e dhënies të masave disiplinore
8) Hartimi i listë - pagesave të pagesave të pagave.

Për periudhën objekt auditimi struktura organizative të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SHA (OSHEE) është miratuar dhe ndryshuar, si më poshtë:
-Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 21, datë 02.07.2020 "Mbi miratimin e strukturës organizative të OSHEE Group SHA (Shoqëria mëmë)", është miratuar në parim struktura e saj. Me anë të këtij vendimi janë miratuar departamentet, sektorët dhe njësitë e strukturës organizative, por nuk janë miratuar sa punonjës do të ketë çdo departament/sektor /njësi e shoqërisë. Kjo bie në kundërshtim me vendimin e Entit Rregullator të Energjisë nr.798/2, datë 20.12.2018, në të cilin përcaktohet periudha tranzitorë që do të përfundonte pas 12 muajsh, pra në datën 20.12.2019, ku përfshihej dhe sa më lart cituar përcaktimi i saktë i strukturave organizative.
-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 8935/2 prot, datë 23.12.2020 "Mbi miratimin e strukturës organizative të OSHEE GROUP SHA", është miratuar struktura organizative dhe numri total i punonjësve të shoqërisë prej 304 punonjësish.
-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 4518/1 prot, datë 10.06.2022 "Mbi miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative të shoqërisë "Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, OSSH" SHA", është krijuar Zyra e Zyrtarit të Pajtueshmërisë, e përbërë nga Zyrtari i Pajtueshmërisë me nivel page 270,000 lekë dhe nga një specialist me nivel page 210,000 lekë.
-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 5275/1 prot, datë 01.08.2022 "Mbi miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative të shoqërisë "Furnizuesi i Shërbimit Universal" SHA", është miratuar një ndryshim në Departamentin e Menaxhimit të Kontratave.
-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 5275/6 prot, datë 01.08.2022 "Mbi miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative të shoqërisë OSHEE SHA", është miratuar shtimi i pozicionit të Zyrtarit të Përputhshmërisë me nivel page 280,000 lekë.
-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 7256/1 prot, datë 03.10.2022 "Mbi miratimin e një ndryshimi në strukturën organizative të shoqërisë OSHEE SHA", është miratuar zvogëlimi i numrit të punonjësve të Departamentit të Kontrollit dhe Rikuperimit të Humbjeve (1 + 205) me 83 punonjës. Në varësinë e Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE Group SHA krijohet Task Forca e Energjisë me përbërje (1 + 82). Me këtë vendim ngarkohet Administratori i shoqërisë OSHEE Group SHA të vendosë në dispozicion fondin e pagave dhe punonjësit e nevojshëm për Task Forcën e Energjisë.
- Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 7784/1 prot, datë 20.10.2022 "Për emërimin në detyrë të Drejtorit të Përgjithshëm të Task Forcës së Energjisë", është emëruar Drejtori i Përgjithshëm i Task Forcës, me pagë të barazvlefshme me Drejtorin e Departamentit në

OSSH SHA. Në këtë vendim janë përcaktuar nivelet e pagave për pozicionet si: pozicioni Drejtor Drejtorie me pagë të barasvlershme me Drejtorin e Drejtorisë në OSSH SHA, pozicioni Shef Sektori me pagë të barasvlershme me Shefin e Sektorit në OSSH SHA, dhe pozicioni Specialist me pagë të barasvlershme me Specialist në OSSH SHA.
- Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 8201 prot, datë 27.10.2022 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e strukturës në varësi të Asamblesë, Task Forca e Energjisë", janë miratuar rregullat e organizimit dhe funksionimit të kësaj strukture.

-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 22326 prot., datë 01.11.2019 midis OSHEE SHA të përfaqësuar nga Administratori A Ç dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë (FSPISH) të përfaqësuar nga T K, për një periudhë katër vjeçare.
-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 44 prot., datë 07.01.2020 midis FTL SHA të përfaqësuar nga Administratori E R dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë (FSPISH) të përfaqësuar nga T K, me afat deri më 07.01.2023.
-Marrëdhëniet e punës janë të rregulluara me kontratën kolektive nr. 64 prot., datë 08.01.2020 midis OSSH SHA të përfaqësuar nga Administratori P L dhe Federatës Sindikale të Punonjësve të Industrisë (FSPISH) të përfaqësuar nga T K, me afat deri në 01.01.2023.
- Niveli i pagave është përcaktuar me Vendimin e Këshillit të ministrave nr.574, datë 03.08.2016 "Miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA".

| **Titulli i Gjetjes** | Mos plotësimi i numrit mesatar të punonjësve. |
|---|---|
| **Situata 1:** | Sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7,138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 6,420 punonjës. Fondi i pagave është 3,258,029,500 lekë, pra 359,374,326 lekë më pak se programi.<br>Sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7,138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 6,564 punonjës. Fondi i pagave është 6,536,253,000 lekë, pra 420,424,852 lekë më pak se programi.<br>Sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 6,156 punonjës. Fondi i pagave është 6,359,574,212 lekë, pra 921,310,438 lekë më pak se programi. |
| **Kriteri:** | Përcaktimet e programeve ekonomike të viteve 2021 dhe 2022. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos plotësimi i nevojave të shoqërisë me numrin e parashikuar të punonjësve ndikon në performancën e saj. |
| **Shkaku:** | Numri i punonjësve të shoqërisë është më i ulët se parashikimet e programit dhe për pasojë sjell mos plotësimin e nevojave të saj. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë referuar parashikimeve të programit ekonomik. |

| | |
|---|---|
| **Afati:** | Në vazhdimësi |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Mangësi në procedurat e rekrutimit të punonjësve. |
| **Situata 2:** | Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA:<br>-Nuk është hartuar Rregullorja e Brendshme.<br>-Është hartuar "Procedura e lëvizjeve të stafit", "Kodi i sjelljes", dhe "Udhëzimet operative në sektorin e planifikimeve, trajnimeve dhe vlerësimet e performancës".<br>-Nuk është bëre për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve.<br>-Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzorë, pranë OSHEE SHA nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.<br>-Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.<br>-Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 86 masa disiplinorë, në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA, mëposhtme nga këto 14 "Vërejtje me shkrim",3 masa "Vërejtje me shkrim, paralajmërim për largim nga puna"dhe 69 masa "Pushim nga puna". Janë audituar 35 nga këto procedura, pra 40%. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinorë konstatohet se nuk ka procedura transparente, dhe nuk ka nuk ka komision apelimi. |
| **Kriteri:** | Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015. |
| **Ndikimi/Efekti:** | Mos zbatimi i procedurave të rekrutimit të marrëdhënieve të punës sipas ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015 sjell parregullësi dhe mangesi në punësimin e punonjësve për shoqërinë OSHEE SHA. |
| **Shkaku:** | Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë" dhe mangësitë në zbatimin e procedurave rekrutimit të punonjësve të rinj të shoqërisë OSHEE SHA. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime 1:** | Nga Administratori dhe Departamanti i Burimeve Njerëzore , të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimi dhe miratimi i rregullores së brendshme të shoqërisë OSHEE SHA. |
| **Rekomandimi 2:** | Nga Administratori dhe Departamanti i Burimeve Njerëzore , të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë OSHEE SHA. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Mos miratimi dhe mos përcaktimi i kritereve për klasifikimin e pagave. |
| **Situata 3:** | Nga auditimi konstatohet se, niveli i pagave është përcaktuar me Vendimin e Këshillit të ministrave nr. 574, datë 03.08.2016 "Miratimin e trajtimit financiar të |

| | |
|---|---|
| | personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA".<br>Niveli i klasave në këtë vendim është bërë në 4 grupe nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, por në këtë klasifikim nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë qartë këto klasa. *Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk ka kritere të përcaktuara qartë dhe praktika e krijuar ka qenë klasifikimi nga 1, si shkalla me e ulët në 4, si shkalla më e lartë, duke ju lenë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësive, detyrave dhe shkalles se vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë.* Nga sa më sipër rezulton se nivelet e pagave për vitet 2020, 2021 dhe 2022, duhet të ishin miratuar nga organet kolegjiale drejtuese (Këshilli Mbikqyrës) të shoqërisë tregtare, me kapital mbi 50 % shtetëror, brenda kufirit minimal e maksimal të pagës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare të OSHEE SHA. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6, pika 1, shkronja *(a), ku citohet se organe kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërorë dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.* |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos përcaktimi i kritereve lidhur me klasifikimin e nivelit të pagave, sjell paqartësi në dhënien e tyre. |
| **Shkaku:** | Mos përcaktimi i kritereve lidhur me klasifikimin e nivelit të pagave |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandimi:** | Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura, lidhur me miratimin e pagave dhe përcaktimin e kritereve për klasifikimin e tyre sipas secilit nivel. |

| **Titulli i Gjetjes** | Paguar më tepër punonjësve pagë në natyrë se sa kuota e miratuar. |
|---|---|
| **Situata 4:** | Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën mars 2018 – qershor 2020 rezultoi se; me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.02.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë", pika 2, germa a), kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt/ditë pune. Nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjorë për caktimin e dietës ushqimorë në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, dhe paga në natyrë (dieta) për trajtim ushqimor është paguar në masën 500 lekë vakt/ditë pune. Ky fenomen është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse të cilat përsëri konstatohet se nuk janë bërë reflektimet e duhura për përditësimin e legjislacionit dhe ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive. Nga llogaritja e listëpagesave të periudhës korrik 2020 – dhjetor 2022 rezulton se ky përfitim është në masën 1,878,988,532 lekë, nga 1,127,393,119 lekë që duhej të ishte pra është paguar më |

| | |
|---|---|
| | tepër shuma prej ***751,595,412.8 lekë*** *e cila konsiderohet* ***efektit financiar negativ*** për buxhetin e shoqërisë. |
| **Kriteri:** | Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. Nr. 68, datë 7.2.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore", pika 2, gërma a). |
| **Ndikimi/Efekti**: | Efekt financiar negativ në shumën prej ***751,595,412.8 lekë*** lekë. |
| **Shkaku:** | Mos azhurnimi i ndryshimeve ligjore dhe ndryshimi i kontratës kolektive të shoqërisë në përputhje me këto ndryshime. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandimi:** | Këshilli Mbikqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrë masat e duhura, për mos azhurnimin e legjislacionit, dhe të ndiqen procedurat administrative për personat përgjegjës, bazuar në Kodin e Punës dhe Rregulloren e brendshme të Shoqërisë. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrë masat e duhura dhe të kryejë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatës për mosvazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga përcaktimet ligjore. |

| **Titulli i Gjetjes** | Proceset gjyqësore për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhenieve të punës. |
|---|---|
| **Situata 5:** | Në lidhje me proceset gjyqësorë në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësorë në apel, janë humbur 25 çështje gjyqësorë në Gjykatat e Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **18,796,671 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë humbur dhe janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësorë në Gjykatën e Shkallës së Parë, në vlerën **63,843,433 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimorë. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera ***82,640,104 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ*** **për buxhetin e shoqërisë.** |
| **Kriteri:** | Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Efekt financiar negativ në shumën prej 82,640,104 lekë. |
| **Shkaku:** | Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", dhe mangësitë në zbatimin e procedurave të largimit nga puna të punonjësve, të shoqërisë OSHEE SHA. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandimi:** | Nga Administratori, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave te shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Dhënia e shpërblimeve në kushtet kur shoqëria paraqitet me rezultat financiar negativ. |
| **Situata 6:** | Nga auditimi konstatohet se, me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 2123/1 prot, datë 14.04.2022 "Mbi dhënien e një page shpërblim për punonjësit e angazhuar në kuadër të Planit të Gatishmërisë së shoqërisë OSSH SHA", janë shpërblyer 1211 punonjës me vlerën **60,925,595 lekë.**<br>-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 9423 prot, datë 30.12.2021 "Mbi dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë për punonjësit e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group SHA, FTL SHA, OSSH SHA dhe FSHU SHA", janë dhënë shpërblime me vlerën **128,240,000 lekë.**<br>Duke qenë se shoqëria rezulton me rezultat financiar negativ (pra me humbje), dhe shpërblimi për një kategori punonjësish është dhënë 2 herë brenda një viti, vlera ***189,165,595 lekë,*** *konsiderohet efektit financiar negativ* për buxhetin e shoqërisë. |
| **Kriteri:** | Neni 34 i Kontratës Kolektive *"Për një kategori të caktuar punonjësish, në përputhje me interesat e shoqërisë dhe me performancën e saj ekonomike, Administratori mund të japë një shpërblim ekstra në vit me motivacion realizimin e objektivave të ngarkuara".* |
| **Ndikimi/Efekti**: | Efekt financiar negativ në shumën prej 189,165,595 lekë. |
| **Shkaku:** | Mos zbatimi i përcaktimeve të kontratës kolektive të shoqërisë lidhur me dhënien e shpërblimeve për punonjësit. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandimi:** | Asambleja e Aksionarit dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë situatën dhe të marrin masa lidhur me dhënien e shpërblimeve konform rezultateve financiare të shoqërisë. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Proceset gjyqësore për ndërprerjen e paligjshme të marrëdhenieve të punës. |
| **Situata 7:** | Në lidhje me proceset gjyqësorë në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësorë në apel, janë humbur 25 çështje gjyqësorë në Gjykatat e Lartë dhe në Gjykatat e Apelit, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **18,796,671 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë humbur dhe janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësorë në Gjykatën e Shkallës së Parë, në vlerën **63,843,433 lekë** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimorë. Në total për periudhën objekt auditimi janë paguar si dëmshpërblime për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera ***82,640,104 lekë e cila konsiderohet efektit financiar negativ*** **për buxhetin e shoqërisë.** |
| **Kriteri:** | Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", i ndryshuar me ligj nr.136/2015, datë 05.12.2015. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Efekt financiar negativ në shumën prej 82,640,104 lekë. |

| | |
|---|---|
| **Shkaku:** | Mos zbatimi i ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i punës i Republikës të Shqipërisë", dhe mangësitë në zbatimin e procedurave të largimit nga puna të punonjësve, të shoqërisë OSHEE SHA. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandimi:** | Nga Administratori, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave te shkëputjes të marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë. |

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr. 3 datë 10.03.2023 dhe për këtë çështje personat e atakuar me shkresën përcjellëse Nr. 4230/24 Prot, datë 30.05.2023, administruar në KLSH me Nr. 826/7, datë 31.05.2023, znj. Blerta Isa, ka bërë komente dhe shpjegime dhe konkretisht:

***<u>Pretendimet e subjektit:</u>***
*1.VKM Nr.574, datë 03.08.2016 nuk është përcaktuar detyrimi për miratimin e nivelit të pagave për vitet në vijim. Bazuar në këtë fakt nuk është e nevojshme të ketë miratime të tjera përveç atij të vitit 2016.*
*2.Në periudha të ndryshme kohore OSHEE SHA ka publikuar vende vakante të krijuara në shoqëri.*
*3.Aplikimi i masës 300 (treqind) lekë në ditë do të cënonte përparësinë që ka Kontrata Kolektive në rregullimin e marrëdhënieve të punës.*
*4.Sa i takon shpërblimeve, shoqëria u përball me një situate të kushteve ekstreme të motit në të gjithë territorin.*
*5.Kjo praktikë është ndjekur në vite, stafi është i trajnuar mbi procedurat e zgjidhjes së marrëdhënies të punës dhe kanë eksperiencë pune në vazhdimësi.*
*6.Aktiviteti i Departamentit të Burimeve Njerëzore mbështetet në procedurat e miratuara nga Administratori i Shoqërisë, lidhur me funksionet bazë, si: rekrutimi, lëvizje stafi, masa disiplinore, pagat dhe kompesimet.*

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit të KLSH -së:</u>** Nga shqyrtimi i observacionit të sjellë nga subjekti konstatohet se, argumentet e sjella nuk qartësojnë arsyet pse nuk janë vendosur kritere lidhur me klasifikimin e pagave për çdo kategori, si dhe arsyen e mos miratimit të tyre. Sa më sipër observacioni juaj nuk merret në konsideratë.
Sa i takon pretendimeve të tjera, duke qenë se nuk paraqitet dokumentacion justifikues bashkëlidhur, observacionet nuk merren në konsideratë dhe qëndimi i grupit të auditimit është i njëjtë.

**2.4**. **Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime etj.).**
Për auditimin e këtij drejtimi të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i pagesave të bankës,
Dokumentacioni i arkëtimeve, pagesave të arkës,
Dokumentacioni hyrjeve dhe daljeve të magazinës,

Dokumentacioni i mbajtur mbi marrjen në dorëzim të furnizimeve,
Dokumentacioni i mbajtur për blerjet me vlera të vogla.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***
Me urdhrin nr. 550, datë 15.01.2020, Administratori i OSHEE-së, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga L M, kryetar, A G anëtar dhe E D anëtare.
Me urdhrin nr. 02 datë 05.01.2021, Administratori i OSHEE-së, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga kryetar, A G,anëtar L M dhe E D anëtare.
Me urdhrin nr. 01, datë 05.01.2022, Administratori i OSHEE-së, ka ngritur komisionin e blerjeve me vlera të vogla i përbërë nga L M, kryetar, A G anëtar dhe E D anëtare.

Në procesin e auditimit të kontratave që shoqëria ka lidhur për shërbimin e ruajtjes fizike të ndërtesave, aseteve dhe njerëzve u konstatuan parregullsi si vijon:

| **Titulli i Gjetjes** | Parregullsi në kontratat e shërbimit të sigurisë fizike |
|---|---|
| **Situata 1:** | -Në kontratën e lidhur me E. S. sh.p.k., dhe OSSH Drejtoria Rajonale Burrel, me datë 17.06.2021, me vlerë 123,310,827 lekë si dhe në kontratën e lidhur më datë 19.08.2021, mes Drejtorisë Rajonale të OSSH sh.a., dhe FSHU sh.a. Berat dhe operatorit ekonomik M.-Security sh.p.k., kontraktuesi duhet të paraqesë sigurim kontrate në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e një garancie sigurimi, lëshuar nga një institucion financiar. Vlera me TVSH e kontratës është 85,963,221 lekë.<br>Kontrata është formuluar duke iu referuar kontratave të formatuara për furnizime tipike të procedurave të tenderimit, dhe duke mos reflektuar specifikat e shërbimit të kërkuar si dhe risqet që mbart mos realizimi i kontratës.<br>Në nenin 15, citohet se: Dëmet e likuiduara për kryerjen e vonuar të shërbimeve do të llogariten me tarifat 1/1000 të vlerës përkatëse të mbetur nga çmimi i përgjithshëm i kontratës por jo më pak se 25% e vlerës së kontratës.<br>Autoriteti Kontraktor nuk ka siguruar riskun e mos realizimit të shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve e aseteve të shoqërisë. Në një kontratë me një operator tjetër ekonomik që ofron shërbim të njëjtë kjo pikë është përcaktuar me marrjen e një siguracioni të përgjegjësisë së aktivitetit, sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për të zhdëmtuar Autoritetin Kontraktor për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimit.<br>-Kontrata e sipërcituar nuk është formuluar sipas parakushteve të paracaktuar në nenin 18 "Kontrata ndërmjet palëve" të të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë fizike",udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018, "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike", Kreu V, Menaxhimi i shërbimeve të SHPSF-së, -Organizimi dhe drejtimi i SHPSF-së, që sanksionon që:*2. Kontrata ndërmjet palëve për kryerjen e shërbimeve nga SHPSF-të përmban: a) Nënkategorinë e licencës, drejtuesin teknik dhe objektin konkret në ruajtje. b) Mënyrën e ruajtjes së objektit, duke specifikuar llojin e shërbimit (me punonjës shërbimi, me pajisje sinjalizuese alarmi, me kamera sigurie, me qen, me kombinim të mënyrave të mësipërme etj.). c) Numrin e vendrojave kur objekti ruhet me roje dhe numrin e punonjësve të shërbimit, duke llogaritur 40 orë punë* |

| | |
|---|---|
| | *në javë ose koeficienti 1.66 për një punonjës shërbimi, si dhe skemat e ruajtjes së objektit. d) Rregulloren e brendshme të institucionit/ subjektit ku të përcaktohen rregullat për regjimin e hyrje/daljeve në objekt, ndriçimin, rrethimin dhe mjetet vëzhguese e sinjalizuese.* ***e) Trajtimin financiar të punonjësit të shërbimit të SHPSF-së, duke përcaktuar detyrimin që paga të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Pagesa bëhet me bankë. f) Skemën e ruajtjes së objekteve, së bashku me planin e dislokimit, kur merren në ruajtje objekte. Skema e ruajtjes dhe plani i dislokimit përgatiten nga drejtuesi teknik i SHPSF-së. g) Llojin e armatimit, pajisjet, mjetet e shërbimit, uniformën, simbolet dhe shenjat dalluese. h) Detyrimet financiare midis tyre, në raste të shkaktimit të dëmit.*** *i) Detyrat dhe të drejtat e palëve. j) Kohëzgjatjen e kontratës dhe mënyrat e zgjidhjes së saj.*<br>Në lidhje me zbatimin e kontratës, nga Autoriteti Kontraktor nuk janë kërkuar deklarimet e pagesave të sigurimeve shoqërore për punonjësit të cilët ka përcaktuar për të kryer shërbimin e kontraktuar. Duke u nisur nga fakti që në ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedura, pjesa më e madhe e kostos së shërbimit përbëhet nga pagat e punonjësve, pagë kjo e përcaktuar që të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me VKM-në përkatëse, si dhe shtesat që do të bëhen në pagën e punonjësve për turnin e II, III, ditët e festave, dhe sigurimet shoqërore, Autoriteti Kontraktor nuk mund të kryejë verifikimet nëse fondet e kaluara ndaj operatorit ekonomik janë përfituar në përputhje me ofertat ekonomike të kryera në procesin e prokurimit. |
| **Kriteri:** | Udhëzimi nr. 130, datë 05.03.2018, "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike", Kreu V, pika 2, ka përcaktuar qartë trajtimin financiar të punonjësit të shërbimit sa është dhe se duhet të kryhet me bankë. |
| **Ndikimi/Efekti**: | -Mos sigurimi i riskut për mos realizimin e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve e aseteve të shoqërisë, mund të sjellë pasoja me dëme të rëndësishme për shoqërinë. Sigurimi i një siguracioni të përgjegjësisë të aktivitetit, sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për të zhdëmtuar Autoritetin Kontraktor për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimit, ul riskun e zvogëlimit të aseteve të shoqërisë.<br>-Formulimi i kontratës mes palëve pa përfshirë dhe përcaktimet e udhëzimit në lidhje pikën 2, ka si pasojë rritjen e riskut për mos kryerjen e shërbimit me personelin e parashikuar dhe zvogëlimin e mundësive të AK për verifikimet përkatëse. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Autoriteti Kontraktor të marrë masa që në kontratat e ardhshme të shërbimit të sigurisë fizike detyrimet financiare mes palëve në rastet e shkaktimit të dëmeve të përcaktohen qartë dhe duke detajuar asetet përkatëse që OE do marrë përsipër për sigurinë fizike. Duke u nisur nga fakti që vlera e aseteve që i lihen për ruajtje është më e lartë se vlera e kontratës së shërbimit, garancia prej 10% e kontratës së shërbimit nuk mbulon dëmin që mund të shkaktohet në rast të moskryerjes së shërbimit. AK duhet të kërkojë garanci nga OE se do dëmshpërblehet në rast të |

| | |
|---|---|
| | shkaktimit të dëmeve nga moskryerja e ruajtjes së sigurisë fizike.<br>- Autoriteti Kontraktor të marrë masa për hartimin e kontratave në përputhje të parakushteve të përcaktuara në udhëzime dhe të ndjekë zbatimin e tyre nga OE fitues. |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 826/7Prot., datë 31.05.2023, "Mbi projekt raportin e KLSH ", dhe shkresë nr. 8410/3 datë 30.05.2023 nga personat përgjegjës znj. L P dhe z. S K, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

| |
|---|
| ***Pretendimi i subjektit:***<br>*Pretendimi i subjektit është se kontratat janë lidhur sipas standardeve të udhëzimeve të APP për kontratat e furnizimeve normale dhe 10% sigurim i kontratës është i mjaftueshëm.* |

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit:**
Autoriteti Kontraktor nuk ka sqaruar se si kanë vendosur mes palëve në rast të shkaktimit të dëmit të aseteve të shoqërisë, (pika ***h) Detyrimet financiare midis tyre, në raste të shkaktimit të dëmit.***) i cili në këto raste mund të tejkalojë disa herë vlerën e kontratës, si do të garantohet AK me 10% e vlerës.
Në lidhje me pretendimet tuaja ku nuk janë paraqitur argumente të reja për uljen e riskut të dëmtimit të aseteve ju kujtojmë se përveç ligjeve dhe VKM përkatëse, si shoqëri publike duhet të zbatoni pjesën II, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, i ndryshuar, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Menaxhimi i riskut të lidhur me aktivet, pikat 17-25, ku përcaktohen objektiva, plane mekanizma kontrolli dhe masat përkatëse për uljen e riskut të dëmtimit të aktiveve të shoqërisë.
Observacioni i mësipërm nuk merret në konsideratë.

| **Titulli i Gjetjes** | Mos dokumentimi i kryerjes së detyrimeve kontraktore në Bashkimet e Operatorëve Ekonomikë me fatura tatimore. |
|---|---|
| **Situata 2:** | -Në procedurat e pagesave disa furnitorëve, bashkime operatorësh ekonomik, u konstatua se pagesat e shërbimeve dhe mallrave janë faturuar nga një nga operatorët ekonomikë dhe jo nga të gjithë pjesëmarrësit e bashkimit ekonomik. Këto bashkime operatorësh ekonomikë nuk kanë përmbushur detyrimet mbi bazën e të cilave janë shpallur fitues dhe kanë nënshkruar kontratat. |
| **Kriteri:** | Këto veprime janë në kundërshtim me Nenin 88, Bashkimi i operatorëve ekonomikë ku citohet: 1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14,të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. 2. ***Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës.*** Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke |

| | |
|---|---|
| | specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.<br>***5. Në rast se bashkimi i operatorëve ekonomikë shpallet fitues, kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.***<br>Në Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 32.2 përcaktohet se kur dhe si lind detyrimi për zbatimin e TVSH. Neni 32.2 citon: ***Gjithashtu që një transaksion të konsiderohet në fushën e zbatimit të TVSH, duhet të ekzistojë një lidhje e drejtpërdrejtë mes furnizimit të kryer dhe kundërvlerës (pagesës) së marrë.*** |
| **Ndikimi/Efekti**: | Në këtë raste, kemi të bëjmë me deklarime të pasakta pranë organeve tatimore, pasi shoqëritë kanë deklaruar një shumë për të cilën nuk ka lidhur kontratë.<br>Gjithashtu këto fatura tatimore mund të përdoren në procedura prokurimi si kontrata e ngjashme me një vlerë të pasaktë. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Autoriteti Kontraktor duhet të marrë masa që me shpalljen fitues të procedurës së tenderimit, BOE të firmosin kontratën për furnizim mallrash ose shërbime, dhe duke ofruar shërbimet në përqindjet e rëna dakord dhe duke i shoqëruar me faturat tatimore përkatëse. |

Në procesin e auditimit të pagesave të bankës u konstatua se:

| **Titulli i Gjetjes** | Lidhje e kontratave pa kryer procedurat e prokurimit |
|---|---|
| **Situata 3:** | -Nga auditimi konstatohet se shërbimi i ekspertëve kontabël për auditimin e pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi, është kryer me miratim Asambleja e Aksionarit pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.<br>Për periudhën 2020 janë shpenzuar 42,073,200 lekë.<br>Për periudhën 2021 janë shpenzuar 97,372,800 lekë.<br><br>-Nga auditimi i pagesave të bankës për periudhën objekt auditimi u konstatua se shoqëria ka lidhur kontratë për kolaudimin e matësve me shoqëritë 3 G sh.p.k, VME sh.p.k. dhe HTT sh.p.k. pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. |
| **Kriteri:** | Neni 4, i Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:1. "Autoritet kontraktor" është çdo ent që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij publike. 9. "Fondet publike" janë:<br>a) çdo vlerë monetare e buxhetit të shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;<br>b) çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;<br>c) fonde ndihme ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, në të cilën kërkohet zbatimi i procedurave të këtij ligji; |

| | |
|---|---|
| | ç) të ardhurat nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos kryerja e procedurave të prokurimit ul ekonomicitetin dhe eficiencën në përdorimin e fondeve publike. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve në zbatim të funksionit ligjor për zgjedhjen e ekspertëve kontabël për auditimin ligjor të pasqyrave financiare të shoqërisë duhet të kryejë procedurat e prokurimit për këtë proces. Megjithëse tarifa orare është e caktuar me rregullore të brendshme nga IEKA, sasia e orëve të punës për angazhimet audituese mund të ndryshojë në varësi të eksperiencës së tyre, njohjes së mëparshme të subjekteve, kapaciteteve të tyre pa e ulur cilësinë e auditimit. |

| **Titulli i Gjetjes** | Copëzim i fondit limit në blerjet me vlera të vogla |
|---|---|
| **Situata 4:** | Nga auditimi i procedurave të prokurimit për vitin 2022, konstatohet se Autoriteti Kontraktor, Komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla ka copëzuar fondin limit. Konkretisht në procedurat me objekt “Blerje ndriçues zyre për godinën qendrore të OSHEE Group sha” me vlerë 950,000 lekë pa Tvsh, me urdhër prokurimi nr. 7469/2 datë 29.07.2022, ku është kërkuar malli ndriçues zyre, copë 300, dhe “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike për mirëmbajtjen e godinës qendrore” me vlerë 750,000 lekë pa Tvsh, me urdhër prokurimi nr. 7462/1 datë 28.07.2022. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, neni 34 pika 2, me ndryshimet vijuese të tij, ku citohet: “*1. Llogaritja e vlerës së parashikuar të një prokurimi bazohet në shumën totale që duhet paguar pa TVSH, siç parashikohet nga autoriteti ose enti kontraktor, duke përfshirë çdo pagesë siç përcaktohet qartë në dokumentet e tenderit. Kur autoriteti ose enti kontraktor u jep çmime ose pagesa kandidatëve ose ofertuesve, ai duhet t'i mbajë ato parasysh kur përllogarit vlerën e prokurimit. 2. Përzgjedhja e metodës që përdoret për përllogaritjen e vlerës së prokurimit nuk bëhet me qëllim për ta përjashtuar atë nga fusha e zbatimit të këtij ligji. Prokurimi nuk duhet të ndahet me qëllim shmangien nga fusha e zbatimit e këtij ligji, përveçse kur kjo justifikohet nga arsye objektive.*” |
| **Ndikimi/Efekti**: | Ndikimi në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e efiçencës në përdorimin e këtyre fondeve. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore. |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandime:** | AK të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomicitet. |

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla.

**2.5. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësit e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë; analiza e debitorëve e kreditorëve; arkëtimi i detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj., ndaj buxhetit të shtetit.**

Në zbatim të kësaj pike të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
Dokumentacioni i pasqyrave financiare për periudhat ushtrimore 2021-2022;
Dokumentacioni i regjistrimit të llogarive kontabël;
Dokumentacioni mbi hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare;
Dokumentacioni i mbajtur mbi përllogaritjen, njohjen, pagesën dhe regjistrimin e detyrimeve fiskale;
Dokumentacioni i mbajtur mbi detyrimet.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet:***
Përgatitja dhe paraqitja e pasqyrave financiare është bërë përgjithësisht në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe statutit të shoqërisë. Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, (SNRF). Shoqëria i ka përgatitur pasqyrat financiare në bazë të parimit të vijimësisë që supozon se shoqëria do ti përmbushë kërkesat e veta për financime, apo për të paguar detyrimet e saj në kohën kur kërkohen dhe për të vazhduar aktivitetet e saj në të ardhmen.
Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, përveç rasteve kur SNRF kërkon baza të tjera matje.
Shoqëria "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike" sh.a (OSHEE), është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror. Në 31.12.2019 kapitali i shoqërisë ishe 29,936,709,000 lekë i ndarë në 29,936,709 aksione me vlerë 1,000 lekë për aksion. "Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë"është zotërues 100% i vlerës së aksioneve.
Në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike, bazuar në vendimin e Asamblesë së OSHEE-GROUP Sh.a nr. 458, datë 15.02.2017 "Për aprovimin e modelit të korporatës", Ministri i MIE, me urdhrin nr. 157, datë 12.02.2018, urdhëroi krijimin e tre shoqërive aksionare, me ofertë private, me kapital themeltar nga 3,500 mijë lekë financuar nga OSHEE-GROUP Sh.a.
Në kuadër të reformës me qëllim liberalizimin e sektorit të energjisë detyrimi për ndarjen e aktiviteteve dhe krijimin e shoqërive të reja është sanksionuar edhe në VKM nr.519, datë 13.07.2016 "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike".

Shoqëria në momentin e ndarjes kishte si objekt të veprimtarisë: "*Të ofrojë energji elektrike nëpërmjet rrjetit të shpërndarjes për fushat e mëposhtme të mbuluara: kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe të drejtpërdrejta të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike, për furnizimin e klientëve tariforë të lidhur me rrjetin e saj të shpërndarjes, me tarifa të rregulluara në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar. Kryerja e veprimtarive të nevojshme dhe drejtpërdrejtë të lidhura me funksionimin e rrjetit të shpërndarjes, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe licencën e akorduar, duke përfshirë, por pa u kufizuar në: ndërtimin, funksionimin dhe pronësinë e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sigurimin e energjisë elektrike klientëve etj."*

Në funksion të ndarjes në 1 Janar 2020 filluan aktivitetin ekonomik shoqëritë FSHU sh.a, OSSH sh.a dhe FTL sh.a. Duke vlerësuar ecurinë e procesit të ndarjes së aktivitetit të shoqërisë OSHEE-GROUP Sh.a, si dhe plotësimin e nevojshëm me aktet ligjore e nënligjore, me propozim të aksionerit, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi që licencat të bëhen efektive pas një periudhe transitore prej 12 muaj, duke saktësuar se gjatë kësaj periudhe, veprimtaria e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, vazhduan të kryhen nga OSHEE-GROUP Sh.a gjatë vitit 2019.
Ministri i MIE, me urdhrin nr. 157, datë 12.02.2018, në përputhje me ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" me qëllim ndarjen e aktivitetit të shërbimit universal të furnizimit për klientët e tregut të rregulluar, nga aktiviteti i shpërndarjes dhe aktiviteti i shitjes në tregun e lirë të energjisë elektrike, urdhëroi krijimin e tre shoqërive aksionare, me ofertë private, me kapital themeltar nga 3,500 mijë lekë financuar nga OSHEE-GROUP Sh.a.
Nisur nga përcaktimi i ligjit dhe objekti i aktivitetit të secilës shoqëri stafi drejtues i shoqërisë OSHEE sh.a. përcaktoi2 kritere kryesore për ndarjen:
Për ndarjen e Aktivit të shoqërisë si kriter të ndarjes ka përcaktuar:
-Kriterin e funksionit të aktiveve të shoqërisë OSHEE sh.a në raport me objektin e aktivitetit të secilës shoqëri. Kjo do të thotë se aktivet e shoqërisë OSHEE sh.a do t'i transferohen shoqërisë përkatëse në funksion të aktivitetit të së cilës janë.
-Për ndarjen e kapitalit themeltar, kapitaleve të veta dhe detyrimeve:
Është përdorur kriteri i ndarjes së kapitaleve të veta mbi bazën përqindjes së vlerës neto të aktiveve të çdo shoqërie të ndarë në raport me aktivin neto të shoqërisë OSHEE sh.a para ndarjes.

***Për afatet e hartimit dhe deklarimit të pasqyrave financiare në organet përkatëse***

| **Titulli i Gjetjes** | Deklarime me vonesë të detyrimeve tatimore. |
|---|---|
| **Situata 1:** | OSHEE Group sha, ka kryer vetëm deklaratën e tatim fitimit për periudhën 2020, brenda afatit dhe të gjitha deklarimet e tjera janë bërë me vonesë.<br>Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e OSHEE Group sh.a., nuk i ka miratuar pasqyrat financiare të periudhës 2020 dhe 2021, si dhe ka vendosur t'i aprovojë pasi ekspertët kontabël që po bëjnë ri-auditimin të shprehen me opinion ndryshe nga auditimi i parë i cili ishte "refuzim opinioni".<br>-Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (F.SH.U.), përveç deklaratës së tatim fitimit të kryer më 31.03.2021, të gjithë dorëzimet e tjera i ka kryer me vonesë.<br>-Operatori i Sistemit të Shërbimit sh.a. (O.S.SH.) përveç deklaratës së tatim fitimit të kryer më 31.03.2021, të gjithë dorëzimet e tjera i ka kryer me vonesë.<br>-Furnizuesi i Tregut të Lirë, sh.a, (F.T.L.), përveç deklaratës së tatim fitimit të kryer më 31.03.2021, të gjithë dorëzimet e tjera i ka kryer me vonesë. |
| **Kriteri:** | Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me:<br>Depozitimi në sistemin tatimor është kryer jashtë afatit ligjor në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, neni 29, Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit ku citohet: "1. *Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda* |

| | |
|---|---|
| | *datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*"<br>- Asambleja e Ortakëve ka detyrimin për të aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë në afatin e caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 33/1 ku citohet: "*Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi*".<br>Mos depozitimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit QKB, si dhe kryerjet jashtë afateve ligjore janë në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar,neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46 ku citohet : *"....3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:a) pasqyrat financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe raportin e auditimit, të mbajtur sipas kërkesave ligjore, në rastet kur mbajtja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme; Neni 46, Regjistrimi i pasqyrave financiare, 1. Subjektet, që kanë detyrimin e hartimit të dokumenteve, sipas shkronjës "a", të pikës 3, të nenit 43, të këtij ligji, dhe që nuk i kanë depozituar më parë, në përputhje me afatin e parashikuar në pikën 5, të nenit 22, të këtij ligji, detyrohen në çdo rast t'i depozitojnë këto dokumente jo më vonë se 7 muaj nga data e mbylljes së çdo viti financiar*." |
| **Ndikimi/Efekti**: | Vonesat në hartimin, aprovimin dhe depozitimin kanë pasoja në vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike si dhe për vendim-marrjet e palëve të interesuara. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Nga titullari i AK të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen, të depozitohen, të aprovohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredidhënie etj. |

-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë OSHEE Group sh.a., anëtarët e Këshillave të Drejtimit të shoqërive OSSH sh.a., FSHU sh.a., si dhe administratorët e shoqërive.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e OSHEE Group sh.a., nuk i ka miratuar pasqyrat financiare të periudhës 2020 dhe 2021, si dhe ka vendosur ti aprovojë pasi ekspertët kontabël që po bëjnë ri-auditimin të shprehen me opinion ndryshe nga auditimi i parë i cili ishte "refuzim opinioni". |

| | |
|---|---|
| **Situata 2:** | Në zbatim të ligjit nr. Nr. 10 091, datë 5.03.2009, "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", me vendimin nr. 23, datë 14.12.2020, Aksioneri i vetëm i shoqërisë OSSH, ka caktuar ekspertët kontabël I.Ç dhe B.P për auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2020. Më datë 23.01.2020 është lidhur kontrata mes palëve me vlerë 24,102,000 lek pa tvsh dhe 28,922,400 lek me tvsh.<br>Me datë 28.06.2021, audituesit ligjor në raportin e tyre janë shprehur për "Refuzim opinioni", bazuar në konstatimet se shoqëria nuk ka finalizuar regjistrin e aseteve si dhe nuk ka marrë titujt e pronësisë për pronat e paluajtshme që ka në përdorim.<br>Më datë 26.01.2022, Aksionari i vetëm i OSHEE Group,ka dërguar shkresën me nr. 817 Prot., ku informon se Asambleja e Përgjithshme nuk miraton pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë për arsye të refuzimit të dhënies së opinionit të audituesve ligjor në OSSH sh.a., si dhe marrjen e masave te duhura për të qartësuar problematikat dhe çështjet e shtruara në seksion "Bazat e refuzimit", në raportin e audituesve.<br>Me shkresën nr. 2158/3 datë 03.03.2022, drejtimi i OSHEE i ka relatuar Aksionarit të shoqërisë për përfundimin e procesit të inventarizimit dhe rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale, proces ky i kryer me kontratë shërbimi nga të tretët.<br>Me vendimin nr. 1289/1, datë 13.04.2022, Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë ka miratuar rezultatet e inventarizimit të aktiveve materiale dhe jo materiale, rivlerësimin e tyre dhe sistemimin e diferencave. Në pikën 4 të vendimit përcaktohet se: "Veprimet kontabël për rezultatet e inventarizimit e rivlerësimit dhe efektet e ndarjes së aseteve sipas shoqërive të Grupit e llogaritjes së amortizimit në vitin 2020, të evidentohen në Pasqyrat Financiare në fillim të vitit 2021 sipas standardeve kontabël".<br>Më datë 14.04.2022, drejtimi i shoqërisë OSHEE i ka kërkuar Aksionarit të shoqërisë, emërimin e audituesve ligjor për "Auditimin e pasqyrës së veçantë dhe të konsoliduar të lëvizjes së aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë OSHEE Group sh.a.".<br>Më datë 13.05.2022, Aksionari i shoqërisë, me shkresën nr. 3235/1 ka vendosur për caktimin e audituesve ligjor L K, E H, I D dhe V Ç për dhënien e opinionit të auditimit për pasqyrat financiare të konsolidurara për vitin e mbyllur më 31.12.2020, pas regjistrimit të rezultateve të inventarizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale në këto pasqyra, për shoqërinë OSHEE Group sh.a.<br>Me shkresën nr. 5577 datë 07.06.2022, drejtimi i shoqërisë OSHEE Group sh.a., ka kërkuar saktësimin e periudhës së regjistrimit të rezultateve të inventarizimit e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale e jomateriale dhe për dhënien e opinionit nga audituesit ligjor.<br>Me shkresën nr. 4587/1, datë 08.07.2022, Aksionari i shoqërisë ka sqaruar se: "*Me shkresën e saj nr. 817 prot., datë 26.01.2022, Asambleja e Përgjithshme, mbështetur në refuzimin e opinionit të Audituesve Ligjore, të caktuar për auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të shoqërisë "OSHEE" Group sh.a për vitin 2020, nuk i miratoi këto pasqyra duke i kërkuar njëherazi* |

| | |
|---|---|
| | *shoqërisë "OSHEE" Group sh.a marrjen e masave të duhura për të zgjidhur çështjet e shtruara në seksionin "Bazat e refuzimit". Në vijim, Asambleja e Përgjithshme, me vendimin e saj nr. 2289/1, datë 13.04.2022 në miratimin e rezultateve të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale e jomateriale, rivlerësimin e tyre dhe sistemimin e diferencave, vendosi detyrat dhe hapat që duhen ndjekur nga shoqëria "OSHEE Group" sh.a, për regjistrimin dhe reflektimin e këtyre rezultateve në Pasqyrat Financiare në fillim të vitit 2021, në zbatim të standardeve kontabël,Asambleja e Përgjithshme me shkresën e saj nr. 3235/l prot., datë 13.05.2022, caktoi audituesit ligjore për dhënien e opinionit të auditimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara me dhe për vitin e mbyllur më 31.12.2020, pas regjistrimit të rezultateve të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale në këto pasqyra, për shoqërinë "OSHEE Group". Për sa më lart dhe në vijim të shkresës tuaj nr. 5577 prot., datë 07.06.2022 "Mbi saktësimin e periudhës së regjistrimit të veprimeve kontabile, rezultateve të inventarizimit dhe efektet e ndarjes së aseteve", saktësojmë se regjistrimi dhe reflektimi i rezultateve të inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, rivlerësimi i tyre dhe sistemimi i diferencave do të përfshihen në Pasqyrat Financiare të Konsoliduara me dhe për vitin e mbyllur me 31.12.2020 për shoqërinë "OSHEE Group" sh.a me qëllimin që audituesit e caktuar nga Asambleja e Përgjithshme të shprehin opinionin e tyre për këto pasqyra dhe viti ushtrimor 2020 të mos mbartet në fillim në vitin 2021 me refuzim opinioni."*<br>**Vendim-marrja e Asamblesë së Ortakëve për një ri-auditim të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore 2020, pasi të ishin reflektuar *rezultatet e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, rivlerësimi i tyre dhe sistemimi i diferencave* për të mos pasur mbartje në vitin 2021 me refuzim opinioni nuk ka mbështetje në ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009, "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", i ndryshuar si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Nëse refuzimi i ekspertëve të mëparshëm kishte lidhje me inventarizimin dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale dhe sistemimin e diferencave, nuk kishte arsye për dhënie opinioni përsëri për pjesët e tjera të pasqyrave financiare. Organet drejtuese të shoqërisë të merrnin masa për korrigjimin e situatës dhe diferencat të reflektoheshin në periudhën pasardhëse.**<br>-Mos aprovimi nga Asambleja e Ortakëve është në tejkalim të afatit të caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 33/1. |
| **Kriteri:** | ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar "Për tatimin mbi të ardhurat", neni 33/1 ku citohet: "*Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit 1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinojnë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore,* |

| | |
|---|---|
| | *pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi*". |
| **Ndikimi/Efekti**: | Veprimet e Asamblesë së Ortakëve kanë sjellë vonesa jo të justifikuara duke kërkuar auditim sërish për pasqyrat financiare të OSHEE Group sh.a. Deri në momentin e mbylljes së auditimit Asambleja e Ortakëve nuk ka aprovuar pasqyrat financiare të periudhës 2020 dhe 2021. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që në të ardhmen që aprovimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrit rregullator përkatës që kanë si objektiv dhënien e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, e që janë të dobishme për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish, përveç anës formale të jetë i orientuar në pjesën thelbësore të problematikave dhe zgjidhjen e tyre. |

Për sa më sipër mban përgjegjësi Asambleja e Ortakëve e OSHEE Group sh.a.

| **Titulli i Gjetjes** | Mos plotësim i regjistrit të aktiveve me kërkesat minimale |
|---|---|
| **Situata 3:** | -Shoqëria OSSH sh.a nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër.<br>-Nga auditimi i kontabilizimeve të aktiveve të blera u konstatua se emërtimet me të cilat regjistrohej në sistemin SIP, sistemi që përdor financa, emërtimi nuk përfshinte markën, shpjegime më të qarta duke e bërë të vështirë identifikimin në periudhat e mëpasshme për inventarizimet periodike. |
| **Kriteri:** | Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30, ku përcaktohet:"*Formati i regjistrit të aktiveve hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjata apo afatshkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbaje regjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia* ". |
| **Ndikimi/Efekti :** | Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandimi:** | Administratori i shoqërisë, dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë |

| | |
|---|---|
| | së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre. |

Për sa më sipër kanë përgjegjësi administratori i shoqërisë si dhe nëpunësi zbatues.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Mos inventarizimi i plotë detyrimeve |
| **Situata 4:** | -OSHEE Group sh.a. nuk ka kryer inventarizimin e plotë të detyrimeve për periudhat 2021 e 2022 duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës. |
| **Kriteri:** | Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15,Inventari i aktiveve dhe detyrimeve 1. *Njësitë ekonomike, subjekt i këtij ligji, duhet të kontrollojnë, të paktën një herë gjatë periudhës raportuese, ekzistencën dhe vlerësimin* ***e aktiveve, të detyrimeve dhe të kapitaleve të veta,*** *nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumenteve kontabël përkatëse në përputhje me rregulloren e inventarizimit të hartuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit. 2. Organi i drejtimit të njësisë ekonomike mban përgjegjësi për procedurat e ndjekura për inventarizimin e aktiveve dhe detyrimeve, me qëllim paraqitjen me vërtetësi dhe besueshmëri të elementeve të aktivit dhe detyrimeve në pasqyrat financiare." dhe pika 74 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, date 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar ku citohet: "***Çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit*** *ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale,* ***aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës."*** |
| **Ndikimi/Efekti:** | Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj." |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Administratori i shoqërisë, dhe Nëpunësi Zbatues për të ulur riskun e zvogëlimit të aseteve së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të plotë të detyrimeve për periudhat, 2021 e 2022 duke kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës. procedura rakordimi dhe dakortësimi për saldot vjetore, shoqëruar me relacionet përkatëse. |

-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë OSHEE Group sh.a., anëtarët e Këshillave të Drejtimit të shoqërive OSSH sh.a., FTL sh.a., FSHU sh.a., si dhe administratorët e shoqërive.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Mosparaqitja e kamatëvonesave në faturën e shërbimit |
| **Situata 5:** | -Në auditimin e faturimeve të shërbimit të ofrimit të energjisë elektrik, të kryera nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., kamatëvonesat e akumuluara nuk pasqyrohen në faturat që i dërgohen përdoruesve. Shoqëria i evidenton vetëm në momentin e arkëtimit, duke zbatuar dhe parimin e sigurisë dhe duke mos i deklaruar si të ardhura në momentin që maturohen. Ndërsa kjo |

| | |
|---|---|
| | është një praktikë e mirë për të mos deklaruar të ardhura që nuk kanë siguri se do të arkëtohen, kur vlerat janë materiale dhe përfituesit e shërbimit janë shoqëri private biznesi ose publike shtetërore që kanë detyrimin ligjor për të zbatuar SNK ose SKK, mos pasja e vlerave të kamatëvonesave në faturë si detyrim për tu paguar sjell vështirësi për paraqitjen e tyre si provizione në pasqyrat financiare. Ky problem është me rëndësi materiale për shumë shoqëri publike shtetërore të cilat ka detyrime të konsiderueshme ndaj FSHU sh.a., dhe paraqesin në pasqyra detyrimin vetëm për principalin. |
| **Kriteri:** | Kushtet e përgjithshme te kontratës se shërbimit universal te furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, Miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018,Neni 10, Çmimi i Energjisë Elektrike 10.1 Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare, apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur Klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike. 10.2 Ndryshimet e çmimit të energjisë elektrike bëhen me vendim të ERE-s. Palët në kontratë bien dakord që çdo ndryshim i çmimit i bëre me vendim të ERE–s, do të aplikohet automatikisht në kontratë. 10.3 Furnizuesi e publikon vendimin për ndryshimin e çmimit, nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit të paktën 15 ditë kalendarike përpara aplikimit. Neni 11, Leximi i Matësit dhe Faturimi i Energjisë Elektrike 11.1 Furnizuesi do të bëjë leximin periodik të matësit të energjisë elektrike të Klientit, konform parashikimeve të Kodit të Matjes, Kodit të Rrjetit si dhe legjislacionit në fuqi për Metrologjinë, për një periudhë kohore prej 30 ditësh kalendarike dhe do ti dërgojë Klientit fundor në adresën e dhënë në kontratë, faturën tip të energjisë elektrike, brenda 10 ditëve nga data e leximit. 11.2 Çdo faturë e energjisë elektrike duhet të përmbajë minimalisht: Të dhënat teknike mbi pikën e lidhjes;Të dhëna identifikuese të Klientit;Data e leximit;Periudha e faturuar;Leximi i matësit dhe konsumi përkatës për periudhën e faturuar;Çmimi për njësi sipas strukturës së tarifave dhe përbërësit e tij;Shuma në lekë që i korrespondon periudhës së faturimit;Shumat e taksave që i korrespondojnë sipas legjislacionit në fuqi; Data limit e pagimit të faturës;***Kamatëvonesa e aplikuar për çdo ditë vonesë; Penalitetet e mundshme për pagesë të vonuar; Vlera e detajuar e debisë së Klientit.*** |
| **Ndikimi/Efekti:** | Mos paraqitja e kamatëvonesave për tu paguar dëmton paraqitjen me saktësi dhe siguri të pasqyrave financiare përkatëse. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., të marrë masa që kamatëvonesat e akumuluara të pasqyrohen në faturat që i dërgohen përdoruesve, duke rritur transparencën në marrëdhëniet me konsumatorët si dhe duke reflektuar më saktë detyrimet aktuale të përdoruesve. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Mos përfundimi i procesit të kalimit të pronësisë |
| **Situata 6:** | -Shoqëria nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të iniciuara me VKM nr. 1108, datë |

| | |
|---|---|
| | 30.07.2008"Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.".<br>Shoqëria nuk ka zbatuar plotësisht VKM nr. 1108, datë 30.07.2008"Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a." pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" , i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 1108, datë 30.07.2008"Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a." pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" , i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45 ku citohet:<br>*1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., sipas lidhjeve (gjithsej 1416 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.*<br>*2. Heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të sistemit të prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a.-së, miratuar me vendimin nr. 122, datë 4.3.2004 të Këshillit të Ministrave, të pronave, që i përkasin sistemit të shpërndarjes, sipas fletëve, të përcaktuara në shtojcën nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.*<br>*3. Në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore të sistemit të prodhimit dhe të transmetimit të energjisë elektrike, në përgjegjësi administrimi të KESH sh.a.-së, ndryshohen të dhënat për pronat, sipas tabelave (gjithsej 3 fletë), që i bashkëlidhen këtij vendimi.*<br>*-Neni 45 Regjistrimi i kalimit të pronësisë me anë të ligjit, me vendim të gjykatës apo të një akti administrativ1. Në rastet kur shteti, personi juridik/fizik ka fituar të drejtën e pronësisë mbi një pasuri të paluajtshme, me anë të ligjit, vendimit gjyqësor të formës së prerë për fitimin apo kalimin e së drejtës së pronësisë apo të aktit të një organi administrativ, regjistruesi, mbështetur në këto akte të paraqitura nga personi i interesuar, bën regjistrimin, duke shënuar pronar shtetin, personin juridik/fizik, të cilit i ka kaluar e drejta e pronësisë.* |
| **Ndikimi/Efekti:** | Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Nga drejtimi i shoqërive të merren masa që në të ardhmen, të ndiqet me përgjegjshmëri përfundimi i procesit të kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, në shoqërinë OSHEE SHA, ose në tre shoqëritë bija sipas raporteve respektive të ndarjes. |

-Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi administratorët e shoqërive.

| **Titulli i Gjetjes** | Mungesa e deklaratës së mirë administrimit |
|---|---|
| **Situata 7:** | -Në raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumenteve shpjegues, mungonte deklarata e miradministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj si dhe profili i administratorëve dhe anëtarëve të këshillave ku shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria.<br>Këto veprime zvogëlojnë transparencën e menaxhimit të shoqërisë si dhe janë në kundërshtim me nenin 134, të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar. |
| **Kriteri:** | Neni\s 134, të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, ku citohet:"*1. Organet e shoqërive aksionare janë: a) asambleja e përgjithshme; dhe, në varësi të dispozitave të statutit, b) këshilli i administrimit, si organ i vetëm administrimi, i cili ushtron, njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje, të veprimtarisë së shoqërisë (sistemi me një nivel); c) këshilli mbikëqyrës dhe një apo më shumë administratorë, ku funksionet e administrimit e të mbikëqyrjes shpërndahen ndërmjet këtyre 2 organeve (sistemi me dy nivele). Në këtë rast, sipas parashikimeve të statutit, administratorët mund të caktohen e shkarkohen nga asambleja e përgjithshme apo nga këshilli mbikëqyrës. 2. Shoqëritë aksionare, në raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe pasqyrat financiare vjetore duhet të përshijnë një dokument shpjegues, ku trajtohen e shpjegohen parimet e rregullat e miradministrimit dhe të drejtimit të brendshëm të shoqërisë dhe praktikat, që ndiqen prej saj, në zbatim të dispozitave të këtij ligji. Deklarata e miradministrimit të shoqërisë duhet të përmbajë* ***një profil të administratorëve dhe të anëtarëve të këshillave, si dhe të shpjegojë elementet e faktet, për të cilat këta individë janë të kualifikuar për të kryer detyrat, që i janë caktuar nga shoqëria.*** *Kjo deklaratë vendoset edhe në faqen e internetit të shoqërisë."* |
| **Ndikimi/Efekti:** | Këto veprime zvogëlojnë transparencën e menaxhimit të shoqërisë. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandime:** | Administratorët e shoqërive të marrin masa për plotësimin e deklaratave të miradministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj si dhe profilet e administratorëve dhe anëtarëve të këshillave ku shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria, për të rritur transparencën e menaxhimit të shoqërisë. |

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi administratorët e shoqërive.

| **Titulli i Gjetjes** | Mos paraqitja e informacioneve sqaruese |
|---|---|
| **Situata 8:** | Në shënimet shpjeguese nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore në kundërshtim me pikat 75të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje). |

| | |
|---|---|
| | -Në lidhje me përllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, shoqëria përdor norma menaxheriale si dhe normat fiskale, duke paraqitur diferencën në shpenzimet e pa-zdritshme, të rezultatit të periudhës ushtrimore.<br>Normat menaxheriale dhe ato fiskale të përdorura kanë mbetur të pandryshuara nga periudha e ish CEZ. Jetëgjatësia e aktiveve është rishikuar nga vlerësimi i kryer nga grupi i ekspertëve vlerësues dhe kontabël, që me urdhrin nr. 1460, datë 20.02.2015, i ndryshuar të ministrit të MZHETTS si dhe bazuar në kontratën nr. 23318 prot., datë 31.12.2015 "Për rivlerësimin e aktiveve afatgjatë materialë të shoqërisë Oshee SHA".<br>-Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16, ku citohet: *"Vlera e mbetur dhe jeta e dobishme e një aktivi do të rishihet të paktën çdo fund-viti financiar dhe nëse pritshmëria ndryshon nga parashikimet e mëparshme, ndryshimet do të trajtohen si ndryshime në vlerësimet kontabël në përputhje me SNK 8, Politikat kontabël, Ndryshimet në vlerësimet kontabël dhe gabimet."* |
| **Kriteri:** | Pika 75të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje) ku citohet: "***Zgjedhja e metodës së amortizimit dhe vlerësimi i jetës së dobishme të aktiveve është çështje gjykimi. Prandaj dhënia e informacioneve shpjeguese për metodat e përdorura dhe vlerësimet e jetëve të dobishme ose të normave të amortizimit, u siguron përdoruesve të pasqyrave financiare informacion që i lejon ata të shqyrtojnë politikat e zgjedhura nga drejtimi dhe mundëson krahasimin me njësi të tjera ekonomike.,*** *dhe 76 "Në përputhje me SNK 8 një njësi ekonomike jep informacion shpjegues për natyrën dhe efektin e një ndryshimi në vlerësimin kontabël që ka efekt në periudhën aktuale ose pritet të ketë efekt në periudhat e mëpasshme. Dhënia e këtyre informacioneve shpjeguese për aktivet afatgjata materiale mund vijë nga ndryshimet në lidhje me: (a) vlerat e mbetura; (b) kostot e vlerësuara të zbërthimit, heqjes ose rikrijimit të zërave të aktiveve afatgjata materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje); (c) jetët e dobishme; dhe (d) metodat e amortizimit."*<br>Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, ku citohet: *Përcaktimin e sistemeve dhe procedurave për zëvendësimin apo shtimin e aktiveve afatgjata. Planifikimi në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim te ciklit te tyre te jetës është një tjetër mënyre për parandalimin e mosfunksionimin e papritur te ndonjë aktivi. Jetëgjatësia standarde qe jepet ne regjistrin e aktiveve afatgjata nëpërmjet normave te amortizimit është një tregues se kur një aktiv duhet te zëvendësohet. Është e rëndësishme qe jetëgjatësia standarde te mos ndiqet verbazi, pasi aktivi mund te vazhdoje te jete ne gjendje pune dhe njëkohësisht i nevojshëm ose i dobishëm për plotësimin e objektivave te njësisë. Dobishmëria e çdo aktivi duhet vlerësuar nga komisioni i vlerësimit te aktiveve, i cili ngrihet dhe funksionon sipas kritereve te këtij udhëzimi.* |
| **Ndikimi/Efekti**: | Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirë-argumentuara nga specialistët |

| | |
|---|---|
| | përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.<br>Këto veprime zvogëlojnë transparencën e menaxhimit të shoqërisë |
| **Shkaku:** | Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E mesme |
| **Rekomandime:** | Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre. |
| **Titulli i Gjetjes** | Fatura të padeklaruara në periudhën përkatëse |
| **Situata 9:** | Në kontrollet e kryera në librat e blerjes për deklarimet e faturave të blerjes, u konstatua se kishte fatura që i përkisnin periudhave ushtrimore të mëparshme ose të lëshuara nga subjektet disa muaj më parë dhe që departamentit të financës, u ishin vënë në dispozicion në muajin e deklaruar. Këto veprime sjellin efekte në kontabilizimin e aktiveve dhe përcaktimin e datës së hyrjes në përdorim. Në Standardin Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16 *Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje), neni 55,* përcaktohet se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, pra pasi aktivi është marrë në dorëzim dhe është bërë pjesë e sistemeve përkatëse.<br>**Ky veprim sjell shtrembërime në llogaritjen e saktë të amortizimit të aktiveve të shoqërisë duke ndikuar në rezultatin e shoqërisë.** |
| **Kriteri:** | Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 4, të ligjit nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", ku citohet: *Neni 4 Veprimet juridike ndërmjet sipërmarrjeve tregtare dhe autoriteteve publike Në veprimet juridike tregtare, ku debitori është një ndërmarrje tregtare apo një autoritet publik, kreditori ka të drejtë që nga dita e nesërme, pas kalimit të afatit për kryerjen e pagesës, të përfitojë kamatëvonesë, pa qenë nevoja për t'i dërguar njoftim për vendosje në vonesë debitorit, në rastet kur:a) kreditori i ka përmbushur detyrimet sipas kontratës dhe ligjit dhe debitori nuk e ka kundërshtuar detyrimin; b) kreditori nuk e ka arkëtuar shumën për t'u paguar brenda afatit, me përjashtim të rastit kur përgjegjës për vonesën nuk është debitori.* |
| **Ndikimi/Efekti:** | Vonesat në mos likuidimin e faturave, krijojnë mundësinë e krijimit të penaliteteve nga Operatori Ekonomik, i cili ka kryer objektin e investimit, dhe në bazë të neneve të kontratës dhe Ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", nenit 4, OE i lind e drejta për të kërkuar kamatëvonesa.<br>Veprimet e mësipërme sjellin efekte dhe në raportin e Tvsh-së kreditore dhe debitore, duke mos pasqyruar detyrimet e sakta në kohë të shoqërisë, për pagesat e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar. |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Nga administratori i shoqërisë të merren masa që procesi i firmosjes së faturës |

| | |
|---|---|
| | tatimore nga personat e autorizuar si një dokument zyrtar i shoqërisë, i pranimit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, të kryhet me përgjegjshmëri dhe brenda afateve përkatëse. |

Për sa më sipër mban përgjegjësi Nëpunësi Zbatues, Drejtori i Departamentit të Financës T T.

| **Titulli i Gjetjes** | Mos zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë |
|---|---|
| **Situata 10:** | Në auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara u konstatua se nuk është kryer zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë sipas metodologjisë të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim.<br>Për periudhat e mëparshme shoqëria ka përdorur metodologjinë e përcaktuar në raportin e audituesit ligjor B T A Shpk, e miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 39 datë 20.07.2017. Në raportin e paraqitur nga audituesi ligjor janë kryer supozime hipotetike nga pika 5.5.17 C dhe 5.5.19 për maksimumin e periudhës kontraktuale pa vlerësuar të dhënat aktuale që disponon shoqëria. Raporti paraqet metodologjinë e zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme sipas standardit të raportimit SNRF 9. Shoqëria OSHEE nuk duhet të marrë parasysh veç metodologjinë e standardit por edhe ligjet kombëtare bashkë me ligjet e faljes së detyrimeve të cilat janë të parat që duhen reflektuar në pasqyrat financiare dhe më pas në programin ekonomik.<br>Në metodën e paraqitur në raportin e audituesit ligjor sipas **Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 9** ***Instrumentet Financiar është kryer zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme. Ky standard citon***<br>***Matja e humbjeve të parashikuara të kredisë***<br>- *5.5.17 Një njësi ekonomike duhet të masë humbjen e parashikuar të kredisë të një instrumenti financiar në një mënyrë të tillë e cila reflekton:*<br>- *(a) një shumë të paanshme dhe të ponderuar që përcaktohet duke vlerësuar një gamë e rezultateve të mundshme;*<br>- *(b) vlerën në kohë të parasë; dhe*<br>*(c) informacionin e arsyeshëm dhe të mbështetur i cili është i disponueshëm pa ndonjë kosto ose përpjekje të pa arsyeshme në datën e raportimit për ngjarjet e shkuara, situatën aktuale dhe parashikimet për kushtet ekonomike në të ardhmen.*<br>*5.5.19 Maksimumi i periudhës së marrë në konsideratë kur bëhet matja e humbjes së parashikuar të kredisë është maksimumi i periudhës kontraktuale (përfshi mundësinë e zgjatjes) gjatë të cilës njësia ekonomike është e ekspozuar kundrejt rrezikut të kredisë dhe jo më gjatë, edhe pse një periudhë më e gjatë mund të jetë në përputhje me praktikën e biznesit.*<br>Gjithashtu, Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët, Kontratat me klientët citon *Paragrafi 113 Një njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues për periudhën e raportimit për të gjitha shumat në vijim, me përjashtim të rastit kur këto shuma janë paraqitur veçmas në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse në përputhje me Standardet e tjera: (b) çdo humbje nga zhvlerësimi të njohur (në përputhje me SNRF 9) nga çdo llogari e arkëtueshme ose aktive kontrate që vijnë nga kontratat e njësisë ekonomike me klientët, <u>për të cilat njësia ekonomike duhet të japë</u>* |

| | |
|---|---|
| | *informacion shpjegues veçmas nga humbjet nga çvlerësimi i kontratave të tjera.*<br>Ky informacion nuk ka shpjegimet përkatëse të cilat e bëjnë të përshtatshëm për tu përdorur nga palët e treta, si dhe drejtimi i shoqërisë. |
| **Kriteri:** | Situata është në kundërshtim me Ligjin Nr. 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike"Neni 80 Kontrata e furnizimit me energji elektrike, Neni 82 Të drejtat e furnizuesit që përveç të drejtave të përcaktuara në kontratë, sipas nenit 80, të këtij ligji, Neni 84 dhe Neni 92, Masat e ekzekutimit të detyrueshëm të detyrimeve të papaguara.<br>Për të siguruar ekzekutimin e detyrimit të papaguar furnizuesi, në përputhje me parashikimet e kontratës, merr masat e mëposhtme:<br>a) fillon procedurën e ndërprerjes së energjisë elektrike;<br>b) fillon procedurat e ekzekutimit të detyrueshëm, duke kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 8662, datë 18.9.2000, "Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike", të ndryshuar;<br>c) vendos barrën hipotekare mbi pasurinë e paluajtshme që furnizohet me energji elektrike, në rast se detyrimi i papaguar, që rrjedh nga një kontratë furnizimi energjie elektrike, është mbi 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për klientin jofamiljar. |
| **Ndikimi/Efekti** | Mos paraqitje e saktë dhe e besueshme e kërkesave tregtare për arkëtim |
| **Shkaku:** | Mos vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për kryer zhvlerësimin i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë sipas metodologjisë të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim, duke u nisur nga të dhënat aktuale që disponon shoqëria për të pasur një situatë sa më të besueshme dhe reale. |

| **Titulli i Gjetjes** | Mos kryerje me saktësi e llogaritjeve për sasitë e artikujve të kërkuar në Buxhetin e shoqërisë |
|---|---|
| **Situata 11:** | -Gjatë procesit të inventarizimit fizik të vlerave materiale në magazinat e OSSH-së, nga komisionet përkatës, për periudhën 2021, në relacionin përfundimtar në zbatim të Urdhrit nr. 13037 Prot., datë 06.12.2021, u evidentuan artikuj me qarkullim të ngadalshëm në këto magazina, **me vlerë totale në 257,303,138 lekë**, artikuj të bërë hyrje në periudha të mëparshme dhe në ato të fundit.<br>Në relacionin teknik drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për nevojat e shoqërisë për bazë materiale për mirëmbajtje, nga Divizionit të Shpërndarjes, janë hartuar dhe përllogaritur në Planin e Mirëmbajtjes, sasitë vjetore të parashikuara.<br>Nga kjo drejtori nuk janë kryer me saktësi llogaritjet për sasitë e artikujve të kërkuar për Buxhetin e viteve 2020, 2021, duke krijuar material stok, që përveç se ka impenjuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo |

| | |
|---|---|
| | efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë. |
| **Kriteri:** | Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ku citohet:<br>*"Neni 1 Objekti i ligjit Ky ligj përcakton parimet, rregullat, procedurat, strukturat administrative dhe metodat për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë e sektorit publik të Republikës së Shqipërisë, si dhe përgjegjësitë menaxheriale për planifikimin, zbatimin, kontrollin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin. Neni 2 Qëllimi i ligjit Qëllimi i këtij ligji është përdorimi sa më efiçient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike, duke respektuar parimet e transparencës dhe të ligjshmërisë, si dhe shmangia e shpërdorimit, keqpërdorimit dhe vjedhjes së pasurisë."* |
| **Ndikimi/Efekti**: | Përllogaritja jo e saktë e sasive të artikujve të kërkuar për tu blerë, sjell riskun e krijimit të materialit stok, që përveç se impenjon fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë. |
| **Shkaku:** | Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Nga administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, strukturat e ngarkuara për planifikimin e bazës materiale për mirëmbajtje, të kryejnë kërkesat e tyre të bazuara në raporte të mirë argumentuara, të specifikuara dhe të detajuara, për shmangien e krijimit të materialeve stok dhe një menaxhim me efektivitet dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë. |

| **Titulli i Gjetjes** | Mos kryerja e ankandit për shitjen e materialit skrap të mbetur në magazina. |
|---|---|
| **Situata 12:** | -Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2021 u konstatua se shoqëria ka gjendje pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 197,492,859 lekë.<br>Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin si dhe ka miratuar vlerën e inventarit 108,7843,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar.<br>Bazuar në relacionin e administratorit të shoqërisë për shtyrjen e afatit të ekspertes për rivlerësimin e artikujve të miratuar për tu shitur si skrap, pasi e ka aprovuar Këshilli Mbikëqyrës, me shkresën nr. 16029/8 Prot., datë 09.08.2019, i ka përcjellë për miratim aksionarit, MIE, vendimin nr. 23, datë 25.07.2019.<br>Me shkresën nr. 8472/1 Prot., datë 15.11.2019, aksionari i shoqërisë e ka konsideruar të mbyllur misionin e ekspertit vlerësues dhe kontratën e lidhur me të dhe i kërkohet OSHEE, për zhvillimin e procedurës së ankandit publik |

| | |
|---|---|
| | për sasinë e materialeve skrap.<br>Shoqëria deri në përfundim të datës së auditimit, nuk ka iniciuar procedurat për hapjen e ankandit publik veprime që ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë.<br>-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur si dhe për të vepruar sipas Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103. |
| **Kriteri:** | Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike", i ndryshuar, ku citohet: "108. *Aktivet afatgjata qe konsiderohen te panevojshme për njësinë ne një periudhe te mëvonshme te funksionimit te saj (ne rast mbylljeje/shkrirjeje te njësisë, ndryshimi te misionit apo objektivave afatgjate te njësisë), por qe mbeten ne gjendje përdorimi mund të jepen ne rend shterues (nga a ne b). a. transferohen pa pagese në një njësi tjetër publike brenda sektorit te qeverisjes se përgjithshme. Konfirmimi zyrtar nga njësia përfituese vërteton përfundimin e transaksionit; b. shiten në formën e ankandit publik.*"<br>*Kriteret për vlerësimin e Aktiveve 103. Vlerësimi i Aktiveve bëhet sipas këtyre kritereve : a. kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit te skadences, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen; b. kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër; c. kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit, d. kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm. e. kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër; f. kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë; g. kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmbytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit; h. kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve te punës, misionit te njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjate nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.* |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos kryerja në kohë e ankandit sjell vështirësi logjistike, duke bllokuar hapësira magazinuese si dhe rrit riskun për dëmtime dhe zhvlerësime të mëtejshme të vlerës së aktiveve të vendosura për tu shitur. |
| **Shkaku:** | Jo vlerësimi dhe ndjekja e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Administratori i shoqërisë të marrë masa për vlerësimin e gjendjes aktuale të materialeve skrap, testimin real të tregut,hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve dhe duke proceduar më pas në vijimësi sipas situatës. |

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi administratori, dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës

| Titulli i Gjetjes | Rritje e detyrimeve debitore të shoqërisë. |
|---|---|
| Situata 13: | Situata debitore e OSHEE Group në fund të periudhës 2022 është përkeqësuar në krahasim me vitin 2020, duke u rritur me 13,997,171 mijë lekë, në një total prej 139,653,687 mijë lekë. Në strukturën e detyrimeve që ka shoqëria një pjesë e madhe përbëhet nga detyrimet ndaj Korporatës Elektro-energjetike Shqiptare sh.a. për blerje energjie, hua dhe interesa dhe për periudhën 2021-2022, janë rritur në vlerën 4,387,945 mijë lekë, dhe detyrimi total është në vlerën 65,743,270 mijë lekë. Mes shoqërive është rënë dakord për balancën e detyrimeve që OSHEE ka ndaj KESH më datë 31.12.2020, vlera 48,910,915 mijë lekë. Kjo vlerë do të paguhet me këste, duke filluar në vitin 2021 deri në vitin 2046.<br>Detyrimet e OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, hua dhe interesa për periudhën 2021-2022, ku OSHEE i detyrohet OST detyrime në vlerën 15.268,646 mijë lekë deri në 31.12.2022, detyrimet e OSHEE ndaj OST deri në vitin 2022 janë rritur me vlerën 3,557,129 mijë lekë. OSHEE ka lidhur një marrëveshje me OST datë 15.04.2021 për pagesën e detyrimeve të prapambetura.<br>Shoqëria ka rritje të detyrimit për energji elektrike ndaj HEC-eve në vlerën 2,746,462 mijë lekë si dhe ka ulur me 8,961,484 mijë lekë detyrimin për energji elektrike nga importi.<br>Gjatë periudhës 2022 janë rritur huatë afatgjata me 6,026,538 mijë lekë, me pjesën më të madhe në 5,497,318 mijë lek nga EBRD.<br>Huat ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) përbëhen nga:-Hua afatgjatë të financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, miratuar me Ligjin nr. 170/2014 dt. 11.12.2014. Për zbatimin e projektit, Shoqëria dhe MFE kanë nënshkruar marrëveshjen e nën-huas më 31.12.2014, të ndryshuar më 19.01.2018, me vlerë 69,679 mijë Euro. -Huatë buxhetore nga MFE, detyrimi i përket huas afat gjatë në vlerën 1.5 mld lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017 me interes 0.25 % për tu ripaguar brenda vitit 2019 dhe huasë afat shkurtër në vlerën 1 mld lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017me interes 0.25 % për tu ripaguar brenda vitit 2018, por që mbetet në detyrimet e shoqërisë.<br>Detyrimet ndaj Tatimeve janë ulur në vlerën 1,151,068 mijë lekë dhe vlera e fund vitit 2022 5,279,056 mijë lekë përbëhet nga detyrimet për tatimin mbi fitimin kur 1,146,452 mijë lekë është principal 2,805,637 mijë lekë gjoba dhe 1,269,529 mijë lekë janë interesa.<br>Shoqëria ka pasur një rritje në 9,579,154 mijë lek në hua afatshkurtra (Overdrafte) nga bankat e nivelit të dytë. |
| Kriteri: | Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pika 2 neni 12, ku citohet:<br>gj) garantimin që të gjithë kreditorët të paguhen në kohë dhe në rastet kur kreditorët nuk janë paguar apo në rast ankesash për mospagesë nga kreditorët, nëpunësi zbatues duhet t'ia shpjegojë rrethanat nëpunësit autorizues. |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi/Efekti**: | Rritja e detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata shton barrën financiare si dhe duke kufizuar aftësitë e shoqërisë për investime të mëtejshme. |
| **Shkaku:** | Vështirësitë e shkaktuara në sistemin energjetik për arsye klimaterike, mungesa e reshjeve gjatë viteve 2017 dhe 2019 si dhe rritja e pa parashikuar e çmimeve në import në 6-mujorin e dytë të 2021, dhe në vitin 2022, detyroi OSHEE të blinte energji elektrike në tregun e jashtëm me çmime jo të favorshme, duke kërkuar një pjesë e rëndësishme e arkëtimeve të shoqërisë. |
| **Rëndësia:** | E lartë |
| **Rekomandime:** | Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa në përmirësimin e situatës debitore të shoqërisë duke rritur të ardhurat kryesore, mbledhjen e llogarive të pagueshme nga klientët, uljen e kostove, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit si dhe shtimin e kapitalit të shoqërisë. |

**2.6. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.**

Gjatë auditimit në bazë të Programit të Auditimit 826/1, datë 12.10.2022, mbi proçedurat e prokurimeve të realizuara në OSHEE SHA, veprimtaria e të cilit është nën autoritetin e Këshillit Mbikëqyrës dhe Aksionerit, për periudhën buxhetore **01.07.2020 deri më 31.12.2022**, grupi i audituesve të KLSH-së, u fokusua në zbatimin e bazës ligjore dhe nënligjore të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "*Për prokurimin Publik*", i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, VKM nr. 918 datë 29.12.2014 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike", Udhëzim e APP-së nr.2 datë 27.01.2015 "*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të prokurimit publik*" dhe çdo akti juridike që është në fuqi në lidhje mbi prokurimet publike të financuara nga Buxheti i Shtetit, ndryshimet e tjera të APP-së, Vendime të KPP; DST sipas procedurave të prokurimit të audituara, si dhe lidhja e zbatimi i kontratatave. Grupi i auditimit ka proceduar me marrjen e regjistrave të parashikimit dhe më pas me ato të realizimit të prokurimeve dhe në vijim ka shqyrtuar në Sistemin e Prokurimit Elketronik (SPE) për secilën prej tyre (kryesisht duke u përqendruar në vlerat e larta të fondit limit), numrin e opertaorëve ekonomik (OE) pjesëmarrës, OE të skualifikuar bashkë me shkaqet e skualifikimit nga Komisioni i Vlerësimit të ofertave (KVO). Më pas, në varësi të sa më lart janë shqyrtuar analitikisht procedurat e prokurimit të përzgjedhura në SPE për dokumentet e tenderit (DST) lidhur me veprimtarinë e KVO, si dhe sipas rastit është vazhduar dhe me dosjen e auditimit lidhur me përcaktimin e fondit limit dhe vendosjen e kritereve të veçanta dhe specifikimeve teknike nga komisionet e posaçme. Gjatë auditimit është mbajtur në konsideratë shqyrtimi i të gjitha llojeve të procedurave të prokurimit, me fokus kryesor vlerën dhe numrin e pjesëmarrësve. Përqendrimi i grupit të audititimit, është mbështetur në pikat e renditura të audituara si më poshtë:

- Hartimin dhe njoftimin e rregjistrit të prokurimit publik; Llogaritjen e fondit limit dhe procedurat e shpalljes së prokurimit; Hartimi i kërkesave për kualifikim, miratimi i dokumentave standarte të tenderit; Paraqitja dhe shqyrtimi i ofertave elektronik (SPE); Menaxhimi i procesit të ankimit, pjesëmarrësit në proces; Vlerësimi i ofertave dhe klasifikimi i ofertuesve, verifikimi në sistemin prokurimit; Njoftimi, hartimi dhe nënshkrimi i kontratës me operatorin fitues dhe zbatimi i saj;

Zbatimi dhe monitorimi i kontratës. Grupi i auditimit ka përzgjedhur proçedura prokuruese, në bazë të vlerës së lartë të kontratës, duke u mbështetur në metodën e gjurmimit të dokumentacionit si dhe çdo paqartësi është diskutuar me personat përgjegjës për proçesin e prokurimit të audituar.

**1.** Nga **<u>Drejtoria e Përgjithshme e OSHEE SHA</u>** për periudhën 01.07.2020 deri më 31.12.2022, sipas shyqrtimit në SPE janë zhvilluar gjithsej **43 procedura** prokurimi të ndryshme (pa përfshirë blerjet dinamike të biletave, dhe blerjet e vogla) si e hapur, kërkesë për propozim, me negocim, marrëveshje kuadër etj, për mallra, punime civile, shërbime, shërbime të konsulencës etj., si për investime ashtu edhe për shpenzime e nevojshme për kryerjen e aktivitetit të shoqërisë. Grupi i auditimit ka arritur të shqyrtojë mesatarisht 30.3 % të numrit të procedurave të prokurimit, të cilat përfaqësojnë rreth 41.4 % të fondit të kontraktuar dhe përafërsisht dhe të atij limit. *Tabela nr. 1* Të dhëna të përgjithshme për prokurimet 6 mujori i II 2020 – 2022.

| Nr. | Emërtimi | 6-muj II 2020 | 2021 | 2022 | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Numri i procedurave gjithsej | 10 | 19 | 14 | **43** |
| 2 | Numri i procedurave të audituara | 2 | 5 | 3 | 10 |
| 3 | Procedura të audituara në përqindje | 20 | 27 | 21 | 23 |
| 4 | Fondi limit gjithsej mijë lekë | 694,754,011 | 1,441,796,627 | 1,843,306,776 | 3,979,857,414 |
| 5 | Fondi limit i audituar mijë lekë | 319,010,935 | 812,549,979 | 1,257,599,863 | 2,389,160,777 |
| 6 | Fond limit i audituar në përqindje | 46 | 56 | 68 | **60** |

*Burimi: Të dhëna të OSHEE, të përpunuara nga grupi i auditimit.*

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group nga 01.07.2020 janë kryer *10 procedura prokurimi*, me vlerë 694,754,011 lekë pa tvsh.
II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSHEE Group , për vitin 2021 janë kryer *19 procedura prokurimi*, me vlerë 1,441,796,627 lekë pa tvsh.
III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSHEE Group, për vitin 2022 janë kryer *14 procedura prokurimi*, me vlerë 1,843,306,776 lekë pa tvsh.
I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group, për periudhën (01.07.2020 deri 31.12.2020) janë kryer 10 proçedura prokurimi, me vlerë 694,754,011 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 10 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 694,754,011 |
| Procedura të hapura | 4 |
| Procedura kërkesë për propozim | 1 |
| Sherbim konsulence | 0 |
| B.vogel | 3 |
| Negocim | 2 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Auditimi i zbatimit të procedurave të prokurimit të kryera nga ky AK, u ushtrua bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik si dhe në aktet ligjore që kanë lidhje me objektet e prokurimit, si dhe sipas drejtimeve të përcaktuara në Programin e Auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH-së. Vlerësimi i hartimit të nevojave për mallra, punë dhe shërbime nga subjekti i audituar, Argumentimi dhe përllogaritja e vlerës limit të kontratës sipas nevojave konkrete për mallra dhe shërbime. Analizimi dhe vlerësimi i zbatimit të procedurave të prokurimit nga momenti

i nxjerrjes së urdhrit të prokurimit deri në lidhjen e kontratës. Auditimi mbi lidhjen dhe zbatimin e kontratave deri në marrjen në dorëzim të mallrave, punëve dhe shërbimeve. <u>*Dërgimi i regjistrit të parashikimeve dhe realizimit të prokurimeve publike.*</u>

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | 6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 10 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 694,754,011 |
| Vlera e realizuar | 679,242,315 |
| Procedura të hapura | 6 |
| Procedura kërkesë për propozim | 1 |
| Sherbim konsulence | 1 |
| B.vogel | 0 |
| Negocim | 2 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, OSHEE Group nuk ka realizuar kontratat shtesë .

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group, për vitin 2021 janë kryer 19 procedura prokurimi, me vlerë 1,441,796,627 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit | Viti 2021 OSHEE GROUP (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | 19 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 1,441,796,627 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 1,366,077,846 |
| Procedura të hapura | 17 |
| Procedura kërkesë për propozim | 2 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor (OSHEE Group), për vitin 2022 janë kryer 14 procedura prokurimi, me vlerë 3,579,710,225 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | Viti 2022 OSHEE GROUP (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 14 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 1,843,306,776 |
| Vlera e realizuar | 1,723,932,684 |
| Procedura të hapura | 10 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 3 |
| Totali | 13 |
| Procedura te anulluara | 1 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit.*

**2.** Autoritetit Kontraktor, OSSH <u>**Drejtoria e Tensionit të Lartë, DTL**</u>

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, DTL OSSH sh.a nga 01.07.2020 janë kryer *18 procedura*

*prokurimi*, me vlerë 2,609,128,482 lekë pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor DTL OSSH sh.a, për vitin 2021 janë kryer *14 procedura prokurimi*, me vlerë 1,432,409,600 lekë pa tvsh.

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor DTL OSSH sh.a, për vitin 2022 janë kryer *6 procedura prokurimi*, me vlerë 856,970,425 lekë pa tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, DTL OSSH, për periudhën (01.07.2020 deri 31.12.2020) janë kryer 39 proçedura prokurimi, me vlerë 4,898,508,507 lekë pa tvsh. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 DTL OSSH (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 18 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 2,609,128,482 |
| Procedura të hapura | 17 |
| Procedura kërkesë për propozim | 1 |

*Burimi: OSSH sh.a , përpunoi Grupi Auditimit.*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 DTL OSSH SHA (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 27 proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 2,609,128,482 |
| Vlera e realizuar | 2,573,481,510 |
| Procedura të hapura | 17 |
| Procedura kërkesë për propozim | 1 |

*Burimi: OSHEE GROUP , përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, DTL OSSH SHA nuk ka realizuar kontratat shtesë.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, DTL OSSH SHA , për vitin 2021 janë kryer 14 nga keto (22 procedura prokurimi), me vlerë 1,432,409,600 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 DTL (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara **(SPE)** | 22 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 1,432,409,600 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 1,301,087,447 |
| Procedura të hapura | 12 |
| Blerje te vogla | 1 |
| Negocim pa njoftim | 1 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor (DTL OSSH), për vitin 2022 janë kryer 6 procedura prokurimi, me vlerë 3,579,710,225 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | Viti 2022 DTL (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara (SPE) | 11 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 856,970,425 |
| Vlera e realizuar | 849,324,170 |
| Procedura të hapura | 5 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 1 |
| Totali | 6 |
| Procedura te anulluara | 3 |
| Procedura te kryera | 6 |
| Procedura të paperfuduara | 5 |

*Burimi: OSHEE GROUP, përpunoi Grupi Auditimit*

**3.** Autoritetit Kontraktor, OSSH Drejtoria Rajonale **Tiranë**

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a nga 01.07.2020 janë kryer *9 procedura prokurimi*, me vlerë 966,540,433 lekë pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a për vitin 2021 janë kryer *14 procedura prokurimi*, me vlerë 1,729,707,491 lekë pa tvsh.

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a për vitin 2022 janë kryer *8 procedura prokurimi*, me vlerë 788,850,100 lekë pa tvsh. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE) | 6 mujori II Viti 2020 Tirane OSSH sh.a (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 9 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 966,540,433 |
| Procedura të hapura | 8 |
| B.vogel | 1 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a përpunoi Grupi Auditimit*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al. *Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | 6 mujori II Viti 2020 Tirane OSSH sh.a (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 9 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 966,540,433 |
| Vlera e realizuar | 920,821,495 |
| Procedura të hapura | 8 |
| B.vogel | 1 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a nuk ka realizuar kontratat shtesë .

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a për vitin 2021 janë kryer 14 procedura prokurimi me vlerë 1,729,707,491 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 Tirane OSSH sh.a (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | 14 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 1,729,707,491 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 1,658,632,126 |
| Procedura të hapura | 12 |
| Procedura kërkesë për propozim | 2 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a për vitin 2022 janë kryer 8 procedura prokurimi, me vlerë 788,850,100 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2022** Tirane OSSH sh.a **(SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 8 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 788,850,100 |
| Vlera e realizuar | 423,280,341 |
| Procedura të hapura | 5 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 1 |
| Blerje te vogla | 1 |
| Totali | 8 |
| Procedura te anulluara | 1 |
| Procedura te kryera | 7 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale Tirane OSSH sh.a përpunoi Grupi Auditimit*

**4.** Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH, **Durrës**

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Durrës nga 01.07.2020 janë kryer *18 procedura prokurimi*, me vlerë 1,695,235,275 lekë pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Durrës , për vitin 2021 janë kryer *18 procedura prokurimi*, me vlerë 1,695,235,275 lekë pa tvsh.

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Durrës , për vitin 2022 janë kryer *6 procedura prokurimi*, me vlerë 204,963,585 lekë pa tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Durrës, për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020") janë kryer 15 proçedura prokurimi, me vlerë 1,695,235,275 leke. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 18 proçedura (SPE) |
| Vlera e realizuar SPE (pa TVSH) | 1,695,235,275 |
| Procedura të hapura | 14 |
| Procedura kërkesë për propozim | 1 |
| Procedura te anulluara | 3 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale e OSSH Durrës, përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, Drejtoria Rajonale e OSSH Durres nuk ka realizuar kontrata shtesë. Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar

në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Durrës, për vitin 2021 janë kryer 15 procedura prokurimi, me vlerë 1,666,164,519 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 OSSH Durres** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | 15 Proçedura (SPE) |
| Vlera e realizuar (SPE) | 1,666,164,519 |
| Procedura të hapura | 15 |

Burimi: Drejtoria Rajonale e OSSH Durrës, përpunoi Grupi Auditimit

Gjatë Vitit 2021, Drejtoria Rajonale e OSSH Durres nuk ka realizuar kontratat shtesë.
III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Durres për vitin 2022 janë kryer 6 procedura prokurimi, me vlerë 204,963,585 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2022 OSSH Durres (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 6 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 204,963,585 |
| Procedura të hapura | 2 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 2 |
| Blerje te vogla | 2 |

Burimi: Drejtoria Rajonale e OSSH Durres , përpunoi Grupi Auditimit.

Gjatë Vitit 2022, Drejtoria Rajonale e OSSH Durres nuk ka realizuar kontratat shtesë.

**5.** Autoritetit Kontraktor, OSSH-sha/Drejtoria Rajonale **Elbasan**
I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH-sha/Drejtoria Rajonale Elbasan nga 01.07.2020 deri ne 31.12.2020janë kryer *12 procedura prokurimi (sipas regjistrit te realizimit marre nga faqja e APP*.gov.al.*)*, me vlerë 1.701.999.168,89 lekë pa tvsh.
II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSSH-sha/Drejtoria Rajonale Elbasan, për vitin 2021 janë kryer *2 procedura prokurimi* (shërbimi i ruajtjes me roje private dhe shoqërimi i vlerave monetare), me vlerë 89.176.770,48 lekë pa tvsh.
III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSSH-sha/Drejtoria Rajonale Elbasan, për vitin **2022** janë kryer *0 procedura prokurimi*.
I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH-sha/Drejtoria Rajonale Elbasan, për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020 janë kryer 12 proçedura prokurimi, me vlerë 1.701.999.168,89leke. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020(për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH-sha/ Elbasan (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 12 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 1.701.999.168,89 |
| Procedura të hapura | 12 |
| Procedura te tjera (perfshire blerjet e vogla) | 0 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH-sha/ Elbasan (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 12 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 1.701.999.168,89 |
| Vlera e realizuar | 1.673.866.737,67 |
| Procedura të hapura | 12 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujorit II Viti 2020, OSSH-sha/Drejtoria Rajonale Elbasan nuk ka realizuar kontratat shtesë .

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH-sha/Drejtoria Rajonale Elbasan, për vitin 2021 janë kryer 2 procedura prokurimi((sherbimi i ruajtjes me roje private dhe shoqerimi i vlerave monetare), me vlerë 89.176.770,16 lekë.Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara **(SPE)** | 2 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 89.176.770,48 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 77.789.577,13 |
| Procedura të hapura | 2 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSSH-sha/Drejtoria Rajonale Elbasan, për vitin 2022 nuk është realizuar asnje procedure prokurimi.

**6.** OSSH Sh.a Drejtoria Rajonale **<u>Fier</u>**

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH Sh.a Drejtoria Rajonale Fier nga 01.07.2020 janë kryer *21 procedura prokurimi*, me vlerë 2,220,667,522 lekë pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSSH Sh.a, Drejtoria Rajonale Fier për vitin 2021 janë kryer *16 procedura prokurimi*, me vlerë 846,352,237 lekë pa tvsh.

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSSH Sh.a, Drejtoria Rajonale Fier, për vitin 2022 janë kryer *5 procedura prokurimi*, me vlerë 207,736,326 lekë pa tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH Sh.a Drejtoria Rajonale Fier, për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020”) janë kryer 21 proçedura prokurimi, me vlerë leke. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 21 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 2,220,667,522 |
| Procedura të hapura | 21 |

*Burimi: OSSH Sh.a Drejtoria Rajonale Fier, përpunoi Grupi Auditimit.*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH sh.a(SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 21 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 2,220,667,522 |
| Vlera e realizuar | 1,904,423,772 |
| Procedura të hapura | 21 |

*Burimi: OSSH sh.a, përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, OSSH sh.a nuk ka realizuar kontratat shtesë.
II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH sh.a Drejtoria Rajonale Fier, për vitin 2021 janë kryer 16 nga keto , me vlerë 846,352,237 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 OSSH sha Fier (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | 16 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 846,352,237 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 785,411,831 |
| Procedura të hapura | 16 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSSH sh.a Drejtoria Rajonale Fier, për vitin 2022 janë kryer 5 procedura prokurimi, me vlerë 207,736,326 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2022 OSSH sha Fier (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | *5 Proçedura* |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | *207,736,326* |
| Vlera e realizuar | 172,877,000 |
| Procedura të hapura | 2 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 1 |
| Blerje te vogla | 2 |
| Totali | 5 |
| Procedura te anulluara (2020-2022) | 7 |
| Procedura te kryera (2020-2022) | 5 |

*Burimi: OSSH sh.a Drejtoria Rajonale Fier, përpunoi Grupi Auditimit*

**7.** Autoritetit Kontraktor, OSSH, Drejtoria Rajonale, **Berat**
I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH, Drejtoria Rajonale, Berat nga 01.07.2020 janë kryer *7 procedura prokurimi*, me vlerë 500,738,273 lekë pa tvsh.
II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH, Drejtoria Rajonale, Berat për vitin 2021 janë kryer *4 procedura prokurimi*, me vlerë 273,377,436 lekë pa tvsh.
III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH, Drejtoria Rajonale, Berat për vitin 2022 janë kryer *3 procedura prokurimi*, me vlerë 105,145,195 lekë pa tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH, Drejtoria Rajonale, Berat për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020) janë kryer 7 proçedura prokurimi, me vlerë 500,738,273 lekë pa tvsh. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH, BERAT (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 7 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 500,738,273 |
| Procedura të hapura | 7 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH, BERAT (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 7 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 500,738,273 |
| Vlera e realizuar | 401,827,017 |
| Procedura të hapura | 7 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, OSSH, Berat nuk ka realizuar kontratat shtesë.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH, Berat, për vitin 2021 janë kryer 4 procedura prokurimi me vlere 273,377,436. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara **(SPE)** | 4 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 273,377,436 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 267,079,658 |
| Procedura të hapura | 3 |
| Blerje te vogla | 1 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor (OSSH, BERAT ), për vitin 2022 janë kryer 3 procedura prokurimi, me vlerë 105,145,195 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2022 OSSH, BERAT (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 3 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 105,145,195 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 99033845 |
| Procedura të hapura | 1 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 2 |
| Procedura te kryera | 3 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

**8.** Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale “OSSH” Sh.a **Burrel**

I. Nga Drejtoria Rajonale “OSSH” Sh.a Burrel për periudhën 01.07.2020 deri më 31.12.2022, janë zhvilluar gjithsej 9 proçedura prokurimi me këto të dhëna:

II. Nga Ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH Sh.A Rajoni Burrel nga data 12.10.2020 është zhvilluar 1 proçedurë prokurimi me fond limit 125,299,062 lekë (pa TVSH ).

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH Sh.a Burrel, për vitin 2021 janë zhvilluar 8 proçedura prokurimi me vlerën e fondit limit 356,408,027 lekë (pa TVSH).

Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH Sh.a Burrel , për vitin 2022 nuk ka kryer proçedura prokurimi. I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH Rajoni Burrel, për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020 është kryer 1 proçedurë prokurimi, me vlerë 124,420,662 lekë (pa TVSH). (Vlera e kontratës). Në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH Rajoni Burrel (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 1 proçedurë (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 125,299,062 |
| Procedura të hapura | 1 |
| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH Rajoni Burrel (SPE)** |
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 1 Proçedurë (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 125,299,062 |
| Vlera e realizuar | 124,420,662 |
| Procedura të hapura | 1 |

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSSH Rajoni Burrel , për vitin 2021 janë kryer 8 nga keto (9 proçedura prokurimi), me vlerë 748,175,826.93 lekë pa TVSH *(Fondi Limit)* dhe 743,471,518.24 lekë pa TVSH *(Vlera e Kontratës).* Në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **Viti 2021 OSSH Rajoni Burrel (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 8 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 748,175,826.93 |
| Procedura të hapura | 8 |
| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2021 OSSH RAJONI BURREL (SPE)** |
| Prokurime gjithsej | 8 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 748,175,826.93 |
| Vlera e realizuar | 743,471,518.24 |
| Procedura të hapura | 8 |
| Totali | 8 |
| Procedura te kryera | 8 |

Nga OSSH Rajoni Burrel, për vitin 2022 nuk janë kryer procedura prokurimi.

**9.** Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a **Korçë**

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce nga 01.07.2020 janë kryer *2 procedura prokurimi*, me vlerë 149,739,951 lekë pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce, për vitin 2021 janë kryer *15 procedura prokurimi*, me vlerë 130,286,242 lekë pa tvsh.
III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce, për vitin 2022 janë kryer *0 procedura prokurimi*, me vlerë 0 lekë pa tvsh.
I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce, për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020") janë kryer 2 proçedura prokurimi, me vlerë 149,739,951 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH sh.a Korce (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 2 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 161,784,002 |
| Procedura të hapura | 2 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.
*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSSH sh.a Korce (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 2 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 161,784,002 |
| Vlera e realizuar | 149,739,951 |
| Procedura të hapura | 2 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce nuk ka realizuar kontratat shtesë. II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce, për vitin 2021 janë kryer 15 procedura prokurimi, me vlerë 130,286,242lekë pa tvsh. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 OSSH sh.a Korce (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | 15 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 150,362,950 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 130,286,242 |
| Procedura të hapura | 4 |
| Procedura kërkesë për propozim | 8 |
| Negocim | 1 |
| Blerje te vogla | 1 |
| Blerje e drejperdrejte | 1 |

*Burimi: OSHEE GROUP , përpunoi Grupi Auditimit*

**IV.** Nga ana e Autoritetit Kontraktor (Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korcë), për vitin 2022 janë kryer 0 procedura prokurimi, me vlerë 0 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | Viti 2022 Drejtoria Rajonale e OSSH sh.a Korce (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 0 Proçedura |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

**10.** Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale **Shkodër**

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE sh.a Drejtoria Rajonale Shkoder nga 01.07.2020 janë kryer *21 procedura prokurimi*, me vlerë 989,451,284 leke pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSHEE sh.a Drejtoria Rajonale Shkoder, për vitin 2021 janë kryer *7 procedura prokurimi*, me vlerë 131,709,218 lekë pa tvsh.

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSHEE sh.a Drejtoria Rajonale Shkoder, për vitin 2022 janë kryer *7 procedura prokurimi*, me vlerë 118,549,146 lekë pa tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE GROUP, për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020") janë kryer 35 proçedura prokurimi, me vlerë 1,239,709,648 leke pa tvsh. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE) | 6 mujori II Viti 2020 OSHEE SHKODER |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 21 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 989,451,284 |
| Procedura të hapura | 21 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | 6 mujori II Viti 2020 OSHEE Group (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 21 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 989,451,284 |
| Vlera e realizuar | 973,337,310 |
| Procedura të hapura | 21 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit.*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, OSHEE GROUP nuk ka realizuar kontratat shtesë .

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group, për vitin 2021 janë kryer 196 nga keto (57 procedura prokurimi), me vlerë 10,765,898,730.16 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit | Viti 2021 OSHEE GROUP (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | **7 Proçedura (SPE)** |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 131,709,218 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 118,720,987 |
| Procedura të hapura | 4 |
| Procedura e hapur e thjeshtuar | 2 |
| Blerje te vogla | 1 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor (OSHEE Group), për vitin 2022 janë kryer 26 procedura prokurimi, me vlerë 3,579,710,225 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2022 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 7 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 118,549,146 |
| Vlera e realizuar | 114,689,871 |
| Procedura të hapura | 2 |
| Blerje te vogla | 5 |
| Totali | 7 |
| Procedura te kryera | 7 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

**11.** Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group **Vlorë**

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group Vlorë nga 21.11.2020 janë kryer *2 procedura prokurimi*, me vlerë 164.285.664 lekë pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSHEE Group Vlorë, për vitin 2021 janë kryer *4 procedura prokurimi*, me vlerë 662,751.803 lekë pa tvsh.

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor OSHEE Group, për vitin 2022 janë kryer *5 procedura prokurimi*, me vlerë 4,930.05 lekë pa tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group Vlorë, për periudhën 21.11.2020 deri 31.12.2020") janë kryer 3 proçedura prokurimi, me vlerë 164,285.664 leke. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 21.11.2020 deri 31.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 2 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 164.285.664 |
| Procedura të hapura | 2 |
| Procedura kërkesë për propozim | 1 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi*.

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 3 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 164,285.664 |
| Vlera e realizuar | 243,364,837 |
| Procedura të hapura | 2 |
| Procedura kërkesë për propozim | 1 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, OSHEE Group nuk ka realizuar kontratat shtesë .

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, OSHEE Group , për vitin 2021 janë kryer 4 nga keto (4 procedura prokurimi), me vlerë 10,765,898,730.16 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit

për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | 4 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 662.751.803 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 289.395.925 |
| Procedura të hapura | 4 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor (OSHEE Group ), për vitin 2022 janë kryer 5 procedura prokurimi, me vlerë3,973,241 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2022 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | **26 Proçedura** |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 3,579,710,225 |
| Vlera e realizuar | 4.633.9 |
| Procedura të hapura | 5 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 5 |
| Blerje te vogla | 5 |
| Konsulence | 1 |
| Totali | 5 |
| Procedura te anulluara | 0 |
| Procedura te kryera | 5 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

**12.** Autoritetit Kontraktor, OSSH **<u>Gjirokastër</u>**

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër nga 01.07.2020 janë kryer *6 procedura prokurimi*, me vlerë 372,843,970 lekë pa tvsh.

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër për vitin nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi.

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër, për vitin 2022 janë kryer *7 procedura prokurimi*, me vlerë 16,301,582 lekë pa tvsh.

I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër, për periudhën (01.07.2020 deri 31.12.2020) janë kryer 6 proçedura prokurimi, me vlerë 360,848,942 lekë pa tvsh. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 6 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 372,843,970 |
| Procedura të hapura | 6 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | 6 mujori II Viti 2020 OSSH Gjirokastër (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 6 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 372,843,970 |
| Vlera e realizuar (pa TVSH) | 360,848,942 |
| Procedura të hapura | 6 |

*Burimi: OSHEE Group , përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër nuk ka realizuar kontrata shtesë. II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër, për vitin 2021 nuk është zhvilluar asnjë procedurë prokurimi. Kjo pasqyrohet në regjistrin e parashikimit dhe atë të realizimit për këtë vit kalendarik në të cilën nuk rezulton asnjë zë në regjistër.
III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor (Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastër), për vitin 2022 janë kryer 7 procedura prokurimi, me vlerë 13,879,237 lekë pa TVSH. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE) | Viti 2022 OSSH Gjirokastër (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 7 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 16,301,582 |
| Vlera e realizuar (pa TVSH) | 13,879,237 |
| Procedura të hapura | 1 |
| Blerje te vogla | 5 |
| Negociim pa shpallje paraprake | 1 |
| Totali | 7 |

*Burimi: OSHEE Group, përpunoi Grupi Auditimit*

**13.** Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH sh.a **Kukës**
I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukes nga 01.07.2020 janë kryer *6 procedura prokurimi*, me vlerë 241,677,989 lekë pa tvsh.
II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukes, për vitin 2021 janë kryer *5 procedura prokurimi*, me vlerë 88,235,555 lekë pa tvsh.
III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukes, për vitin 2022 janë kryer *3 procedura prokurimi*, me vlerë 15,401,000 lekë pa tvsh.
I. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukes , për periudhën 01.07.2020 deri 31.12.2020") janë kryer 6 proçedura prokurimi, me vlerë 241,677,989 leke.
Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2020 (për periudhën 01.07.2020 deri 30.12.2020) rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| Të dhëna mbi procedurën e prokurimit(SPE) | 6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE) |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 6 proçedura (SPE) |
| Vlera e parashikur totale (pa TVSH) | 247,387,815 |
| Procedura të hapura | 6 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukës, përpunoi Grupi Auditimit.*

Nga ana e AK, është krijuar në SPE regjistri i parashikimeve të prokurimeve publike brenda afateve ligjore, të përcaktuar në nenin 4 "Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik" regjistri vjetor i parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve janë botuar, në formë elektronike, në faqen e APP.gov.al.

*Mbi regjistrin përfundimtar të parashikimeve dhe realizimi.*

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **6 mujori II Viti 2020 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara | 6 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 247,387,815 |
| Vlera e realizuar | 241,677,989 |
| Procedura të hapura | 6 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukës, përpunoi Grupi Auditimit*

Gjatë 6 mujori II Viti 2020, Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukes nuk ka realizuar kontratat shtesë .

II. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukes, për vitin 2021 janë kryer 5 procedura prokurimi me vlerë 88,235,555 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2021 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit** | **Viti 2021 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej te parashikuara**(SPE)** | 5 Proçedura (SPE) |
| Vlera totale e prokuruar (pa TVSH) | 97,140,944 |
| Vlera e realizuar (SPE) | 88,235,555 |
| Procedura të hapura | 4 |
| Procedura kërkesë për propozim | 0 |
| Minikontrata | 0 |
| Blerje te vogla | 1 |

*Burimi:* Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukes, *përpunoi Grupi Auditimit*

III. Nga ana e Autoritetit Kontraktor (Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukës), për vitin 2022 janë kryer 3 procedura prokurimi, me vlerë 15,401,000 lekë. Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi viti 2022 rezultoi se në mënyrë të përmbledhur janë këto të dhëna:

| **Të dhëna mbi procedurën e prokurimit (SPE)** | **Viti 2022 OSHEE GROUP (SPE)** |
|---|---|
| Prokurime gjithsej | 3 Proçedura |
| Vlera e parashikuar totale (pa TVSH) | 17,922,200 |
| Vlera e realizuar | 15,401,000 |
| Procedura hapur e thjeshtuar | 3 |
| **Procedura te anulluara** | 1 |
| **Procedura te kryera** | 3 |
| **Procedura të paperfuduara** | 6 |

*Burimi: Drejtoria Rajonale OSSH sh.a Kukës, përpunoi Grupi Auditimit*

Nga auditimi i procedurave të prokurimit dhe kontratave të lidhura, në rastet në vijim janë konstatuar këto mospërputhje (problematika) me kuadrin rregullator përkatës si më poshtë vijon:

**1. Mbi zbatimin e procedurës së prokurimit: "Rikonstruksion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore").**

Projekti i zbatimit për Kontratën "Rikonstruksion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore"është miratuar nga z. P L, administrator i OSSH. Preventivi ështëpërgatitur nga z. K M dhe z. R C, miratuar nga Drejtori i Drejtorisë Rajonale Elbasan z. A A. Vlera e investimit është miratuar në shumën 179,626,163 lekë. Çmimet e aplikuara janë bazuar në manualin e çmimeve të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015, ku ka qenë e mundur si dhe në librin nr. 6 "Montimi i linjave dhe n/stacioneve".

U konstatuan mangësi si më poshtë:

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Hartim i kritereve të kualifikimit të pa argumentuara. |
| **Situata 1:** | Në dokumentet e tenderit "Rikonstruksion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore", kriteret e veçanta, "Kapacitetet teknike dhe profesionale", është kërkuar licencim sipas kategorisë (N.S -14) "Impiante të brendshme, elektrike, telefonie, radiotelelefon TV etj". Kjo kategori licence nuk i përket punimeve që realizohen sipas kësaj kontrate.<br>Në pikën 1 "Makineri e pajisje", ndër të tjera është kërkuar rul vibrues. Kompresor, autobitumatrice, sfaltshtruese. Bazuar në preventivin e punimeve, nuk ka asnjë zë i cili i përket përdorimit të këtyre makinerive.<br>Sa i përket mjeteve kit komplet linjash, terrametër për matjen e rezistencës së tokëzimit, megaometër etj., në pikën 4 është përcaktuar: "*Për pajisjet me qira të paraqitet kontrata e lidhur para noterit* ***për këtë objekt****, shoqëruar me akt pronësie origjinal ose fotokopje e noterizuar (kontrata shitblerje, kontrata dhurimi, fatura tatimore shitje, deklaratë zhdoganimi) të vlefshme*". Përcaktimi "Për këtë objekt", shvlerëson kontratat e mundshme të qirasë të lidhura në periudha të mëparshme, të cilat mund të shërbejnë për kontrata të tjera, por dhe për këtë kontratë. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i shfuqizuar), neni 26, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Vështirësi të OE në plotësimin e kërkesave. |
| **Shkaku** | Mo argumentimi dhe shqyrtimi ligjor i kritereve. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjëve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente. |

*Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. V K, z. A Gj dhe z. D M.*

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

| **Procedura e Prokurimit: "Rikonstruksion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore".** | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi nr. 3059/1, prot., datë 26.03.2021**<br>2. lloji i Procedurës së Prokurimit<br>E hapur-punë | **3. njësia e prokurimit**<br>V K<br>A Gj<br>D M | **4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 3059/2 prot., datë 26.03.2021.**<br>Z Dh<br>A H<br>S K |
| **5. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>179,626,163 lekë | **6. Oferta Fituese (pa tvsh)**<br>174,538,453 lekë | **7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)**<br>5,087,710 lekë |
| **8. Data e hapjes së ofertave**<br>04.05.2021 | **9. Burimi i Financimit**<br>Financim nga të ardhurat e OSHEE | **10. Operatorët Ekonomikë**<br>**1.** Shoqëria "V K & Sh I" me vlerë oferte 174,538,453lekë.<br>**b.** Skualifikuar – 0 OE |
| **11. Ankimime**<br>- | **12. Përgjigje e ankesës nga AK**<br>- | **13. Përgjigje ankesës nga KPP**<br>- |
| **b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave** | | |
| **14. lidhje e kontratës**<br>nr. 3059/9 prot., datë 13.07.2021 | **15. Vlera e kontratës (me tvsh)** | **16. Likuiduar**<br>- lekë |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 209,446,143.9 lekë | | Pa likuiduar:<br>- lekë | |
| **17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi`**<br>**Vlera 209,442,017 lekë** | **18. Afati i kontratës në ditë.**<br>Parashikuar 6muaj<br>Zbatuar: 6 muaj | | **19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë**<br>- | |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>A Q | **Licencë nr.**<br>MK. 2791/1 | **Kontrata**<br>Punonjës i shoqërisë | **Likuiduar** | **Pa likuiduar lekë** |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>G K | **Licencë nr.**<br>MK. 2847/1 | **Kontrata**<br>Punonjës i shoqërisë | **Likuiduar** | **Pa likuiduar** |
| **22. Aktkolaudimi**<br>13.07.2022 | **23. Akti i marrjes në dorëzim.**Nr. 64659/4 prot., datë 08.08.2022 | | **24. Fletë Hyrja** | |

Në tender ka marrë pjesë vetëm një OE, i cili ka paraqitur dokumentacionin e ofertës sipas përcaktimeve në dokumentet e tenderit.

Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga znj. V K, z. A Gj dhe z. D M.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar z. A Gj, z. D M dhe znj. V K, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230/7 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***

*Pretendohet se me shkresë nr. 3059 prot., datë 26.03.2021, janë përcjellë pranë prokurimit së bashku me kërkesën për prokurim edhe kapacitetet teknike të hartuara nga grupi i punës i përbërë nga specialist të fushës si preventivues e projektues të këtij projekti. Pretendohet se bashkengjitur observacionit paraqitet shkresa përkatëse, sipas të cilës specialistët e fushës kanë përcaktuar domosdoshmërinë e licencimit sipas kategorisë N-14, si dhe makineritë rul vibrues, kompresor, autobitumatriçe e asfaltoshtruese.*

**<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>**

Sqarojmë se bashkëngjitur observacionit nuk është paraqitur shkresa përkatëse. Gjithsesi, nga auditimi nuk ka rezultuar se për hartimin e kritereve është ngarkuar strukturë tjetër. Në përbërje të njësisë së prokurimit gjithashtu ka specialistë të fushës.

Nga administrimi bashkëngjitur observacionit për projektraportin e auditimit, është paraqitur dokumentacion i cili vërteton marrjen nga ana e njësisë së prokurimit të një projektpreventivi dhe specifikime teknike, por nuk ka dokumentacion që vërteton ngritjen e një strukture të posaçme për hartimin e tyre. Kriteret në kundërshtim me aktet ligjore kanë karakter profesional sa i takon makinerive, por sa i përket licencimit, apo vendosjes së kritereve për objektin përkatës kanë karakter të përgjithshëm. Pavarësisht marrjes së dokumentacionit nga njësitë përbërëse të KESH, nga ana e njësisë së prokurimit duhet të rishikoheshin kriteret, sepse për këtë rast nuk disponohet një urdhër i veçantë për ngritje strukture përkatëse.

**2. Mbi zbatimin e procedurës së prokurimit "Ndertimi i rrjetit TM 20kV, fideri F6, kabinave perkatese dhe rrjetit TU me percjelles ABC, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti III".**

Fondi limit është përllogaritur me vlerë 159,671,466 lekë. Preventivi i punimeve është i ngjashëm me të gjitha procedurat e zhvilluara nga OSHEE. Çmimet janë mazuar në manualet e punimeve të ndërtimit dhe librin 6.
Procesverbali i hartimit të kritereve është mbajtur me nr. 3162/3 prot., datë 22.09.2020, nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. G Gj, z. A G (Jurist) dhe z. F G.
U konstatuan mangësi si më poshtë:

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Hartim i kritereve të kualifikimit të pa argumentuara. |
| **Situata 2:** | Në kërkesat e veçanta pika 2.3.3, krahas të tjerave janë përfshirë kërkesat si më poshtë:<br>a. Licenca profesionale sipas kategorisë NP-12 (punime të inxhinierisë së mjedisit) si dhe NS-14 (Impiante të brendshme, elektrike, telefonie, etj.).<br>Sipas pikës 2.3.4, është kërkuar disponimi i makinerive si autovinç transportues mbi 5 ton me karroceri – 2 copë, kamion (5 deri 7 ton) 2 copë dhë kamion 20 ton 4 copë, frezë asfalti, prerëse asfalti 3 copë dhe 1 minifrezë asfalti, asfaltoshtruese dhe miniasfaltoshtruese, eskavator me goma, minieskavator dhe 2 fadroma. Referuar preventivit, nuk ekzistojnë punime mjedisore dhe kërkesa për disponimin e licencës përkatëse është e pa argumentuar.<br>Kërkesa për asfaltshtruese, ndërkohë që kërkohet edhe miniasfaltshtruese është e pa argumentuar, pasi kemi të bejmë me shtresa asfaltobetoni me gjerësi të vogël.<br>Kërkesa për dy fadroma, ndërkohë që ka kërkesë edhe për eskavator dhe minieskavator është e pa argumentuar, pasi procesi i gërmimit është i parashikuar me hedhje në automjet.<br>Janë kërkuar 5 mjete prerëse asfalti, megjithëse me emërtim të ndryshëm, ndërkohë që volumi i punës nuk i përgjigjet nevojës sipas kërkesës.<br>Kërkesa për 2 autovinc trasportues, të cilët kryejnë edhe rolin e kamionit, 2 kamionë 5 deri në 7 ton dhe 4 kamionë 20 ton është e pa argumentuar, pasi volume i punimeve sipas preventivit, nuk ka përmasat për përdorimin e këtyre mjeteve. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i shfuqizuar), neni 26, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Vështirësi të OE në plotësimin e kërkesave. |
| **Shkaku** | Mos argumentimi dhe shqyrtimi ligjor i kritereve. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjëve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente. |

*Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. A G, znj. G Gj dhe z. F G.*

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

| |
|---|
| **Procedura e Prokurimit: "Ndertimi i rrjetit TM 20kV, fideri F6, kabinave perkatese dhe rrjetit TU me percjelles ABC, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti III ".** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi nr. - prot., datë -**<br>2. lloji i Procedurës së Prokurimit<br>E hapur-punë | **3. njësia e prokurimit**<br>A G<br>G Gj<br>F G | | **4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr.., datë**<br>I L<br>A N<br>K C | |
| **5. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>159,671,466 lekë | **6. Oferta Fituese (pa tvsh)**<br>155,527,423 lekë | | **7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)**<br>4,144,043 lekë | |
| **8. Data e hapjes së ofertave**<br>28.10.2020 | **9. Burimi i Financimit**<br>Financim nga të ardhurat e OSHEE | | **10. Operatorët Ekonomikë**<br>**1.** BOE : "K K" sh.p.k & "E" SHPK me vlerë oferte 159,671,466 lekë.<br>2. E SHPK, nuk ka paraqitur ofertë<br>**b.** Skualifikuar – 1 OE | |
| **11. Ankimime**<br>- | **12. Përgjigje e ankesës nga AK**<br>- | | **13. Përgjigje ankesës nga KPP**<br>- | |
| **b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave** | | | | |
| **14. lidhje e kontratës**<br>datë 05.01.2021 | **15. Vlera e kontratës (me tvsh)**<br>186,632,907.6 lekë | | **16. Likuiduar**<br>- lekë<br>Pa likuiduar:<br>- lekë | |
| **17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi`**<br>Vlera 155,313,423 lekë (Pa TVSH) | **18. Afati i kontratës në ditë.**<br>Parashikuar 4 muaj<br>Zbatuar: 4 muaj | | **19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë**<br>- | |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>A A | **Licencë nr.**<br>MK. | **Kontrata**<br>Punonjës i shoqërisë | **Likuiduar** | **Pa likuiduar Lekë** |
| **21. Kolaudatori i punimeve** | **Licencë nr.** | **Kontrata** | **Likuiduar ............** | **Pa likuiduar ........** |
| **22. Aktkolaudimi** | **23. Akti i marrjes në dorëzim.** | | **24. Fletë Hyrja** | |

Vlerësimi i ofertave është bërë me datë 23.11.2020, pas njoftimit mbi shqyrtimin e ankesës. Në tender kanë marrë pjesë dy OE, ndërkohë që njëri OE konkretisht "E" SHPK, si në pothuajse të gjitha procedurat e prokurimit merr pjesë por nuk paraqet asnjë dokument përveç ekstraktit te QKB.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:
*Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. A G, znj. G Gj dhe z. F G.*

**3. Mbi zbatimin e procedurës së prokurimit "Blerja e PDA dhe tablet si dhe monitorimi i punonjësve".**
Kërkesa për prokurim sipas Kontratës "Blerja e PDA dhe tablet si dhe monitorimi i punonjësve", është bërë nga Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit z. T K me shkresë nr. 2158 prot., 02.03.2021. Komisioni i përllogaritjes së fondit limit dhe përcaktimit të specifikimeve teknike është ngritur me Urdhër nr. 2158/1 prot., datë 03.03.2021, i përbërë nga z. M D, z. D Z dhe z. L D.
Nga auditimi i kësaj procedure u konstatuan mangësi si më poshtë:

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Mangësi në përllogaritjen e vlerës së kontratës sipas studimit të tregut. |
| **Situata 3:** | Për përcaktimin e çmimit është aplikuar studimi i tregut nëpërmjet ofertave të 5 OE dhe konkretsisht: "B", Prishtinë, me vlerë 161,000,000 lekë, "A T" |

| | |
|---|---|
| | SHPK, me vlerë 160,000,000 lekë. "I" SHPK, me vlerë 154,000,000 lekë, "P I" SHPK, me vlerë 156,000,000 lekë, "B" SHPK, me vlerë 186,000,000 lekë. Fondi limit është përcaktuar me vlerë 157,200,000 lekë.<br>Nga auditimi rezulton se OE "I" SHPK dhe OE "P I" SHPK, nuk kanë të regjistruar në QKB aktivitet programimi. OE "B" SHPK, nuk ka të regjistruar asnjë objekt në lidhje me prokurimin, si për ofrimin e pajisjeve elektronike, ashtu dhe programimin.<br>Sa më sipër arrihet në konkluzionin se përllogaritja e fondit limit duke pranuar oferta nga OE që nuk ushtrojnë aktivitet të fushës, plotësisht apo plotësisht, nuk është e argumentuar. |
| **Kriteri:** | VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i shfuqizuar), neni 59. |
| **Ndikimi:** | Nuk jepet garanci për një vlerësim të saktë të çmimit të tregut. |
| **Shkaku** | Mos argumentimi dhe shqyrtimi ligjor i kritereve. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **1.1 Rekomandimi:** | OSHEE, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjëve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente. |

*Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi komisioni i përllogaritjes së fondit limit, i përbërë nga z. M D, z. D Z dhe z. L D.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar z. M D, z. D Z dhe znj. L D, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230/9 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

| |
|---|
| ***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***<br>*-Pretendohet se Në momentin kur grupi ka marrë detyrën për të përcaktuar fondin limit të kësaj procedure dhe të hartojë specifikimet teknike të mallrave dhe shërbimeve ka kontaktuar me operatorë të ndryshëm në treg nga të cilët, të interesuarit kanë shprehur gatishmërinë që të marrin pjesë në procesin e ofertimit për procedurën e sipërcituar. Duke vlerësuar angazhimin e tyre në proces si dhe duke parë ekstraktet e këtyre kompanive në faqen e QKB, është evidentuar dhe vlerësuar që kompanitë e përmendura nga grupi i auditivit kanë në objekt të veprimtarisë "Import dhe eksport të pajisjeve elektronike", duke konsideruar se programimi i tyre është pjesë e paketës së tregtimit të tyre.* |

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit.</u>**

Në lidhje me programimin sqarojmë se nuk bëhet fjalë për paketën e programeve bazë por me programim transmetim dhe përpunim të dhënash të pajisjeve në databazën e institucionit. Në observacion nuk përmendet fakti se një operator të cilit i është marrë ofertë nuk ka asnjë objekt të paktën të ngjashëm me objektin e prokurimit.

Sa i takon specifikimeve, nuk paraqiten argumente ligjore për mënyrën e hartimit të tyre.

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Hartim i specifikimeve teknike të pa argumentuara. |
| **Situata 4:** | Në specifikimet teknike janë përcaktuar disa kritere ndër të tjera, për **PDA të jenë me konstrukt** Industrial i standardit IP65 i markuar me logon e OSSH, me tastierë me 20 butona, peshë më e vogël se 500 gram, kontrlleri duhet të jetë me ngjyra lehtësisht të dallueshme nga syri i njeriut. Për tabletet është kërkuar |

| | |
|---|---|
| | që ekrani të jetë multitouch Full HD mbi 10.1", pesha më e vogël se 700 gram, me 2 mikrofonë;<br>Nga ana e APP me email të datës 29.03.2021, janë vendosur disa pikëpyetje mbi përcaktimet e mësipërme. Nga ana e OSHEE, janë rishikuar dokumentet e tenderit, por pa ndryshuar asnjë nga përcaktimet e mësipërme. |
| **Kriteri:** | Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 23, pika 1 dhe 3.c. |
| **Ndikimi:** | Vështirësi të OE në plotësimin e kërkesave. |
| **Shkaku** | Mos argumentimi dhe shqyrtimi ligjor i specifikimeve teknik. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjëve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më eficiente. |

*Për sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi komisioni i përcaktimit të specifikimeve teknike i përbërë nga z. M D, z. D Z dhe z. L D.*

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

<table>
<tr><td colspan="5">Procedura e Prokurimit: "Blerja e PDA dhe tablet si dhe monitorimi i punonjësve".</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi nr. 2158/3, prot., datë 12.03.2021<br>2. lloji i Procedurës së Prokurimit<br>E hapur-mallra</td><td colspan="2">3. njësia e prokurimit<br>E Ç<br>D M<br>V K</td><td colspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 2158/4 prot., datë 12.03.2021.<br>T K<br>A G<br>A Xh</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa tvsh)<br>157,200,000 lekë</td><td colspan="2">6. Oferta Fituese (pa tvsh)<br>151,420,000 lekë</td><td colspan="2">7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)<br>5,780,000 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave<br>14.04.2021</td><td colspan="2">9. Burimi i Financimit<br>Financim nga të ardhurat e OSHEE</td><td colspan="2">10. Operatorët Ekonomikë<br>1. Shoqëria "L & S" me vlerë oferte 151,420,000 lekë.<br>b. Skualifikuar – 0 OE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime<br>-</td><td colspan="2">12. Përgjigje e ankesës nga AK<br>-</td><td colspan="2">13. Përgjigje ankesës nga KPP<br>-</td></tr>
<tr><td colspan="5">b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave</td></tr>
<tr><td>14. lidhje e kontratës<br>nr. 2158/12 prot., datë 24.05.2021</td><td colspan="2">15. Vlera e kontratës (me tvsh)<br>181,704,000 lekë</td><td colspan="2">16. Likuiduar<br>- lekë<br>Pa likuiduar:<br>- lekë</td></tr>
<tr><td>17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi`</td><td colspan="2">18. Afati i kontratës në ditë.<br>Parashikuar 45 ditë<br>Zbatuar: ___ ditë</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë<br>-</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve</td><td>Licencë nr.</td><td>Kontrata</td><td>Likuiduar ............</td><td>Pa likuiduar Lekë</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve</td><td>Licencë nr.</td><td>Kontrata</td><td>Likuiduar ............</td><td>Pa likuiduar ........</td></tr>
<tr><td>22. Aktkolaudimi</td><td colspan="2">23. Akti i marrjes në dorëzim.</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja</td></tr>
</table>

Në tender ka marrë pjesë vetëm një OE, i cili ka paraqitur dokumentacionin sipas kërkesave të tenderit.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar z. E Ç, z. D M dhe znj. V K, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230/6 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

| |
|---|
| ***<u>Pretendimi i subjektit:</u>*** |
| *Pretendohet se specifikimet teknike janë hartuar nga një komision i posaçëm i caktuar me urdhër të titullarit nr. 2158/2 prot., datë 12.03.2022.* |

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit.</u>**

Sqarojmë se në dosjen e prokurimit nuk ndodhej dokumentacion që vërteton ngarkimin e një strukture tjetër për hartimin e kritereve. Gjithsesi, nga shqyrtimi i observacioneve të paraqitura nga z. M D, z. D Z dhe z. L D mbi përllogaritjen e fondit limit të procedurës së mësipërme, si dhe dokumentacionit mbështetës observacionit, përgjegjësia për hartimin e kritereve është e komisionit të përllogaritjes së fondit limit, komision i cili është ngarkuar edhe për hartimin e specifikimeve.

**4.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: ***"F.V dhe Instalim të sistemit të Matjes Inteligjente në Kabinat Elektrike të OSSH sh.a, softŴare-t dhe integrimet e tyre në platformen MDMS (Mater data mangement system)"***, viti 2022, konstatohet:

*<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit:</u>*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"F.V dhe Instalim të sistemit të Matjes Inteligjente në Kabinat Elektrike të OSSH sh.a, SoftŴare-t dhe integrimet e tyre në platformen MDMS (Mater data mangement system)"* | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur"<br>REF-23133-03-25-2022<br>Urdhri nr. 11913/3 prot., datë 23.03.2022 | **1.1 Komisioni percaktimit preventivit, ST, fondit limit**<br>Urdhri nr. 11913/1 prot., datë 09.11.2021<br>1. I S<br>2. G B<br>3. L A<br>4. A B<br>5. E B | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. A Gj<br>2. D M<br>3. V K | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr. 11913/4 prot., datë 23.03.2022.<br>1. M D<br>2. M B<br>3. L Rr<br>4. L S<br>5. R E |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>1.048.176.705 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>992,576,392 lekë<br>Operatori Fitues: "A E" shpk | | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>55,600,313 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 12/05/2022, 27.05.2022 | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **5 OE**<br>b) S'kualifikuar **4 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 B/OE** |
| **7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 18 muaj nga dorezimi i sheshit | | | |

***Të dhëna mbi projektin dhe qëllimi i projektit sipas termave të referencave***

Qellimi i punës për këtë paketë përfshin dy blloqet kryesore të aktiviteteve të mëposhtme:

1) <u>Përgatitjen e infrastruktures për LV SMART GRID (Rrjetin inteligjent në TU) dhe të gjitha modulet për operacionet e saj.</u>

<u>2) Pajisjet matëse të Pikës së Transformimit (TP).</u>

OSHEE Group kërkon të investoje në Sistemin e Matjes Inteligjente në kabinat elektrike të OSSH sh.a, si dhe të përgatisi infrastrukturën për implementimin e sistemit e rrjetit inteligjent në TU (SMART GRID). Smart Grid është një koncept për transformimin e rrjetit të energjisë elektrike të OSSH /OSHEE sha Group, duke përdorur teknika të avancuara të kontrollit automatik dhe komunikimit dhe forma të tjera të teknologjisë së informacionit. Ai integron mjete dhe teknologji

inovative nga gjenerimi, transmetimi dhe shpërndarja deri tek pajisjet dhe pajisjet e konsumatorit. Kontraktori do të sigurojë aplikacionin në ŵeb të Shërbimit Desk dhe akses në linjën e nxehtë për raportimin e incidenteve të dështimit. Kontraktori do të japë njoftime periodike në lidhje me arnimacionet, përditësimet dhe përmirësimet e Head End System.

***Nga auditimi i ofertës fituese u konstatua disa pasaktësi si më poshtë vijon:***

Referuar kapaciteteve teknike të OE fitues, konstatohet se ky operator disponon vetëm 26 punonjonjës kryesisht elektricista, 4 Inxh elektrik, 1 Inxh elektroenergjitik dhe 1 Inxhinier Ndërtimi. Gjithashtu në dokumentat e hedhura në tender nuk disponohet asnjë kontratë me specialist të fushës së programimeve apo kompani për sistemet smart Grid. Referuar zërave të preventivit: Upgrade i sistemit HES në vlerën 45,000,000 lekë, Training Packege në vlerën 8,500,000 lekë, Test dhe Inspektimi në vlerën 3,350,000 lekë, Komisionim dhe operimi në vlerën 3,350,000 lekë, në total prej 60,200,000 lekë pa TVSH, nga AK OSHEE sh.a, *realizimi i të cilave paraqitet me risk bazuar në kapacitetit teknik të OE fitues*.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*F.V dhe Instalim të sistemit të Matjes Inteligjente në Kabinat Elektrike të OSSH sh.a, softŴare-t dhe integrimet e tyre në platformen MDMS (Mater data mangement system)"* nuk janë kërkuar kapacitete teknike për realizimin dhe përgatitjen e infrastruktures për LV Smart Grid (Rrjetin inteligjent në TU) dhe të gjitha modulet për operacionet e saj. |
| **Situata 5:** | Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 01.09.2022 për F.V dhe Instalimin e sistemit të Matjes Inteligjente, në DST dhe relacion teknik pika 2.3.4, nuk është *kërkuar Inxh. Elektronikë, Inxh. Mekatronik apo Inxh. Infromatikë* që autoriteti kontraktor të sigurohet për realizimin e sofŵarëve apo Upgradimin i sistemit HES. Në dokumentat e hedhura në tender nuk kërkohet asnjë kontratë me specialist të fushës së programimeve apo kompani për bashkëpunim për mirëmbajtje programesh në lidhje me specifikimet e projektit, sipas nenit 39 "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike" të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Pika 2, Pika 4. dhe *nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*". Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, ku operatori fitues disponon vetëm 26 punonjonjës kryesisht elektricista, 4 Inxh elektrik, 1 Inxh elektroenergjitik dhe 1 Inxhinier Ndërtimi. Referuar zërave të ofertës fituese Upgrade i sistemit HES në vlerën 45,000,000 lekë, Training Packege në vlerën 8,500,000 lekë, Test dhe Inspektimi në vlerën 3,350,000 lekë, Komisionim dhe operimi në vlerën 3,350,000 lekë, në total prej 60,200,000 lekë pa TVSH, nga AK OSHEE sh.a, *realizimi i tyre paraqitet me risk bazuar në kapacitetit teknik të OE fitues*. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 8734, datë 1.2.2001 "Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike".<br>- VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit |

| | |
|---|---|
| | - Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti:** | Risk për realizimin dhe përgatitjen e infrastruktures për LV SMART GRID (Rrjetin inteligjent në TU) dhe të gjitha modulet për operacionet e saj |
| **Shkaku:** | Nga Autoriteti Kontraktor, nuk janë kërkuar kapacitete teknike që autoriteti kontraktor të sigurohet për realizimin e sofŵarëve apo Upgradimin i sistemit HES. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | Autoriteti kontraktor OSHEE Group, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. |

**5.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: *"Fiderat e rinj 20 KV të Nënstacionit Vorë*", njësia rajonale Tiranë, viti 2021, fond limit 198,830,262 lekë pa TVSH", konstatohet:

<u>*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*</u>

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Fiderat e rinj 20 KV te Nenstacionit Vore" 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur"<br>REF-83508-12-30-2020 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. D M<br>2. E M<br>3. Zh B | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. D Xh<br>2. A A<br>3. F N |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>198,830,262 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>197,702,421 lekë<br>Operatori Fitues: "G" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>1,127,841 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 01.02.2021<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>12 muaj nga dorezimi i sheshit | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. Sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **2 OE**<br>b) S'kualifikuar **1 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP**-s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

***a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:***
Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 26 "Kontrata për punë publike"; pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Fiderat e rinj 20 KV të Nënstacionit Vorë"* Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim. |
|---|---|
| **Situata 6:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë në datën 01.02.2021 nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.<br>- Në pikën 3.d të DST, kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 60 punonjës, *për periudhën e 6 muajve të fundit* (duke |

| | |
|---|---|
| | marre si reference datën e hapjes së tenderit). Kërkohet që Operatori Ekonomik për të realizuar objektin e prokurimit duhet të kete minimalisht 30 specialiste ku të përfshihen: 20 elektricistë (nga të cilet 15 të jenë me kategorine e III-te dhe 5 të jene me kategorinë e IV) dhe 10 specialistë ndërtimi. *Numri i elektricistëve prej 30 punonjës dhe kategorizimi i tyre nuk është argumentuar nga NJP. Specifikimi në kategoritë përkatëse të IQT, ngushton konkurrencën dhe jo në përputhje me parimet e stimulimit të biznesit.*<br>- Në pikën 3.f të DST kërkohet që Operatori Ekonomik në zbatim të VKM Nr.108 datë 09.02.2011"Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarresit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe të shendetit në punë", ndryshuar me VKM Nr. 632 date 15.07.2015, duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontrate shërbimi / me subjekte të specializuara për këte qëllim. Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet te plotësoje ketë kerkese duke pasur në konsiderate edhe parashikimet e ligjit te cituar me lart.<br>- Vendosja e kriterit, "*Në rastin e BOE sejcili prej operatoreve ekonomike duhet të plotësoje këtë kriter*", është një kriter i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 74 pika 3 ku citohet .... "*secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*". Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme sforcon kërkesat kualifikuese dhe zvogëlon konkurrencën, ku një operator, i cilit nuk disponon "*Mjek*" nuk mund të kryej bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, *pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit si dhe OE të cilët këtë shërbim mund ta marrin nëpërmjet kontraktimit dhe jo punësimit të drejtpërdrejtë të një mjeku.* |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës dhe dokumentet e tenderit<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" |
| **Ndikimi/Efekti:** | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim. |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përputhshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik"i ndryshuar. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandimi:** | Drejtoria Rajonale OSSH Tiranë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

Në lidhje me observacionet e dërguara nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit Tiranë z. D M, E M dhe Zh B nr. 4230/5 prot. Datë 30.05.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 827/7 prot. Datë 31.05.2023, mbi pretendimet e konstatimeve të projekt raportit dërguar me nr. 826/6 datë 09.05.2023.

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***

*-Në lidhje me certifikatat e sigurimit teknik dhe numrin e punonjësve, pretendimet e NJP sqarohen se ky numër punonjësish është kërkuar duke patur parasysh preventivin e tenderit dhe kohëzgjatjen e tij. Specifikimi i kategorive është kërkuar dhe lidhen ngushtë me preventivin e punimeve, ku do të kryhen punime në kabina të tensionit të mesëm të cilat kërkojnë specialistë të kualifikuar.*

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>**

Në lidhje me observacionin e dërguar nga NJP, nuk mund të merret në konsideratë pasi pretendimet tuaja referuar rastit konkret nuk gjejnë mbështetje ligjore dhe nuk janë paraqitur prova apo dokumentacion shtesë në mbështetje të pretendimeve. Kriteret kualifikuese nga grupi i auditimit, janë trajtuar në bazë të parimeve të stimulimit të konkurrencës dhe të rritjes së efiçencës e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore. Në hartimin e raportit dhe rekomandimet mbi konstatimet qëndrojnë në masa organizative për institucionin që vazhdimisht të udhëhiqet nga parimi ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë. Referuar ligjit mbi prokurimin publik, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Nga observacionet nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

**6.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt*: "**Bazë materiale për nyjet kritike**"*, Drejtoria e Tensionit të Lartë, viti 2021, fond limit 199,925,120 lekë pa TVSH*"*, konstatohet:

*<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit:</u>*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Bazë materiale për nyjet kritike 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur-Mallra"<br>REF-91646-03-29-2021 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. R S<br>2. A P<br>3. T Gj | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. D Xh<br>2. Z K<br>3. Dh Gj |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>199,925,120 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>186.400.000 lekë<br>Operatori Fitues: "A" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>13,525,120 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 22.04.2021, ndryshohet 24.04.2021, ndryshohet ***05.05.2021***<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>6 muaj | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **2 OE**<br>b) S'kualifikuar **1 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP**-s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit në SPE konstatohet:**
Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 27 "Kontratat e mallrave"; pika 3, "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*".

| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Bazë materiale për nyjet kritike*" Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim |
|---|---|
| **Situata 7:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë në datën 14.05.2021 nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.<br>- Në pikën 3.4 të DST, kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 50001 - 2018 (e vlefshme) për sistemim e manaxhimit te energjisë, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim. Çertifikata ISO 50001:2018, e cila është e paargumentuar nga AK, specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është ti lejojë një ndërmarje të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumin. ISO 50001: 2018 specifikon kërkesat e zbatueshme për përdorimin dhe konsumin e energjisë, duke përfshirë matjen, dokumentacionin dhe raportimin, hartimin dhe praktikat e prokurimit për pajisje, sisteme, procese dhe personel që kontribuojnë në performancën e energjisë. *Pra, sic shikohet kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi OE do vetëm do të realizojë blerjen e mallrave sipas specifikimeve të kërkuara dhe kjo certifikatë nuk i nevoitet OE për menaxhimin e energjisë.*<br>- Në pikën 3 të DST, kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në listëpagese, *mjekun e shoqërisë* të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, ose të ketë një kontratë me mjek të licensuar apo subjekte që ofrojne sigurimet shendetesore, sipas parashikimeve te Vendimit Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave. Vendosja e kërkesës së mjekut në shoqërinë, nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit, duke larguar nga konkurrimi operatoret ekonomike tregtare. Kriteri bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 ku përcaktohet: "*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik*". Në pikën 4 të DST, |

| | |
|---|---|
| | kërkohet Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik mbështetës, si dhe të *figuroj në Licensën e shoqërisë* dhe në listëpagesat e shoqërisë, i cili të jetë i siguruar të pakten për 3 (tre) muajt e fundit 1 Inxhinier Elektrik. Vendosja e kriterit të Inxhinierit elektrik në licensën e shoqërisë është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 27 "*Kontratat e mallrave*", pasi procedura e prokurimit është "*Blerje-mallra*" dhe jo procedure e hapur pune, ku përcaktohen rregullat në nenin 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014. Vendosja e kriterit të Inxhinierit elektrik në licensën e shoqërisë, nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare. Vendosja për të paktën 3 muaj në listëpagesë, kufizon konkurrencën duke favorizuar vetëm ata OE, të cilët kanë Inxhinierë elekrikë mbi 3 muaj në listëpagesë, ku në DT është përjashtuar edhe mundësia e kontraktimit të Inxh. Elektrik përgjatë realizimit të kontratë. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës "Blerje Mallra" dhe dokumentet e tenderit.<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik"i ndryshuar. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | 1. Drejtoria e Tensionit të Lartë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të Mallrave që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Drejtoria e Tensionit të Lartë anëtarët e NJP, të A P, T Gj, R S dhe KVO Z K, Dh Gj, D Xh me nr. 4230/16 prot. Datë 30.05.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 827/7 prot. Datë 31.05.2023, mbi pretendimet e konstatimeve të projekt raportit dërguar me nr. 826/6 datë 09.05.2023.

| |
|---|
| ***Pretendimi i subjektit:***<br>*- Në lidhje me kërkesën e mjekut, sqarohet se është vendosur sipas parashikimeve VKM nr. 108 datë 09.02.2011, ku bën pjesë objekti i prokurimit.*<br>*- Në lidhje me ISO 50001:2018, sqarohet se ky kriter është përcaktuar në bazë të nenit 46/2 të LPP dhe kjo certifikatë aplikohet për punë mallra e shërbime në cdo shoqëri.*<br>*- Në lidhje me Ing elektrik drejtues teknik, sqarohet se është vendosur se OE duhet të ketë të dhëna për implementimin apo përdorimin e mallrave.*<br>*- Në lidhje me vlerësimin e ofertave për operatorin GSA, sqarohet se KVO nuk mund të bëjë interpretim apo vlerësim të kritereve kualifikuese. Gjithashtu sqarohet se OE ka realizuar tërheqje nga gara dhe nuk ka qenë e nevojshme nga AK mbi verifikim e përmbajtjeve të mangësive.* |

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>**

Kriteret kualifikuese nga grupi i auditimit, janë trajtuar në bazë të parimeve të stimulimit të konkurrencës dhe të rritjes së efiçencës e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore. Në hartimin e projekt-raportit dhe rekomandimet mbi konstatimet qëndrojnë në masa organizative për institucionin që vazhdimisht të udhëhiqet nga parimi ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit, bazuar në kritere të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë. Referuar ligjit mbi prokurimin publik, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në lidhje me vlerësimin e ofertave në akt konstatimi është referuar neni 53 i LPP dhe nuk është lenë vend për interpetime të komisionit të vlerësimit të ofertave. Nga observacionet nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

**7.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: *"**Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti II**"* me fond limit *120,349,195 lekë pa tvsh* , njësia rajonale Durrës viti 2020, konstatohet:

*<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit:</u>*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti II" 2020* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur"<br>REF-75358-10-13-2020 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. A G<br>2. G Gj<br>3. F G | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. H K<br>2. Y M<br>3. A N |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>120,349,195 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>119,137,962 lekë<br>BOE: E" sh.p.k & "S" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>1,211,233 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 13/11/2020<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>5 muaj nga dorezimi i sheshit | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **4 OE**<br>b) S'kualifikuar **1 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP-**<br>s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:**

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 26 "Kontrata për punë publike"; pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti II*" Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim. |
|---|---|
| **Situata 8:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 13.11.2021 nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.<br>- Në pikën 2.3.1, b të DST, kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 50001-2018 (e vlefshme) për sistemim e manaxhimit te energjis, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Çertifikata ISO 50001:2018, e cila është e paargumentuar nga AK, specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është ti lejojë një ndërmarje të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumin. ISO 50001: 2018 specifikon kërkesat e zbatueshme për përdorimin dhe konsumin e energjisë, duke përfshirë matjen, dokumentacionin dhe raportimin, hartimin dhe praktikat e prokurimit për pajisje, sisteme, procese dhe personel që kontribuojnë në performancën e energjisë. Pra, kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi OE do vetëm do të realizojë punën e ndërtimit të rrjetit të Fiderit, sipas specifikimeve të kërkuara dhe kjo certifikatë nuk i nevoitet OE për menaxhimin e energjisë.<br>- Në pikën 2.3.1,dh të DST kërkohet që operatori ekonomik duhet te kete minimum 50 punonjes elektricist nga muaji janar 2020 (duke marre si reference datën e hapjes së tenderit), të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të leshurara nga organe kompetente të akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar, nga te cilet, 10 punonjes te kene grupin e IV-et ose te V-te te sigurimit teknik, 15 punonjes grupin e III-te te sigurimit teknik dhe pjesa e mbetur grupin e I-re ose te II-te te sigurimit teknik. *Numri i elektricistëve prej 10 punonjës dhe kategorizimi i tyre <u>nuk është argumentuar nga NJP.</u> Specifikimi në kategoritë përkatëse të IQT, ngushton konkurrencën dhe jo në përputhje me parimet e stimulimit të biznesit.*<br>- Në pikën 2.3.1, dh, a të DST Operatori ekonomik duhet ketë pjese te stafit te tij, *<u>si drejtues teknik,</u>* nga muaji janar 2020 deri muajin e fundit qe perkon me datën e hapjes se ofertave personelin si me poshtë:1 (nje) inxhiniere Elektrike, 1 (një) inxhinier Ndertimi, 1 (një) inxhinier Mekanik, 1 (një) inxhinier Gjeodet, 1 (një) inxhinier Mjedisi. Kriteri i inxhinierëve të mësipërm vështirëson pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik të cilët nuk e kanë inxhinierët e mësipërm *në licencën e shoqërisë*.<br>- Në pikën 3.f të DST kërkohet që Operatori Ekonomik në zbatim të VKM Nr.108 datë 09.02.2011"Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarresit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe të shendetit në punë", ndryshuar me VKM Nr. 632 date 15.07.2015, duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontrate shërbimi / me subjekte të specializuara për këte qëllim. Mjeket të |

| | |
|---|---|
| | jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet te plotësoje ketë kerkese duke pasur në konsiderate edhe parashikimet e ligjit te cituar me lart.<br>Vendosja e kriterit, "*Në rastin e BOE sejcili prej operatoreve ekonomike duhet të plotësoje këtë kriter*", është një kriter i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 74 pika 3 ku citohet .... "*secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*". Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme sforcon kërkesat kualifikuese dhe zvogëlon konkurrencën, ku një operator, i cilit nuk disponon "*Mjek*" nuk mund të kryej bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, *pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit si dhe OE të cilët këtë shërbim mund ta marrin nëpërmjet kontraktimit dhe jo punësimit të drejtpërdrejtë të një mjeku.*<br>Në pikën 2.3.2 të DT kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë automjetet dhe makinerit (sipas tabeles) të cilat duhet të jenë në pronësi të tij ose me qira të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës, për Asfaltoshtruese 1copë, Rul për ngjeshje asfalti 1 copë, Prerëse asfalti 1 copë, Miniasfaltoshtruese 1 copë. *Sa më sipër, konstatohen kërkesa kualifikuese të mjeteve jo në përputhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës, pasi referuar preventivit të punimeve nuk ekzistojnë punime asfalti*. Kjo kërkesë bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 26 "Kontrata për punë publike" pika 5. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit.<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim. |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik"i ndryshuar. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | 1. Drejtoria Rajonale Durrës, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

**8.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: *"**Ndërtim i disa kabinave te reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabell me vetepermbajtje ABC ne kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 te N/St Gramsh**"*, njësia rajonale Elbasan, viti 2020, fond limit

184,825,230 lekë pa TVSH, kontrata e nënshkruar është 03.12.2020, kohëzgjatja 5 muaj konstatohet:

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Ndërtim i disa kabinave te reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabell me vetepermbajtje ABC ne kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 te N/St Gramsh" 2020* | | |
|---|---|---|
| 1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur"<br>REF-72204-09-17-2020 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. J B<br>2. E B<br>3. A M | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. N T<br>2. S T<br>3. N C |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>184,825,230 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>182,972,257 lekë<br>Operatori Fitues: "E" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>1,852,973lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 21.10.2020 ndryshohet 26.10.2020<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 5 muaj nga dorezimi i sheshit | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **3 OE**<br>b) S'kualifikuar **1 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE**<br>d) Tërhequr **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP-**s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:**

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*". Janë konstatuar shkelje të nenin 46, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 26 "Kontrata për punë publike"; pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët KVO-ja ka kryer në SPE në datën 26.10.2020 vlerësimin si më poshtë:

| Nr | *Shoqëria OE/BOE* | *Oferta Lekë PA TVSH* |
|---|---|---|
| 1 | "E" sh.p.k | 182.972.256 |
| 2 | "E" sh.p.k | 184.813.638 |
| 3 | "E" sh.p.k | Pa ofertë |

Referuar procedurës informohet se OE "E" shpk me ofertë prej 182,972,257 leke pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme. Nga auditimi kontatohet se OE "E" shpk, plotëson të gjitha kriteret e përgjithme dhe vecanta të kualifikimit.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Ndërtim i disa kabinave te reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabell me vetepermbajtje ABC ne kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 te N/St Gramsh"* Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim. |

| | |
|---|---|
| **Situata 9:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 26.10.2020 nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.<br>Në pikën 2.3.4, b, të DST kërkohet që Operatori ekonomik duhet të ketë minimum 30 punonjës të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të lëshurar nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar), nga të cilët të jenë punonjës me specialitetin elektriçist jo më pak se 20 punonjës, ku jo më pak se 10 prej tyre të jenë të pajisur me kategorinë e IV-V të Sigurimit Teknik. Specifikimi i kategorisë vështirëson dhe ngushton pjesëmarrjen. Në pikën 2.3.3, d, të DST kërkohet që Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në licence të shoqërisë e të punësuar në stafin e tij teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratën noteriale pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës dhe me një experience pune mbi 5 *(pesë)*vjet (ndryshuar me shtojcën nr. 1 datë 20.10.2020), si dhe të figurojnë detyrimisht në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar në pikën a, stafi inxhinierik si më poshtë: Minimumi 1 Inxhinier Ndërtimi, Minimumi 1 Inxhinier Elektrik, *Minimumi 1 Inxhinier Elektronik*, *Minimumi 1 Inxhinier Mekanik*, Minimumi 1 Inxhinier Topograf/ Gjeodet, *Minimumi 1 Inxhinier Mjedisi (Profili Energjitike).* NJP ka vështirësuar pjesëmarjen e operatorëve ekonomik, duke drejtuar ofertuesit të kenë 1 Inxhinier Mekanik, 1 Inxhinier Elektronik në kompani dhe për më tepër *1 Inxhinier Mjedisi i Profilizuar për Energjitike*, nuk është në përputhje me objektin pasi objekti nuk përmban asnjë punim mekanik, elektronik.<br>- Pika 2.3.3, në kuadër të informatizimit të rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatori ekonomik në përfundim të investimit duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor projektin As-Biult sipas azhornimeve dhe zbatimit faktik të kabinave dhe trasesë së linjave të hedhura në formatin UMT ose Gaus Kruger. Sa mësipër Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me liçencë *profesionale në fushën e projektimit*, lëshuar nga organet përkatëse, e cila të përmbajë kategoritë e mëposhtme: Kat. 4 (c) - *Projektim të linjave e rrjeteve elektrike...*, Kat. 10 (e) - *Projektim kabina elektrike të rrjetit shpërndarës - linja të tensionit të ulët - të mesëm.* Kërkesa e mësipërme nuk stimulon për pjesëmarrje operatorët ekonomik për punime ndërtimi dhe kufizon konkurencën, duke stimuluar ata OE të cilët disponojnë licensë projektimi. Kërkesa për paraqitjen e projektit të azhurnuar apo As-Built, është detyrë kontraktuale e kontraktuesit referuar edhe legjilacionit mbi disiplinimin e punimeve. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit.<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik".<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim. |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, |

| | |
|---|---|
| | datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik"i ndryshuar. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | 1. Drejtoria Rajonale Elbasan, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

**9.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: *"**Kabëll dhe aksesorë për rrjetin shpërndarës**"*, njësia rajonale Fier, viti 2021, fond limit 198,830,262 lekë pa TVSH*"*, konstatohet:

*<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit:</u>*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Kabëll dhe aksesorë për rrjetin shpërndarës 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur"<br>REF-83569-12-31-2020 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. D R<br>2. E C<br>3. F D | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. A N<br>2. A Gj<br>3. A Rr |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>198,266,000 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>191,290,000 lekë<br>Operatori Fitues: "R" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>6,976,000 lekë ose zbritur 96.4 % nga F.L |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 01/02/2021, ndryshon 08/02/2021<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>90 ditë | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **4 OE**<br>b) S'kualifikuar **2 OE,**<br>c) Kualifikuar **2 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP**-s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:**

Procedura e prokurimit me REF-83569-12-31-2020, me objekt "Kabëll dhe aksesorë për rrjetin shpërndarës" është procedure e hapur mallrash. Kriteret kualifikuese kanë përcaktuar në përputhje me LPP, duke përcaktuar kapacitetet ekonomike dhe teknike. Janë kërkuar Autorizim te prodhuesit/të distributorëve të autorizuar per listen e mallrave, Katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit/ve dhe që Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Mostra te mallit, ne permbushje me Specifikimet Teknike perfshire ne DST. Gjithashtu *<u>me lëvrimin e mallit</u>*, referuar nenit 62, "Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës të LPP, nenit 77 te VKM 914, për t'u siguruar që cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë për të cilën është shpallur fitues kontraktori, furnizuesi i mundshem duhet te paraqese: Çertifikate cilesie, Çertificate Origjine, Çertificate Garancie, Raportet e testeve (provave), Manuali i perdorimit, mirembajtjes, skicat e montimit dhe skemat e lidhjes dhe Autorizim Prodhuesi/ distributor.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Kabëll dhe aksesorë për rrjetin shpërndarës"* Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave. |
| **Situata 10:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 11.01.2021, referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka kualifikuar 2 (dy) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues OE "R" shpk, ka s'kualifikuar 2 B/OE të tjerë me |

| | |
|---|---|
| | arsyetimin si vijon:<br>1. “N” shpk, refuzohet, pasi:<br>*Personi i paraqitur në datën dorëzimit të mostrave, i cili u prezantua si punonjesi i firmës, nuk kishte autorizim me vete.*<br>2. “A.-C.” shpk, refuzohet, pasi:<br>1. *Kanë paraqitur kërkesë për tërheqje pasi në rast se kualifikohen të parët e kan të pamundur të plotesoni kontraten brenda afateve ligjore*.”<br>Së pari, për sa më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, në vlerësim të grupit të auditimit, konstatohet se KVO-ja për një ofertë ka kryer vlerësimin jo në frymën e LPP.<br>Në lidhje me skualifikimin e *OE “N” shpk*.<br>-Arsyeja se “*personi i paraqitur në datën dorëzimit të mostrave, i cili u prezantua si punonjësi i firmës suaj, nuk kishte autorizim me vete*” nuk është një arsye e plotë për skualifikim.<br>Vlerësimi i përmbushjes së kritereve të pjesëmarrjes nga operatori “*N*” shpk për rastin konkret, është bërë duke mos konsideruar faktin se:<br>**1-** Në kriteret e veçanta të kualifikimit Autoriteti Kontraktor ka kërkuar përkatësisht “*Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese Mostra te mallit, ne permbushje me Specifikimet Teknike perfshire ne DST, ne diten e hapjes se ofertve, prane zyrave te Drejtorise Rajonale OSSH Fier...*”, kriter ky i fundit i cili është përmbushur nga OE i skualifikuar. Nga ana tjetër neni 27 pika 3 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, ndër të tjera përcakton se: “*Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e kritereve*”. Në funksion të kësaj dispozite, nga AK nuk është përcaktuar në asnjë moment që mostrat e mallit të shoqërohen nga një person i pajisur me autorizim. Mënyra e dorëzimit të mostrave nuk është specifikuar nga AK, çka, në vlerësim të grupit të auditimit, do ta bënte një ofertë të vlefshme edhe sikur mostrat e mallit të dërgoheshin në mënyrë alternative psh në rrugë postare. Nga ana tjetër vetë AK në arsyen e skualifikimit shprehet se “*Personi i paraqitur, i cili u prezantua si punonjesi i firmes, nuk kishte autorizim me vete*”. Në këto kushte edhe sikur personi në fjalë të paraqiste autorizimin në një moment të dytë nuk do të ndryshonte asnjë kriter që tregojn gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.<br>**2-** Në funksion të qëllimit të ligjit, për sa i përket fazës së vlerësimit të ofertave, LPP parashikon instrumentin/mekanizmin e përcaktuar në nenin 53 pika 4 sipas të cilit: “*autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*”. Mbi s’kualifikimin e OE “N” shpk, KVO-ja, duhej të mbante në konsideratë Nenit 53 Pika 4 e LPP: *Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet.* KVO në rastin e mësipërm është referuar Neni 46 pika 1 e LPP: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë* |

| | |
|---|---|
| | *pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese…*”. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës “Blerje Mallra” dhe dokumentet e tenderit<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos rritje e efiçencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit |
| **Shkaku:** | Mos mbajta në konsideratë gjatë vlerësimit të Nenit 53 Pika 4 e LPP: *Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet.* |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | 1. AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përmbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”. |

**10.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “***Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti III*** " me fond limit 163,632,671 pa TVSH, viti 2020, rajoni Durres, konstatohet:

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *“Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti III” 2020* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>“E hapur”<br>REF-75365-10-13-2020 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. A G<br>2. G Gj<br>3. F G | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. I L<br>2. A N<br>3. K C |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>163,632,671 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>163,040,058 lekë<br>Operatori Fitues: “C“ sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>592,613 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 13/11/2020<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 5 muaj nga dorezimi i sheshit | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. Sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **4 OE**<br>b) S’kualifikuar **3 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s’ka; APP**–s’ka**; KPP**-s’ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

### a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 61, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për*

*përgatitjen e tyre*". Janë konstatuar shkelje të nenin 46, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 26 "Kontrata për punë publike"; pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.* ***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE, për të cilët, referuar procesverbalit përkatës të hapjes 13.11.2020, KVO-ja ka kryer në SPE në datën 09.12.2020 vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | *Shoqëria OE/BOE* | *Oferta Lekë PA TVSH* |
|---|---|---|
| 1 | "Sh I" sh.p.k | 162,867,753.3 |
| 2 | "E " sh.p.k | 0 |
| 3 | "G" sh.p.k | 156,462,871 |
| 4 | "C" sh.p.k | 163,040,058 |

S'kualifikohet Operatori ekonomik: "G" sh.p.k, për arsye:
*1. -Ky operator nuk ploteson kushtin per punët e ngjashme. Në sistem është paraqitur vetëm një pune e ngjashme dokumentacioni i së cilës nuk është i plotë, pasi mungon formulari i vleresimit i leshuar nga enti publik perkates.*
*2. -Ky operator nuk ka paraqitur dokumentacion te plote per kriterin teknik te punonjesve elektriciste me kartela te sigurimit teknik te vlefshme. Nga 65 punonjes elektriciste te kerkuar OE ka paraqitur 47 te tille. Kartelat e tjera te paraqitura nuk jane per punonjes elektriciste por te profesioneve te tjera.* Nga auditimi i dokumenteve të hedhura në sistem nga ky operator, në fakt rezultoi se ky opeator ka paraqitur 50 punonjës me IQT, 47 elektricistë dhe 3 manovrator.
*3. -Ky operator nuk ploteson kushtin per detyrimet e taksave lokale të vitit 2020 sipas adresave në QKB.OE rezulton debitor sipas vertetimit te paraqitur ne sistem per bashkine Tiranë.*
Në lidhje me këtë pikë s'kualifikimi, sipas vërtetimit të lëshuar nga bashkia Tiranë me nr. 6081/1 prot. Datë 07.08.2020, konstatohet se subjekti "G" është debitor në masën 84,932,509 lekë, i *cili ka lëshuar garanci bankare,* me Ref.357026 me nr prot 2077 datë 13.07.2020, Ref 357095 me nr prot 2076 datë 13.07.2020, Ref 358154 me nr prot 2075 datë 13.07.2020, Ref 357290 me nr prot. 2135 datë 17.07.2020. Sa më sipër referuar garancisë bankare, ky operator plotëson kërkesën e kërkuar sipas dokumenteve të tenderit.
Operatori ekonomik: "Sh I" sh.p.k, për arsye:
*1. -Ky operator nuk ploteson kushtin per numrin mesatar te punonjesve ne listepagese. Nga 100 punonjes te kerkuar operatori ekonomik disponon nje numer mesatar prej 97 punonjesish sipas vertetimit perkates te paraqitur ne sistemin elektronik.*
Referuar rëndësisë e një oferte ekonomike më të mirë ekonomikisht, në lidhje me numrin mesatar të punonjësve, nga KVO duhej të mbahej në konsideratë Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 1 citohet:
*Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të*

*kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme*. Pika 4 e nenit 53 citon ”*Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet.* Referuar sa më sipër nga KVO nuk duhej të citohej kjo arsye s'kualifikimi,pasi edhe në nenin 46 Kualifikimi i ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë,pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, *gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.*

*2. -Ky operator nuk plotëson kushtin e numrit te punonjesve elektriciste me kartela te sigurimit teknik. Nga **65** punonjes te kerkuar operatori ka paraqitur dokumentacion vetem per **52** punonjës.* Arsyeja e një diference vetëm me 13 punonjës elektricist, përsëri nuk do të cënonte realizimin e kontratës. Referuar rëndësisë e një oferte ekonomike më të mirë ekonomikisht, në lidhje me numrin elektricistëve me IQT, nga KVO duhej të mbahej në konsideratë Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 1 citohet "*Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme*. Pika 4 e nenit 53 citon "*Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet.*

| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalezit, Loti III"* Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim. |
|---|---|
| **Situata 11:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 09.12.2020 nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.<br>- Në pikën 2.3.1, b të DST, kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 50001-2018 (e vlefshme) për sistemim e manaxhimit te energjisë, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit. Çertifikata ISO 50001:2018, e cila është e paargumentuar nga AK. ISO 50001: 2018, specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është ti lejojë një ndërmarje të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, përfshirë efikasitetin e energjisë, përdorimin e energjisë dhe konsumin. ISO 50001: 2018 specifikon kërkesat e zbatueshme për përdorimin dhe konsumin e energjisë, duke përfshirë matjen, dokumentacionin dhe raportimin, hartimin dhe praktikat e prokurimit për pajisje, sisteme, procese dhe personel që kontribuojnë në performancën e energjisë. Pra, kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi OE do vetëm do të realizojë punën e ndërtimit të rrjetit të Fiderit, sipas specifikimeve të kërkuara dhe kjo |

| | |
|---|---|
| | certifikatë nuk i nevoitet OE për menaxhimin e energjisë.<br>- Në pikën 2.3.1, dh të DST kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë minimum 65 punonjes elektricistë të pajisur me kartela personale të sigurimit teknik, të leshurara nga organe kompetente te akredituara nga DPA-ja sipas ligjit 8734 date 01.02.2001 i ndryshuar, nga te cilet, 10 punonjës të kënë grupin e IV-et ose te V-te te sigurimit teknik, 20 punonjes grupin e III-te te sigurimit teknik dhe pjesa e mbetur grupin e I-re ose te II-te te sigurimit teknik. *Numri i elektricistëve dhe kategorizimi i tyre nuk është argumentuar nga NJP. Specifikimi në kategoritë përkatëse të IQT, ngushton edhe më tej konkurrencën dhe jo në përputhje me parimet e nxitjes së konkurrencës.* Ndërkohë është kërkuar gjithashtu që operatori ekonomik duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën 100 persona, nga muaji janar 2020 deri në muajin e fundit që perkon me datën e hapjes se ofertave. *Pra kërkohet kompani ku mbi 65 % të stafit të kompanisë të jetë me profesione elektricistë.*<br>- Në pikën 2.3.1, dh, a të DST Operatori ekonomik duhet ketë pjese te stafit te tij, *si drejtues teknik*, nga muaji janar 2020 deri muajin e fundit qe perkon me datën e hapjes se ofertave personelin si me poshtë: 1 (një) inxhiniere Elektrike, 1 (një) inxhinier Ndertimi, 1 (një) inxhinier Mekanik, 1 (një) inxhinier Gjeodet, 1 (një) inxhinier Mjedisi. Kriteri i inxhinierëve të mësipërm trajton në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomik të cilët nuk e kanë inxhinierët e mësipërm *në licencën e shoqërisë. Nga Ak nuk argumentohen kërkesat e mësipërme se pse duhet të jenë pjesë e licensës dhe në listëpagesa, kur mjaftonte kontrata e punës, cv dhe libreza.* Kërkesat e mësipërme kanë vështirësuar pjesëmarrjen e OE, duke detajuar kategoritë e elektricistëve në mënyrë të pargumentuar numrin e tyre prej 65 punonjësish elektricist. Gjithashtu në DST janë kërkuar në total 100 punonjës total, ku përshihen Inxh përkatës, Mjedis, gjeodet, mekanik, ndërtimi. Janë këkuar 3 manovratorë dhe 1 mjek. Pra në total 8 punonjës shtesë, pa përfshirë administratorë, ekonomist apo jurist në kompani. Rrjedhimisht konstatohet mospërputhje të kritereve, ku nuk përputhen punimet civile të preventivit me makineritë dhe me fuqin punëtore.<br>- Në pikën 3.f të DST kërkohet që Operatori Ekonomik në zbatim të VKM Nr.108 datë 09.02.2011"Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarresit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me ceshtjet e sigurisë dhe të shendetit në punë", ndryshuar me VKM Nr. 632 date 15.07.2015, duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontrate shërbimi / me subjekte të specializuara për këte qëllim. Mjeket të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet te plotësoje ketë kerkese duke pasur në konsiderate edhe parashikimet e ligjit te cituar me lart. Vendosja e kriterit, "*Në rastin e BOE sejcili prej operatoreve ekonomike duhet të plotësoje këtë kriter*", është një kriter i padrejtë dhe është në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", neni 74 pika 3 ku citohet .... "*secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat* |

| | |
|---|---|
| | *ligjore të parashikuara në nenin 45 të LPP-së dhe atë të përcaktuara në DT. Kërkesat ekonomike, financiarë, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me % e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim të përcaktuar në aktmarrëveshje*". Rrjedhimisht, kërkesa e mësipërme sforcon kërkesat kualifikuese dhe zvogëlon konkurrencën, ku një operator, i cilit nuk disponon "*Mjek*" nuk mund të kryej bashkim operatorësh apo aktmarrëveshje për realizim punimesh, *pra përjashtohen OE duke i mohuar mundësinë e bashkimit si dhe OE të cilët këtë shërbim mund ta marrin nëpërmjet kontraktimit dhe jo punësimit të drejtpërdrejtë të një mjeku.* |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit.<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim. |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik"i ndryshuar. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | 1. Drejtoria Rajonale Durrës, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

**11.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "***Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të Nstacioneve elektrike të shpërndarjes***", Drejtoria e Tensionit të Lartë, viti 2021, fond limit 149,999,025 lekë pa TVSH*"*, konstatohet:
<u>*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*</u>

| **a. Zhvillimi i Procedurës:** *"Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të Nstacioneve elektrike të shpërndarjes 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur-Mallra"<br>REF-91193-03-25-2021 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. R S<br>2. A P<br>3. T Gj | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. D Xh<br>2. Z K<br>3. Dh Gj |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>149,999,025 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>148,810,000 lekë<br>Operatori Fitues: "E" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>1,189,025 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 19/04/2021, ndryshohet 26.04.2021,<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>6 muaj | **8. Burimi Financimit**<br>OSSH. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **3 OE**<br>b) S'kualifikuar **2 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP-**s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit në SPE konstatohet:**
Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*". Janë konstatuar shkelje të nenin 46, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 27 "Kontratat e mallrave"; pika 3, "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".* Me e-mail në datë 02.04.2021 dërguar nga APP, rekomandohet të ndryshon disa kritere kualifikuese por disa nuk u morrën në konsideratë, ku ndryshohet edhe data e hapjes së tenderit. Në DST kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në listpagesë, mjekun e shoqerisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, ose te kete një kontrate me mjek te licencuar apo subjekte qe ofrojne sigurimet shendetesore, sipas parashikimeve te Vendimit Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", I ndryshuar. Vendosja e kërkesës së mjekut në shoqërinë, nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare. Kriteri ka zvogëluar konkurrencën, duke favorizuar operatorë zbatues në punime, pasi kontrata është kontrat "Mallra", cka bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006*"*Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1 ku përcaktohet: "*të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".*

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të Nstacioneve elektrike të shpërndarjes"* Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave. |
| **Situata 12:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 26.04.2021, referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka s'kualifikuar 2 (dy) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues OE "E" shpk, me arsyetimin si vijon:<br>**1.** BOE "D" shpk & "I" shpk.<br>- Në piken 1/d në kriteret e pergjithshme te pranimit është kërkuar "*Ofertuesi duhet te deklaroje* se *ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi*". Shoqeria "I" Shpk ka deklaruar ne deklaraten mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme se ka paguar detyrimet ne fjale sipas legjislacionit ne fuqi, ndërkohe rezulton si vijon: Për Z. J K, inxhinier elektrik, paga sipas kontrates se punës: 180.000 lekë, ndërkohë, në listëpagesat Tetor 2020 – Mars 2020, |

| | |
|---|---|
| | rezulton me page 100.000 lekë. OE: "I" Shpk ka vepruar ne kundershtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar* ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës". Në këto kushte, kjo shoqëri ndodhet ne kushtet e parashikuara ne nenin 13/3 te LPP, pasi ka *paraqitur dokumentacion që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, pasi* në deklaraten mbi permbushjen e kritereve të përgjithshme ka deklaruar shlyerjen e detyrimeve në fjale sipas legjislacionit ne fuqi. Sipas marrëveshjes së bashkepunimit, shoqeria "D" Shpk ka marre persiper 77% të punimeve dhe "I" Shpk 23%, ndërkohe, sipas ofertës se paraqitur nga ky BOE: vlera e punimeve te marre persiper nga shoqeria "D" Shpk eshte 109.2 milion leke ose 77.5 % dhe nga "I" Shpk eshte 31.751 milion leke ose 22.5 % dhe jo 23% sikurse cilesohet ne marreveshjen e bashkëpunimit. *Në lidhje me këtë arsye kualifikimi konstatohet një devijim i vogël, që nuk do të cënonte realizimin e kontratës.* Në pikën 2.34. të kritereve të vecantë të pranimit, është kërkuar: "*4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat e ofertuar, të leshuara nga institucione te autorizuara ose nga prodhuesi, qe vertetojne pajtueshmerine e materialeve te prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kerkuara. VO: Të gjitha dokumentat e mësiperme nese nuk janë në gjuhen shqipe duhet të shoqërohen me përkthimet përkatese dhe noterizim.* Në test-raporte per Panelet (Avr) konsatohet si vijon:<br>Test Raporti No. 42563/04.06.2010, Në pikën 8 të testraportit thuhet se: ky test ka 5 flete, ndërkohë janë përkthyer vetëm 3 fletet e para. Test Raporti No. 1576/04.06.2010. Në pikën 8 të testraportit thuhet se: ky test ka 5 flete, ndërkohe është përkthyer vetëm fleta e parë. Test Raporti No. 20103/03.06.2010. Në pikën 7 të testaportit thuhet se: ky test ka 9 flete, nderkohe eshte perkthyer vetem fleta e parë. Në test-raporte Shkarkues dhe celesa konsatohet se janë përkthyer vetëm fletët e para së secilit test, ndërkohe, testet kane nga 10, 13 apo 47 flete.<br>**2.** OE: "N" shpk me, komisioni i vlersimit te ofertave konstatoi mungesën e dokumentacionit si më poshtë vijon:<br>- Në piken 1/e në kriteret e vecanta të pranimit është kërkuar "Ofertuesi duhet të dorëzojë vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri". Sipas QBK ka adrese ushtrimi aktiviteti edhe në Vaun e Dejes por ska paraqitur informacion në lidhje me detyrimet per kontraten e energjise ne kete adrese. Në piken 2.1.d në kriteret e vecanta të pranimit është kërkuar "Vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore për vitin 2020 lëshuar nga Bashki/të ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet sipas QKB-së". Në përmbushje të këtij kriteri shoqëria "N" shpk ka paraqitur vertetimin per shlyerjen e detyrimeve vendore ne bashkine Tirane, ndërkohë në vitin 2020 ka ushtruar aktivitet edhe ne adresen Shkoder Vau Dejes Vau Dejes Hidrocentrali Vau i Dejes, Njesia Hec Vau Dejes, por |

| | |
|---|---|
| | nuk ka paraqitur dokumentacion mbi shlyerjen e detyrimeve vendore ne Bashkine Vau I Dejes, duke mos përmbushur kriterin e kualifikimit të sipërcituar. Shoqëria "N" shpk nuk ka paraqitur dokumentacion në përmbushje të mjekut.<br>*Nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimit të ofertave konstatohet se problematikat qëndrojnë, por nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara nga operatori fitues "E", konstatohet:*<br>**1.** Kontrata Individuale e Punës, nr. 1320 Rep. 348/1 Kol datë 20.11.2020, me Ing. Mekanik I N me ID J00312025R, nuk është në përputhje me Kodin e Punës i RSH, neni 21, pika 3, shkr H, ku citohet: *Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos*: h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj. Në kontratën individuale të punës midis OE "E" citohet se paga mujore e punëmarrësit do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve. Në listëpagesa, pagesa për Ing. I N, rezulton me page 30.000 leke (pra pagë minimale). Kontrata Individuale e Punës, nr. 1577 Rep. 310/1 Kol datë 17.10.2020, me Ing. Elektronik B S me ID J55608092A, nuk është në përputhje me Kodin e Punës i RSH, neni 21, pika 3, shkr H, ku citohet: *Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos*: h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj. Në kontratën individuale të punës midis OE "E" citohet se paga mujore e punëmarrësit do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve. Në listëpagesa, pagesa për Ing. B S, rezulton me page 30.000 leke (pra pagë minimale).<br>**2.** Test raporti i Shkakuesave lëshuar nga C P and I S, është i përkthyer, nga Punonjësja e "E" Ing. Elektronikë, B s, referuar vërtetimit të përkthimit nr. 668 datë 24.04.2021 të Noterit Dh V. B s, nuk është në listen e përkthyeve të njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe *<u>vërtetimi i përkthimit është i pavlefshëm</u>*.<br>- Test raporti nga Smart solution nuk është i përkthyer dhe noterizuar. Autorizimi i prodhuesit për rregullatorin e tensionit nuk vërteton përkthimin dhe nga krahasimi i përmbajtjes rezultojnë shenja të dyshimta. Test raporti CV 145, nuk është i përkthyer. Test raporti 110 Kv, nuk njihet përkthyesi dhe ka shenja të dyshimta në përmbajtje të materialit. Test raporti SA 36-145kV, nuk ka përkthim ka shenja të dyshimta në përmbajtje të materialit. Test raporti HV SA shkarkuesi, nga C P and I S, është i përkthyer, nga Punonjësja e "E" Ing. Elektronikë, B s, referuar vërtetimit të përkthimit nr. 678 datë 24.04.2021 të Noterit Dh V. B s, nuk është në listen e përkthyeve të njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe *<u>vërtetimi i përkthimit është plotësisht i pavlefshëm</u>*.<br>*Sa më sipër*, OE: "E" Shpk ka vepruar ne kundershtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar* ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës".<br>Referuar mangësive të konstatuara, <u>KVO në rastin e mësipër duhej të mbante parasysh ofertën më të leverdishme dhe varianti tjetër duke anuluar tenderin,</u> të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve. Moskryerja e anulimit të procedurës është në kundërshtim |

| | |
|---|---|
| | me kërkesat e LPP, neni 24 “*Anulimi i një procedure prokurimi*”, pika 1, neni 46 “*Kualifikimi i ofertuesve*”, pika 1, dhe neni 53, “*Shqyrtimi i ofertave*” pika 3. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës “Blerje Mallra” dhe dokumentet e tenderit.<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos rritje e efiçencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit |
| **Shkaku:** | Mos mbajta në konsideratë ofertën më të leverdishme dhe varianti tjetër duke anuluar tenderin. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | 1. AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përmbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”. |

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Drejtoria e Tensionit të Lartë anëtarët e NJP, të A P, T Gj, R S dhe KVO D Xh, Dh Gj, Z.
Kadriu, me nr. 4230/1 prot. Datë 30.05.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 827/7 prot. Datë 31.05.2023, mbi pretendimet e konstatimeve të projekt raportit dërguar me nr. 826/6 datë 09.05.2023.

***Pretendimi i subjektit:***
*- Në lidhje me kërkesën e mjekut, sqarohet se është vendosur sipas parashikimeve VKM nr. 108 datë 09.02.2011, ku bën pjesë objekti i prokurimit. Kjo procedurë është klasifikuar si “Kontratë e përzier”, pasi ka zëra furnizmi dhe vendosjeje.*
*- Në lidhje me vlerësimin e ofertave për operatorin “E”, sqarohet se nuk janë shënuar pagat respektive, nuk është cilësuar si arsye s'kualifikimi pasi në DST nuk është kërkuar.*
*- Në lidhje me përkthimin e test raporteve nuk është në listën e përkthyesve zyrtarë, sqarohet se nuk është evidentuar si pasojë e gabimi njerëzor, ku megjithatë do të konsistonte si devijim i vogël.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**
Kriteret kualifikuese nga grupi i auditimit, janë trajtuar në bazë të parimeve të stimulimit të konkurrencës dhe të rritjes së efiçencës e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore. Në lidhje me vlerësimin e ofertave merren në konsideratë gabimet njërëzore dhe pjesërisht në konsideratë kontratat e Inxhinierëve të OE fitues, pasi referuar nenit 45 të LPP parashikohet se: “Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”. Nga observacionet nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

**12.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "***Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacioneve***", Drejtoria e Tensionit të Lartë, viti 2021, fond limit 149,961,000 lekë pa TVSH*"*, konstatohet:

*<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit:</u>*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacioneve 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur-Mallra"<br>REF-91197-03-25-2021 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. R P<br>2. A P<br>3. S K | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. D Xh<br>2. Z K<br>3. Dh Gj |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>149,961,000 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>148,625,000 lekë<br>Operatori Fitues: "E" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>1,336,000 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 19/04/2021, ndryshohet 26.04.2021,<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 4** muaj | **8. Burimi Financimit**<br>OSSH. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a) Pjesëmarrës në tender Numër **2 OE**<br>b) S'kualifikuar **1 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP**-s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike <u>duhet të argumentohen</u> dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*". Janë konstatuar shkelje të neni 27 "Kontratat e mallrave"; pika 3, "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".* Në DST kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në listpagesë, mjekun e shoqerisë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, ose te kete një kontrate me mjek te licencuar apo subjekte qe ofrojne sigurimet shendetesore, sipas parashikimeve te Vendimit Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", i ndryshuar. Vendosja e kërkesës së <u>mjekut në shoqërinë</u>, nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit, duke larguar nga konkurrimi të gjithë operatoret ekonomike tregtare. Kriteri ka zvogëluar konkurrencën, duke favorizuar operatorë zbatues në punime, pasi kontrata është kontrat "<u>Mallra</u>", cka bie në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006*"*Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacioneve"* Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave. |
| **Situata 13:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 26.04.2021, referuar procesverbaleve përkatës si dhe njoftimit të fituesit rezulton se KVO-ja, pasi ka s'kualifikuar 1 (dy) B/OE nga ato pjesëmarrës në garë dhe ka shpallur fitues OE "E" shpk, me arsyetimin si vijon:<br>**1.** BOE "D" shpk & "I" shpk. |

| | |
|---|---|
| | - Shoqëria “I” Shpk ka deklaruar në deklaraten mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme se ka paguar detyrimet në fjale sipas legjislacionit ne fuqi, ndërkohe rezulton së për Z. J K, inxhinier elektrik, paga sipas kontratës së punës: 180.000 lekë, ndërkohë, në listapgesat Tetor 2020 – Mars 2020, rezulton me page 100.000 lekë. OE “I” Shpk ka vepruar ne kundershtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar* ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”. Në keto kushte, kjo shoqeri ndodhet ne kushtet e parashikuara ne nenin 13/3 te LPP, pasi ka *paraqitur dokumentacion që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, pasi* ne deklaraten mbi permbushjen e kritereve te pergjithshme ka deklaruar shlyerjen e detyrimeve ne fjale sipas legjislacionit ne fuqi. Sipas marrëveshjes së bashkëpunimit, shoqëria “D” Shpk ka marrë përsipër 70% të punimeve dhe “I” Shpk 30%, ndërkohë, sipas ofertës së paraqitur nga ky BOE: vlera e punimeve të marre përsiper nga shoqeria “D” Shpk është 91.74 milion lekë ose 69.51 % dhe jo 70 % sikurse cilesohet në marrëveshjen e bashkëpunimit. Vlera e punimeve të marre përsiper nga “I” Shpk eshte 40.19 milion lekë ose 30.46 % dhe jo 30% sikurse cilësohet në marrëveshjen e bashkëpunimit. Kjo mosperputhje eshte ne kundershtim me nenin 74/ te te VKM-se Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar ku percaktohet se: “*Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”.* <u>*Në lidhje me këtë arsye kualifikimi konstatohet një devijim i vogël, që nuk do të cënonte realizimin e kontratës.*</u><br>- Në pikën 2.34. të kritereve të vecantë të pranimit, është kërkuar: “*4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dëshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat e ofertuar, të leshuara nga institucione të autorizuara ose nga prodhuesi, që vërtetojnë pajtueshmerine e materialeve të prodhuara me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara. VO: Të gjitha dokumentat e mësiperme nëse nuk janë në gjuhen shqipe duhet të shoqërohen me përkthimet përkatese dhe noterizim.* <u>Në testraporte për Panelet (Avr) konsatohet si vijon:</u> Test Raporti No. 42563/04.06.2010<br>Në pikën 8 të testraportit thuhet se: ky test ka 5 flete, ndërkohë janë përkthyer vetëm 3 fletet e para. Test Raporti No. 1576/04.06.2010, Në piken 8 të testraportit thuhet se: ky test ka 5 flete, ndërkohë është përkthyer vetëm fleta e parë. Test Raporti No. 20103/03.06.2010. Në pikën 7 të test raportit thuhet se: ky test ka 9 flete, ndërkohë është përkthyer vetëm fleta e parë. Gjithashtu, të gjithë test-raportet *për tranformatoret e rrymës* janë në gjuhe të huaj dhe pa përkthim. Për me tepër këto test-raporte (për *tranformatoret e rrymes)* janë të gjitha me afat vlefshmerie të skaduar: Test Raporti No. 150059G |

| | |
|---|---|
| | Temperature – rise test: validy: maksimumi 25.04.2016 (faqe 15 e dokumentit). Test Raporti No. 150059G Radio interference voltage test circuit: validy: maksimumi 25.04.2016 (faqe 22 e dokumentit). Test Raporti No. 150059G Radio interference voltage test: validy: maksimumi 24.04.2016 (faqe 24 e dokumentit). Test Raporti No. 150059G Power frequence withstand voltage test circuit: validy: maksimumi 25.04.2016 (faqe 50 e dokumentit). Këto teste janë bëre në periduhen kohore nga 22.05.2015 deri 31.07.2015, etj. Sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur është në kundershtim me kriterein e sipërcituar dhe kundershtim me nenin 14/2 te VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar përcaktohet se: "*Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe*". *Nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimit të ofertave konstatohet se problematikat qëndrojnë, por nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara nga operatori fitues "E", konstatohet:*<br>1. Kontrata Individuale e Punës, nr. 1320 Rep. 348/1 Kol datë 20.11.2020, me Ing. Mekanik I N me ID J......R, nuk është në përputhje me Kodin e Punës i RSH, neni 21, pika 3, shkr H, ku citohet: *Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos*: h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj.<br>Në kontratën individuale të punës midis OE "E" citohet se paga mujore e punëmarrësit do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve. Në listëpagesa, pagesa për Ing. I N, rezulton me page 30.000 leke (pra pagë minimale).<br>- Kontrata Individuale e Punës, nr. 1577 Rep. 310/1 Kol datë 17.10.2020, me Ing. Elektronik B S me ID .......A, nuk është në përputhje me Kodin e Punës i RSH, neni 21, pika 3, shkr H, ku citohet: *Kontrata e punës e lidhur me shkrim duhet të përmbajë sidomos*: h. elementet përbërëse të pagës dhe datën e dhënies së saj. Në kontratën individuale të punës midis OE "E" citohet se paga mujore e punëmarrësit do të përcaktohet me marrëveshje midis palëve. Në listëpagesa, pagesa për Ing. B S, rezulton me page 30.000 leke (pra pagë minimale).<br>**2.** Test raportet për 145 kV transformator rryme, përkthimet janë në te njëjtin format me atë origjinalin (me shenja të dyshimta në përmbajtje të materialit), por nuk vërtetohet përkthimi se nga kush është realizuar. Test raportet e transformator rryme 40.5 kV, (me shenja të dyshimta në përmbajtje të materialit), përkthimet janë në te njëjtin format me atë origjinalin (turk) por nuk vërtetohet përkthimi se nga kush është realizuar. Gjithashtu "Test Report CVT 110kV", "Test raport transformator rryme 20kV", "Test raport transformator Tensioni 6-10kV", "Test Reporte ndaresa", asnjëra nga këto teste të kompanive të ndryshme në shtete të ndryshme, nuk vërteton përkthimin e tyre nga përkthyes zyrtar të njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe *vërtetime të përkthimit nuk ka dokumentacion, rrjedhimisht janë të pavlefshëme*.<br>OE: "E" Shpk ka vepruar ne kundershtim me pikën 2/d të nenit 45 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet se: "*Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja* |

| | |
|---|---|
| | *në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar* ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës". Në këto kushte, kjo shoqëri ndodhet ne kushtet e parashikuara ne nenin 13/3 te LPP, pasi ka *paraqitur dokumentacion që përmbajnë të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, pasi* në deklaraten mbi permbushjen e kritereve të përgjithshme ka deklaruar shlyerjen e detyrimeve në fjale sipas legjislacionit ne fuqi.<br>Referuar mangësive të konstatuara nga grupi auditues, KVO në rastin e mësipër duhej të mbante parasysh ofertën më të leverdishme dhe varianti tjetër duhet të kishte anuluar tenderin, të analizonte shkaqet e dështimit dhe të rishikonte kriteret për të rritur numrin e pjesëmarrësve. Moskryerja e anulimit të procedurës është në kundërshtim me kërkesat e LPP, neni 24 "*Anulimi i një procedure prokurimi*", pika 1, neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1, dhe neni 53, "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës "Blerje Mallra" dhe dokumentet e tenderit<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik". |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos rritje e efiçencës dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit |
| **Shkaku:** | Mos mbajta në konsideratë ofertën më të leverdishme dhe varianti tjetër duke anuluar tenderin. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një skualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përmbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit". |

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Drejtoria e Tensionit të Lartë anëtarët e NJP, të A P, R P, S K dhe KVO D Xh, Dh Gj, Z K, me nr. 4230/14 prot. Datë 30.05.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 827/7 prot. Datë 31.05.2023, mbi pretendimet e konstatimeve të projekt raportit dërguar me nr. 826/6 datë 09.05.2023.

| |
|---|
| ***Pretendimi i subjektit:***<br>*- Në lidhje me kërkesën e mjekut, sqarohet se është vendosur sipas parashikimeve VKM nr. 108 datë 09.02.2011, ku bën pjesë objekti i prokurimit. Kjo procedurë është klasifikuar si "Kontratë e përzier", pasi ka zëra furnizmi dhe vendosjeje.*<br>*- Në lidhje me vlerësimin e ofertave për operatorin "E", sqarohet se nuk janë shënuar pagat respektive, nuk është cilësuar si arsye s'kualifikimi pasi në DST nuk është kërkuar.*<br>*- Në lidhje me përkthimin e test raporteve nuk është në listën e përkthyesve zyrtarë, sqarohet se nuk është evidentuar si pasojë e gabimi njerëzor, ku megjithatë do të konsistonte si devijim i vogël.* |

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit:</u>**
Kriteret kualifikuese nga grupi i auditimit, janë trajtuar në bazë të parimeve të stimulimit të konkurrencës dhe të rritjes së efiçencës e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore.
Në lidhje me vlerësimin e ofertave merren në konsideratë gabimet njërëzore dhe pjesërisht në konsideratë kontratat e Inxhinierëve të OE fitues, pasi referuar nenit 45 të LPP parashikohet se: "Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës". Nga observacionet nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

**13.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "***Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht***", Drejtoria e Tensionit të Lartë, viti 2021, fond limit 249,996,339 lekë pa TVSH *"*, konstatohet:

| **a. Zhvillimi i Procedurës:** *"Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur-Punë"<br>REF-82920-12-22-2020 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. R S<br>2. A P<br>3. T Gj | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. D Xh<br>2. Z K<br>3. Dh Gj |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>249,996,339 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>248,999,000 lekë<br>Operatori Fitues: "E sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>997,339 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 22/01/2021, ndryshohet 28.01.2021, ndryshohet 05.02.2021<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>12 muaj | **8. Burimi Financimit**<br>OSSH. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **1 OE**<br>b) S'kualifikuar **0 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–ka ; **KPP**-s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit mbi përllogaritjen e fondit limit, konstatohet:**
Si objekt i punës së këtij projekti është fuqizimi dhe rikonstruksioni i linjës ajrore 35 kV Korce-Bilisht. Kjo linjë ishte shumë e amortizuar. Linja është ndërtuar në vitin 1969. Për t'iu përgjigjur nevojës për fuqizimin e kapacitetit transmetues dhe rritjes së stabilitetit të parametrave teknike të furnizimit të linjes ekzistuese 35kV Korcë-Bilisht, kërkohet të bëhet demontimi i linjes ekzistuese dhe të ndërtohet linje e re me përcjelles ACSR 240/40mm2, dhe shtyllat duhet të jenë për tension deri në vlerën 110kV. *<u>Linja e re, do të ndërtohet kryesisht paralel me linjen ekzistuese</u>* (kjo pasi Bilishti ka pikë të vetme furnizimi me energji elektrike ketë linje 35kV që vjen nga Korca dhe rehabilitimi i saj në aksin ekzistues është i pamundur pasi linja nuk mund të stakohet për kohë të gjatë). Referuar relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, Kontraktori do të siguroje mallrat dhe shërbimet sipas një kontrate bazë ku do përfshihen: *projektimi*, prodhimi, furnizimi, cinstalimi, instalimi, testimet dhe komisionimi i paisjeve që furnizohen në kuadrin e kësaj kontrate. <u>Kontributi i Investitorit</u>, është që nuk do të furnizoje ndonje paisje dhe asnjë sherbim tjetër (asnje pune paraprake në objekt), <u>vecse sigurimin e të dhenave teknike dhe projekteve të vjetra ekzistuese</u>. Kontraktori (Sipërmarrësi) ka për detyrë, Projektin e të gjitha pajisjeve dhe materialeve të kërkuara për ta bërë linjen 35 kV të funksionoje në mënyre që të plotësoje pikësynimin e projektit.
Studimet dhe projektet do të përfshijnë përgatitjen e profileve dhe planimetrive të linjave, zëvendesimin e shtyllave egzistuese të papërshtateshme me shtylla të reja, investigimin dhe

raportin e dheut/tokes, projektimin dhe llogaritjet e bazamenteve, llogaritjet elektrike dhe mekanike të përcjellesve dhe trosit OPGW, dokumentacioni i projektimit të shtyllave dhe analiza strukturale e tyre, llogaritja dhe zgjedhja e izolacionit të linjave, koordinimi i izolatoreve-morseterise-armatures së linjave, projektimi i mënyrës së varjes së përcjellësve dhe montimit të tyre. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë *subjekt i aprovimit nga Investitorit*. Investitori ka të drejten ti kërkoje kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontrates.

Ofertuesi duhet të ofroje sasite në perputhje me formularin e çmimeve. *Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara ne projekt idene paraprake.* Verifikimi i Drejtoria e Tensiont të Lartë sakte i sasive do të bëhet gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe jane subjekt i miratimit nga Investitorit. Kontraktori duhet të vendose sasitë e nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. *Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës prej 249,996,339 lekë pa TVSH.* Preventiti i hedhur në SPE është në formën si më poshtë:

| Nr | Përshkrimi | Njësia | Sasi | Cmim/njësi | Cmimi total |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Punimet paraprake te linjave (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | **1** | | |
| 2 | Bazamentet e shtyllave, perfshire sistemin e tokezimit dhe mbrojtjen e skarpatave (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | **1** | | |
| 3 | Montimi i shtyllave te reja, perfshire cdo lartesi shtylle (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | **1** | | |
| 4 | Montim Percjellesi & Trosi OPGW, perfshire izolacionin, armaturen, etj. (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | **1** | | |
| 5 | Demontim i shtyllave egzistuese (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | **1** | | |
| **6** | **Projekti I detajuar inxhinierik** | **Komplet** | **1** | | |
| | **Shuma TOTALE pa TVSH** | | | | |
| | **TVSH** | | | | |
| | **Shuma TOTALE me TVSH** | | | | |

Kapitulli i Projektit të detajuar inxhinierik, vlerësohet si efekt ekonomik negativ, pasi nga OSSH. sha, për projektin mund të shfrytëzoheshin kapacitetet inxhinierike e profesionale të specialistëve të *"Sektorit të Projekteve",* të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara konform rregullores së brendshme të institucionit apo edhe zyrës së projekteve të Drejtorisë së Tensionit të Lartë, ku deri më përiudhën aktuale projektet hartoheshin pikërisht nga specialistët e zyrës së projektimit.

Duke rezultuar në faktin se nga AK (OSSH sha, DTL) në rast të pamundësisë për të hartuar projektin inxhinierik të plotë do të duhej të realizoheshin dy procedura prokurimi. Në fillim një procedurë *prokurimi të llojit shërbim me qëllim realizimin e projektit (Për pjesën që nuk mund të realizohej me strukturat administrative të OSSH) dhe më pas duke u bazuar në projekt të zhvillohej procedurë të llojit "Punë". Pasi mënyra që është vepruar, bën që të ulet konkurrenca në prokurim.* Pra, për këtë procedure prokurimi është përzgjedhur gabim lloji i procedurës së prokurimit si prokurim i përbashkët me shërbimin ose konkurs projektimi me atë të zbatimit të punimeve e për të cilën ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit të AK, strukturë e ngarkuar sipas VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar në nenin 57.

**b-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit mbi kapacitetet teknike, konstatohet:**

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*". Janë konstatuar shkelje të nenin 46, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet*

*të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 26 "Kontrata për punë publike"; pika 5, *kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.*

***c-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | *Shoqëria OE/BOE* | *Oferta Lekë PA TVSH* |
|---|---|---|
| 1 | "E" sh.p.k | 248,999,000 |

Nga vlerësimi i KVO datë 05.02.2021, nuk ka Operatorë të s'kualifikuar dhe ka marrë pjesë vetëm një ofertë, i cili është shpall fitues OE "E" sh.p.k me vlerë oferte 248,999,000 lekë pa TVSH.

***d-Në lidhje Zbatimin e punimeve.***

Objekti i kësaj kontrate është ndërtimi i linjës 35 kv që del nga nënstacioni 110/35/10 kv Korçë dhe furnizon nënstacionin 35/10 kv Bilisht. Kontrata është nënshkruar me nr. 2409/19 prot., datë 10.03.2021 me objekt "*Rikonstruksion i linjës 35 kV Korçë-Bilisht*", lidhur midis Drejtoria e Tensionit të Lartë përfaqësuar nga z. A K dhe Operatorit Ekonomik "E"shpk, përfaaqësuar nga z. J H. Afati i zbatimit të kontratës *është 12 muaj* nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Projekti i zbatimit për këtë është bërë nga kontraktori "E"shpk dhe dorëzuar pranë Ak më dt. 04.06.2021, në vlerën prej *9,650,000 lekë pa TVSH*. Miratimi i projektit është bërë nga zyra e projektit të AK dhe konfirmuar me datë 09.06.2021. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. A H. Përfaqësues i Investitorit dhe Administrator kontrate është përcaktuar Ing. N S.

Autoriteti Kontraktor në funksion të linjës së re ka marrë masat për aplikimet për leje zhvillimore si më poshtë: Deklaratë paraprake për kryerje punimesh drejtuar bashkisë Devoll më datë 28.06.2021. Nga ana e Bashkisë Devoll në datë 02.07.2021 ka dalë Vendimi nr. 51, për miratimin e Deklaratës për kryerje punimesh. Deklaratë paraprake për kryerje punimesh drejtuar bashkisë Korçë më datë 28.06.2021. Nga ana e Bashkisë Korçë *kërkesa është refuzuar*. Leje infrastrukture është drejtuar KKT më datë 24.08.2021. Në funksion të këtij aplikimi është zhvilluar prezantimi pranë KKT më datë 21.10.2021. Më tej është dhënë miratimi në parim dhe nga ana e Drejtorisë Ligjore / OSHEE sh.a kanë vijuar procedurat për shpronësim për t'i hapur rrugë zbardhjes së plotë të lejes zhvillimore. Më datë 15.09.2022 është bërë dorëzimi pjesor i sheshit të ndërtimit, i cili ndodhet në territorin e bashkisë Devoll. Kjo, mbështetur në miratimin e dhënë nga kjo bashki si edhe duke qenë se linja ekzistuese nuk jep siguri në furnizimin e pandërprerë të nënstacionit Bilisht me energji elektrike, sipas shkresës që AK i ka drejtuar kontraktorit me nr. 2409/27 prot., datë 06.09.2022. Me datë 07.12.2022 nga ana e kontraktorit është përcjellë Situacioni pjesor nr.1, për punimet e kryera deri më datë 05.12.2022. Nga DTL dokumentacioni përkatës i situavionit nr.1 është dorëzuar pranë OSSH sh.a me shkresën nr. 2409/31 prot., datë 21.12.2022.

- Nga ana e kontraktorit kanë vijuar punimet në objekt deri më datë 30.01.2023, pasi është bërë pezullimi i punimeve, për arsye të *mosmiratimit të stakimit të kërkuar*. Aktualisht, kontrata është e pezulluar deri në miratimet e stakimeve të kërkuara nga kontraktori, ku nga ana e AK duhet të merren masat e nevojshme për miratimet përkatëse, në mënyrë që investimi të përfundojë dhe të vihet në eficensë. Me datë 14.02.2023, me prezencën e administratorit të kontratës z. N S, u verifikuan zërat e punimeve të realizuara në objekt deri në situacionin nr.1, të realizuara me

përqindje, pasi kontrata rezulton "*me celsa në dorë*" si dhe e tillë ka edhe mënyrën e pagesës. Volumet e dhëna në preventivin paraprak janë të përafërta dhe jo përfundimtare dhe ofertuesi kryen studim të hollësishëm të projekt-idesë, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit. Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të projektit, pa kërkuar asnjë fond shtesë. Nga verifikimi në terren konfirmohen se janë vendosur 36 shtylla, e njëjtë me sit. Nr.1. Më poshtë paraqitet situacioni nr. 1, i likuiduar deri më datë 05.12.2022.

| Nr | Përshkrimi | Njësia | Sasia | Cmim/njësi | Sit. 1 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Punimet paraprake te linjave (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | 75 % | 10,150,000 | 7,612,500 |
| 2 | Bazamentet e shtyllave, perfshire sistemin e tokezimit dhe mbrojtjen e skarpatave (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | 41.95 % | 39,950,000 | 16,759,025 |
| 3 | Montimi i shtyllave te reja, perfshire cdo lartesi shtylle (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | 39.75 % | 125,449,000 | 49,865,977 |
| 4 | Montim Percjellesi & Trosi OPGW, perfshire izolacionin, armaturen, etj. (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | 0 % | 53,750,000 | 0 |
| 5 | Demontim i shtyllave egzistuese (referuar pershkrimeve dhe volumeve perkatese te parashikuara ne vijim) | Komplet | 0 % | 10,050,000 | 0 |
| **6** | **Projekti I detajuar inxhinierik** | **Komplet** | 100 % | 9,650,000 | 9,650,000 |
| | **Shuma TOTALE pa TVSH** | | | 248,999,000 | 83,887,502 |
| | **TVSH** | | | 49,799,800 | 16,777,500 |
| | **Shuma TOTALE me TVSH** | | | 298,798,800 | 100,665,003 |

Sa më sipër konstatuar, Projektit të detajuar inxhinierik në vlerën 9,650,000 lekë pa TVSH vlerësohet si efekt negativ ekonomik dhe jo në përputhje me parimet e eficensës, ekonomicitetit dhe efektivitetit, pasi nga OSSH. sha, për projektin mund të shfrytëzoheshin kapacitetet inxhinierike e profesionale të specialistëve të *"Sektorit të Projekteve",* të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara konform rregullores së brendshme të institucionit apo edhe zyrës së projekteve të Drejtorisë së Tensionit të Lartë, ku deri më përiudhën aktuale projektet hartoheshin pikërisht nga specialistët e zyrës së projektimit.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht"* Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim. |
| **Situata 14:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se në tenderin e zhvilluar më datë 05.02.2021 nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Referuar relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, Kontraktori do të siguroje mallrat dhe shërbimet sipas një kontrate bazë ku do përfshihen: *projektimi*, prodhimi, furnizimi, cinstalimi, instalimi, testimet dhe komisionimi i paisjeve që furnizohen në kuadrin e kësaj kontrate. Kontributi i Investitorit, është që nuk do të furnizoje ndonje paisje dhe asnjë sherbim tjetër (asnje pune paraprake në objekt), vecse sigurimin e të dhenave teknike dhe projekteve të vjetra ekzistuese. Kontraktori (Sipërmarrësi) ka për detyrë, Projektin e të gjitha pajisjeve dhe materialeve të kërkuara për ta bërë linjen 35 kV të funksionoje në mënyre që të plotësoje pikësynimin e projektit. Nga auditimi në lidhje me hartimin e miratimin e DST, rezulton se, nga Njësia e Prokurimit (NjP) janë miratuar Dokumentet Standarde të Tenderit (DST) në të cilën, janë përcaktuar dhe kriteret e veçanta për kualifikim, ku janë kërkuar, si *Licenca për projektim dhe Licencat profesionale në fushën e zbatimit të punimeve.* Në dokumentet e tendetir janë përcaktuar shtyllat, |

| | |
|---|---|
| | aksesorët, bazamentet për tippet e shtyllave, gjurma e linjës, Tros OPGV etj. Në pikën 2.2.1, kërkohet që Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licence profesionale në fushën e projektimit, lëshuar nga organet perkatese, e cila të përmbaje kategorit e meposhtme: Projektues konstruktor - Pika 3/b, Projektues instalator - Pikat 4/c, Projektim impianteve të shpërndarjes energjisë elektrike - Pika 10/ d. Pika 2.3.1, kërkohet që Operatori ekonomik ofertues që disponon licencen e projektimit për realizimin e projektit, duhet të disponojë:<br>a) Program të licencuar "*PLS CADD and TOWER*" ose të ngjashëm;<br>b) Të paktën 1(nje) Inxhinier Elektrik të çertifikuar për përdorimin e programeve "PLS CADD and TOWER" ose të ngjashme për realizimin e projektit të linjës, i cili të figuroje në <u>*listpagesa të paktën*</u> *6 muajt e fundit*. Vendosja e kërkesës së për programin e licensuar "PLS CADD & Tower" dhe Ing. Elektrik të certifikuar për këtë program, zvogëlon në mënyrë të ndjeshme konkurrencën, duke favorizuar OE të cilët disponojnë këtë program të licensuar. Gjithashtu vendosja për të paktën *6 muaj në listëpagesë*, ngushton konkurrencën. *Sa më sipër*, komisioni *nuk ka hartuar kërkesa shtesë* në lidhje me projektimin e veprës si: shërbime të ngjashme me objektin e procedurës konkurruese, të cilat janë zbatuar ose janë finalizuar me sukses, në vitet e fundit sipas LPP. Dëshmi për përvojën e mëparshme, ku të kërkoheshin vërtetime ku të shënohen vlera, koha dhe natyra e shërbimeve të bëra dhe/ose çdo lloj dokumenti tjetër që parashikohet në legjislacionin në fuqi, <u>*për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të shërbimit të projektimit të linjës*</u>. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim. |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik"i ndryshuar. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandimi:** | 1. Drejtoria e Tensionit të Lartë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht"* pasaktësi në përllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës. |
| **Situata 15:** | Për procedurën e prokurimit "*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht*", përllogaritja e fondit limit është bërë e përgjithshme për punimet që do të realizohen, por në dokumentet e tenderit preventivi është konceptuar me |

| | |
|---|---|
| | çelësa në dorë. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë *subjekt i aprovimit nga Investitorit*. Investitori ka të drejten ti kërkoje kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontrates. Ofertuesi duhet të ofroje sasitë në perputhje me formularin e çmimeve. *Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara ne projekt idenë paraprake.* Verifikimi i sasive nga Drejtoria e Tensiont të Lartë do të bëhet gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe jane subjekt i miratimit nga Investitorit. Kontraktori duhet të vendose sasitë e nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. *Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës prej 249,996,339 lekë pa TVSH.* Parashikimi i projektimit për realizim nga kontraktori, si dhe përcaktimi kontratë me çelësa në dorë ndërkohë që projektimi duhet të prokurohej nga autoriteti kontraktor, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 1.b. Në preventivin e punimeve është përfshirë pagesë për realizimin e projektit të zbatimit. Nga ana e Kontraktorit është parashikuar për projektimin vlera 9,650,000 lekë pa TVSH. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" |
| **Ndikimi/Efekti**: | Përcaktimi i një kontrate me çelësa në dorë, ndërkohë që është i mundur hartimi i një preventivi të detajuar të volumeve, rrit riskun që autoriteti kontraktor të përfitojë punime me kosto të rritur. |
| **Shkaku:** | Mangësi në interpretimin e dispozitave ligjore |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandimi:** | 1. Nga ana e Autoritetit Kontraktor, të merren masa që në të ardhmen të bëhen analiza kosto përfitim për kontratat e parashikuara. Projektzbatimi dhe preventivi i punimeve duhen realizuar para hapjes së procedurës së prokurimit, duke stimuluar konkurrencën e operatorëve ekonomik.<br>2. Drejtoria e Tensionit të Lartë, të marrë masa që në të ardhmen projektet inxhinierike në sektorin e energjisë, të hartohen nga specialistët, me profesione në fushat inxhinierike që disponon Sektori i Projektimit të shoqërisë, duke ulur në këtë mënyrë shpenzimet e tepërta në kontratat publike. |

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Drejtoria e Tensionit të Lartë anëtarët e NJP, të A P, T Gj, R S dhe KVO D Xh, Dh Gj, Z K, me 4230/14 prot. Datë 30.05.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 827/7 prot. Datë 31.05.2023, mbi pretendimet e konstatimeve të projekt raportit dërguar me nr. 826/6 datë 09.05.2023.

| |
|---|
| ***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***<br>*- Në lidhje me mos hartimin e projektit nga strukturat e OSSH apo DTL, sqarohet se projekti përfshin raportin gjeologjik, topografik dhe llogaritjen e bazamentëve ku kërkohen Ing. Konstruktorë, Gjeolog dhe Gjeodet, të cilat OSSH dhe DTL nuk kanë të punësuar. Ndodhur përpara pamundësive, AK ka vendosur ta sigurojë projektin bashkë me zbatimin.* |

*- Në lidhje me mundësinë në dy procedura të ndryshme, sqarohet se tipi i kontratës është përcaktuar me celsa në dorë sipas VKM 914 neni 26/2/b, ku ndjekja e një procedurë të tillë nuk ka cënuar konkurrencën pasi operatorët ekonomik mund të realizonin bashkim operatorësh.*
*- Në lidhje me kriteret kualifikuese për programin e licensuar PLS CADD and Tower ose të ngjashëm, nuk zvogëlon konkurrencën pasi është vendosur termi ekuivalent dhe nevoitet për hartimin e projekteve teknike.*
*- Në lidhje me mos kërkesën e shërbimeve të ngjashme, hartimi i projektit konsiderohet si element i kontratës dhe jo i ndarë apo si kontratë e ndryshme.*
*- Në lidhje me vendosjen në listëpagesë për 6 muajt e fundit të punonjësve, nuk kufizon konkurrencë dhe është vendosur për të garantuar sigurinë, besueshmërinë etj.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**
Kriteret kualifikuese nga grupi i auditimit, janë trajtuar në bazë të parimeve të stimulimit të konkurrencës dhe të rritjes së efiçencës e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore.
- Në lidhje me mos disponimin e stafit të OSSHE për Inxhinierë projektues merret pjesërisht në konsideratë, megjithatë kur projekti dhe detajet do të jenë subjekt i aprovimit nga Investitorit, atëherë konstatohet se nuk realizohet oponencë teknike mbi ketë projekt. Ndarja në 2 prokurime "konkurs projektimi" apo shërbim konsulence etj, është në përputhje me nenit 38, pika 3,a "konkurs projektimi" të VKM 914 "Rregullave të Prokurimit Publik dhe legjislacionin Prokurimit Publik.
Gjithashtu ju rikujtojmë VKM 354 datë 11.05.2016 "Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim". Tarifa e projektimit llogaritet mbi bazë e kostove të kalkulueshme ku përfshihen kostot e ndërtimit (materiale e ndërtimit) plus punëtorinë, i cila nga DTL nuk është realizuar se si ka dal vlera e projektit.
Mbështetur në nenin 7, "Përcaktimi i Tarifave" pika 5 të VKM 354 datë 11.05.2016 "Mirami i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim", citohet: Nëse, gjatë kohës të vlefshmërisë së kontratës, ndryshon projekti me kërkesë të porositësit, duke ndikuar në ndryshimin e kostos së llogaritshme, vlerat ose njësitë e llogaritjes, atëherë marrëveshja mbi të cilën është e llogaritur tarifa, duhet të rillogaritet dhe të dokumentohet me shkrim. Pra AK, duhet të marrë masa për përcaktim e saktë të vlerës së projektimit. Vlera e projektimit e paguar nuk ka ndjekur asnjë fazë sipas VKM 354 "Tipologjitë e shërbimit të përcaktuara në këtë manual janë të ndara sipas fazave paraqitur më poshtë:
Faza I: Analiza e detyrës së projektimit /termat e referencës dhe përcaktimi i bazës së projektit;Faza II: Projektideja paraprake; Faza III: Projektideja përfundimtare; Faza IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit; Faza V: Projekti i zbatimit; Faza VI: Preventivi përfundimtar; Faza VII: Përgatitja e dokumentacionin për procedurë tenderimi;Për shkak të mos ndjekjes së fazave të projektit ashtu sic u konstatua në zbatimin e linjës nuk ishte ende realizuar për shkak të lejeve përkatëse. Gjithashtu nuk është respektua ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve" i ndryshuar, vendimit nr. 1055 datë 22.12.2010 "Për vendosjen e opononencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit" për objekte mbi 100 milion lekë. Sipas VKM 914 neni 26/2/b "Kjo kontrate do të trajtohet si një kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit". Nga AK nuk ka patur asnjë vëllim punësh dhe as një projekt, ku ofertuesi të kryej studim të hollësishëm të tij në mënyrë që të ofertojë sipas dispozitës përkatëse. Nga observacionet nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në projektraportin e

auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.

**14.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "***Rikonstruksion dhe ndërtim kabinash murature në Korcë***", Rajoni Korçë, viti 2021, fond limit 36,853,343 lekë pa TVSH*"*, konstatohet:

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

| **a. Zhvillimi i Procedurës:** *"Rikonstruksion dhe ndertim kabinash murature ne Korce 2021* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur-Punë"<br>REF-83808-01-11-2021 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. E Dh<br>2. R K<br>3. A D | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. A B<br>2. Gj D<br>3. M H |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>36,853,343 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>36,550,728 lekë<br>Operatori Fitues: "L K" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>302,615 lekë |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 12.02.2021<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:**<br>4 muaj | **8. Burimi Financimit**<br>OSSH. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **2 OE**<br>b) S'kualifikuar **1 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka**; KPP**-s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit në SPE konstatohet:**

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 2 "hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit" ku citohet se: "*Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*". Janë konstatuar shkelje të nenin 46, pika 3 të LPP, *kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik* dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar "Për miratimin e rregullave të prokurimit public" neni 27 "Kontratat e mallrave"; pika 3, "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".*

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 2 OE ku procedura e prokurimit, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH |
|---|---|---|
| 1 | OE: B shpk" shpk | 30,637,305 |
| 2 | OE: L K shpk | 36,550,728 |

Nga vlerësimi i KVO datë 19.02.2021, është s'kualifikuar ofertuesit i mëposhtëm:

B shpk pasi, operatori ekonomik nuk ka përmbushur tek Kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti teknik piken 8, OE nuk ka paraqitur 20 punetorë ndërtimi. Referuar rëndësisë e një oferte ekonomike më të mirë ekonomikisht, në lidhje me numrin mesatar të punonjësve, nga KVO duhej të mbahej në konsideratë Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 53 "Shqyrtimi i ofertave", pika 1 citohet "*Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u*

*kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme*. Pika 4 e nenit 53 citon: *Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet.* Referuar sa më sipër nga KVO edhe në nenin 46 Kualifikimi i ofertuesve, gjykohet se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë AK, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomik, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë,pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, *gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.* OE B shpk" shpk, ka paraqitur në total 16 punonjës ndërtimi (ku përfihen edhe elektricistët si punonjës ndërtimit).

| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: "*Rikonstruksion dhe ndertim kabinash murature ne Korcë"* Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim. |
|---|---|
| **Situata 16:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në DST pika 2 kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të disponojë:<br>Licencse lidhur me ndikimin ne mjedis leshuar nga QKL kodi I-2-A (*Shërbime profesionale të mbrojtjen civile*), Licencse lidhur me ndikimin ne mjedis leshuar nga QKL kodi III-2-A, (*Shërbime profesionale lidhur me ndikimin në mjedis*), License lidhur me ndikimin ne mjedis leshuar nga QKL kodi III-2-B, (*Shërbime profesionale lidhur me ndikimin në mjedis*). Referuar projekt preventivit dhe legjislacionit prokurimit publik, nuk argumentohet vendosja e këtyre licensave të mësipërme, pasi nuk janë të lidhura me objektin dhe natyrën e kontratës. Gjithashtu nuk argumentohet vendosja e licensës III-2-A apo III-2-B, të cilat mbivendosen duke ngushtuar konkurencën. Në DST pika 3 kërkohet që Operatori ekonomik duhet et disponoje nje staf drejtues teknik te inxhiniereve te perbere prej: Ing ndërtimi 1 (një), Ing mjedisi 1 (një), Ing gjeodet/ topograf/ markshajder 1 (një), Ing elektrik 1 (një), Ing mekanik 1 (një). Gjithashtu në DST pika 4, kërkohet që Operatori ekonomik duhet e kete drejtues teknik ne license: Ing ndertimi 1 (nje), Ing elektrik 1 (një), Ing mjedisi 1 (nje). Kriteri i inxhinierëve të mësipërm trajton në mënyrë të pabarabartë operatorët ekonomik të cilët nuk e kanë inxhinierët e mësipërm *në licencën e shoqërisë. Nga Ak nuk argumentohen kërkesat e mësipërme se pse duhet të jenë pjesë e licensës dhe në listëpagesa, kur mjaftonte kontrata e punës, cv dhe libreza.* Referuar preventivit konstatohet, se nuk ka asnjë punim mjedisi, mekanik dhe nevojë për punime topografike, duke ngushtuar konkurrencën. Në pikën 5 të DST kërkohet që Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, Urdhër mjeku, diplome, CV, libreze pune dhe te figurojne *në listpagesat e 6 muajve te fundit 1(nje) mjek.* |

| | |
|---|---|
| | Vendosja e kërkesës së mjekut në shoqërinë, nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit. Gjithashtu vendosja për të paktën *6 muaj në listëpagesë*, ngushton konkurrencën. Në pikën 7, kërkohet që operatori ekonomik duhet të disponoje një numer mesatar prej jo me pak se 60 punonjës të siguruar per periudhen qershor-dhjetor 2020. Në pikën 8, kërkohet që operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka në stafin e punonjësve, të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme të pajisur me dëshmi kualifikimi profesionale, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhen e kërkuar si me poshtë: Elektricist 8(tete), Punëtor izolimi 1(një), Manovrator 8 (tete), Punetor ndertimi 20 (njezet), Makinist per hapje kanalesh 1(një). Në pikën 9, operatori ekonomik duhet te kete te paktën: Punonjës të certifikuar për mbrojtjen nga zjarri 2 persona, Ekspert i ndihmes se pare 2 persona, Mbrojtje në lartësi 2 persona, Sigurimi ne kantjer 1 person. *Specifikimet e punonjësve nuk janë argumentuar nga NJP, në lidhje me volumin e kontratës. Nga ana e AK, janë vendosur kërkesa të cilat kanë vështirësuar dhe ngushtuar konkurrencën, ku nga 60 punonjës në total që duhet të ketë OE, janë specifikuar rreth 50 punonjës duke përfshirë stafin drejtues teknik etj.* Në pikën 10, kërkohet që Shoqëria duhet të jete e certifikuar sipas standarteve ISO 1452-1: 2019, e cila është e paargumentuar nga AK. ISO 1452-5:2009 specifikon karakteristikat për përshtatshmërinë për qëllime të sistemeve të tubacioneve të paplastifikuara të poli (vinilklorurit) (PVC-U) të destinuara për furnizim me ujë dhe për kullimin dhe kanalizimet e groposura dhe mbi tokë nën presion. Pra, kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi OE do vetëm do të realizojë punën e ndërtimit të Rikonstruksionit të gabinave, sipas specifikimeve të kërkuara dhe kjo certifikatë nuk i nevoitet OE për realizim e punës, referuar projekt-preventivit. ISO 3834-2:2006 (kërkesat e cilesisë për bashkim me saldi të metaleve) ISO 3834-2:2006, (kërkesat e cilësise per bashkim me saldi te metaleve) Çertifikata ISO 3834-2:2005, e cila është e paargumentuar nga AK. Kjo certifikatë është e përgatitur e tillë që është e pavarur nga lloji i konstruksionit të salduar që do të prodhohet; ai përcakton kërkesat e cilësisë për saldimin si në punëtori ashtu edhe në vend; ai ofron udhëzime për përshkrimin e aftësisë së një prodhuesi për të prodhuar ndërtime të salduara për të përmbushur kërkesat e specifikuara; mund të përdoret gjithashtu si bazë për vlerësimin e prodhuesit në lidhje me aftësinë e tij të saldimit. Pra, kjo certifikatë është për prodhuesit e konstruksioneve metalike të cilët duhet të jenë të certifikuar në lidhje me saldimet dhe kjo certifikatë nuk ka asnjë llojë lidhje me objektin e prokurimit e cila sjell zvogëlim shum të ndjeshëm të konkurencës.<br>- BS EN 13331-1: 2002 e cila është e paargumentuar nga AK. Ky standard specifikon kërkesat për sistemet e veshjes metalike të kanaleve të montuara tërësisht nga komponentë të parafabrikuar. Pra kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit.<br>- DS CEN/TR 15128: 2005 e cila është e paargumentuar nga AK, Ky standard jep një studim të standardeve evropiane të disponueshme në fushën e rehabilitimit të sistemeve të kullimit dhe kanalizimeve. Pra kjo certifikatë |

| | |
|---|---|
| | nuk ka lidhje me objektin e prokurimit. Në pikën 12 të makinerive dhe pajisjeve, janë kërkuar kërkesa kualifikuese shum të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Janë kërkuar mjete Kamion mbi 20 ton 3 copë, Kamioncine deri 3.5 3 copë, Eskavator me zinxhir 2 copë, Minieskavator 2 copë, Eskavator me krahe te gjate 18 m 1 copë, Buldozer 1 copë, Autobetoniere, 3 copë, Rrul 1 copë, Sharre per prerje asfalti 1 copë, *në mënyrë të paargumentuar, pasi nuk ka volum punimesh dhe zëra në preventiv.* |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin Publik" |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 "Për prokurimin publik"i ndryshuar. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | Drejtoria Rajonale Korçë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Drejtoria Rajonale Korcë anëtarët e NJP, të E Dh, R K, A D dhe KVO A B, Gj D dhe M H, me 4230/29 prot. Datë 30.05.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 827/7 prot. Datë 31.05.2023, mbi pretendimet e konstatimeve të projekt raportit dërguar me nr. 826/6 datë 09.05.2023.

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***
*- Në lidhje licensat sqarohet se ato lidhen ngushtë me objektin. Stafi drejtues është lidhur me natyrën e punimeve dhe mjeku është vendosur duke pasur parasysh riskun e punimeve elektrike.*
*- Në lidhje me profesionet e punonjësve janë vendosur kërkesa referuar zërave të punimeve.*
*- Në lidhje me vlerësimin e ofertave pretendohet se KVO ka konstatuar ofertë të vlefshme operatorët që përmbushin dokumentet e tenderit dhe specifikimet teknike.*

**<u>Qëndrimi i grupit të auditimit</u>:**
Kriteret kualifikuese nga grupi i auditimit, janë trajtuar në bazë të parimeve të stimulimit të konkurrencës dhe të rritjes së efiçencës e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore. Nga observacionet nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të cilat mund të merret në konsideratë.

**15.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "***Rikonstruksione te rrjetit TM, TU ne zonat e pergjegjesise ne agjensine Bilisht. Rikonstruksion kabinash tip murature ne agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr 6 N/St Bilisht. Rikonstruksion rrjeti TM 10kV fideri 8 ndërtim kabine BOX***", Rajoni Korçë, viti 2021, fond limit 43.668.240 lekë pa TVSH*"*, konstatohet:

*<u>Të dhëna mbi objektin e prokurimit:</u>*

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i Procedurës: “Rikonstruksione te rrjetit TM, TU ne zonat e pergjegjesise ne agjensine Bilisht. Rikonstruksion kabinash tip murature ne agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr 6 N/St Bilisht. Rikonstruksion rrjeti TM 10kV fideri 8 ndërtim kabine BOX 2021</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>“E hapur-Punë”<br>REF-83778-01-11-2021</td><td>2 Njësia e Prokurimit<br>1. E Dh<br>2. R K<br>3. A D</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>1. A B<br>2. Gj D<br>3. M H</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)<br>43.668.240 lekë</td><td>5. Oferta fituese (pa tvsh)<br>43,297,932 lekë<br>Operatori Fitues: “L K” sh.p.k</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)<br>370,308 lekë</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 12.02.2021</td><td rowspan="2">8. Burimi Financimit<br>OSSH. sha</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE<br>b) S’kualifikuar 0 OE,<br>c) Kualifikuar 1 OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:<br>4 muaj</td></tr>
<tr><td>10.Ankimime<br>AK-s’ka; APP–s’ka; KPP-s’ka</td><td>11. Përgjigje Ankesës nga AK:</td><td>12.Përgjigje Ankesës</td></tr>
</table>

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 1 OE ku procedura e prokurimit, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH |
|---|---|---|
| 1 | OE: L K shpk | 43,297,932 |

Nga vlerësimi i KVO datë 19.02.2021, informohet OE “L K” shpk, se oferta e paraqitur, është oferta e sukseshme, duke plotësuar kriteret e përgjithshme dhe vecanta kualifikuese.

Neni 53 pika 4 sipas të cilit: “*autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit...*”.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Në procedurën e prokurimit: “*Rikonstruksione te rrjetit TM, TU ne zonat e pergjegjesise ne agjensine Bilisht. Rikonstruksion kabinash tip murature ne agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr 6 N/St Bilisht. Rikonstruksion rrjeti TM 10kV fideri 8 ndërtim kabine BOX”* Njësia e Prokurimit nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim. |
| **Situata 17:** | Nga auditimi në SPE, konstatohet se nuk janë argumentuar kritere kualifikuese dhe një pjesë nuk janë në përpjesëtim me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në DST pika 2 kërkohet që Operatori Ekonomik duhet të disponojë:<br>Licencse lidhur me ndikimin ne mjedis leshuar nga QKL kodi I-2-A (*Shërbime profesionale të mbrojtjen civile*), Licencse lidhur me ndikimin ne mjedis leshuar nga QKL kodi III-2-A, (*Shërbime profesionale lidhur me ndikimin në mjedis*), Licencse lidhur me ndikimin ne mjedis leshuar nga QKL kodi III-2-B, (*Shërbime profesionale lidhur me ndikimin në mjedis*). Referuar projekt preventivit dhe legjislacionit prokurimit publik, nuk argumentohet vendosja e këtyre licensave të mësipërme, pasi nuk janë të lidhura me objektin dhe natyrën e kontratës. Gjithashtu nuk argumentohet vendosja e licensës III-2-A apo III-2-B, të cilat mbivendosen duke ngushtuar konkurencën. Në pikën 5 të DST kërkohet që Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar, të vërtetuar me kontrate pune të vlefshme, |

| | |
|---|---|
| | Urdhër mjeku, diplome, CV, libreze pune dhe te figurojne *në listpagesat e 6 muajve te fundit 1(nje) mjek*. Vendosja e kërkesës së mjekut në shoqërinë, nuk është në përputhje me natyrën e objektin e prokurimit. Gjithashtu vendosja për të paktën *6 muaj në listëpagesë*, ngushton konkurrencën. Në pikën 10, kërkohet që Shoqëria duhet të jete e certifikuar sipas standarteve: ISO 1452-1: 2019, e cila është e paargumentuar nga AK. ISO 1452-5:2009 specifikon karakteristikat për përshtatshmërinë për qëllime të sistemeve të tubacioneve të paplastifikuara të poli (vinilklorurit) (PVC-U) të destinuara për furnizim me ujë dhe për kullimin dhe kanalizimet e groposura dhe mbi tokë nën presion. Pra, kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit, pasi OE do vetëm do të realizojë punën e ndërtimit të Rikonstruksionit të gabinave, sipas specifikimeve të kërkuara dhe kjo certifikatë nuk i nevoitet OE për realizim e punës, referuar projekt-preventivit. ISO 3834-2:2006 (kerkesat e cilesise per bashkim me saldi te metaleve) ISO 3834-2:2006, (kerkesat e cilesise per bashkim me saldi te metaleve) Çertifikata ISO 3834-2:2005, e cila është e paargumentuar nga AK. Kjo certifikatë është e përgatitur e tillë që është e pavarur nga lloji i konstruksionit të salduar që do të prodhohet; ai përcakton kërkesat e cilësisë për saldimin si në punëtori ashtu edhe në vend; ai ofron udhëzime për përshkrimin e aftësisë së një prodhuesi për të prodhuar ndërtime të salduara për të përmbushur kërkesat e specifikuara; mund të përdoret gjithashtu si bazë për vlerësimin e prodhuesit në lidhje me aftësinë e tij të saldimit. Pra, kjo certifikatë është për prodhuesit e konstruksioneve metalike të cilët duhet të jenë të certifikuar në lidhje me saldimet dhe kjo certifikatë nuk ka asnjë llojë lidhje me objektin e prokurimit e cila sjell zvogëlim shum të ndjeshëm të konkurencës. BS EN 13331-1: 2002 e cila është e paargumentuar nga AK. Ky standard specifikon kërkesat për sistemet e veshjes metalike të kanaleve të montuara tërësisht nga komponentë të parafabrikuar. Pra kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit. DS CEN/TR 15128: 2005 e cila është e paargumentuar nga AK, Ky standard jep një studim të standardeve evropiane të disponueshme në fushën e rehabilitimit të sistemeve të kullimit dhe kanalizimeve. Pra kjo certifikatë nuk ka lidhje me objektin e prokurimit. Në pikën 12 të makinerive dhe pajisjeve, janë kërkuar kërkesa kualifikuese shum të ekzagjeruar në lidhje me volumin, natyrën dhe objektin e kontratës. Janë kërkuar mjete Kamion mbi 20 ton 3 copë, Kamioncine deri 3.5 3 copë, Eskavator me zinxhir 2 copë, Minieskavator 2 copë, Eskavator me krahe te gjate 18 m 1 copë, Buldozer 1 copë, Autobetoniere 3 copë, Rrul 1 copë, Sharre per prerje asfalti 1 copë, *në mënyrë të paargumentuar, pasi nuk ka volum punimesh dhe zëra në preventiv*. |
| **Kriteri:** | - VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.<br>- Termat e referencës procedurës dhe dokumentet e tenderit<br>- Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik” |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos argumentim i kritereve kualifikues dhe mos nxitje të pjesëmarrjes në konkurrim. |
| **Shkaku:** | Kritere kualifikuese jo në përpuethshmëri me parashikimet e Ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”i ndryshuar. |

| | |
|---|---|
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandimi:** | 1. Drejtoria Rajonale Korçë, Njësitë e Prokurimit në procedurat e prokurimit të punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar dhe e dokumentuar në përputhje me parashikimet ligjore, duke nxitur pjesëmarjen e operatorëve ekonomik. |

**16.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: ***"Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit të Traktoreve 110/20 kV***", Drejtoria e Tensionit të Lartë, viti 2020, fond limit 149,998,057 lekë pa TVSH, kontrata e nënshkruar është 13.11.2020, kohëzgjatja 6 muaj konstatohet:

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *"Rikonstruksion dhe fuqizim i N/Stacionit të Traktoreve 110/20 kV" 2020* | | |
|---|---|---|
| 1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur"<br>REF-70566-09-02-2020 | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. A P<br>2. R P<br>3. S K | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>1. A P<br>2. Z K<br>3. Dh Gj |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>149,998,057 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>149,184,363lekë<br>BOE: "H E "E" sh.p.k | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>813,694 lekë ose zbritur 99.4 % nga F.L |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 05.10.2020 ndryshohet 12.10.2020 ndryshohet 19.10.2020<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 6 muaj nga dorezimi i sheshit | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **2 OE**<br>b) S'kualifikuar **1 OE,**<br>c) Kualifikuar **1 OE**<br>d) Tërhequr **0 OE** |
| **10.Ankimime**<br>**AK-s'ka; APP**–s'ka; **KPP**-s'ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** | **12.Përgjigje** Ankesës |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:**

Dokumentet e tenderit të hartuara e miratuara nga AK, nuk kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61, pika 2 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij dhe te figurojne si drejtues teknik me licencen e shoqërisë dhe ne listepagesat e shoqerise per *12 muajt e fundit*, 2-Inxhinier Elektrik, 1-Inxhinier Mekanik, 1-Inxhinier Ndertimi, 1-Inxhinier Mjedisi, 1-Inxhinier Gjeodet. Me shtojcën datë 30.09.2020 ndryshon duke hequr Inxhinier Mjedisi dhe në listepagesat e shoqerisë për *6 muajt e fundit. Vendosja për të paktën 12 muaj në listëpagesë dhe më pas 6 muaj, ngushton konkurrencën duke stimuluar vetëm ata OE të cilët kanë të Drejtues teknik në listpagesat e shoqërisë mbi 6 muaj.*

***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët KVO-ja ka kryer në SPE në datën 26.10.2020 vlerësimin dhe klasifikimin përkatës si më poshtë:

| Nr | *Shoqëria OE/BOE* | *Oferta Lekë PA TVSH* |
|---|---|---|
| 1 | BOE: "H E" & E | 149.184.363 |
| 2 | "E" sh.p.k | Pa ofertë |

Referuar procedurës, informohet BOE: "H E" shpk dhe E shpk se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 149,184,363 lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Në lidhje me observacionet e dërguara nga Drejtoria e Tensionit të Lartë anëtarët e NJP, të A P, R P, S K, nr. 4230/1 prot. Datë 30.05.2023, të protokolluara në KLSH me nr. 827/7 prot. Datë 31.05.2023, mbi pretendimet e konstatimeve të projekt raportit dërguar me nr. 826/6 datë 09.05.2023.

***Pretendimi i subjektit:***

*- Në lidhje me vendosjen e drejtuesit teknik minimumi 6 muaj në listëpagesë, është vendosur që AK të krijojë bindjen që ofertuesit të kenë stafin e duhur, eksperiencën dhe qëndrueshmërinë për realizimin e kontratës.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

*Kriteret kualifikuese nga grupi i auditimit, janë trajtuar në bazë të parimeve të stimulimit të konkurrencës dhe të rritjes së efiçencës e efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore. Vendosja e drejtuesit teknik minimumi 6 muaj në listëpagesë, nuk favorizon ato kompani që e kanë 3 muaj, 5 muaj në listëpagesë apo që sapo ka filluar punësimin dhe nuk cënohet qëndrueshmëria apo besueshmëria në realizimin me sukses të kontratës. Nga observacionet nuk ka asnjë evidencë jusitifikuese dhe as bazë ligjore të re nga ato të trajtuara në projektraportin e auditimit. Sa më sipër nga ana e grupit të auditimit mbahet i njëjti qëndrim.*

**17.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: "***Shërbimi i internetit për një periudhë 3 vjecare***" REF-01153-07-16-2021, OSHEE Group sh.a, fond limit 95,723,816 lekë pa TVSH*"*, konstatohet:

*Të dhëna mbi objektin e prokurimit:*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** "*Shërbimi i internetit për një periudhë 3 vjecare*" | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>"E hapur-Shërbime"<br>REF-01153-07-16-2021.<br>Urdhri nr. 5400/3 prot. Datë 16.07.2021 | **1.1 Komisioni percaktimit preventivit, ST, fondit limit**<br>Urdhri nr. 5400/1 prot. Datë 26.05.2021<br>1. P Gj,<br>2. O K<br>3. A K. | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. A G<br>2. V K<br>3. A Gj | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr. 5400/4 prot., datë 16.07.2021.<br>1. D D<br>2. T K<br>3. V Xh |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>95,723,816 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>89,980,416 lekë<br>Operatori Fitues: "**A**" sh.a | | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>7,743,400 lekë ose zbritur 94 % nga F.L |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 23.08.2021,<br>**7/2 Kohëzgjatja e kontratës:** 36 muaj | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **6 OE**<br>b) S'kualifikuar **4 OE,**<br>c) Kualifikuar **2 OE** |
| **10.Ankimime**<br>5152 prot. OSHEE datë 22.09.2021;<br>**APP**–s'ka**; KPP**-ka | **11. Përgjigje Ankesës nga AK:** ka | | **12.Përgjigje** Ankesës |

Me Urdhrin e brendshëm nr. 5400/1 prot. Datë 26.05.2021, ngrihet komisioni për përcaktimin e preventivit, specifikimeve teknike, fondit limit, termave të references dhe kapaciteteve teknike për kualifikim për procedurën me objektin e prokurimit, i përbërë nga P Gj, O K dhe A K. Me relacionin nr. 5400/2 prot. Datë 14.07.2021 të komisionit përllogaritjes fondit limit, ST dhe termave të references, për hartimin e fondit limit komisioni u bazua në studimin e tregut referuar nenit **76** të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, "Mënyrat për përllogaritjen e vlerës së prokurimit".

Vlera e përllogaritur nga mesatarja e ofertave rezulton në 95,723,816 lekë pa TVSH. Me Urdhrin

e prokurimit nr. 5400/3 prot. Datë 16.07.2021, urdhërohet të kryhet prokurimi i procedures prokuruese dhe ngrihet njësia e prokurimit e përbërë nga A G, V K dhe A Gj. Me urdhrin nr. 5400/4 prot. Datë 16.07.2021, ngrihet komisioni i ofertave i përbërë nga T K, D D dhe V Xh. ***b- Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

1. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE, për të cilët, KVO-ja ka kryer në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar përkatës si më poshtë:

| Nr | *Shoqëria OE/BOE* | *Oferta Lekë PA TVSH* |
|---|---|---|
| 1 | *T C shpk* | *69,656,400* |
| 2 | *A sh.a* | *89,980,416* |
| 3 | *V A sh.a* | *94,700,000* |
| 4 | *N shpk* | *64,120,000* |
| 5 | *A T U U & D C* | *71,887,250* |
| 6 | *A S C* | *259,426,800* |

*Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:*

**1.** Operatori Ekonomik *N shpk, për arsye:*

Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 viteve te fundit. Nuk ka paraqitur zgjidhjen teknike dhe bllok skemën e plotë për zgjidhjen e ofruar si dhe licencën përkatëse te lëshuar nga AKEP. Nuk ka paraqitur deklarate që është i gatshëm për zhvendosjen fizike të lidhjeve online të pikave të OSHEE GROUP sh.a, ose ndarjen e kapacitetit të një linje në linja të veçanta në vendndodhje të ndryshme me kusht që shumatorja e kapaciteteve të jetë e njëjtë me kapacitetin e linjës se mëparshme, kur kjo kërkohet nga kompania OSHEE GROUP sh.a, Shpenzimet për këto zhvendosje dhe ndarje kapaciteti do të mbulohen nga ofruesi i shërbimit . Për 2 nga 3 Inxhinierat e kerkuar nuk ka paraqitur, certifikatat përkatëse të kualifikimit, diplomën e studimeve Universitare të nivelit të paktën bachelor në elektronikë, telekomunikacion, shkenca kompjuterike ose fusha të ngjashme dhe liste pagesa E-sig të pakten muajin e fundit. Nuk ka paraqitur deklarate që do ti ofrojë kompanisë OSHEE GROUP sh.a. komunikim telefonik fiks për thirrjet kombëtare, sipas kërkesës së saj. Nuk ka paraqitur deklarate që do te ofroje 2 blloqe nga 16 IP për t'u përdorur nga OSHEE Group sh.a.

**2.** Operatori Ekonomik *A S C shpk, për arsye:*

Në mbeshtetje të nenit 76 dhe 77 te ligjit nr. 162 date. 23.12.2020, KVO ka vendosur të skualifikoje Operatorin Ekonomik "A S C" sh.p.k pasi oferta e paraqitur në vlerën 256,426,800 leke pa TVSH tejkalon fondin limit. Për kete arsye KVO nuk merr ne shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga ky OE.

**3.** Bashkimi i Operatoreve *Ekonomike "A T U & D C" shpk, për arsye:* Asnjë nga operatoret në bashkim nuk kanë paraqitur në deklarate se nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale, personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale dhe nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale. OSHEE informon Operatorin Ekonomik T C sh.p.k., se oferta e paraqitur *është identifikuar si Oferta e suksesshme*. Me publikimin e njoftimit datë 14.09.2021, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të LPP. Formulari i njoftimit të fituesit realizohet me nr. 5400/6 prot. Datë 14.09.2021.

- Me shkresën nr. 5152 prot. OSHEE datë 22.09.2021, drejtuar edhe KPP paraqitet ankesë nga operatori "*A sh.a*, mbi kualifikimin e OE "T C shpk. Në ankesë pretendohen mangësi të shumta në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe teknik të OE të shpallur fitues. Me urdhrin e titullarit nr.

10066/1 prot. Datë 23.09.2021, pezullohet procedura për shqyrtimin e ankesës dhe ngrihet KSHA i përberë nga E. C., A. M. dhe K.K. Me shqyrtimin e ankesës nr. 10066/2 prot. Datë 30.09.2021, KSHA vendos mos ta pranoj ankesës së OE “A” sh.a, ku OE njoftohet për mos pranimin e ankesës me nr. 10066/3 prot. Datë 01.10.2021. Në datën 22.10.2021, KPP me vendimin nr. 799/2021 ka vendosur:
Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A” SHA për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i internetit për një periudhë 3 vjeçare”, duke vendosur që AK të anullojë vendimin mbi kualifikimin e OE “T C” sh.p.k. Operatori ekonomik “T C” SHPK eshte skualifikuar per mos plotesimin e kriterit ekonomik per xhiron vjetore te kerkuar ne DT. Më pas, KVO-ja ka kryer në SPE në datën 11.11.2021 vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar përkatës si më poshtë:

| Nr | *Shoqëria OE/BOE* | *Oferta Lekë PA TVSH* |
|---|---|---|
| 1 | *T C shpk* | *69,656,400* |
| 2 | *A sh.a* | *89,980,416* |
| 3 | *V A sh.a* | *94,700,000* |
| 4 | *N shpk* | *64,120,000* |
| 5 | *A T U U & D C* | *71,887,250* |
| 6 | *A S C* | *259,426,800* |

*Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:*
**1.** *Operatori Ekonomik **N** shpk, për arsye:*
Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Nuk ka paraqitur dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 viteve te fundit. Nuk ka paraqitur zgjidhjen teknike dhe bllok skemën e plotë për zgjidhjen e ofruar si dhe licencën përkatëse te lëshuar nga AKEP. Nuk ka paraqitur deklarate që është i gatshëm për zhvendosjen fizike të lidhjeve online të pikave të OSHEE GROUP sh.a, ose ndarjen e kapacitetit të një linje në linja të veçanta në vendndodhje të ndryshme me kusht që shumatorja e kapaciteteve të jetë e njëjtë me kapacitetin e linjës se mëparshme, kur kjo kërkohet nga kompania OSHEE GROUP sh.a, Shpenzimet për këto zhvendosje dhe ndarje kapaciteti do të mbulohen nga ofruesi i shërbimit . Për 2 nga 3 Inxhinierat e kerkuar nuk ka paraqitur, certifikatat përkatëse të kualifikimit, diplomën e studimeve Universitare të nivelit të paktën bachelor në elektronikë, telekomunikacion, shkenca kompjuterike ose fusha të ngjashme dhe liste pagesa E-sig të pakten muajin e fundit. Nuk ka paraqitur deklarate që do ti ofrojë kompanisë OSHEE GROUP sh.a. komunikim telefonik fiks për thirrjet kombëtare, sipas kërkesës së saj. Nuk ka paraqitur deklarate që do te ofroje 2 blloqe nga 16 IP për t’u përdorur nga OSHEE Group sh.a.
**2.** *Bashkimi i Operatoreve Ekonomike “**A T U & D C**” shpk, për arsye:* Asnjë nga operatoret në bashkim nuk kanë paraqitur në deklarate se nuk janë dënuar për ndonjë vepër penale, personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale dhe nuk janë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale.
**3.** *Operatori Ekonomik **A S C** shpk, për arsye:*
Në mbeshtetje të nenit 76 dhe 77 te ligjit nr. 162 date. 23.12.2020, KVO ka vendosur të skualifikoje Operatorin Ekonomik “A S C” sh.p.k pasi oferta e paraqitur në vlerën 256,426,800 leke pa TVSH tejkalon fondin limit. Për kete arsye KVO nuk merr ne shqyrtim dokumentacionin e paraqitur nga ky OE.
**4.** *Operatori Ekonomik **T C** sh.p.k, për arsye:*
- Në datën 22.10.2021, KPP me vendimin nr. 799/2021 ka vendosur:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “A” SHA për procedurën e prokurimit me objekt: “Shërbimi i internetit për një periudhë 3 vjeçare”, zhvilluar me datë 23.08.2021 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group Sh.A.
Kontrata e shërbimit nënshkruhet me nr. 5400/11 prot. Datë 16.11.2021, midis OE “A” dhe OSHEE. Sh.a.

**18.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit në objekt: “***Blerje kancelari per nevojat OSHEE Group sh.a***” REF-20194-02-21-2022, OSHEE Group sh.a, fond limit 29,969,358 lekë pa TVSH”, konstatohet:
*Të dhëna mbi objektin e prokurimit e anulluara:*

| **a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt:** *“Blerje kancelari per nevojat OSHEE Group sh.a* | | |
|---|---|---|
| **1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit**<br>“E hapur-Mallra”<br>REF-20194-02-21-2022. | **2 Njësia e Prokurimit**<br>1. A G<br>2. V K<br>3. D M | **3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave**<br>Urdhri nr. 5400/4 prot., datë 16.07.2021.<br>1. D D<br>2. T K<br>3. V Xh |
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>29,969,358 lekë | **5. Oferta fituese (pa tvsh)**<br>0 lekë | **6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)**<br>Anulluar |
| **7/1 Data e hapjes së tenderit:**<br>Data 09/03/2022<br>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj | **8. Burimi Financimit**<br>OSHEE. sha | **9. Operatoret Ekonomike**<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër **3 OE**<br>b) S’kualifikuar **3 OE,**<br>c) Kualifikuar **0 OE** |

**a-Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit konstatohet:**
- Referuar dokumenteve të tenderit të hedhura në SPE dhe njoftimit të kontratës, është publikuar procedura e prokurimit me objekt “*Blerje kancelari per nevojat OSHEE Group sh.a*”. Fondi Limit i përcaktuar nga kjo procedure është 29,969,358 lekë pa TVSH, me afat 12 muaj dhe data e hapjes së procedures është 09.03.2022. Referuar preventivit sipas DT, janë përllogaritur materiale kancelarie për 88 zëra mallrash të ndryshëm kancellarik me sasitë e nxjerra nga nevojat e OSHEE group. Këkesat e përgjithshme dhe të vecanta kualifikuese janë në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Kriteret e përgjithshme janë kërkuar me vetëdeklarimet e ofertuesve. Kriteret e vecanta Ak ka Kërkuar Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2019, 2020 dhe 2021, Bilancet vjetore, për vitet financiare 2018, 2019 dhe 2020, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, Dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit në një vlerë jo më të vogël 35 % e F.L, Certifikate ISO 9001 per sistemin e menaxhimit te cilesise, ose ekuivaliente, Staf punonjësish prej minimalisht 5 persona per muajin e fundit, Minimalisht 3 makina transporti në pronesi ose me kontrate qeraje, Autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike te prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede te jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij per produktin leter A4.
***b-Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

1. Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 3 OE, për të cilët, KVO-ja ka kryer në SPE në datën 09.03.2022, nga KVO nuk realizohet vlerësim i operatorëve ekomonik duke Anulluar procedurën, sipas raportit përmbledhës me nr. 940/9 prot. Datë 18.03.2022. Referuar SPE në tender kanë marrë pjesë 3 operatorë ekonomik si më poshtë:

| Nr | Shoqëria OE/BOE | Oferta Lekë PA TVSH |
|---|---|---|
| 1 | *L D* | *29,938,099* |
| 2 | *I O* | *58,134,282* |
| 3 | *M D* | *59,036,780* |

Nga verifikimi i dokumenteve të hedhura në Sistemin elektronik të Prokurimit, konstatohet se OE "L D", nuk ka hedhur dokumentacion të plotë mbi sigurimin e ofertës. Me shkresën e NJP nr. 940/12 prot. Datë 04.04.2020, drejtuar titullarit të OSHEE, njoftohet mbi problematikën e kontatuar gjatë zhvillimit të procedures së prokurimit me objekt "*Blerje kancelari per nevojat OSHEE Group sh.a.* Mbështetur në relacionin nr. 940/2 prot. Datë 18.02.2022 me objekt "Hartimin e preventivit të detajuar, psecifikimeve teknike, përllogaritjen e vlerës së parashikuar, afatin e realizimit dhe hartimin e kritereve të vecanta për kualifikim", është zhvilluar procedura e prokurimit me REF 20194-02-21-2022, ku në procedurë morën pjesë 3 operatorë ekonomik. Bashkëlidhur dokumeteve të ofertës së OE "I O" shpk, është paraqitur një dokument sqarues datë 09.03.2022, ku justifikon vlerën e ofertës së dhënë me arsyetimin se vlera e letrës në treg është rritur dhe nuk përputhet me vlerën e përllogaritur nga OSHEE Group. Nga formularët e ofertave konstatohet se për zërin (Letër), operatorët kanë ofertuar me cmim shumë të lartë, sesa vlera e përllogaritur në relacionin e studimit të tregut nr. 940/2 prot. Datë 18.02.2022. Në përfundim të procesit të vlerësimit KVO ka s'kualifikuar të gjithë operatorët dhe procedura është anuluar. Ndodhur në këto kushte si dhe në zbatim të nenit 93/2 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, kërkohet të merren në konsideratë shkaqe që cuan në dështimin e procedures dhe të korrigjohet përllogaritja e fondit limit që të rritet konkurenca. Bashkëlidhur nga NJP vihet në dispozicion raporti përmbledhës nr. 940/9 datë 18.03.2022, shkresë informuese të I O datë 09.03.2022, ofertat e OE "I O" shpk dhe "M D" shpk. Me relacionin të grupit të përllogaritjes së FL, nr. 3798 prot. Datë 19.04.2022, i përbërë nga I K, E M dhe I H, mbështetur në shkaqet që cuan në dështimin e procedures, kanë vendosur të rishikojnë relacionin nr. 940/2 prot datë 18.02.2022, ku u vendos të rishikohen edhe një here preventivi i detajuar. Me urdhrin e prokurimit nr. 3798/1 prot. Datë 21.04.2021, urdhërohet të realizohet procedura e prokurimit me object "*Blerje kancelari per nevojat OSHEE Group sh.a*" me fond limit prej 59,423,158 lekë pa TVSH, ku edhe ngrihet njësia e prokurimit e përbërë nga A G, D M dhe V K.

<table>
<tr><td colspan="3">a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje kancelari per nevojat OSHEE Group sh.a</td></tr>
<tr><td>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit<br>"E hapur-Mallra"<br>REF-26060-04-21-2022.<br>Urdhri nr. 3798/1 prot. Datë 21.04.2021</td><td>2 Njësia e Prokurimit<br>1. A G<br>2. V K<br>3. D M</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr. 3798/2 prot., datë 21.04.2022.<br>1. A Gj<br>2. G P<br>3. Q K</td></tr>
<tr><td>4. Fondi Limit (pa tvsh)<br>59,423,158 lekë</td><td>5. Oferta fituese (pa tvsh)<br>0 lekë</td><td>6. Diferenca me fondin limit (pa tvsh)<br>Anulluar</td></tr>
<tr><td>7/1 Data e hapjes së tenderit:<br>Data 23.05.2022</td><td rowspan="2">8. Burimi Financimit<br>OSHEE. sha</td><td rowspan="2">9. Operatoret Ekonomike<br>a)Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE<br>b) S'kualifikuar 3 OE,<br>c) Kualifikuar 0 OE</td></tr>
<tr><td>7/2 Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj</td></tr>
</table>

***Në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO.***

Me procesverablin nr. 2 datë 23.05.2022, për hapjen e procedures u konstatua se në procedurën prokuruese kanë marrë pjesë 4 operatorë ekonomik, të cilët po me datë 23.05.2022 kanë paraqitur mostrat e kërkuara për procedurën sipas DST.

| Nr | *Shoqëria OE/BOE* | *Oferta Lekë PA TVSH* |
|---|---|---|
| 1 | *L D* | *47,747,725* |
| 2 | *I O* | *47,374,239* |
| 3 | *M D* | *57,454,392* |
| 4 | *I* | *59,032,679* |

Me procesverbalin nr. 3, të vlerësimit të ofertave datë 03.06.2022 dhe me formularin e njoftimit të fituesit, konstatohet se u s'kualifikuan 2 operatorë ekonomik si më poshtë:

- OE "L D" shpk nëpërmjet shkresës datë 25.05.2022, bëhet me dije se ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, verifikuar kjo me shkresën e tatimeve nr. 4472/1 datë 25.05.2022 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, por nuk sjell ansjë prove apo argument se në datën dhe orën e hapjes rezulton me detyrime tatimore, kjo referuar vërtetimit të aksesuar në e-alabania nga KVO. Në këto kushte KVO vlerëson se ky operator nuk përmbush kërkesën e parashikuar në pikën 1/dh te KPK shtojca. 7- "*nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.* Gjithashtu KVO gjatë vlerësimit të dokumentacionit të ofertës të dorëzuar në SPE, konstaton se operatori ekonomik "L D" shpk, nuk ploteson piken 2.2.2 të kapaciteteve ekonomike dhe financiare pasi bilanci i vitit 2019 nuk është dorëzuar i shoqëruar me akt ekspertizën e eksperti kontabël të autorizuar.
- OE "M D" shpk nëpërmjet shkresës date 26.05.2022 protokolluar në OSHEE me nr. 5153 prot date 26.05.2022, bën me dije se detyrimi vjen si pasojë e masës administrative gjobe marre nga punonjesve të saj e cila është shfaqur në sistem në datë 11.05.2022 dhe thekson që me marrjen e kërkesës për sqarim nga ana e OE është marr masa për të likujduar plotesisht detyrimin në datë 24.05.2022 një dite pas hapjes se ofertave. Pra ky operator nuk sjell ansjë provë apo argument që në datën e hapjes së ofertave plotëson kërkesën e pikes 1/dh te KPK shtojca 7. Ndaj në këto kushte KVO vlerëson se ky operator nuk përmbush kërkesën e parashikuar në pikën 1/dh te KPK shtojca 7- "*nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.* KVO vendosi të refuzoj ofertën si të papërgjegjshme.
- Referuar s'kualifikimit të OE "M D" shpk dhe shkresës me nr. 5153 prot date 26.05.2022, ky operator sqaron se masa administrative gjobe marrë nga punonjesve të saj e cila është shfaqur në sistem në datë 11.05.2022, ndërkohë që vërtetimi i paraqitur në procedurën e prokurimit është shkarkuar më datë 05.05.2022. OE është marr masa për të likujduar plotesisht detyrimin në datë 24.05.2022 prej 75,000 lekësh një dite pas hapjes se ofertave dhe ka nisur paralelisht procedurat e apelimit administrativ të gjobës. Referuar nenit 76 pika 2 "*Kriteret detyruese për skualifikim*" të Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", citohet: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur ç) *operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës*.
- Me procesverbalin nr. 4 datë 06.06.2022, mbi vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria "I O" shpk, i kualifikuar i pari në garë, konstatohet se ky operator me zarfin nr. 5544 prot. Datë 06.06.2022 plotëson dokumentacionin e dorëzuar dhe *KVO e shpall fitues të procedurës*. Formulari i njoftimit të fituesit realizohet me nr. 3798/7 prot datë 07.06.2022.
- Me urdhrin nr. 6022/1 prot. Datë 17.06.2022, pezullohet procedura e prokurimit për shkak të ankesës së vlerësimit nga shoqëria "I" shpk, mbi mospërmbushje të kritereve nga OE "I O" shpk.

Shqyrtimi i ankesës realizohet nga G.M.. Në datë 16.06.2022 me nr. 1293/2022 prot. Pranë Komisionit të Prokurimit Publik është rregjistruar ankesa e OE "I" shpk, me status paguar të mandatit të pagesës. Me shqyrtimin e ankesës nga G. M. nr. 6022/2 prot. Datë 23.06.2022, sqarohen cështjet e pretenduara nga OE "I" shpk, mbi mospërmbushje të kritereve nga OE "I O" shpk.

1. Nga OE "I" shpk, pretendohet se OE "I O" shpk, ka detyrime dhe taksa të papaguara nga Shtetit. Nga shqyrtimi i ankesës konstatohet se ankimimi nuk qëndron, pasi OE "I O" shpk, ka paraqitur vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve. Po ashtu OE "I O" shpk, ka paraqitur vërtetim nga organet e qeverisjes vendore, i cili ka paguar të gjitha detyrimet.

2. Nga OE "I" shpk, pretendohet se OE "I O" shpk, nuk ka paraqitur skedën teknike të prodhuesit, e cila duhet të jetë e certifikuar nga prodhuesi ose distributor. Nga shqyrtimi i ankesës konstatohet se ankimimi nuk qëndron, pasi distributor i autorizuar për Shqipërinë për të gjitha produktet e prodhuara nga N SA, sipas marrëveshjes datë 25.02.2020.

3. Nga OE "I" shpk, pretendohet se mostrat e paraqitura nga OE "I O" shpk, nuk janë sipas specifikimeve teknike. Nga kontrolli dhe verifikimi i mostrës rezulton se mostra plotëson të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe pretendimi nuk qëndron.

- Me shkresën e OSHEE group nr. 6022/3 prot. Datë 23.06.2022, drejtuar OE "I" shpk, për dijeni KPP, konstatohet se pretendimet e ngritura nga OE "I" shpk, nuk qëndrojnë.

- Me shkresën e OSHEE group nr. 6022/4 prot. Datë 23.06.2022, drejtuar KPP, dërgohet dokumentacioni i procedures prokuruese.

- Me shkresën e KPP nr. 1293/4 prot. Datë 04.07.2022, drejtuar OSHEE, kërkohet dorëzimi i mostrave të OE "I O" shpk. Me kërkesën e Kryetarit të KPP nr. 1293/6 prot. Datë 15.06.2022, drejtuar Operatorit ekonomik "E S P" shpk, për dijeni OSHEE dhe operatorëve "I" shpk dhe "I O" shpk, kërkohet asistenca e tij për kryerjen e hetimit administrative në lidhje me pretendimet e ngritura nga OE "I" shpk. Konkretisht pretendimet janë në lidhje me specifikimet teknike për letrën A4 dhe kërkohet testimi i mostrës së letrës A4 sipas parametrave të kërkuar në DST, për:

1. Pesha e testuar sipas ISO 534 – format A4, jo më pak se 78 gr/m2, paketuar në rizma 500 fletë, Një rizëm me peshë jo më të vogël se 2,500 gr në peshore elektronike.

2. Bardhësinë CIE e testuar sipas ISO 11,475 – jo më pak se 148.

3. Opaciteti i testuar sipas ISO 2,471 > 92%

4. Ndricimi i testuar sipas ISO 2,470 – jo më pak se 101. KPP sqaron se, në përgjigje të shkresës së KPP nr. 641/11 prot. Datë 04.05.2022 "Kërkesë për Informacion", *Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit me shkresën nr. 185/1 prot. Datë 09.05.2022 informon se: "...laboratori i vetëm i akredituar prej saj për testimin e letrës dhe kartonit është kompania E S P*". Referuar korespondencave dhe LPP, nga KPP kërkohet informacion nëse kompania E S P është profilizuar ose jo për të kryer vlerësimin teknik të parametrave të kërkuar për letrën A4, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së tyre me ST. Me shkresën nr. 567 prot., datë 25.07.2022, protokolluar në KPP me nr. 1293/9, datë 27.07.2022 me objekt "Kthim-përgjigje shkresës me nr. 1293/6 prot., datë 15.06.2022", "E S P" SHPK, informon Komisionin e Prokurimit Publik si më poshtë vijon: "[...] *E S P SHPK ka në përbërje Laborator të Akredituar dhe të kompletuar me instrumente të standardeve bashkëkohore dhe efikase dhe kryen testim permanent dhe me kampione të komponentëve të [...] letrës dhe kartonit." Për kryerjen e matjeve laboratorike E S P është e pajisur me Certifikatë Akreditimi me numër Regjistrimi LT 070, konform Standartit S SH ISO/IEC* ***17025:2017****, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me ligjin Nr. 116/2014 "Për Akreditimin e Organeve të Vlerësimit të Konformitetit në Republikën e Shqipërisë".* Me kthimin e përgjigjes së OE "I" shpk, drejtuar KPP, për dijeni OSHEE me nr. 7197 prot. Datë

21.07.2022, ky operator vë në dijeni KPP se kompania “E S P”, nuk përpush të gjitha certifikatat e testimit të letrës A4.
Operatori “I” shpk, informon se më datë 13.06.2022, kanë mbajtur korrespondencë me Drejtorinë e Përgjithme të Akreditimit, ku është kërkuar se cilat subjekte janë të pajisura me certifikatën e akreditimit për testimin e të gjithë parametrave të artikullit “letër A4”. Nga e-maili i datës 13.06.2022, i është vendosur në dispozicion certifikata e Akreditimit për subjektin “E S P”, subject i cili është akredituar për të kryer analiza laboratorike në përputhje me *SSHISO/IEC **17025:2017***. Nga analizimi i certificates të subjektit “E S P” lëshuar nga DA, konludon se metodat e provës me të cilën është i vlefshëm akreditimi është i ndryshëm me metodat e kërkuara në DST ose për disa nga metodat që kërkohen në DST, ky subject nuk është i akredituar nga DA. Konkretisht metoda e provës për gramaturën, Letër/karton, sipas certificates së lëshuar për subjektin “E S P” shpk, nga DA (Drejtoria e Akreditimit) është ISO 536:2019 *e ndryshme* nga ajo e kërkuar në DST, ISO 534. Metoda e provës për Bardhësinë sipas ISO 11,475 jo më pak se 148, *nuk figuron* në certifikatën e lëshuar për subjektin “E S P” shpk, c’ka do të thotë që nuk është i akredituar për këtë metodë. Metoda e provës për Opacitet > 92 % sipas ISO 2,471, *nuk figuron* në certifikatën e lëshuar për subjektin “E S P” shpk, c’ka do të thotë që nuk është i akredituar për këtë metodë. Metoda e provës për ndricimin jo më pak se 101 sipas ISO 2,470, *nuk figuron* në certifikatën e lëshuar për subjektin “E S P” shpk, c’ka do të thotë që nuk është i akredituar për këtë metodë. Me Vendimin nr. 757/2022, datë 08.08.2022 të Komisionit të Prokurimit Publik vendosi:
1. Të urdhërojë kryerjen e ekspertizës për analizimin e gramaturës së mostrës të paraqitur nga operatori ekonomik, “I O” shpk sipas metodës/standardit të kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet standarde të tenderit nga laboratori i akredituar i shoqërisë “E S P” SHPK, nëse mostra e paraqitur është në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “I O” SHPK Procedurë e Hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-26060-04-21-2022, me objekt “Blerje kancelari për nevojat OSHEE Group Sh.A, për një vit”, me fond limit 59,423,158.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor Operatori i Shpërndarjes se Energjisë Elektrike Group sh.a.
2. Operatori ekonomik “I” shpk, të parapaguajë për llogari të shoqërisë “E S P” SHPK, shumën prej 5,700 lekë pa TVSh si tarifë e përcaktuar me anë të shkresës nr. 567 prot., datë 25.07.2022 për testimin e mostrave dhe të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit, brenda datës 11.08.2022 ora 11:00.
Me shkresën nr.647 prot., datë 07.09.2022, protokolluar në KPP me nr. 1293/14 prot., datë 09.09.2022, “E S P” shpk ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “*Raport Testimi*” të mostrave të plotësuar, nr. 618/1 Prot. datë 07.09.2022 ku përcaktohet sasia e mostrës është 1 rizëm. Në konkluzion rezultoi se vlera totale e një rizme me 500 flete pa paketimin mbështjellës është shuma e Mostres II dhe Mostra IV që në total rezulton 2382,58 g ose 2,38258 kg, ndërsa vlera totale e rizmes bashkë me paketimin mbeshtjelles eshte 2405.74 g ose 2.40574 kg.”. Nga verifikimi në QKB të Ekstraktit historik të shoqërisë “E S P” shpk, me NIPT L.....Q, konstatohet se objekti i aktivitetit ka të bëjë me “*Studim, projektim dhe monitorim mjedisor. Vlerësim të ndikimit në mjedis, auditim mjedisor si dhe hartim të raportit të ndikimt në mjedis, për të kryer auditim mjedisor për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore. Laborator për monitorim, auditim dhe vlerësimin e konformitetit mjedisor dhe impaktit në mjedis. Import-eksport dhe tregtim të pajisjeve dhe aparaturave laboratorike. Import-eksport dhe tregtim të makinerive dhe pajisjeve. Asistence dhe ekspertize për sigurinë dhe shëndetin në punë. Asistence dhe ekspertize për monitorimin e kushteve të sigurisë, ergonomisë dhe konfortit në punë. Monitorimi i mjediseve të punes dhe trajnimi periodik i stafit për sigurine në punë. Bar-Restorant, Fast-Food. Administrim*

*pronash. Asistence, konsulence dhe plotesim dokumentacioni për certifikime me standarte të ndryshme. Asistencë për studime dhe ekspertize në pregatitjen e Projektve dhe Raporteve të Fizibilitetit. Asistencë për studime dhe ekspertize në vlerësimin e impakteve social-Ekonomike të projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme. Asistencë dhe ekspertize në vleresimin e eficences së energjisë. Asistencë, konsulencë dhe plotësim dokumentacioni për certifikime të produkteve, 2 paisjeve dhe makinerive sipas standarteve të ndryshme. Tregëtim me shumicë dhe pakice të materialeve dhe paisjeve Kancelarike, të Zyres, të Paisjeve Elektronike dhe Librit. Programim dhe zhvillim sistemesh informatike, software dhe aplikacione. Dizenjim dhe përpunim grafik".*
*Sa më sipër, konstatohet qartë se ky subjekt nuk ka aktivitet në lidhje me testimet të produkteve të letrës/kartonit* dhe nuk duhej të merrej si ekspert mbi vlerësimin e parametrave të letrës në procedurën e prokurimit, referuar edhe certifikatave të dhena nga DA. Me shkresën nr. 1293/16 prot. Datë 14.09.2022, dërgohet në OSHEE vendimi nr. **887/2022** prot datë 14.09.2022 i Komisionit të Prokurimit Publik.
KPP referuar Raportit të Testimit të mostrave, të dorëzuar në datë 22.08.2022 dhe *09.09.2022* nga Laboratori "E S P" shpk, si një laborator i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për testimin e mostrave, konstaton, se mostra e paraqitur për testim nga operatori ekonomik "I O" shpk, nuk është në përputhje me specifikimet teknike, pasi masa mesatare e një fijeje letre A4 sipas raportit të testimit të laboratorit "E S P" shpk është 75.903 g/m2, ndërkohë në specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pesha e një flete A4 duhet të jetë jo me pak se 78 gr/m2 . KPP vëren, se pas plotësimit të raportit të testimit të dërguar nga laboratori E S P me nr. 618/1 prot., datë 07.09.2022 rezulton, se 12 pesha e rizmës për të cilën në dokumentet e tenderit e konkretisht në specifikimet teknike autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar ndonjë standard europian apo ndërkombëtar të caktuar për testim është 2405.74 g ose 2.40574 kg, ndërkohë në specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor pesha e rizmës me 500 fletë duhet të jetë jo më pak se 2500 gr. Në përfundim, nga verifikimi i dokumentacionit dhe Raporteve të Testimit të mostrës (nr.618 prot., datë 18.08.2022 dhe nr. 618/1 prot., datë 07.09.2022) të Laboratorit të akredituar "E S P" shpk, konstatohet, se mostra për letrën A4, nuk është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Sa më sipër, nga KPP pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "I" shpk, qëndron dhe vendoset:
1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik "I" shpk për procedurën e prokurimit "E hapur, mbi kufirin e lartë monetar" me Nr. REF-26060-04-21-2022, me objekt "*Blerje kancelari për nevojat OSHEE Group Sh.a, për një vit*", me fond limit 59,423,158 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 23.05.2022 nga autoriteti kontraktor OSHEE Group Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik "I O" shpk, dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e skualifikuar këtë operator ekonomik. Me raportin përmbledhës nr. 3798/9 prot. Datë 19.09.2022, miratohet procedura e prokurimit, ku shpallet fituese OE "I" shpk, në zbatim të vendimit të KPP nr. 887/2022 datë 14.09.2022.
Referuar kronologjisë së procedurës dhe mangësive të subjektit "E S P" shpk, nga grupi auditues në lidhje me vendimin **887/2022 prot datë 14.09.2022,** i Komisionit të Prokurimit Publik, ka ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike, në përdorimin dhe kontraktimin e fondeve dhe për pasojë kryerjen e kontratës me një vlerë me të lartë ekonomike. Nga s'kualifkimi "I O" shpk" dhe shpalljen fitues të OE "I" shpk, Vendimi i KPP i ka shkaktuar buxhetit efekt negativ financiar në vlerën *11,658,440 lekë,* si diferenca midis ofertave të OE në klasifikimin, shkaktuar nga testimi i shoqërisë "E S P" shpk.

**B. Mbi zbatimin e kontratave të punimeve.**

**1. Mbi zbatimin e Kontratës "Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC".**

Kontrata e punimeve "Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC", është nënshkruar me nr. 1089/16 prot., datë 06.01.2021, me vlerë 85,450,203, me Kontraktorin "E P" SHPK. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur z. K K. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 100 ditë.
Leja e infrastrukturës është lëshuar nga Bashkia Berat me nr. 287, datë 27.05.2021. Procesverbali i fillimit të punimeve, i piketimit të objektit dhe sheshit të ndërtimit, janë mbajtur me datë 27.05.2021.
Kontrata përfshin punime për zgjatimin e fiderit A 1, 20 kV të N/Stacionit Burdullias, ndërtim rrjeti i tensionit të ulët me kabullo ABC. Kabinat janë përcaktuar parafabrikat dhe konkretisht kabina F1/13, F1/14, F1/15 dhe F1/18.
Janë certifikuar punime si më poshtë:
Situacioni nr. 1, me vlerë 13,900,626.9 lekë, është paraqitur me datë 31.05.2021.
Situacioni nr. 2, me vlerë 31,189,734.9 lekë, është paraqitur me datë 30.06.2021.
Situacioni nr. 3, me vlerë 36,316,192.3 lekë, është paraqitur me datë 31.07.2021.
Situacioni nr. 4, me vlerë 568,676 lekë, është paraqitur me datë 31.08.2021.

Nga auditimi konstatohen mangësi si më poshtë:

| **Titulli i gjetjes:** | Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. |
|---|---|
| **Situata 18:** | Nga auditimi i kontratës "Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC", u konstatua se në situacionin nr. 2, janë përfshirë punime kanali edhe për urën 60 m, ndërkohë që në këtë urë, kabullot kalojnë të inkastruar në anë të urës të futur në tuba plastikë dhe çeliku. Nga përllogaritjet rezultojnë diferenca si më poshtë: |

| Nr. | Përshkrimi i punimeve | Njësia | Sasia | Çmimi (lekë) | Vlera (lëkë) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prerje asfalti me disk | ml | 120 | 201.9 | 24,228 |
| 2 | Prishje shtresë çakulli | $m^2$ | 30 | 101.9 | 3,057 |
| 3 | Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 $m^3$... | $m^3$ | 32.4 | 357.4 | 11,579 |
| 4 | Gërmim me krahë seksion i detyruar... | " | 10.8 | 832.56 | 8,991 |
| 5 | Transport dheu me auto deri 5 km | " | 43.2 | 263.34 | 11,376 |
| 6 | Shtresë rëre (14.4 $m^3$ tek ura, 60 $m^3$ vol.tullave) | " | 74.4 | 1,444.4 | 107,463 |
| | **Shuma:** | | | | **166,691** |

Vlera ***166,691 lekë*** është përfituar më tepër nga Kontraktori "E P" SHPK.
Ndër zërat e punimeve të përfshirë në fondin rezërvë është edhe "F.V hekur betoni periodik Ø 6 mm deri Ø 10 mm (zgarë 10 x 10 cm), në sasinë 0.64 ton. Sasia e betonit respektive është 0.2 $m^3$, që i përgjigjet zgarës në sasinë 0.04 ton. ***Vlera 67,215 lekë*** (0.6 ton x 112,025 lekë/ton), është përfituar më tepër nga Kontraktori "E P" SHPK.
Nga verifikimi i punimeve në objekt, u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve prej betoni të shtyllave 9/15 kV dhe 9/6 kV. Themelet

| | |
|---|---|
| | nuk janë ndërtuar në të gjithë thellësinë me beton por vetëm në sipërfaqe me një trashësi 30 cm, kjo e dallueshme lehtësisht pothuajse në të gjitha shtyllat e verfifikuara. Si pasojë e mos zbatimit të kushteve teknike sa më sipër, në 3 shtylla devijimi nga vertikaliteti është i dukshëm. Nga përllogaritjet e përafërta rezulton se për shtyllat 9/15 kV dhe 9/15 kV është hedhur sasia 0.3 $m^3$ beton (100 cm x 100 cm x 30 cm). Nga verifikimi i librezës së masave dhe situacionit përfundimtar, për këto dy kabina janë certifikuar të vendosura 52 shtylla, me sasi totale betoni 83.3 $m^3$. Sasia e vendosur rezulton 15.6 $m^3$ (52 shtylla x 0.3 $m^3$), nga ku rezulton diferenca 67.7 $m^3$. ***Vlera 571,360 lekë*** (67.7 $m^3$ x 8439.6 lekë/$m^3$), është përfituar më tepër nga Kontraktori "E P" SHPK. |
| **Kriteri:** | Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.<br>Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Certifikim i padrejtë i vlerës 805,266 lekë. |
| **Shkaku** | Gabim në përgatitjen e librezës së masave. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **805,266 lekë**, nga Kontraktori **"E P"** SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

Kërkesa për miratimin e fondit rezervë është bërë me shkresë nr. 12/12 prot., datë 26.08.2021. Qëllimi i përdorimit të fondit rezervë është likuidimi i diferencës së disa zërave të punimeve, të cilat nuk ishin parashikuar në preventivin përkatës. Vlera e fondit rezervë është 3,333,6145 lekë.
Kërkesa për përdorimin e fondit rezervë në përfundim të punimeve, për problematika që kanë lindur më parë është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika 19, ku përcaktohet:

> *"Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar,* ***dhe i raporton, periodikisht, investitorit për gjendjen e tij.*** *Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë".*

Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me shkresë nr. 12/13 prot., datë 01.09.2021, datë në të cilën është mbajtur edhe procesverbali i përfundimit të punimeve. Akti i kolaudimit është mbajtur me datë 15.10.2021, nga znj. A A. Punimet janë marrë në dorëzim të përkohshëm nga Komisioni i përbërë z. T B, z. B D dhe z. G K, të cilët kanë hartuar certifikatën përkatëse me nr. 966/4 prot., datë 26.11.2021.

Me datë 12.12.2021, me prezencën e mbikëqyrësit të punimeve z. K K, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt, të cilat kanë të bëjnë me shtrimin e linjës së tensionit të mesëm, furnizimin dhe vendosjen e kabinave parafabrikat si dhe linjat e tensionit të ulët në zonën sipas kabinës F1/13, F1/14 dhe kabinës Veterrik Shkolla. Sa i përket furnizimit dhe vendosjes së kabinave rezulton se janë realizuar punime me cilësi të mire, si dhe pajisjet elektrike të vendosura janë sipas specifikimeve. Sa i përket linjës së tensionit të mesëm, theksojmë se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të padukshme, por sa i takon punimeve të dukshme, rezulton se shtresat asfaltike janë realizuar me cilësi të mirë, pas procesit të gërmimit, mbushjes dhe ngjeshjes me

materiale.
Më poshtë paraqiten foto nga punimet e realizuara.





Në shtyllat e vendosura mungon:
- Etiketa e identifikimit të prodhuesit, në të cilën përcaktohen: Emri i prodhuesit, data, muaji dhe viti i prodhimit, numri i strukturës, gjatësia e shtyllës, kapaciteti (momenti) në sipërfaqen e tokës, ose pika e fiksimit, logo e blerësit/OSHEE etj.
- Etiketa e identifikimit të shtyllës, në të cilën përcaktohen: Emri i pikës së transformimit, emri i linjës dalëse TU, lloji i shtyllës, ndërmjetëse/ankerore ose ankerore fundore, numri i shtyllës. Etiketa duhet të jetë më sfond ngjyrë gri, korniza ngjyrë e gjelbër me trashësi 10 mm, me dimensione 210 x140 mm.
- Etiketa paralajmëruese e sigurimit teknik.
Mos pajisja e shtyllave më etiketat si më sipër është në kundërshtim me specifikimet teknike “Shtylla beton arme të centrifuguara”, pika 8.
*Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. K K.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar z. K K, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***Pretendimi i subjektit:***
*- Në lidhje me zërin prerje asfalti me disk, pretendohet se fillimisht është bërë prerja e asfaltit me qëllim realizimin e kanalit të kabullove dhe si pamundësi e bllokimit të rrugës, u lejua përdorimi i rrugës pa u sistemuar ende shtresat e fundit asfaltike, si pasojë u dëmtua asfalti në anën e kanalit të kabullove. Në momentin e kryerjes së asfaltimit anët e kanalit të kabullove u riprenë me qëllim plotësimin e kushteve teknike për riparimin e shtresave asfaltike, si rrjedhojë në këto segmente është kryer prerje 2 deri 4 herë. Theksohet se sasia e asfaltit e realizuar në terren është më e madhe se ajo e situacionuar. Pretendohet se dhe volumet e tjera janë realizuar më shume se sasitë e*

*certifikuara.*
*- Pretendohet se shtesa e hekurit është e justifikuar.*
*- Duke qenë se betonimi bëhet në dy faza të ndryshme sipas faktit ka patur raste (të cilat konsiderohen minore dhe nuk cënojnë integritetin e projektit dhe qëllimin e tij) që kanë krijuar diferenca midis dy pjesëve të betonit të bazamentit të shtyllave.*

**<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>**

Sqarojmë se në lidhje me punimet e prerjes së asfaltit, gërmim, shtresë çakulli etj., kemi të bëjmë me raportim të punimeve të pa realizuara pasi ato janë përfshirë në urë, ku nuk mund të kryhen punime të tilla (tubi me linjat përkatëse është inkastruar në shpatullat e urës).
Diferenca në sasinë e betonit është bazuar në krahasimin e volumeve të librezës së masave me matje në objekt, për rastet e konstatuara me diferencë.
Sasia e hekurit e përfshirë është e pa argumentuar.

**2. Mbi zbatimin e Kontratës "Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime".**

Kontrata "Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime", është nënshkruar me nr. 4/15 prot., datë 11.11.2020, me Kontraktorin "E"SHPK, me vlerë 120,072,887 lekë pa TVSH.
Kontrata përfshin punime për rikonstruksionin e linjave të tensionit të ulët për 23 kabina në zonën e Shtërmenit, Gostimës, Shtëpanjës, Floq etj.
Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 180 ditë, referuar datës së fillimit të punimeve.
Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur znj. A Xh, e cila është zëvendësuar nga z. V G.
Bashkia Cërrik, me shkresë nr. 3364 prot., datë 11.12.2020, ka dhënë konfirmimin për fillimin e punimeve si dhe përcaktimin e venddepozitimit të mbetjeve në hyrje të Fshatit Gjyral të Njësisë administrative Gostimë.
Procesverbali i fillimit të punimeve është mbajtur me datë 24.12.2020. Bazuar në ditarin e objektit, punimet kanë përfunduar me datë 18.06.2021, brenda afatit të parashikuar në termat e kontratës.
Procesverbali i përfundimit të punimeve është mbajtur me datë 18.06.2021.
Për përdorimin e fondit rezervë është dhënë miratimi nga OSSH me shkresë nr. 426/1 prot., datë 02.06.2021. Fondi rezervë është përdorur për furnizim vendosje shtylla të reja të pa parashikuara dhe zgjatim kabollash të cilat kanë rezultuar të nevojshme për tú vendosur nga rezultati në fak, në terren. Vlera e miratuar e fondit rezervë është 5,716,358 lekë.
Punimet kanë përfunduar me datë 18.06.2021. Bazuar në situacionin përfundimtar, vlera e punimeve është 144,059,077 lekë.
Për kolaudimin e punimeve është përzgjedhur z. N GJ, ndërsa komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. G B, z. A K dhe z. G H, është ngritur me Urdhrin e Titullarit AK z. A A me nr. 491/4 prot., datë 26.06.2021. Kolaudimi i punimeve është bërë me datë 25.06.2021, ndërsa certifikata e marrjes në dorëzim të punimeve është lëshuar me datë 09.07.2021.
Me datë 21.12.2022, me prezencën e mbikëqyrësit të punimeve z. V G, u verifikuan disa zëra punimesh në objekt, kryesisht për kabinat në zonën e Shtermen (Kabina 1, 2,6,8) dhe Gostimë (1,2,3). Nga verifikimi i punimeve rezultoi se nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i takon bazamentit të shtyllave prej betoni, si për shtyllat 9/6 kN, ashtu dhe për shtyllat 9/16 kN. Në disa raste të verifikuara shtresa e betonit ndërtohet sipas dimensioneve vetëm në sipërfaqe për trashësi afërsisht 30 cm, por në thellësi nuk respektohen dimensionet e përcaktuara në librezën e masave.
Për shtylla 9/6 kN, konsiderohet i realizuar seksioni 0.6 x 0.6 m (për thellësinë 1.3 m). Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 0.7 $m^3$.
Për shtylla 9/15 kN, është konsideruar i realizuar seksioni 0.8 x 0.8 (për thellësinë 1.7 m). Për shtyllat 9/15, rezulton se në shumicën e shtyllave, dimensioni i kokës së betonit të realizuar është

mesatarisht 1 x 1 m. Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 1.72 $m^3$.
Disa nga shtyllat e rezultuara me themele në kundërshtim me specifikimet teknike, paraqiten si më poshtë:





Nga përllogaritje të përafërta, rezulton se është certifikuar më shumë beton sipas tabelës së mëposhtme:

| **Kabina** | **Shtylla të reja 9/6 (copë)** | **Shtylla të reja 9/15 (copë)** | **Betoni i certifikuar ($m^3$)** | **Betoni i hedhur në fakt (1 x 0.7) + (2 x 1.72) ($m^3$)** | **Diferenca (4-5) ($m^3$)** |
|---|---|---|---|---|---|
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| Kabina Shtermen 1 | 26 | 29 | 94.75 | 68.08 | 26.67 |
| Kabina Shtermen 2 | 24 | 28 | 104.1 | 64.96 | 39.14 |
| Kabina Shtermen 6 | 22 | 10 | 47.8 | 32.6 | 15.2 |
| Kabina Shtermen 8 | 17 | 9 | 43.2 | 27.38 | 15.82 |
| Kabina Gostimë 1 | 12 | 15 | 55.4 | 34.2 | 21.2 |
| Kabina Gostimë 2 | 7 | 4 | 18.18 | 11.78 | 6.4 |
| Kabina Gostimë 3 | 13 | 7 | 32.9 | 21.14 | 11.76 |
| **Shuma:** | | | **396.3** | **260.14** | **136.19** |

Sa më sipër është certifikuar padrejtësisht shtresë beton1 në sasinë 136.19 $m^3$. ***Vlera 1,021,425 lekë*** (136.19 $m^3$ x 7,500 lekë/$m^3$), është përfituar më tepër nga Kontraktori "E" SHPK.

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. |
| **Situata 19:** | Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës "Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime", kryesisht për kabinat në zonën e Shtermen (Kabina 1, 2,6,8) dhe Gostimë (1,2,3), u konstatua se nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i takon bazamentit të shtyllave prej betoni, si për |

| | |
|---|---|
| | shtyllat 9/6 kN, ashtu dhe për shtyllat 9/16 kN. Në disa raste të verifikuara shtresa e betonit ndërtohet sipas dimensioneve vetëm në sipërfaqe për trashësi afërsisht 30 cm, por në thellësi nuk respektohen dimensionet e përcaktuara në librezën e masave.<br>Për shtylla 9/6 kN, konsiderohet i realizuar seksioni 0.6 x 0.6 m (për thellësinë 1.3 m). Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 0.7 $m^3$.<br>Për shtylla 9/15 kN, është konsideruar i realizuar seksioni 0.8 x 0.8 (për thellësinë 1.7 m). Për shtyllat 9/15, rezulton se në shumicën e shtyllave, dimensioni i kokës së betonit të realizuar është mesatarisht 1 x 1 m. Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 1.72 $m^3$.<br>Nga përllogaritjet rezulton se për këtë kontratë, është certifikuar më shumë sasia 136.2 $m^3$ beton me vlerë 1,021,425 lekë. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.<br>Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Certifikim i padrejtë i vlerës 1,021,425 lekë. |
| **Shkaku** | Gabim në përgatitjen e librezës së masave. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,021,425 lekë**, nga Kontraktori **"E" SHPK**, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

Në shtyllat e vendosura mungon:
- Etiketa e identifikimit të prodhuesit, në të cilën përcaktohen: Emri i prodhuesit, data, muaji dhe viti i prodhimit, numri i strukturës, gjatësia e shtyllës, kapaciteti (momenti) ne sipërfaqen e tokës, ose pika e fiksimit, logo e blerësit/OSHEE etj.
- Etiketa e identifikimit të shtyllës, në të cilën përcaktohen: Emri i pikës së transformimit, emri i linjës dalëse TU, lloji i shtyllës, ndërmjetëse/ankerore ose ankerore fundore, numri i shtyllës. Etiketa duhet të jetë më sfond ngjyrë gri, korniza ngjyrë e gjelbër me trashësi 10 mm, me dimensione 210 x140 mm.
- Etiketa paralajmëruese e sigurimit teknik.

Mos pajisja e shtyllave më etiketat si më sipër është në kundërshtim me specifikimet teknike "Shtylla beton arme të centrifuguara", pika 8.
*Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. V G.*

**3. Mbi zbatimin e kontratës "Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabine e re shtyllore".**

Kontrata "Rikonstruksion rrjeti TU me kabell ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabine e re shtyllore" është nënshkruar me BOE "V K & Sh I" SHPK, me vlerë 209,446,143.9 lekë. Kontrata është paraqshikuar të përfundojë 6 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit.
Kontrata përfshin punime në linja që lidhen me 40 kabina, në fshatrat e Qarkut të Elbasanit: Merhoj, Pajalli, Pepaj, Pokgjen, Shkozë, Soshkë, Stanaj, Shegas, Rrasë, Grekan, Gjolenë, Kajan,

Kosovë, Mamël, Petresh, Shënmëhill, Polis, Papër, Blate, Sop, Xibrakë dhe Gjyrale.
Sheshi i ndërtimit i është dorëzuar Kontraktorit sipas procesverbalit nr. 11090/3 prot., datë 13.12.2021. Për mbikëqyrjen e punimeve është emëruar znj. A Q.
Me informacionin e mbikëqyrësit të punimeve datë 17.01.2022, punimet kanë ecur normalisht. Bazuar në relacionin e monitoruesit të kontratës z. T Sh, të datës 07.06.2022, janë certifikuar dy situacione, të cilat përfshijnë punime të 29 kabinave nga 40 që janë parashikuar në preventiv.
Kërkesa për përdorimin e fondit rezervë është bërë me nr._datë 13.05.2022, bazuar në procesverbalin e mbajtur në këtë datë. Deri në këtë datë nuk është reflektuar në asnjë dokument nevoja e përdorimit të fondit rezervë, gjendja etj. Me datë 20.05.2022, është mbajtur procesverbali i miratimit të përdorimit të fondit rezervë. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Pika I.19, ku përcaktohet:

*"Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar,* ***dhe i raporton, periodikisht, investitorit për gjendjen e tij****. Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë".*

*Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve znj. A Q.*

Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me nr. 28 prot., datë 13.06.2022. situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 209,442,017.8 lekë.
Me Urdhër nr. 6459/1 prot., datë 05.07.2022 të Drejtorit OSSH z. P L, është caktuar për kolaudimin e punimeve z. G K.
Akti i Kolaudimit është mbajtur nga kolaudatori me datë 13.07.2022, nënshkruar dhe nga mbikëqyrësi i punimeve dhe kontraktori.
Procesverbali i marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve është mbajtur me datë 08.08.2022, nga komisioni i përbërë nga z. R C, z. K P dhe N R. Procesverbali është nënshkruar edhe nga kontraktori, mbikëqyrësi dhe kolaudatori i punimeve.
Me datë 10.11.2022, me prezencë të mbikëqyrësit të punimeve dhe administratorit të kontratës, u verifikuan disa zëra punimesh në linjat që lidhen me kabinat e fshatrave Kajan, Petresh, Kosovë dhe Grekan, përkatësisht për linjat e 10 kabinave.
Nga auditimi konstatohet se shtyllat e vendosura janë të reja pa defekte të dukshme. Ato janë të pajisura me aksesorët e domosdoshëm të parashikuara në preventiv si qafore, tirantues, konektorë izolues, kokë fundore, elektroda tokëzimi, shirit apo litar çeliku i zinkuar, kapikorda etj. Janë vendosur linja me kabull ABC me vetëmbajtje, në të gjithë gjatësinë, ashtu dhe koaksial për abonentët.
Pavarësisht nga sa më sipër, u konstatuan mangësi që kanë të bëjnë kryesisht me realizimin e specifikimeve teknike në lidhje me bazamentin e shtyllave, me material betoni.
Në zonën Petresh dhe Kosovë, 4 shtylla janë anuar, duke përbërë rrezik për rënien e tyre.
Në fshatrat e verifikuara rezulton se bazamenti është kryesisht dhera, por dhe zhavorishte, ndërkohë që parashikimi në projektpreventiv është vetëm për kategorinë argjilë e fortë. Kjo mund të ndikojë në qëndrueshmërinë e shtyllave, si pasojë e realizimit të bazamenteve jo në dimensionet përkatëse.
Në shtyllat e vendosura mungon:
- Etiketa e identifikimit të prodhuesit, në të cilën përcaktohen: Emri i prodhuesit, data, muaji dhe

viti i prodhimit, numri i strukturës, gjatësia e shtyllës, kapaciteti (momenti) ne sipërfaqen e tokës, ose pika e fiksimit, logo e blerësit/OSHEE etj.
- Etiketa e identifikimit të shtyllës, në të cilën përcaktohen: Emri i pikës së transformimit, emri i linjës dalëse TU, lloji i shtyllës, ndërmjetëse/ankerore ose ankerore fundore, numri i shtyllës. Etiketa duhet të jetë më sfond ngjyrë gri, korniza ngjyrë e gjelbër me trashësi 10 mm, me dimensione 210 x140 mm.
- Etiketa paralajmëruese e sigurimit teknik.
Mos pajisja e shtyllave më etiketat si më sipër është në kundërshtim me specifikimet teknike "Shtylla beton arme të centrifuguara", pika 8.
*Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve znj. A Q.*

| | |
|---|---|
| **Titulli i gjetjes:** | Mos plotësim i specifikimeve teknike. |
| **Situata 20:** | Në shtyllat e vendosura sipas kontratës "Rikonstruksion rrjeti TU me kabell ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabine e re shtyllore", por dhe kontrata të tjera mungon:<br>- Etiketa e identifikimit të prodhuesit, në të cilën përcaktohen: Emri i prodhuesit, data, muaji dhe viti i prodhimit, numri i strukturës, gjatësia e shtyllës, kapaciteti (momenti) ne sipërfaqen e tokës, ose pika e fiksimit, logo e blerësit/OSHEE etj.<br>- Etiketa e identifikimit të shtyllës, në të cilën përcaktohen: Emri i pikës së transformimit, emri i linjës dalëse TU, lloji i shtyllës, ndërmjetëse/ankerore ose ankerore fundore, numri i shtyllës. Etiketa duhet të jetë më sfond ngjyrë gri, korniza ngjyrë e gjelbër me trashësi 10 mm, me dimensione 210 x140 mm.<br>- Etiketa paralajmëruese e sigurimit teknik. |
| **Kriteri:** | Specifikimet teknike "Shtylla beton arme të centrifuguara", pika 8 |
| **Ndikimi:** | Vështirësi në identifikim si dhe mos paralajmërim rreziku. |
| **Shkaku** | Pjesë e spefikimeve teknike, por e pa reflektuar në preventiv. |
| **Rëndësia:** | I mesëm. |
| **Rekomandimi:** | OSSH, të marrë masa që për projektet e realizuara, në proces apo në vazhdimësi, të parashikojë dhe kërkojë vendosjen e etiketave të identifikimit të prodhuesit, identifikimit të shtyllës dhe etiketës paralajmëruese të sigurimit teknike, në të gjitha shtyllat si betonarme, ashtu metalike apo material tjetër. |

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar znj. A Q, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230/20 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***<u>Pretendimi i subjektit:</u>***
*Shtyllat e anuara ndodhen anash rrugëve rurale, anim i cili ka ardhur nga faktor të jashtëm.*
*Sa i përket etiketave të prodhuesit, identifikimit dhe paralajmëruese, nga ana e kontraktorit janë paraqitur certifikatat e origjinës, testimit, katalogë etj.*
*Theksohet se për mangësitë e konstatuara do t'i kërkohet kontraktorit marrja e masave, duke qenë se objekti është në periudhën e riparimit të defekteve.*

**<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit:</u>**
Sa i takon etiketave të shtyllave, ato janë detyrim i specifikimeve teknike për t'u vendosur për çdo shtyllë. Gjithsesi, ato nuk janë përfshirë në preventivin përkatës.

**4. Mbi zbatimin e Kontratës "Blerje bokse individuale dhe aksesorë për sistemin e matjes".**

Kontrata e furnizimit është nënshkruar me nr. 877/22 prot., datë 26.03.2021, me ndërmjet OSSH Dega Fier, përfaqësuar nga z. A F dhe Kontraktorit bashkimin e OE "C & N E P", me vlerë 211,620,000 lekë me TVSH. Afati i përfundimtar i dorëzimit të materialeve është përcaktuar 90 ditë, referuar datës së nënshkrimit të kontratës.
Komisioni i kolauditimi dhe marrjes në dorëzim të materialeve është ngritur me Urdhër të Titullarit të AK z. A F, me nr. 877/24 prot., datë 30.03.2021, me përbërje znj. M G(shefe sektori), z. Xh H (asistent teknik) dhe z. E T (specialist faturimi). Për administrimin e kontratës është caktuar z. R.K.Nga verifikimi i dokumentacionit si fatura, akte kolaudimi dhe marrje në dorëzim, fletë-hyrje etj., furnizimi është bërë në periudhën e parashikuar në kontratë.

| **Titulli i gjetjes:** | Blerje e pa argumentuar. |
|---|---|
| **Situata 21:** | Nga zbatimi i kontratës "Blerje bokse individuale dhe aksesorë për sistemin e matjes", rezulton se megjithëse ka kaluar një periudhë e konsiderueshme afro 3 vite nga realizimi i furnizimit, një pjesë e konsiderueshme e materialeve nuk janë vënë në përdorim.<br>Vlera e materialeve të pa vëna në përdorim është në shumën 67,781,800 lekë, ose 38 % e vlerës së kontratës. Nëse u referohemi zërave të veçantë, boxet për matësit 3 fazorë janë vënë shumë pak në përdorim, nga 13550 copë të blerë, janë vendosur 5120 copë, ose 37 % e sasisë. Theksojmë faktin se, boxet e blera nuk janë vënë në përdorim vetëm në rajonin e Fierit, por edhe në rajone të tjera, të cilat kanë patur nevojë, nëpërmjet transferimit.<br>Sa më sipër arrihet në konkluzionin se:<br>- Nuk janë bërë parashikime të sakta në lidhje me nevojën për materiale, duke krijuar stok të pa nevojshëm (mallra me qarkullim të ngadaltë), sidomos sa i takon bokseve për matës 3 fazorë.<br>- Blerja e materialeve në sasi të konsiderueshme, të cilat nuk futen në përdorim përbën shpenzime pa efektivitet, pasi fondet e shpenzuara mund të përdoreshin për investime sidomos në përmirësimin e rrjetit të transmetimit, e cila shoqërohet me ulje të humbjeve teknike dhe rrjedhimisht rritje të të ardhurave të shoqërisë. |
| **Kriteri:** | Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", (i ndryshuar), pika 18. |
| **Ndikimi:** | Është krijuar stok i pa nevojshëm. |
| **Shkaku** | Mos parashikimi i saktë i nevojave për materiale. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të planifikojë në mënyrë sa më të saktë nevojat për blerjen e materialeve, në mënyrë që të shmanget blerja përtej nevojave, duke krijuar stok dhe qarkullim të ngadaltë të tyre. |

| **Titulli i gjetjes:** | Furnizim i materialeve pa respektimin e specifikimeve teknike. |
|---|---|
| **Situata 22:** | Nga verifikimi i materialeve të furnizuara sipas kontratës “Blerje bokse individuale dhe aksesorë për sistemin e matjes”, rezulton se sipas zërit 1 “Bokse individual të integruar për matës statik 1 fazor me automat 1 P 230 V 25 A, pa matës”, bokset janë dorëzuar pa asnjë shenjë dalluese të prodhuesit, të ndonjë specifikimi të llojit apo specifikim tjetër. Po ashtu, bazamenti i boxeve ishte transparent, nga ku vërtetohet që bazamenti nuk është i përforcuar me fibra xhami, pasi është i njëjti material me kapakun. Në amballazhin e boxeve është paraqitur se boxet plotësojnë standardin IP 41-54, ndërkohë që standardi i kërkuar është jo më i vogël se 54. Mbulesa e përparme është përcaktuar me copë litari me shkumë poliuratani, ndërkohë që në specifikime teknike përcaktohet që *kapaku do të jetë transparent, i pathyeshëm, rezistente ndaj temperaturës së lartë dhe rrezeve ultraviolet (UV), si dhe i bërë nga polikarbonat rezistent*”. Vendosja e diapazonit nga 41 deri 54, nuk garanton në çdo rast specifikimin e kërkuar. Sa i takon bokseve për matës 3 fazorë, boksi ka të stampuar vetëm markën “YAVUZ” dhe në amballazh nuk ka të përcaktuar asnjë specifikim teknik. |
| **Kriteri:** | -Specifikimet teknike, Pika 7.<br>-Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, (i ndryshuar) pikat 45, 46, 47. |
| **Ndikimi:** | Furnizim i materialeve pa cilësinë e kërkuar, nuk jepet garanci për jetëgjatësinë e materialit. |
| **Shkaku** | Mos verifikimi me korrektësi gatë marrjes në dorëzim të produkteve. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të marrë masa që për kontrata në vazhdimësi të verifikojë me korrektësi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të materialeve të furnizuara me ato të parashikuara në procedurat e prokurimit, me qëllim garantimin e cilësisë së materialeve dhe jetëgjatësinë e tyre. |

*Ngarkohet me përgjegjësi komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga znj. M G, z. Xh H dhe z. E T.*

Më poshtë paraqiten foto të materialeve, gjendje në magazinë.

Bokse për matës 1 fazorë.








Bokse për matës 3 fazorë.





*Komisioni i marrjes në dorëzim i përbërë nga znj. M G, z. Xh H dhe z. E T.*
Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar z. Xh H, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230/22 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***Pretendimi i subjektit:***
*Në trupin e boxit është markuar emri i prodhuesit.*
*Bazamenti i poshtëm është i përbërë nga fibër xhami, sipas deklaratës së konformitetit dhe test raporteve të paraqitura nga blerësi.*
*Në specifikimet teknike dhe dokumente tenderi nuk është kërkuar në asnjë moment që mallrat të kenë të markuar të dhëna teknike.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**
Sqarojmë se në specifikime teknike është kërkuar që bazamenti të jetë i përforcuar me fibra xhami, ngjyrë gri. Bazamentet për të dy llojet e boxeve ishin transparent. Merret pjesërisht në konsideratë fakti se në dokumentet shoqëruese të materialeve paraqiten specifikimet përkatëse.

**5. Mbi zbatimin e Kontratës "Zgjatim i fiderit 12 me kabina dhe rrjet të ri TU, nënstacioni 110/20 Sallmone, Lot I".**

Kontrata "Zgjatim i fiderit 12 me kabina dhe rrjet të ri TU, nënstacioni 110/20 Sallmone, Lot I", është nënshkruar me nr. 219/9 prot., datë 01.06.2021, ndërmjet OSSH Rajoni Durrës përfaqësuar nga z. P M dhe BOE "E P SHPK dhe A I G C SHPK", përfaqësuar nga z. T B dhe z. A A, me vlerë 131,022,407 lekë pa TVSH, ose 157,226,407 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 6 muaj, referuar datës së fillimit të punimeve. Bazuar në Urdhrin nr. 219/11 prot., datë 27.08.2021, për mbikëqyrjen e punimeve është caktuar z. Z.Dh, ndërsa admnistrator kontrate është caktuar z. I L.

Njoftimi i fillimit të punimeve është protokolluar me nr. 219/12, datë 13.09.2021. Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit dhe akti i piketimit të objektit, janë mbajtur me datë 13.09.2021.

Janë certifikuar 7 situacione pjesore, përfshirë situacionin përfundimtar. Vlera e situacionit përfundimtar është 130,940,806 lekë pa TVSH, ose 157,128,967 lekë me TVSH.

Gjatë zbatimit të kontratës janë konstatuar diferenca të zërave të punimeve me zbritje dhe shtesa. Kontraktori me shkresë nr. 10/10 prot., ka kërkuar miratimin për saktësimin e volumeve.

Procesverbali i përfundimit të punimeve dhe njoftimi përkatës janë bërë me datë 11.03.2022. Bazuar në ditarin e punimeve, njoftimin e fillimit dhe përfundimit, punimet kanë përfunduar brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Kolaudimi i punimeve sipas kontratës është bërë nga z. T. D. me datë 31.03.2022, caktuar me Urdhër të Titullarit të AK nr. 219/31 prot., datë 17.03.2022. punimet janë marrë në dorëzim nga grupi i përbërë nga z. I L, z. A B dhe z. Y M, ngritur me Urdhrin e titullarit të AK nr. 219/33 prot., datë 04.04.2022.

Mbi verifikimin e disa zërave të punimeve në objekt.

U verifikuan disa zëra të punimeve në objekt, sa i takon shtrimit të linjës kabllore nëntokësore 20 kV. Nga auditimi u konstatuan diferenca në realizimin e shtresave asfaltike si më poshtë:

| Zëri i punimeve | Përshkrimi i punimeve | Njësia | Sasia e certifikuar | Sasia e realizuar | Çmimi lekë | Vlera lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| B.2.1 | Prerje asfalti me disk | Ml | 1620 | 410 | 244 | 295,240 |
| B.2.10 | Shtresë stabilizant 10 cm | $m^2$ | 512.12 | 287 | 468 | 105,356 |
| B.2.11 | Shtresë binder 7 cm, me makineri | " | 512.12 | 287 | 1,899 | 427,502 |
| B.2.12 | Shtresë asfaltobetoni, 3 cm ... | " | 520.38 | 287 | 1,101 | 256,951 |
| | | | | | | 1,085,049 |

| **Titulli i gjetjes:** | Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. |
|---|---|
| **Situata 23:** | Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratës "Zgjatim i fiderit 12 me kabina dhe rrjet të ri TU, nënstacioni 110/20 Sallmone, Lot I" u konstatuan mangësitë si më poshtë:<br>-Në situacionin nr. 7, II "Rrjeti ajror 20 kV me shtylla betoni", sipas zërit B 5 "Punime montimi" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 18.74 $m^3$ me çmim 8,308 lekë/$m^3$. Po për bazamentet e shtyllave është certifikuar sipas zërit B 6 "Punime civile" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) sasia 12.74 $m^3$, me çmim 8,392 lekë/$m^3$, pa detajim dhe përcaktim përmasash. Sasia 12.74 $m^3$, me vlerë 106,914 lekë (12.74 $m^3$ x 8,392 lekë/$m^3$, është certifikuar padrejtësisht për punime të pa realizuara.<br>-Në situacionin 7, I "Rrjeti ajror 20 kV me shtylla betoni", sipas zërit B 5 |

| | |
|---|---|
| | "Punime montimi" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 139 $m^3$ me çmim 8,309 lekë/$m^3$. Sipas këtij zëri, në librezën e masave është përllogaritur sasia 232 $m^3$. Në situacionin 7,I, zëri B 6 "Punime civile" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 93.7 $m^3$ me Çmim 8,474 lekë/$m^3$. Për të njëjtin zë punimesh janë certifikuar sasi në dy raste. Sasia 93.7 $m^3$ me vlerë 794,013 lekë (93.7 $m^3$ x 8,474 lekë/$m^3$), është certifikuar padrejtësisht. Po ashtu sasia 93 $m^3$ (232 $m^3$ – 139 $m^3$), duhet të përfshihej në situacion me diferencë në vlerë 13,345 lekë [93 $m^3$ (8,474 – 8,309)]. Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit BOE "E P SHPK dhe A I G CSHPK", është përfituar më tepër ***vlera 916,272 lekë*** (106,914 lekë + 794,013 lëkë + 13,345 lekë).<br>Sipas situacionit nr. 7 dhe përfundimtar, janë certifikuar volumet e shtresave asfaltike volumi i të cilave nuk përputhet me atë të realizuar në fakt. Këto shtresa janë paraqitur në librezën e masave nga piketa 3 deri piketë 4, në distancë 802 m dhe gjerësi 0.8 m. Në fakt gjatësia e realizuar është 410 m, me gjerësi mesatare 0.7 m, kjo për faktin se një pjesë e linjës është shtruar në bankinë dhe jo në trupin e rrugës. Për pjesën e realizuar në trupin e rrugës, prerja e asfaltit është bërë vetëm në një anë. Është certifikuar më shumë "Prerje asfalt me disk" me vlerë 295,240 lekë, "Shtresë stabilizant" me vlerë 105,356 lekë, "Shtresë binderi" me vlerë 427,502 lekë dhe "Shtresë asfaltobetoni me vlerë 256,951 lekë.<br>Nga verifikimi i punimeve për realizimin e linjave të tensionit të mesëm ajor dhe tensionit të ulët, rezultuan mangësi në lidhje me realizimin e bazamentit të shtyllave. Sa i takon linjës së tensionit të mesëm u konstatua së në 30 shtylla betoni i bazamentit nuk është vendosur sipas secifikimeve, me një diferencë prej afërsisht 1 $m^3$ beton për shtyllë, në total 30 $m^3$ beton të certifikuar më tepër. Po ashtu në linjat e tensionit të ulët u konstatuan mangësi në realizimin e bazamentit të shtyllave për 35 shtylla, me një diferencë afërsisht 0.9 $m^3$ beton për shtyllë, në total 31.5 $m^3$ beton të certifikuar më tepër. Vlera 510,634 lekë [(30 $m^3$ + 31.5 $m^3$) x 8,303 lekë/$m^3$] është përfituar më tepër nga BOE "E P SHPK dhe A I G CSHPK". |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.<br>Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Certifikim i padrejtë i vlerës ***2,511,955 lekë.*** |
| **Shkaku** | Gabim në përgatitjen e librezës së masave. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **2,511,955 lekë**, nga Kontraktori **"**BOE "E P SHPK dhe A I G CSHPK", për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

*Për sa më sipër, ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve z. Z Dh.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar z. Z Dh,

është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230/8 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***Pretendimi i subjektit:***

*-Pretendohet se sasia e betonit C 16/20 që është përdorur faktikisht për bazamentet e shtyllave 12/6 kN dhe 12/15 kN është 232 m$^3$, e njëjtë me sasinë e betonit të certifikuar në dy modulet nr. 7 I "Rrjeti ajror 20 kV me shtylla betoni", sipas zërit B 5 "Punime montimi" dhe në zërin B 6 "Punime civile".*

*-Në lidhje me punimet e prerjes së asfaltit pretendohet se është bërë nga dy herë deri 4 herë si pasojë e mos ndërprerjes së punimeve.*

*Për shtresat asfaltike pretendohet se janë realizuar në pjesën e kanalit me trashësi 14 cm, për përforcim.*

*Për sasinë e betonit, është përdoruar i njëjti argument si në observacione për kontrata të tjera, ku realizimi i themeleve realizohet në dy faza.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Sqarojmë se rezultatet e grupit të auditimit bazohen në krahasimin e librezës së masave, vizatimeve përfundimtar me faktin në terren. Sa i përket betonit, kemi të bëjmë me dublim volumesh.

Sa i përket shtresave asfaltike, në segmentin nga piketa 3 deri në 4, është përshkruar distanca e realizuar 802 ml, ndërkohë që kjo distancë është 410 m.

I gjithë pretendimi bazohet në argumente të cilat nuk janë pjesë e dokumentacionit teknik, si realizimi i shtresës së asfaltobetonit nga 7 cm në 14 cm etj.

**6. Mbi zbatimin e Kontratës "Rikonstruksion i rrjetit TM dhe TU në lagjet 4, 5 dhe 6, Bashkia Kukës".**

Kontrata e punimeve civile "Rikonstruksion i rrjetit TM dhe TU në lagjet 4, 5 dhe 6, Bashkia Kukës", është nënshkruar me nr. 233/14 prot., datë 24.05.2021, ndërmjhet OSSH Rajoni Kukës përfaqësuar nga z. A H dhe "M" SHPK, përfaqësuar nga z. M L, me vlerë 58,320,240 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 2 muaj, referuar datës së dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Për mbikëqyrjen e punimeve është caktuar z. A Gj.

Akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit është mbajtur me datë 31.05.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë po me këtë datë.

Punimet kanë vazhduar deri me datë 03.07.2021, datë në të cilën është njoftuar pezullim punimesh nga Bashkia Kukës, deri në njoftim të dytë. Rifillimi i punimeve në objekt referuar ditarit përkatës është bërë me datë 27.12.2021. Përfundimi i punimeve është njoftuar me datë 22.01.2022. Kërkesa e pezullimit të punimeve ka të bëjë me punimet që kryheshin po në këtë zonë (Lagje 4, 5 dhe 6), me investim nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rikonstruksion si të infrastrukturës ashtu dhe fasadave të pallateve. Theksojmë se kontratën përkatëse e ka zbatuar i njëjti OE.

Librezat e masave janë hartuar vetëm me volumet dhe jo me detajet nga kanë dalë këto volume, nga i cili nuk mund të përcaktohet saktësia e volumeve, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4, ku përcaktohet:

*"Libri i masave mbahet për çdo objekt e nënobjekt, që ka preventiv dhe është dokument bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve, të kontratës dhe situacioneve. Në të pasqyrohen vëllimet metrike të punimeve, gradualisht me zhvillimin e tyre".*

Referuar librezës së masave e cila nuk është e detajuar është krijuar paqartësi në lidhje me raportimin e volumit të punimeve, pasi në të dy kontratat janë përcaktuar realizim trotuare. Me datë 02 dhe 03.02.2023, në objektin përkatës, me prezencën e mbikëqyrësit të punimeve z. A Gj u verifikuan disa zëra të punimeve kryesisht të dukshme, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e pusetave, lidhjet e kabullove në to, zgjatimi në kabinat përkatëse, realizimin e punimeve sipërfaqësore si trotuare etj. Nga verifikimi nuk u konstatuan mangësi, përjashtuar realizimit të trotuareve me pllaka betoni si dhe shtresave asfaltike në shpërndarjen e linjave të tensionit të ulët në territorin brenda lagjeve (Linjat e TM shtrihen jashtë zonës së kontratës me FSHZH). Në librezë masash, sa i takon realizimit të linjave të tensionit të ulët, sasitë e trotuarit dhe shtresës së binderit sipas piketave përkatëse, paraqiten si më poshtë:

| Kabina | Trotuar ($m^2$) Pllaka të reja | Trotuar me pllaka ekzistuese | Shtresë binderi 7 cm $m^2$ |
|---|---|---|---|
| Kabina nr. 9 | 170 | 60 | 17 |
| Kabina nr. 8 | 40 | 5 | 5 |
| Kabina nr. 17 | 130 | 20 | 20 |
| Kabina nr. 18 | 130 | 20 | 20 |
| Kabina nr. 13 | 120 | 20 | 20 |
| Kabina nr. 14 | 40 | 20 | 4.5 |
| Kabina nr. 15 | 60 | 20 | 4.5 |
| Kabina nr. 16 | 170 | 20 | 13 |

Sa më sipër, në librezë masash është përfshirë sasia 860 $m^2$ trotuar me pllaka betoni (çmimi 1,490 lekë/$m^2$) dhe 185 $m^2$ trotuar me pllaka ekzistuese (çmimi 900 lekë/$m^2$). Po ashtu është përfshirë sasia 103 $m^2$ shtresë binderi (çmimi 1,450 lekë/$m^2$). Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve pretendohet se nga ana e Kontraktorit janë realizuar punime për shtrim me pllaka betoni anash rrugës kryesore ku ndodhen kabinat K. Telekom, K. 13, K. 14, K. 15, K.12. Nga verifikimi rezulton trotuar me pllaka i realizuar, por nuk mund të vërtetohet nëse është realizuar në kuadër të kësaj kontrate.
Nëse për trotuaret nevojitet një rakordim me punimet e realizuara nëpërmjet kontratës me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në lidhje me sasinë e binderit, ato nuk rezultojnë të kryera, pasi nuk ka qenë i nevojshëm prishja dhe rindërtimi i tyre, në kuadrin e rikonstruksionit të plotë të infrastrukturës. Vlera 149,350 lekë (103 $m^2$ x 1,450 lekë/$m^2$), është përfituar më tepër nga Kontraktori "M" SHPK. *Ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i Punimeve z. A Gj.*
Certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim është lëshuar me nr. 233/34 prot., datë 07.03.2022, nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga z. E B, z. A S dhe z. F C.
Akti i kolauditimit është hartuar me datë 23.02.2022, nga kolaudatori i punimeve z. E M.
Dokumentacioni i dosjes teknike të kësaj kontrate nuk është mbajtur në mënyrë korrekte, sidomos sa i takon përllogaritjes së volumeve në librezën e masave. Në territorin e zbatimit të kontratës janë realizuar njëkohësisht dy kontrata nga i njëjti kontraktor dhe nuk ka një rakordim të saktë të volumeve të realizuara sidomos sa i takon punimeve sipërfaqësore (shtesa trotuare, shtresa asfaltike). Gjithsesi rakordimi për të realizuar njëkohësisht punimet e linjave elektrike paralel me infrastrukturën konsiderohet e domosdoshme për të shmangur ndërhyrjet dhe dëmtimin e infrastrukturës së lagjeve në të ardhmen, në raste defektesh apo gjenerimesh të linjave elektrike.

| Titulli i gjetjes: | Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. |
|---|---|
| **Situata 24:** | Librezat e masave sipas kontratës "Rikonstruksion i rrjetit TM dhe TU në lagjet 4, 5 dhe 6, Bashkia Kukës", janë hartuar vetëm me volumet dhe jo me detajet nga kanë dalë këto volume, nga i cili nuk mund të përcaktohet saktësia e volumeve. Krahas këtij investimi po në këtë lagje është realizuar investim edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rikonstruksion si të infrastrukturës ashtu dhe fasadave të pallateve. Theksojmë se kontratat sipas dy investimeve janë realizuar nga i njëjti kontraktor. Nuk ka një ndarje të qartë të investimeve të realizuara nëpërmjet dy kontratave sa i takon kryesisht punimeve për shtresa rrugore apo trotuare.<br>Nëse për trotuaret nevojitet një rakordim me punimet e realizuara nëpërmjet kontratës me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në lidhje me sasinë e binderit, ato nuk rezultojnë të kryera, pasi nuk ka qenë i nevojshëm prishja dhe rindërtimi i tyre, në kuadrin e rikonstruksionit të plotë të infrastrukturës. ***Vlera 149,350 lekë (103 m$^2$ x 1,450 lekë/m$^2$), është përfituar më tepër nga Kontraktori "M" SHPK.*** |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.<br>Udhëzimin i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Certifikim i padrejtë i vlerës 149,350 lekë**.** |
| **Shkaku** | Gabim në përgatitjen e librezës së masave. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **149,350 lekë**, nga Kontraktori "M" SHPK, për punime të certifikuara por të pa realizuara.<br>1.2. OSHEE, të kërkojë bashkëpunim me Fondin Shqiptar i Zhvillimit, në lidhje me investimin e realizuar nga ana e tyre, duke bërë rakordimet përkatëse të volumeve të realizuara nga dy kontratat dhe zbritjen e vlerës, për punime të cilat mund të jenë raportuar të realizuara në të dy kontratat. |

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**
*Mbikëqyrësi i punimeve z. A Gj.*

**7. Mbi zbatimin e Kontratës "Ndërtim i rrjetit TM 20 kV, Fideri F 6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/Stacioni i Lalëzit".**

Kontrata e punimeve civile "Ndërtim i rrjetit TM 20 kV, Fideri F 6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/Stacioni i Lalëzit", është nënshkruar me nr. 3162/14 prot., datë 05.01.2021, me Kontraktor BOE "K K & E" SHPK, me vlerë 155,313,423 lekë pa TVSH, ose 186,376,108 lekë me TVSH.

Kontrata ka të bëjë me punime për linjat e tensionit të mesëm fideri 6, ndërtimin e 10 kabinave elektrike parafabrikat dhe linjat e tensionit të ulët përkatëse. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur z. A A. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 4 muaj, referuar datës së dorëzimit të sheshit të ndërtimit.

Bazuar në njoftimet dhe ditarin përkatës, punimet kanë filluar me datë 05.01.2021 dhe kanë

përfunduar me datë 05.05.2021, brenda afatit të parashikuar në kontratë.
Gjatë zbatimit të kontratës janë certifikuar 4 situacione pjesore si më poshtë:
Situacioni nr. 1, me vlerë 44,436,113 lekë.
Situacioni nr. 2, me vlerë 37,175,422 lekë.
Situacioni nr. 3, me vlerë 32,355,024 lekë.
Situacioni nr. 4, me vlerë 35,172,859 lekë.
Fondi rezervë me vlerë 6,174,005 lekë.
Kërkesa për përdorimin e fondit rezervë është bërë me shkresë nr. 3162/27 prot., datë 31.03.2021. Përdorimi i këtij fondi ka të bëjë me punime me shtesa dhe pakësime në disa zëra punimesh, sipas gjendjes faktike të rezultuar gjatë realizimit të punimeve.

Me datë 09.01.2023, me prezencën e administratorit të kontratës z. I L, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt.
Sa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Në këto themele kryesisht ndërtohet shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendi. Në disa shtylla është konstatuar se janë vendosur tombino betoni, të cilat nuk janë urdhëruar, apo miratuar për vendosje. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, shtyllat kanë pësuar devijim dhe rrezikojnë rënien e tyre, duke shkaktuar dëme jo vetëm për shtyllën përkatëse, por dhe të tjerat, si pasojë e forcës së tërheqjes së kabullove të vendosur në to.
Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për disa shtylla 9/15 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.72 $m^2$, ndërkohë që është certifikuar sasia 2.59 $m^3$, me një diferencë 1.12 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për disa shtylla 9/6 kN, sasia e realizuar afërsisht për shtyllë është 0.56 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 1 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë 0.44 $m^3$ për shtyllë të verifikuar.

| Linja | Bazamente jo sipas spec. shtylla | Diferenca e betonit (nr. Sht. x 0.44 $m^3$) | Bazamente jo sipas spec. shtylla | Diferenca e betonit (nr. Sht. x 1.12 $m^3$) |
|---|---|---|---|---|
| Kabina “F/6/26/B/2” | 6 | 2.6 | 3 | 3.36 |
| Kabina “F/6/27/R/4” | 7 | 3 | 4 | 4.48 |
| Kabina “F/6/28/R/1” | 7 | 3 | 3 | 3.36 |
| Kabina “F/6/29/B/2” | 3 | 1.3 | 3 | 3.36 |
| Shuma: | 23 | **10** | 13 | **14.6** |

Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 24.6 $m^3$ (10 + 14.6). ***Vlera 196,800 lekë (24.6 $m^3$ x 8,000 lekë/$m^3$), është përfituar më tepër nga Kontraktori BOE “K K & E” SHPK.***

| Titulli i gjetjes: | Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. |
|---|---|
| **Situata 25:** | Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës Ndërtim i rrjetit TM 20 kV, Fideri F 6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/Stacioni i Lalëzit", sa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Në këto themele kryesisht ndërtohet shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendi. Në disa shtylla është konstatuar se janë vendosur tombino betoni, të cilat nuk janë urdhëruar, apo miratuar për vendosje. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, shtyllat kanë pësuar devijim dhe rrezikojnë rënien e tyre, duke shkaktuar dëme jo vetëm për shtyllën përkatëse, por dhe të tjerat, si pasojë e forcës së tërheqjes së kabullove të vendosur në to.<br>Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për disa shtylla 9/15 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.72 $m^2$, ndërkohë që është certifikuar sasia 2.59 $m^3$, me një diferencë 1.12 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për disa shtylla 9/6 kN, sasia e realizuar afërsisht për shtyllë është 0.56 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 1 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë 0.44 $m^3$ për shtyllë të verifikuar.<br>Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 24.6 $m^3$ (10 + 14.6), me vlerë 196,800 lekë (24.6 $m^3$ x 8,000 lekë/$m^3$), është përfituar më tepër nga Kontraktori BOE "K K & E" SHPK. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.<br>Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Certifikim i padrejtë i vlerës 196,800 lekë**.** |
| **Shkaku** | Gabim në përgatitjen e librezës së masave. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **196,800 lekë**, nga Kontraktori ***BOE "K K & E" SHPK***, për punime të certifikuara por të pa realizuara. |

*Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve znj. A A.*

**8. Mbi zbatimin e Kontratës "Rikonstruksion i rrjetit TU dhe kabinave Tresh 7, Zejmen 7, Spiten 2, Ded Alija, Pllanë 2, Gajush 3, Gjush 1, Markatomaj 9, Markatomaj 3, Markatomaj 2, Fideri 10 Zejmen, N/Stacioni Lezhë".**

Kontrata "Rikonstruksion i rrjetit TU dhe kabinave Tresh 7, Zejmen 7, Spiten 2, Ded Alija, Pllanë 2, Gajush 3, Gjush 1, Markatomaj 9, Markatomaj 3, Markatomaj 2, Fideri 10 Zejmen, N/Stacioni Lezhë", është nënshkruar me nr. 9106/6 prot., datë 12.11.2020, ndërmjet Drejtorisë Rajonale të OSSH Shkodër, përfaqësuar nga Drejtori z. A Zh dhe Kontraktorit BOE "P SHPK & N SHPK", me vlerë 70,950,215 lekë me TVSH. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 110 ditë, referuar datës së hyrjes në kantier. Për mbikëqyrjen e punimeve është caktuar znj. F D. Për

administrimin e kontratës është caktuar z. K K.
Nga auditimi i dosjes teknike rezulton se gjatë zbatimit, është nevojitur shtesë në disa zëra punimesh, kryesisht furnizim vendosje kabullo. Punimet shtesë janë miratuar rast pas rasti, sipas azhurnimeve në terren. Vlera e preventivuar e punimeve shtesë është 3,305,484 lekë me TVSH, vlerë e përfshirë në fondin rezervë.
Libreza e masave është hartuar me mangësi, sa i përket dimensioneve të themeleve të shtyllave me material betoni C 16/20. Përmasat e përcaktuara nuk përcaktojnë dimensionet për një shtyllë dhe herësin për numrin e shtyllave por një gjatësi e përgjithshme, duke fiksuar të palëvizshëm gjerësinë 0.5 m dhe thellësinë 1.7 m. Nga përllogaritjet e bëra nga grupi i auditimit, rezulton se dimensionet e bazamentit për shtyllë janë 1.2 m x 1.2 m x 1.7 m, për gjashtë kabina dhe gjerësi 1.1 m x 1 m x 1.7 m, për 5 kabinat e tjera.
Dorëzimi i kantierit është bërë me datë 04.01.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve është bërë me shkresë nr. 2106/1 prot., datë 04.01.2021. Bazuar në ditarin e punimeve, punimet kanë përfunduar me datë 23.04.2021, brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Situacioni përfundimtar është certifikuar me vlerë 70,846,547 lekë me TVSH. Kolaudimi i punimeve është bërë nga Kolaudatori z. A. H., me akt të protokolluar me nr. 2106/51 prot., datë 07.06.2021. Certifikata e marrjes më dorëzim të përkohshëm të punimeve është lëshuar me nr. 2106/53 prot., datë 10.06.2021, nga komisioni i përbërë nga z. Gj J, z. Gj B dhe z. A T.

Mbi verifikimin e disa zërave të punimeve në objekt.
Me datë 21.02.2023, me prezencën e mbikëqyrësit të punimeve u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt. Nga verifikimi në përgjithësi konstatohet se punimet janë realizuar me cilësi dhe në sasi kryesisht sa i takon furnizimit dhe vendosjes së shtyllave beton arme, vendosjes së kabullove ABC në shtyllat përkatëse etj., por u konstatuan mangësi në lidhje me sasinë e betonit C 16/20 të vendosur në fakt, krahasuar me atë të përshkruar në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar. Verifikimi i punimeve u përqendrua në kabinat “Markatomaj 2”, “Markatomaj 4”, “Zejmen 7” dhe “Tresh 7”. Nga bazamentet e verifikuara rezulton se janë realizuar me përmasa mesatare 0.9 m x 0.9 m, duke konsideruar thellësinë 1.7 m të njëjtë me atë të certifikuar, ose në sasinë 1.38 $m^3$.
Diferenca e volumeve të betonit C 16/20 për bazamentet e shtyllave, paraqitet në tabelën si më poshtë:

| Kabina | Shtyll. të verifikuara copë | Sasia e certifikuar $m^3$ | Sasia e realizuar nr. Sht. x 1.38 $m^3$ | Diferenca $m^3$ |
|---|---|---|---|---|
| Markatomaj 2 | 30 | 56.1 | 41.4 | 14.7 |
| Markatomaj 4 | 16 | 27.2 | 22 | 5.2 |
| Zejmen 7 | 18 | 44 | 24.8 | 19.2 |
| Tresh 7 | 22 | 53.8 | 30.3 | 23.5 |
| Shuma: | | | | 62.6 |

Sa më sipër***, vlera 532,600 lekë (62.6 $m^3$ x 8,508 lekë/$m^3$),*** është përfituar më tepër nga Kontraktori “P SHPK & N SHPK”**.**

| **Titulli i gjetjes:** | Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. |
|---|---|
| **Situata 26:** | Nga verifikimi i punimeve në objekt u konstatuan mangësi në lidhje me sasinë e betonit C 16/20 të vendosur në fakt, krahasuar me atë të përshkruar në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar. Verfifikimi i punimeve u përqendrua në kabinat “Markatomaj 2”, “Markatomaj 4”, “Zejmen 7” dhe |

| | |
|---|---|
| | "Tresh 7". Nga bazamentet e verifikuara rezulton se janë realizuar me përmasa mesatare 0.9 m x 0.9 m, duke konsideruar thellësinë 1.7 m të njëjtë me atë të certifikuar, ose në sasinë 1.38 $m^3$. Nga përllogaritjet rezulton se është certifikuar më tepër sasia 62.6 $m^3$ beton, me vlerë 532,600 lekë. |
| **Kriteri:** | Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.<br>Udhëzimi i KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Certifikim i padrejtë i vlerës 532,600 lekë**.** |
| **Shkaku** | Gabim në përgatitjen e librezës së masave. |
| **Rëndësia:** | E mesme. |
| **Rekomandimi:** | 1.1. OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **532,600 lekë**, nga Kontraktori **BOE "P SHPK & N SHPK",** për punime të certifikuara por të pa realizuara. |

*Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve znj. F D.*

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projektraportit të Auditimit, nga subjekti i audituar znj. F D, është paraqitur observacioni me shkresë nr. 4230/3 prot., datë 30.05.2023, protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

***Pretendimi i subjektit:***

*Pretendohet edhe pse në paraqitjen tabelare të librezës së masave nuk është paraqitur në formë të detajuar dhe të saktë përmasat e hedhjes së betonit përkatësisht për një shtyllë, kjo nuk ndikon në saktësinë e sasisë së shtresës së betonit C/16 të përdorur në total për kabinë, pra volumet në total janë sipas kërkesave dhe standardeve. Thellësia e montimit të shtyllave referuar specifikimeve teknike të OSHEE varion nga 1.6 deri në 1.8, në varësi të shtyllës dhe është kryer 0.9 x 0.9 x 1.6 për shtylla të tipit 9/6 dhe 1.3 x 1.3 x 1.8 për shtyllat 9/15, ndërkohë që volumi i shtyllës brenda në gropë është hequr nga llogaritja.*
*Sa i takon sasisë 62.6 $m^3$ rezultuar nga matjet në terren, nuk qëndron pasi sipas standardeve të OSHEE betonimi mund të bëhet në dy mënyra, me formë katrore ose rrethore, me përmasa 0.2 m x 0.6 x 0.6 m.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Sqarojmë se sa i përket realizimit në dy mënyra, në asnjë rast në standardet e vendosjes së shtyllave nuk parashikohet ndërtimi i themeleve me dimensione të ndryshme në thellësi të tij, por me dimensione të njëjta të gjatësisë dhe gjerësisë (për një shtyllë të caktuar). Matjet në terren, për të cilat në material është përfshirë vetëm numri i shtyllave të konstatuara me dimensione më të vogla dhe jo të gjitha shtyllat e vendosura, është bërë në mënyrë të saktë.

### 9. Mbi zbatimin e Kontratës "Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC".

Kontrata e punimeve "Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC", është nënshkruar me nr. 1089/16 prot., datë 06.01.2021, me vlerë 85,450,203, me Kontraktorin "E P" SHPK. Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur z. K K. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 100 ditë.
Leja e infrastrukturës është lëshuar nga Bashkia Berat me nr. 287, datë 27.05.2021. Procesverbali

i fillimit të punimeve, i piketimit të objektit dhe sheshit të ndërtimit, janë mbajtur me datë 27.05.2021.
Kontrata përfshin punime për zgjatimin e fiderit A 1, 20 kV të N/Stacionit Burdullias, ndërtim rrjeti i tensionit të ulët me kabullo ABC. Kabinat janë përcaktuar parafabrikat dhe konkretisht kabina F1/13, F1/14, F1/15 dhe F1/18.
Janë certifikuar punime si më poshtë:
Situacioni nr. 1, me vlerë 13,900,626.9 lekë, është paraqitur me datë 31.05.2021.
Situacioni nr. 2, me vlerë 31,189,734.9 lekë, është paraqitur me datë 30.06.2021.
Situacioni nr. 3, me vlerë 36,316,192.3 lekë, është paraqitur me datë 31.07.2021.
Situacioni nr. 4, me vlerë 568,676 lekë, është paraqitur me datë 31.08.2021.

Nga auditimi konstatohen mangësi si më poshtë:

<table>
<tr><td>Titulli i gjetjes:</td><td>Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve.</td></tr>
<tr><td>Situata 27:</td><td>Nga auditimi i kontratës “Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC”, u konstatua se në situacionin nr. 2, janë përfshirë punime kanali edhe për urën 60 m, ndërkohë që në këtë urë, kabullot kalojnë të inkastruar në anë të urës të futur në tuba plastikë dhe çeliku.<br>Nga përllogaritjet rezultojnë diferenca si më poshtë:
<table>
<tr><th>Nr.</th><th>Përshkrimi i punimeve</th><th>Njësia</th><th>Sasia</th><th>Çmimi (lekë)</th><th>Vlera (lëkë)</th></tr>
<tr><td>1</td><td>Prerje asfalti me disk</td><td>ml</td><td>120</td><td>201.9</td><td>24,228</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Prishje shtresë çakulli</td><td>$m^2$</td><td>30</td><td>101.9</td><td>3,057</td></tr>
<tr><td>3</td><td>Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 $m^3$...</td><td>$m^3$</td><td>32.4</td><td>357.4</td><td>11,579</td></tr>
<tr><td>4</td><td>Gërmim me krahë seksion i detyruar...</td><td>“</td><td>10.8</td><td>832.56</td><td>8,991</td></tr>
<tr><td>5</td><td>Transport dheu me auto deri 5 km</td><td>“</td><td>43.2</td><td>263.34</td><td>11,376</td></tr>
<tr><td>6</td><td>Shtresë rëre (14.4 $m^3$ tek ura, 60 $m^3$ vol.tullave)</td><td>“</td><td>74.4</td><td>1,444.4</td><td>107,463</td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma:</td><td></td><td></td><td></td><td>166,691</td></tr>
</table>
Vlera 166,691 lekë është përfituar më tepër nga Kontraktori “E P” SHPK.<br>Ndër zërat e punimeve të përfshirë në fondin rezërvë është edhe “F.V hekur betoni periodik Ø 6 mm deri Ø 10 mm (zgarë 10 x 10 cm), në sasinë 0.64 ton. Sasia e betonit respektive është 0.2 $m^3$, që i përgjigjet zgarës në sasinë 0.04 ton. Vlera 67,215 lekë (0.6 ton x 112,025 lekë/ton), është përfituar më tepër nga Kontraktori “E P” SHPK.<br>Nga verifikimi i punimeve në objekt, u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve prej betoni të shtyllave 9/15 kV dhe 9/6 kV. Themelet nuk janë ndërtuar në të gjithë thellësinë me beton por vetëm në sipërfaqe me një trashësi 30 cm, kjo e dallueshme lehtësisht pothuajse në të gjitha shtyllat e verfifikuara. Si pasojë e mos zbatimit të kushteve teknike sa më sipër, në 3 shtylla devijimi nga vertikaliteti është i dukshëm. Nga përllogaritjet e përafërta rezulton se për shtyllat 9/15 kV dhe 9/15 kV është hedhur sasia 0.3 $m^3$ beton (100 cm x 100 cm x 30 cm). Nga verifikimi i librezës së masave dhe situacionit përfundimtar, për këto dy kabina janë certifikuar të vendosura 52 shtylla, me sasi totale betoni 83.3 $m^3$. Sasia e vendosur rezulton 15.6 $m^3$ (52 shtylla x 0.3 $m^3$), nga ku rezulton diferenca 67.7 $m^3$. Vlera 571,360 lekë (67.7 $m^3$ x 8439.6 lekë/$m^3$), është përfituar më tepër nga Kontraktori “E P” SHPK.</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| **Kriteri:** | Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7.<br>Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. |
| **Ndikimi:** | Certifikim i padrejtë i vlerës 805,266 lekë. |
| **Shkaku** | Gabim në përgatitjen e librezës së masave. |
| **Rëndësia:** | E Lartë |
| **Rekomandimi:** | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **805,266 lekë**, nga Kontraktori **"E P"** SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

Kërkesa për miratimin e fondit rezervë është bërë me shkresë nr. 12/12 prot., datë 26.08.2021. Qëllimi i përdorimit të fondit rezervë është likuidimi i diferencës së disa zërave të punimeve, të cilat nuk ishin parashikuar në preventivin përkatës. Vlera e fondit rezervë është 3,333,6145 lekë.
Kërkesa për përdorimin e fondit rezervë në përfundim të punimeve, për problematika që kanë lindur më parë është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, pika 19, ku përcaktohet:

> *"Mbikëqyrësi i punimeve kontrollon dhe autorizon përdorimin e fondit rezervë, të preventivuar,* ***dhe i raporton, periodikisht, investitorit për gjendjen e tij.*** *Ky i fundit, nëse ka vërejtje, e njofton sipërmarrësin dhe problemi zgjidhet ndërmjet tyre. Për çdo ndryshim të mundshëm, mbikëqyrësi i punimeve vihet në dijeni, për të ndjekur zbatimin e ndryshimeve në fjalë".*

Njoftimi për përfundimin e punimeve është bërë me shkresë nr. 12/13 prot., datë 01.09.2021, datë në të cilën është mbajtur edhe procesverbali i përfundimit të punimeve. Akti i kolaudimit është mbajtur me datë 15.10.2021, nga znj. A A. Punimet janë marrë në dorëzim të përkohshëm nga Komisioni i përbërë z. T B, z. B D dhe z. G K, të cilët kanë hartuar certifikatën përkatëse me nr. 966/4 prot., datë 26.11.2021.

Me datë 12.12.2021, me prezencën e mbikëqyrësit të punimeve z. K K, u verifikuan disa zëra të punimeve të realizuara në objekt, të cilat kanë të bëjnë me shtrimin e linjës së tensionit të mesëm, furnizimin dhe vendosjen e kabinave parafabrikat si dhe linjat e tensionit të ulët në zonën sipas kabinës F1/13, F1/14 dhe kabinës Veterrik Shkolla. Sa i përket furnizimit dhe vendosjes së kabinave rezulton se janë realizuar punime me cilësi të mire, si dhe pajisjet elektrike të vendosura janë sipas specifikimeve. Sa i përket linjës së tensionit të mesëm, theksojmë se kemi të bëjmë me punime të cilat janë bërë të padukshme, por sa i takon punimeve të dukshme, rezulton se shtresat asfaltike janë realizuar me cilësi të mirë, pas procesit të gërmimit, mbushjes dhe ngjeshjes me materiale.
Më poshtë paraqiten foto nga punimet e realizuara.

 

Në shtyllat e vendosura mungon:
<u>- Etiketa e identifikimit të prodhuesit</u>, në të cilën përcaktohen: Emri i prodhuesit, data, muaji dhe viti i prodhimit, numri i strukturës, gjatësia e shtyllës, kapaciteti (momenti) në sipërfaqen e tokës, ose pika e fiksimit, logo e blerësit/OSHEE etj.
- <u>Etiketa e identifikimit të shtyllës</u>, në të cilën përcaktohen: Emri i pikës së transformimit, emri i linjës dalëse TU, lloji i shtyllës, ndërmjetëse/ankerore ose ankerore fundore, numri i shtyllës. Etiketa duhet të jetë më sfond ngjyrë gri, korniza ngjyrë e gjelbër me trashësi 10 mm, me dimensione 210 x140 mm.
- Etiketa paralajmëruese e sigurimit teknik.
Mos pajisja e shtyllave më etiketat si më sipër është në kundërshtim me specifikimet teknike "Shtylla beton arme të centrifuguara", pika 8.
*Ngarkohet me përgjegjësi mbikëqyrësi i punimeve z. K K.*

**10.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "***Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 KV***", njësia rajonale DTL viti 2021, konstatohet:
- Objekti i kontratës *"Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 KV"*, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 335/17 prot. datë 18.06.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Tensionit të Lartë DTL, me përfaqësues z. A K dhe Operatorit Ekonomik "4" shpk, përfaqësuar nga z. A M. Vlera e kontratës është 207,215,336 lekë pa TVSH. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar përfaqësues i DTL. Ing. A M me Licensë për mbikëqyrje kolaudim MK.1718, sipas urdhërit nr. 938/17 prot. Datë 30.10.2020. Përfaqësues i Investitorit dhe Administrator kontrate është përcaktuar Ing. K N. Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 19.07.2021. Njoftmi i fillimit të punimeve dhe procesverbali i fillimit të punimeve është më datë 19.07.2021. Punimet pezullohen dhe në momentin e përfundimit të

punimeve nga DTL, sipërmarrësi do të njoftohet për rifillimin e punimeve. Rifillimi i punimeve është realizuar më datë 23.03.2022. Për shkak të vazhdushmërisë së problematikave të ndryshme në punime të N/stacionit si dhe kërkesa të ndryshme për miratime parametrash teknike, punimet janë pezuar përsëri më datë 21.05.2022 dhe kanë rifilluar më datë 30.06.2022. Njoftimi i përfundimit të punimeve është sipas shkresës nr. 335/79 prot datë 12.07.2022. Me shkresën e sipërmarrësit nr. 335/47 prot. Datë 20.05.2022, drejtuar DTL, konstatohen ndryshime gjatë zbatimit të punimeve lidhur me kabllot e fuqisë 35/20/6 kV, kabllot e qarqeve sekondarë dhe përcjellsat e tokëzimit të konteinerit të celave 35/20/6 kV. Zërat kryesorë të cilat kanë rezultuar në rritje janë si më poshtë:

| Preventivi dhe sasia sipas kontratës | | | | | | Gjendja fakt | | Diferenca vlerë | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emërtimi i materialit | Njësia | Sasia | Cmimi | vlera | Sasi | vlera | Sasi | Vlerë |
| 2.5 | F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2) | ml | 200 | 20,000 | 4,000,000 | 426 | 8,520,000 | +226 | 4,520,000 |
| 8.1 | F.V kabëll XLPE 24 kv Cu (1x300mm2) | ml | 120 | 20,000 | 2,400,000 | 204 | 4,080,000 | +84 | 1,680,000 |
| 8.3 | F.V kabëll XLPE 20 kv Cu (2x630mm2) | ml | 120 | 46,440 | 5,572,800 | 192 | 8,916,480 | +72 | 3,343,680 |

Në total referuar tabelës së lëvizjes së volumeve, është konstatuar se vlera përfundimtare e kontratës e tejkalon vlerën e kontratës krahasuar me gjendjen në fakt. Referuar përmbledhjes kjo kontratë është në kushtet e tejkalimit të vlerës me 8,457,007 lekë pa TVSH, duke mos përfshirë vlerën e fondit rezervë 5% të parashikuar në preventivin e kontratës ose 6,679,063 pa TVSH. Me informacionin e mbikëqyrsit të punimeve drejtuar titullarit të DTL, shprehet se në përgjigje të shkresës nr. 335/47 prot. Datë 20.05.2022, të kontraktorit, baza materiale e kërkuar nga kontraktori është e domozdoshme për realizimin përfundimtar të kontratës. Tejkalimi i vlerës së kontratës i ka kaluar zyrës së projektimit pranë DTL i përbërë nga A. A., D. M. dhe J. V.(i njëjti grup që ka realizuar projekt-preventivin fillestar), ku specialistët realizuan verifikimin faktit të kabllove, përllogaritën cmimet që janë përdorur në preventivin fitues të ofertuar nga sipërmarrësi "4" shpk.
- Me shkresën e titullarit të DTL nr. 335/57 prot. Datë 03.06.2022, drejtuar Drejtorit të OSSH, paraqitet relacioni mbi tejkalimin e kontratës referuar shkresës së sipërmarrësit nr. 335/47 datë 20.05.2022, shkresës së mbikëqyrësit nr. 335/51 prot. Datë 26.05.2022 dhe relacionit të zyrës së nr. 335/56 prot. Datë 01.06.2022. Në lidhje me të gjithë korespondencat e palëve nuk konstatohet nevoja ekstreme për realizimin e punimeve, pasi shtesat i takojnë vetëm pjesës së kabllove të cilat realizohen lehtësisht nga specialistët e DTL, duke vlerësuar edhe gjendjen e mallrave në magazinë. Me shkresën e titullarit të DTL nr. 335/58 prot. Datë 06.06.2022, drejtuar Drejtorit të OSSH, kërkon akordimin e fondeve shtesë me vlerë 8,457,007 lekë pa TVSH. Midis palëve është realizuar modifikim kontrate me nr. 335/78 prot. Datë 28.06.2022, referuar nenit 127 "*Modifikimi i kontratave gjatë afatit të tyre*", me vlerë 8,457,007 lekë pa TVSH, midis DTL dhe OE "4" shpk. Referuar sa më sipër nga grupi i zyrës së projektimit të DTL, i njëjti grup i cili projektoi dhe preventivoi veprën ka përcaktuar cmimet fillestare në fondin limit për zërat të cilat rezultuan me tepër në kontratën fillestare si më poshtë:

| Preventivi dhe sasia sipas kontratës | | | | | | | Shtesa e sasisë | | Difer vlerë nga oferta 4-AM | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emërtimi i materialit | Njësia | Analiza | Sasia | Cmimi | vlera | Sasi | Vlera | cmimi | Vlerë |
| 2.5 | F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2) | ml | Kontrata të ngjashme | 200 | **3,000** | 600,000 | 226 | 678,000 | **20,000** | 4,520,000 |
| 8.1 | F.V kabëll XLPE 24 kv Cu (1x300mm2) | ml | Kontrata të ngjashme | 120 | **4,400** | 528,000 | 84 | 369,600 | **20,000** | 1,680,000 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 8.3 | F.V kabëll XLPE 20 kv Cu (2x630mm2) | ml | Kontrata të ngjashme | 120 | **13,310** | 157,200 | 72 | 958,320 | **46,440** | 3,343,680 |
| Totali | | | | | | | | **2,005,920** | | **9,543,680** |
| Diferenca e Ndryshimit të cmimeve dhe cmimit të ofertës së 4-AM | | | | | | | | | **7,537,760** | |

*Nga zyra e projektimit të DTL dhe mbikëqyrësit të punimeve nuk janë konstatuar diferenca të larta të cmimeve të ofertës së OE "4", për përllogaritje në procedurën shtesë të kontratës.* Akti i Kolauditimit është realizuar me nr. 335/80 prot. Datë 09.08.2022, nga Ing. V G, me licensë MK.0013/1. Garancia e punimeve është përcaktuar 24 muaj nga Akti i kolauditimit. Akti i marrjes në dorëzim nga grupi i marrjes në dorëzim të veprës është më datë 25.08.2022.
*Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:*
**1.** Zëri nr. 2.5, në pajisjet 35 kv *" F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)*".
Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej **426 ml** të zërit " *F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)"*. Librezat e masave rezulton në sasinë prej 426 ml, ku është llogaritur Ura Tr 35/20/6kv nr. 1, Ura Tr 35/20/6kv nr. 2, linja e ajrore N/st Shijak – N/st vore dhe cela 35kv e seksionimit. Në librezën e masave nuk janë bashkëlidhur distancat e kabujve të projektit të zbatuar. Nga verifikimi i projektit të Azhurnuar dhe verifikimeve në terren të kabllove të fuqisë, janë konstatuar disa pasaktësi në sasi si më poshtë vijon:
- Për Ura TR 1

| | | |
|---|---|---|
| Ngritje te TR sipas detajit | 7m x 3 fije | 21 m |
| Ngritje cela sipas detajit | 3.5 x 3 fije | 10.5 m |
| Prerje për skermon | 1 x 6 fije | 6 m |
| Gjatësi mesatre 1 faze në kanal përfshirë përkuljet dhe rezervat | 26.5 m x 3 fije | 79.5 |
| Gjatë totale | | 117 m |

- Për TR 2

| | | |
|---|---|---|
| Ngritje te TR sipas detajit | 7m x 3 fije | 21 m |
| Ngritje cela sipas detajit | 3.5 x 3 fije | 10.5 m |
| Prerje për skermon | 1 x 6 fije | 6 m |
| Gjatësi mesatre 1 faze në kanal përfshirë përkuljet dhe rezervat | 33.5 m x 3 fije | 100.5 |
| Gjatë totale | | 138 m |

- Linja Shijak

| | | |
|---|---|---|
| Prerje për skermon | 1 x 6 fije | 6 m |
| Gjatësi mesatre në kanal + jashtë + shtyllë + përkuljet | 34 m x 3 fije | 102 |
| Gjatë totale | | 108 m |

- Cela e seksionimit

| | | |
|---|---|---|
| Prerje për skermon | 1 x 12 fije | 12 m |
| Gjatësi mesatre në kanal + jashtë + shtyllë + përkuljet | 6 m x 6 fije | 36 |
| Gjatë totale | | 48 m |

- Në total rezulton sasia 117 + 138 + 108 + 48 = 411 ml. Referuar projektit të azhurnuar kablli me linjën kabllore 35 kv është kabëll 3 (1 x 95 mm) dhe observacioneve të dërguara, sipërmarrësi ka përfituar volum më tepër punimesh prej 15 ml (426 ml – 411 ml), në zërin nr. 2.5 në pajisjet 35 kv *" F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)*", me çmimin përkatës të ofertuar prej 20,000 lek / m$^3$, rezulton vlera prej *300,000 lekë pa TVSH*. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **300,000 lekë pa tvsh,** e përfituar më tepër sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "*Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 KV"*, nga kontraktori "4" shpk. |
| **Situata 27:** | *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi.*<br>Zëri nr. 2.5, në pajisjet 35 kv *" F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)*".<br>Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej **426 ml** të zërit " *F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)"*. Librezat e masave rezulton në sasinë prej 426 ml, ku është llogaritur Ura Tr 35/20/6kv nr. 1, Ura Tr 35/20/6kv nr. 2, linja e ajrore N/st Shijak – N/st vore dhe cela 35kv e seksionimit. Në librezën e masave nuk janë bashkëlidhur distancat e kabujve të projektit të zbatuar. Nga verifikimi i projektit të Azhurnuar dhe verifikimeve në terren të kabllove të fuqisë, janë konstatuar disa pasaktësi në sasi si më poshtë vijon:<br>- Për Ura TR 1<br>Ngritje te TR sipas detajit7m x 3 fije 21 m<br>Ngritje cela sipas detajit 3.5 x 3<br>fije 10.5 m<br>Prerje për skermon 1 x 6<br>fije 6 m<br>Gjatësi mesatre 1 faze në kanal përfshirë përkuljet dhe rezervat 26.5 m x<br>3 fije 79.5<br>Gjatë totale 117 m<br>- Për TR 2<br>Ngritje te TR sipas detajit 7m x 3<br>fije 21 m<br>Ngritje cela sipas detajit 3.5 x 3<br>fije 10.5 m<br>Prerje për skermon 1 x 6<br>fije 6 m<br>Gjatësi mesatre 1 faze në kanal përfshirë përkuljet dhe rezervat 33.5 m x 3 fije 100.5<br>Gjatë totale 138 m<br>- Linja Shijak<br>Prerje për skermon 1 x 6<br>fije 6 m<br>Gjatësi mesatre në kanal + jashtë + shtyllë + përkuljet 34 m x 3 fije 102<br>Gjatë totale 108 m<br>- Cela e seksionimit<br>Prerje për skermon 1 x 12<br>fije 12 m<br>Gjatësi mesatre në kanal + jashtë + shtyllë + përkuljet 6 m x 6 fije 36<br>Gjatë totale **48 m**<br>- Në total rezulton sasia 117 + 138 + 108 + 48 = **411 ml.** Referuar projektit të azhurnuar kablli me linjën kabllore 35 kv është kabëll 3 (1 x 95 mm) dhe observacioneve të dërguara, sipërmarrësi ka përfituar volum më tepër punimesh prej **15 ml** (426 ml – 411 ml), në zërin nr. 2.5 në pajisjet 35 kv *" F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)*", me çmimin përkatës të ofertuar prej 20,000 lek / m$^3$, rezulton vlera prej *300,000 lekë pa TVSH.*<br>Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **300,000 lekë** pa tvsh, e përfituar më tepër sipërmarrësi, për llogaritje të |

| | |
|---|---|
| | gabuara nga fakti i punës së realizuar. |
| **Kriteri:** | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. |
| **Shkaku:** | Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandimi**: | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **300,000 lekë** nga kontraktori OE "4" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

**11.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "***Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV, fideri F6, kabinave dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Lot II***", njësia rajonale Durrës viti 2021, konstatohet:

- Objekti i kontratës *"Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV, fideri F6, kabinave dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Lot II"*, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3161/18 prot. datë 05.01.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Durrës, me përfaqësues z. P M dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "I" shpk & "4" shpk, me përfaqësues z. E T dhe z. A M. Vlera e kontratës është 159,477,902 lekë pa TVSH. Afati i realizimit është 4 muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. G K. Përfaqësues i Investitorit dhe Administrator kontrate është përcaktuar Ing. Z Dh. Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 05.02.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve sipas relacioneve përkatëse nga mbikëqyrësi është më datë 05.02.2021. Me shkresën e sipërmarrësit nr. 3161/25 prot. Datë 04.03.2021, kërkohet përdorimi i fondit rezervë prej 5% në vlerën 6,587,295 me TVSH, për shkak të ndryshimeve të sasive në projekt-preventivin e punimeve. Me shkresën nr. 3161/27 prot. Datë 09.03.2021, miratohet fondi rezervë nga titullari i OSSH Durrës. Njoftimi i përfundimit të punimeve është sipas shkresës nr. 3161/29 prot datë 04.06.2021, ku mbahet edhe procesverbali përkatës midis palëve për përfundimin e punimeve. Certifikata e marjes në dorëzim është me nr. 3161/37 prot datë 19.07.2021. Për Kolaudimin e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. T.D. me Lic. MK 2845 dhe akti i kolauditimit është mbajtur me nr. 3161/35 prot. Datë 30.06.2021. Situacioni përfundimtar i certifikuar është në vlerën 159,477,891 lekë pa TVSH. *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:*

B. Linja e tensionit të ulët.

Përsa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendësi të gropës së shtyllës. Në disa raste, janë konstatuar se mbushja e betoneve me tulla dhe jo me beton dhe në disa raste janë konstatuar thyerje të betoneve. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të

parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime dhe rrezikojnë rënien e tyre*, duke shkaktuar jo vetëm dëme për shtyllën përkatëse, por edhe shtyllave të tjerat si pasojë e forcës tërheqjëse së kabujve të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren dhe observacioneve të dërguara, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.55 $m^3$, ndërkohë që është certifikuar sasia 0.65 $m^3$, me një diferencë **0.1** $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsish 1.2 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 1.27 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë **0.07** $m^3$ për shtyllë të verifikuar.

| Linja | Shtylla 9/6 kN | Verifikuar | Diferenca e betonit (nr. Sht. x 0.1 $m^3$) | Shtylla 9/15 kN | Verifikuar | Diferenca e betonit (nr. Sht. x 0.07 $m^3$) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | (copë) | copë | | (copë) | copë | |
| LTU Kabina “F6/11” | 46 | 15 | 1.5 | 7 | 4 | 0.28 |
| LTU Kabina “F6/14” | 81 | 32 | 3.2 | 12 | 5 | 0.35 |
| LTU Kabina “F6/16” | 11 | 4 | 0.4 | 1 | 1 | 0.07 |
| LTU Kabina “F6/17” | 34 | 20 | 2 | 1 | 1 | 0.07 |
| LTU Kabina “F6/18” | 28 | 12 | 1.2 | 7 | 3 | 0.21 |
| LTU Kabina “F6/19” | 33 | 18 | 1.8 | 6 | 3 | 0.21 |
| LTU Kabina “F6/20” | 52 | 34 | 3.4 | 4 | 1 | 0.07 |
| LTU Kabina “F6/21” | 31 | 22 | 2.2 | 2 | 1 | 0.07 |
| LTU Kabina “F6/22” | 32 | 16 | 1.6 | 8 | 4 | 0.28 |
| LTU Kabina “F6/23” | 44 | 24 | 2.4 | 6 | 2 | 0.14 |
| LTU Kabina “F6/24” | 76 | 55 | 5.5 | 5 | 3 | 0.21 |
| Shuma: | 468 | 252 | **25.2** | 59 | 28 | **1.96** |

Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 27.16 $m^3$ (25.2 + 1.96). Vlera 231,539 lekë (27.16 $m^3$ x 8,525 lekë/$m^3$) e zërit “*Shtresë betoni c16/20*”, është përfituar padrejtësisht Kontraktori BOE “I & 4” shpk. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **231,539 lekë** pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “*Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV, fideri F6, kabinave dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Lot II”*, nga zbatuesi i punimeve BOE “I” shpk & “4” shpk |
| **Situata 28:** | *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi.* B. Linja e tensionit të ulët.<br>Përsa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendësi të gropës së shtyllës. Në disa raste, janë konstatuar se mbushja e betoneve me tulla dhe jo me beton dhe në disa raste janë konstatuar thyerje të betoneve. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime dhe rrezikojnë rënien e tyre*, duke shkaktuar jo vetëm dëme për shtyllën përkatëse, por edhe shtyllave të tjerat si pasojë e forcës tërheqjëse së kabujve të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga |

| | |
|---|---|
| | bimësia). Bazuar në përllogaritjet, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.55 $m^3$, ndërkohë që është certifikuar sasia 0.65 $m^3$, me një diferencë 0.1 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsish 1.2 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 1.27 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë 0.07 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 27.16 $m^3$ (25.2 + 1.96). Vlera 231,539 lekë (27.16 $m^3$ x 8,525 lekë/$m^3$) e zërit "*Shtresë betoni c16/20*", është përfituar padrejtësisht Kontraktori BOE "I & 4" shpk. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **231,539 lekë** pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. |
| **Kriteri:** | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. |
| **Shkaku:** | Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandimi**: | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **231,539 lekë** nga kontraktori BOE "I" shpk & "4AM" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

**12.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "***Rikonstruksini i N/Stacionit Salmone 110/20 kV***", Drejtoria e Tensionit të Lartë viti 2021, konstatohet:
- Objekti i kontratës *"Rikonstruksini i N/Stacionit Salmone 110/20 kV"*, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 347/20 prot. datë 01.07.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë së Tensionit të Lartë, me përfaqësuese z. A K dhe operatorit ekonomik "L" shpk, me përfaqësues z. L D. Vlera e kontratës është 158,333,665 lekë pa TVSH. Afati i realizimit është 10 muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. A H. Përfaqësues i Investitorit dhe Administrator kontrate është përcaktuar Ing. N S. Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 17.09.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve sipas relacioneve përkatëse nga mbikëqyrësi është më datë 17.09.2021. Njoftimi i përfundimit të punimeve është më datë 22.07.2022, brenda afatve kontraktuale. Për Kolaudimin e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. A M me licensë MK.1728 dhe akti i kolauditimit është mbajtur me nr. 347/53 prot. Datë 02.09.2022. Situacioni përfundimtar i certifikuar është në vlerën 158,333,665 lekë pa TVSH.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "*Rikonstruksini i N/Stacionit Salmone 110/20 kV*", nga zbatuesi i punimeve OE "L" shpk. |

| | |
|---|---|
| **Situata 29:** | *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon* A. Kabllot e kontrollit, sinjalizimit, mbrojtjes dhe matjes. Librezat e masave ndahen në 2 pjesë, në librezat e masave sipas preventivit dhe libreza të masave për fondin rezervë prej 5 % në vlerën 791,848 lekë. Nga auditimi i librezave të masave të fondit rezervë, nuk rezulton të jetë e argumentuar apo justifikuar sasia e cila ka rezultuar më tepër, pasi nuk disponohen AS-built mbi lidhjet dhe gjatësitë e kabujve. Në librezat e masave të fondit rezervë nuk disponohen përllogaritje të përmasave por vetëm sasi fikse të cilat kanë mbuluar fondin rezervë. Ne lidhje me zërin "Zbara bakri 80x8 (dopio zbarë për fazë), edhe ky zë nuk argumentohet me librezën e masave sasia prej 185 kg, por sipas faktit u konstatua se ishte vendosur shtesë në pjesë të ndërmjetësme midis celave. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet **vlera prej 355,700 lekë** pa TVSH (41,000 + 67,000 + 247,700) e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për mos llogaritje dhe argumentime nga fakti i punës së realizuar. |
| **Kriteri:** | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. |
| **Shkaku:** | Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandimi**: | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **355,700 lekë** nga kontraktori OE "L" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

**13.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "***Ndërtimi i Fiderit 20 kV për përdorimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në zonën e Bypassit (Rotondo) Fier si dhe furnizim me energji elektrike të përdoruesve të kësaj zone***", njësia rajonale Fier viti 2021, konstatohet:

- Objekti i kontratës *"Ndërtimi i Fiderit 20 kV për përdorimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në zonën e Bypassit (Rotondo) Fier si dhe furnizim me energji elektrike të përdoruesve të kësaj zone"*, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 225/24 prot. datë 30.06.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Fier, me përfaqësues z. A F dhe operatorit ekonomik "A" shpk, me përfaqësues z. G B. Vlera e kontratës është 78,061,609 lekë pa TVSH. Afati i realizimit është 4 muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. Z Dh. Përfaqësues i Investitorit dhe Administrator kontrate është përcaktuar Ing. I H. Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët me nr. 225/31 datë 12.07.2021. Njoftimi i fillimit të

punimeve sipas relacioneve përkatëse nga mbikëqyrësi është me nr. 225/29 datë 12.07.2021. Në situacinin nr. 2 është përfshirë edhe fondi rezervë prej 5 %, për shkak të ndryshimeve të sasive në projekt-preventivin e punimeve. Njoftimi i përfundimit të punimeve është datë 11.11.2021, ku mbahet edhe procesverbali përkatës midis palëve për përfundimin e punimeve. Certifikata e marjes në dorëzim është me nr. 225/40 prot datë 02.12.2021. Për Kolaudimin e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. G K me Lic. MK 2847/1 dhe akti i kolauditimit është mbajtur me nr. 225/38 prot. Datë 23.11.2021. Situacioni përfundimtar i certifikuar është në vlerën 78,018,839 lekë pa TVSH.

A. Furnizim me Fider të ri të dedikuar nga Nënstatcioni ekzitues 110/20 kV.

**1.** Zëri nr. 1, *"Prerje Asfalti me disk*".

Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 11,223 ml të zërit "*Prerje Asfalti me disk"*. Librezat e masave rezulton në sasinë prej 12,681.8 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga observacionet e dërguara merren në konsideratë pasaktësi në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në llogjik të dokumentacionit të dërguar janë realizuar prerje në 3 (tre) anë apo prerje të kanalit. Për sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur, rezultojnë diferencat si më poshtë:

| Prerje asfalti me disk | Njësia | Sasia e certi sipas L.M | Gjatesia e certifikuar | Totali sipas L.M | Sasia sipas faktit | Gjatesia sipas faktit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 (1 x 2) | 4 | 5 ( 2 x 4) |
| Piketa 1 - 2' | ml | 4 | 1,477.60 | 5,910.40 | 3 | 4,432.80 |
| Piketa 2c - 2c | ml | 4 | 115.5 | 462.00 | 3 | 346.50 |
| Piketa 2d - 2d' | ml | 4 | 74.2 | 296.80 | 3 | 222.60 |
| Piketa 5 - 5' | ml | 4 | 510.9 | 2,043.60 | 3 | 1,532.70 |
| Piketa 5" - 6 | ml | 4 | 992.2 | 3,968.80 | 3 | 2,976.60 |
| Shuma: | | | | **12,681.60** | | **9,511.20** |

Sa më sipër sipërmarrësi "A"shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "*Prerje Asfalti me disk*", në sasinë 4,882 ml ( 11,223 ml situacinuar – 9,511 ml fakti = 1,712 ml), me cmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezulton vlera prej 342,400 lekë pa TVSH.

B. Rrjeti TM nga kabina Celigrad dhe parafabrikat 7 deri në Spital.

**1.** Zëri nr. 1, *"Prerje Asfalti me disk*".

Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 4,280 ml të zërit "*Prerje Asfalti me disk"*. Librezat e masave rezulton në sasinë prej 7,702 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga auditimi i librezave dhe observacioneve konstatohet pasaktësi në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në fakt janë realizuar prerje në 2 (dy) anë të kanalit, pasi ky aks nuk ishte aks kryesor për të dalë në autostratën e Fierit dhe nuk është prerë 3 apo 4 herë për shkak të përdorej rruga makinave.

| Prerje asfalti me disk | Njësia | Sasia e certif sipas L.M | Gjatesia e certifikuar | Totali sipas L.M | Sasia sipas faktit | Gjatesia sipas faktit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 (1 x 2) | 4 | 5 ( 2 x 4) |
| Piketa 6 - 7 | ml | 4 | 1,509.20 | 6,036.80 | 2 | 3,018.40 |
| Piketa 6 - 10 | ml | 4 | 146.9 | 587.6 | 2 | 293.8 |
| Piketa 10 - 11 | ml | 4 | 269.3 | 1,077.20 | 2 | 538.6 |
| Shuma: | | | | **7,702** | | **3,851** |

Sa më sipër sipërmarrësi "A"shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "*Prerje Asfalti me disk*", në sasinë 429 ml ( 4,280 ml situacinuar – 3,851 ml fakti), me cmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezulton vlera prej 85,800 lekë pa TVSH.

Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet **vlera prej 428,200 lekë** (342,400 + 85,800) lekë pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "*Ndërtimi i Fiderit 20 kV për përdorimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në zonën e Bypassit (Rotondo) Fier si dhe furnizim me energji elektrike të përdoruesve të kësaj zone*", nga zbatuesi i punimeve OE "A" shpk. |
| **Situata 30:** | *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi.* A. Furnizim me Fider të ri të dedikuar nga Nënstatcioni ekzitues 110/20 kV. Zëri nr. 1, *"Prerje Asfalti me disk*". Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 11,223 ml të zërit "*Prerje Asfalti me disk".* Librezat e masave rezulton në sasinë prej 12,681.8 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga auditimi i librezave të masave konstatohet pasaktësi dhe përllogaritje e gabuar në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në fakt janë realizuar prerje në 3 (tre) anë të kanalit. sipërmarrësi "A"shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "*Prerje Asfalti me disk*", në sasinë 4,882 ml ( 11,223 ml situacinuar – 9,511 ml fakti = 1,712 ml), me cmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezulton vlera prej 342,400 lekë pa TVSH.<br>B. Rrjeti TM nga kabina Celigrad dhe parafabrikat 7 deri në Spital. Zëri nr. 1, *"Prerje Asfalti me disk*". Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 4,280 ml të zërit "*Prerje Asfalti me disk".* Librezat e masave rezulton në sasinë prej 7,702 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga auditimi i librezave të masave konstatohet pasaktësi dhe përllogaritje e gabuar në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në fakt janë realizuar prerje në 2 (dy) anë të kanalit. Sipërmarrësi "A" shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "*Prerje Asfalti me disk*", në sasinë 429 ml (4,280 ml situacinuar – 3,851 ml fakti), me cmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezulton vlera prej 85,800 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **428,200 lekë** (342,400 + 85,800) lekë pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. |
| **Kriteri:** | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. |

| | |
|---|---|
| **Shkaku:** | Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandimi**: | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **428,200 lekë** nga kontraktori OE "A" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

**14.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "***Rikonstruksioni i kabinave Vajkan 1 dhe Vërri 2 dhe sistemim i rrjetit TU të tyre dhe sistemimi i rrjetit TU për Kallm i Vogël 1, 2, 3, 4 dhe Kallm i Madh, Nënstatcioni 35/6 Jagodinë***", njësia rajonale Fier viti 2021, konstatohet:
- Objekti i kontratës *"Rikonstruksioni i kabinave Vajkan 1 dhe Vërri 2 dhe sistemim i rrjetit TU të tyre dhe sistemimi i rrjetit TU për Kallm i Vogël 1, 2, 3, 4 dhe Kallm i Madh, Nënstatcioni 35/6 Jagodinë"*, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 716/21 prot. datë 05.01.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Fier, me përfaqësues z. A F dhe operatorit ekonomik "G" shpk, me përfaqësues z. P B. Vlera e kontratës është 24,689,395 lekë pa TVSH. Afati i realizimit është 2 muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. A Q. Përfaqësues i Investitorit dhe Administrator kontrate është përcaktuar Ing. I H. Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët me nr. 716/25 datë 11.01.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve është mr nr. 716/27 datë 11.01.2021. Njoftimi i përfundimit të punimeve është sipas shkresës nr. 716/32 prot datë 10.03.2021. Për Kolaudimin e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. Z Dh me Lic. MK 3697 dhe akti i kolauditimit është mbajtur me nr. 716/35 prot. Datë 10.04.2021. Situacioni përfundimtar i certifikuar është në vlerën 24,481,283 lekë pa TVSH.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "*Rikonstruksioni i kabinave Vajkan 1 dhe Vërri 2 dhe sistemim i rrjetit TU të tyre dhe sistemimi i rrjetit TU për Kallm i Vogël 1, 2, 3, 4 dhe Kallm i Madh, Nënstatcioni 35/6 Jagodinë* ", nga zbatuesi i punimeve OE "G" shpk. |
| **Situata 31:** | *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi, si më poshtë vijon:*<br>A. Rrjeti TU me përcjellsa ABC. Përsa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendësi të gropës së shtyllës. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime*. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë, në trotuare apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.28 $m^3$ (0.9m gjerësi x 0.9m gjatësi x 0.35 m thellësi), ndërkohë që është certifikuar sasia 0.78 $m^3$ ( 0.7m gjerësi x 0.7m gjatësi x 1.6m thellësi), me një diferencë **0.5** $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat |

| | |
|---|---|
| | 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsish 0.38 $m^3$ (1.05m gjerësi x 0.9m gjatësi x 0.35 m thellësi), ndërsa sasia e certifikuar është 1.45 $m^3$ për shtyllë (0.9m gjerësi x 1.05m gjatësi x 1.8m thellësi), me një diferencë **1.07** $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 41.77 m3 (30 + 11.77). Vlera **342,388 lekë** (41.77 m3 x 8,197 lekë/m3) e zërit "*Shtresë betoni c16/20*", është përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. |
| **Kriteri:** | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. |
| **Shkaku:** | Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandimi**: | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **342,388 lekë** nga kontraktori OE "G" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |

**15.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "***Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korcë***", njësia rajonale Korcë viti 2020, konstatohet:

- Objekti i kontratës *"Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korcë"*, është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 445/12 prot. datë 01.12.2020, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Korcë, me përfaqësues z. A Q dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "M" shpk & "A" shpk & "E" shpk, me përfaqësues z. A M, z. F M dhe z. E B. Referuar Akt Marreveshjes datë 16.10.2020, mbi bashkimin e përkëohshëm të shoqërive, është përcaktuar se shoqëria "M" LTD, si udhëheqëse dhe autorizuese për kryerjen e të gjitha veprimeve në emër të BOE. Vlera e kontratës është 119,739,951 lekë pa TVSH. Afati i realizimit është 5 muaj, nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit nga mbikqyrësi i punimeve. Për Mbikëqyrjen e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. K K. Përfaqësues i Investitorit dhe Administrator kontrate është përcaktuar Ing. B M. Akti e dorëzimit të sheshit të ndërtimit është realizuar nga palët datë 01.02.2021. Njoftimi i fillimit të punimeve sipas relacioneve përkatëse nga mbikëqyrësi është me nr. 445/15 datë 01.02.2021. Njoftimi i përfundimit të punimeve është më datë 01.07.2021, ku mbahet edhe procesverbali përkatës midis palëve për përfundimin e punimeve. Për Kolaudimin e kontratës së zbatimit është përcaktuar Ing. G K dhe akti i kolauditimit është mbajtur me nr. 445/18 prot. Datë 09.07.2021. Situacioni përfundimtar i certifikuar është në vlerën 119,734,966 lekë pa TVSH.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "*Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korcë*", nga zbatuesi i punimeve BOE "M" shpk & "A" shpk & "E" shpk. |

| | |
|---|---|
| **Situata 32:** | *Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi.* A. Linja e tensionit të ulët. Përsa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi deri 20 cm por jo në brendësi të gropës së shtyllës dhe ***në shumë raste nuk ishte hedhur beton***. Në disa raste, janë konstatuar se mbushja e betoneve me tulla dhe jo me beton dhe në disa raste janë konstatuar thyerje të betoneve. Punimet e betonit në shtylla, janë realizuar jashtë kushtit teknik dhe nuk mund të pranohej si zë punimi i realizuar. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime dhe rrezikojnë rënien e tyre*, duke shkaktuar jo vetëm dëme për shtyllën përkatëse, por edhe shtyllave të tjerat si pasojë e forcës tërheqjëse së kabujve të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN dhe 9/15 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.1 $m^3$ për shtyllë të verifikuar (*ku në shumë raste nuk ekziston betoni*). Ndërkohë që është certifikuar sasia më tepër në librezën e masave ndërsa në situacionin përfundimtar është ruajtur e njëjta sasi me preventivin fillestar. Një pjesë e shtyllave thjesht janë hedhur 2-3 lopata beton të cilat nuk konsiderohen si të realizuara. Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.1 $m^3$, ndërkohë që është certifikuar sasia 0.78 $m^3$, me një diferencë 0.68 $m^3$ (0.78 – 0.1) për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsish 0.1 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 0.87 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë 0.77 $m^3$ (0.87 – 0.1) për shtyllë të verifikuar. Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 248.63 m3 (169.32 + 79.31). Vlera 2,055,921 lekë ( 248.63 $m^3$ x 8,269 lekë/$m^3$ ) e zërit "*Shtresë betoni c16/20*", është përfituar padrejtësisht Kontraktori BOE "M" shpk dhe përbën dëm ekonomik. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **2,055,921 lekë** pa tvsh e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. |
| **Kriteri:** | Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:<br>- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.<br>- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve. |
| **Shkaku:** | Pasaktësi nga ana e mbikëqyrësit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projekt-preventivit. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |

| Rekomandimi: | OSHEE, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **2,055,921 lekë** nga kontraktori BOE "M" shpk & "A" shpk & "E" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara. |
|---|---|

## 2.7. Mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike.

Procedurat e shitblerjes së energjisë elektrike janë bazuar në Ligjin nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, VKM nr. 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", si dhe Vendimin e ERRE nr. 103, datë 23.06.2016 "Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik".
Për periudhën objekt auditimi, blerja e energjisë elektrike nga ana e OSHEE GROUP sh.a(FTL sh.a) paraqitet si më poshtë:

**Korrik-dhjetor 2020.**

| Blerje | Sasia MẀh | Çmimi mesatar Euro/MẀh | Vlera pa TVSH (Euro) |
|---|---|---|---|
| **Korrik** | 75,144 | 40.95 | 3,076,812 |
| **Gusht** | 138,384 | 44.47 | 6,154,308 |
| **Shtator** | 235,500 | 60.31 | 14,203,285 |
| **Tetor** | 54,505 | 55.24 | 3,011,082 |
| **Nëntor** | 267,940 | 57.12 | 15,305,634 |
| **Dhjetor** | 365,129 | 84.56 | 30,874,776 |
| **Shuma:** | 1,136,602 | 63.90 | 72,625,897 |

Burimi: FTL sh.a, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

**Viti 2021**

| Blerje | Sasia MẀh | Çmimi mesatar Euro/MẀh | Vlera pa TVSH (Euro) |
|---|---|---|---|
| **Janar** | 1,488 | 50.50 | 75,144 |
| **Shkurt** | 1,344 | 50.50 | 67,872 |
| **Mars** | 1,486 | 50.50 | 75,043 |
| **Prill** | 1,440 | 50.50 | 72,720 |
| **Maj** | 1,488 | 50.50 | 75,144 |
| **Qershor** | 1,440 | 50.50 | 72,720 |
| **Korrik** | 58,577 | 107.64 | 6,305,372 |
| **Gusht** | 245,448 | 128.18 | 31,462,159 |
| **Shtator** | 271,448 | 164.98 | 44,784,765 |
| **Tetor** | 258,470 | 265.71 | 68,678,269 |
| **Nëntor** | 278,673 | 276.45 | 77,039,160 |
| **Dhjetor** | 10,120 | 220.95 | 2,235,967 |
| **Shuma:** | 1,131,422 | 204.12 | 230,944,336 |

Burimi: FTL sh.a, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

**Viti 2022**

| Blerje | Sasia MẀh | Çmimi mesatar Euro/MẀh | Vlera pa TVSH (Euro) |
|---|---|---|---|
| **Janar** | 43,344 | 254.30 | 11,022,364 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Shkurt** | 4,032 | 230.57 | 929,658 |
| **Mars** | 4,458 | 230.57 | 1,027,881 |
| **Prill** | 4,320 | 230.57 | 996,062 |
| **Maj** | 4,464 | 230.57 | 1,029,264 |
| **Qershor** | 4,320 | 230.57 | 996,062 |
| **Korrik** | 4,464 | 230.57 | 1,029,264 |
| **Gusht** | 4,464 | 230.57 | 1,029,264 |
| **Shtator** | 4,320 | 230.57 | 996,062 |
| **Tetor** | 4,470 | 230.57 | 1,030,648 |
| **Nëntor** | 4,320 | 230.57 | 996,062 |
| **Dhjetor** | 4,464 | 230.57 | 1,029,264 |
| **Shuma:** | 91,440 | 241.82 | 22,111,859 |

Burimi: FTL sh.a, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

**a. Mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, për muajin nëntor 2020.**

1. Për periudhën 01 deri 07 nëntor 2020.

Planifikimi për blerje të energjisë elektrike për periudhën 01-07.11.2020 është bërë bazuar në parashikimin e kushteve metereologjike, në konfirmimin që KESH SHA të mundësisë për furnizimin e klientëve tariforë me email të datës 29.10.2020, ku përcaktohet se nga ana e KESH do të gjenerohet 8000 MẀh/ditë.

Për periudhën 01-07.2020, nga ana e OSHEE, është përcaktuar blerja e energjisë në sasinë 40,740 Mëh në dy lote si më poshtë:

Lot 1, orari $00^{00}$ deri $24^{00}$ (180 MẀ) për sasinë 30240 MẀh.

Lot 2, orari $09^{00}$ deri $23^{00}$ (100 MẀ) për sasinë 10500 MẀh.

Urdhri për blerjen e energjisë eklektrike është lëshuar me nr. 3079 prot., datë 29.10.2020. Komisioni i blerjes përbëhet nga znj. E D (Shefe sektorit të tregtimit të energjisë), znj. V D (specialiste e tregtimit të energjisë) dhe z. Th A (Shef sektori i analizës së çmimit).

Ftesa për pjesëmarrje është bërë me nr. 3079/2 prot., datë 29.10.2020. Me datë 30.10.2020 është bërë hyrja në sistem dhe printimi i listës së pjesëmarrësve me ofertat e tyre. Ofertat rezultojnë të ngarkuara në sistem para orës $10^{00}$, orë e përcaktuar si mbyllje e procesit. Nga ana e komisionit është mbajtur procesverbali nr. 1, datë 30.10.2020, me përllogaritjet automatikë të sistemit. Kërkesa e parë për optimizim është bërë me nr. 3079/6 prot, datë 30.10.2020. Në orën $11^{21}$ është bërë hyrja në platformën IT dhe janë printuar të dhënat për ofertat e paraqitura. Kërkesa e dytë për optimizim është bërë po në këtë datë dhe kërkesa për paraqitjen e ofertave është bërë me limit orën $11^{00}$. Kërkesat për optimizim kanë për qëllim rritjen e sasive të furnizimit (për rastet e pa mbuluara) dhe mundësinë e uljes së çmimit. Brenda datës 30.10.2020, janë bërë njoftimet përkatëse për pranimin e ofertave, njoftimet e fituesve, është miratuar edhe raporti final, janë bërë njoftimet e kontratave, është njoftuar Kryetari i ERRE. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, nga ana e subjekteve tregtare është bërë furnizimi me energji elektrike, sipas përcaktimeve në kontratën përkatëse, e cila është bazuar në sasinë orare, sipas ditëve përkatëse.

Në përfundim, nga ana e OSHEE është blerë sasia 30240 MẀh, me çmim mesatar 46.68 Euro (çmimi mesatar i bursës 40.2 Euro/MẀh) si dhe sasia 10500 MẀh, me çmim 51.8 Euro (çmimi mesatar i bursës është 45.1 Euro/MẀh).

2. Për periudhën 08 deri 15 nëntor 2020.

Për periudhën 08 deri 15 nëntor 2020, është kërkuar blerja e energjisë elektrike në sasinë 64000 MẀh, në fashën orare $08^{00}$ deri $23^{00}$, me profil bande 200 MẀh. Për këtë periudhë KESH SHA ka ofruar furnizim me energji elektrike në sasinë 6000 MẀh/ditë. Komisioni i blerjes së energjisë

elektrike është ngritur me Urdhër nr. 4042/1 prot., datë 05.11.2020, i përbërë nga znj. E D, znj. V D dhe z. Th A.
Ftesa për blerjen e energjisë është ndarë në dy lote:
Lot 1, nga ora $00^{00}$ deri $24^{00}$, për sasinë 38,400 MẀh.
Lot 2, nga ora $08^{00}$ deri $23^{00}$, për sasinë 25,600 MẀh.
Procesverbali nr. 1, për hyrjen në sistemin elektronik dhe printimin e ofertave të paraqitura është mbajtur me datë 06.11.2020. Kërkesa për optimizim (për mundësinë e rritjes së sasive dhe ulje të çmimit) është bërë po në këtë datë, me afat të paraqitjes së ofertave orën $11^{00}$.
Raport i sistemit është printuar në orën $11^{13}$ dhe të gjitha ofertat janë ngarkuar në sistem në limit të orarit të përcaktuar. Kërkesa për optimizim përfundimtar është bërë me datë 06.11.2020, me orar limit orën $12^{00}$. Nga prinitimi i raportit të sistemit, rezulton se ofertat e paraqitura për lot 2, janë relativisht të larta. Në këto kushte komisioni ka vendosur anulimin e procedurës për këtë lot. Çmimi më i ulët i paraqitur për lot 2 është 54.99 Euro/MẀh.
Për lot 2, po datë 06.11.2020, është rishpallur njoftimi i blerjes së energjisë. Limiti i paraqitjes së ofertave është përcaktuar ora $15^{00}$. Raporti përkatës është printuar në orën $15^{12}$. Për këtë procedurë, për ofertat e pranuara, çmimi më i ulët i paraqitur është 52.71 Euro/MẀh dhe më i larti 53.79 Euro/MẀh. Njoftimi i fituesve është bërë sipas përcaktimeve të sistemit. Raporti final është miratuar me datë 06.11.2020.
Në përfundim është kontraktuar energji si më poshtë:
Lot 1, sasia 38400 MẀh, me vlerë 1,871,616 Euro.
Lot 2, sasia 25600 MẀh, me vlerë 1,367,699 Euro.
Njoftimet e kontratave janë bërë me datë 06.11.2020.
Bazuar në raportet e paraqitura, sasia e energjisë e lëvruar nga OSHEE është e njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën dhe anekset përkatëse të nënshkruara.
3. Për periudhën 16 deri 22 nëntor 2020.
Urdhri për blerjen e energjisë elektrike për peiudhën 16.11.2020 deri 22.11.2020, është lëshuar nga Drejtori i FTL me nr. 4195 prot., datë 12.11.2020. Komisioni i blerjes së energjisë elektrike është ngritur me Urdhër nr. 4195/1 prot., datë 12.11.2020, i përbërë nga znj. E D, znj. V D dhe z. Th A. Ftesa për pjesëmarrje është bërë po në këtë datë, për paraqitje ofertash brenda datës 13.11.2020, ora $10^{00}$, me të dhënat si më poshtë:
Sasia 38640 MẀh, për fashën orare $00^{00}$ deri $24^{00}$.
Sasia 29120 MẀh, për fashën orare $08^{00}$ deri $23^{00}$.
Raporti është printuar në orën $10^{18}$, ndërsa ofertat janë paraqitur në limitet e këtij orari. Kërkesa për optimizim është bërë për paraqitje ofertash deri në orën $11^{00}$ dhe kërkesa e dytë për optimizim është bërë për paraqitje ofertash deri në orën $12^{00}$. Raporti final i proceduës është miratuar me datë 13.11.2020. Njoftimi i fituesve dhe i kontratave përkatëse, sipas klasifikimit të sistemit, është bërë po në këtë datë.
Në përfundim është kontraktuar energji si më poshtë:
Lot 1, sasia 38640 MẀh, me vlerë 2,021,191 Euro.
Lot 2, sasia 29120 MẀh, me vlerë 1,732,281 Euro.
Bazuar në raportet e paraqitura, sasia e energjisë e lëvruar nga OSHEE është e njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën dhe anekset përkatëse të nënshkruara.
4. Për periudhën 23.11.2020 deri 30.11.2020.
Urdhri për blerjen e energjisë elektrike për peiudhën 23.11.2020 der 30.11.2020, është lëshuar nga Drejtori i FTL me nr. 4340 prot., datë 19.11.2020. Komisioni i blerjes së energjisë elektrike është ngritur me Urdhër nr. 4340/1 prot., datë 19.11.2020, i përbërë nga znj. E D, znj. V D dhe z. Th A.

Ftesa për pjesëmarrje është bërë po në këtë datë, për paraqitje ofertash brenda datës 20.11.2020, ora $10^{00}$, me të dhënat si më poshtë:
Sasia 53760 MẀh, për fashën orare $00^{00}$ deri $24^{00}$.
Sasia 40960 MẀh, për fashën orare $08^{00}$ deri $23^{00}$.
Raporti është printuar në orën $10^{20}$, ndërsa ofertat janë paraqitur në limitet e këtij orari. Kërkesa për optimizim është bërë për paraqitje ofertash deri në orën $11^{00}$ dhe kërkesa e dytë për optimizim është bërë për paraqitje ofertash deri në orën $12^{00}$. Raporti final i proceduës është miratuar me datë 20.11.2020. Njoftimi i fituesve dhe i kontratave përkatëse, sipas klasifikimit të sistemit, është bërë po në këtë datë.
Bazuar në raportet e paraqitura, sasia e energjisë e lëvruar nga OSHEE është e njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën dhe anekset përkatëse të nënshkruara.
Bazuar në çmimin ditor të bursës për muajin nëntor 2020, çmimin ditor të blerjes nga OSHEE po për këtë muaj, si dhe sasisë së blerë rezulton si më poshtë:

| Data | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HUPX | 20.09 | 38.83 | 41.75 | 40.87 | 40.37 | 41.10 | 37.22 | 34.45 | 46.38 | 48.01 | 50.70 | 56.65 | 57.78 | 43.91 | 43.19 |
| OSHEE | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 |
| OSHEE | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 |
| HUPX | 86772.6 | 167745.6 | 180360 | 176553 | 174387.6 | 177541.2 | 160779.6 | 165360 | 222638 | 230468 | 243366 | 271934 | 277336 | 210756 | 207334 |
| OSHEE | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 |
| Diferen. | 118816.2 | 37843.2 | 25228.8 | 29035.8 | 31201.2 | 28047.6 | 44809.2 | 68592 | 11314 | 3484 | -9414 | -37982 | -43384 | 23196 | 26618 |

| Data | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HUPX | 55.04 | 49.36 | 48.92 | 50.15 | 49.74 | 39.87 | 38.15 | 61.59 | 55.24 | 56.78 | 65.57 | 79.59 | 63.99 | 54.21 | 56.92 |
| OSHEE | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 |
| OSHEE | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 |
| HUPX | 303820.8 | 272464 | 270059 | 276821 | 274576.3 | 220084 | 210574 | 413898.8 | 371201 | 381558.8 | 440636 | 534814 | 430035 | 364271 | 382522 |
| OSHEE | 288751.2 | 288751 | 288751 | 288751 | 288751.2 | 288751 | 288751 | 417849.6 | 417849 | 417849.6 | 417849 | 417849.6 | 417849.6 | 417849.6 | 417849 |
| Diferen. | -15069.6 | 16287 | 18692 | 11930 | 14174.9 | 68667 | 78177 | 3950.8 | 46648 | 36290.8 | -22787 | -116964 | -12185.4 | 53578.6 | 35327 |

Sa më sipër rezulton se energjia e blerë nga ana e OSHEE ka referuar bursës HUPX, mbi bazën e profilit 24 orë kushton 8,100,671 Euro, ndërsa është blerë nga ana e OSHEE me vlerë 8,674,793 Euro, me një disferencë në rritje me vlerë 574,122.1 Euro. Theksojmë se në këtë vlerë përfshihet pagesa e transmetimit të energjisë elektrike dhe fitimi i kompanive të cilat tregëtojnë energjinë elektrike, duke qenë se OSHEE nuk ka akses të drejtpërdrejtë në bursë.

**b. Mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, për muajin shtator 2021.**
1. Për periudhën nga data 01.09.2021 deri datë 12.09.2021.
Nga ana e KESH, për këtë periudhë është konfirmuar furnizimi me energji elektrike në sasinë 6000 MẀh në ditë. Bazuar në sasinë e nevojshme për furnizimin e klientit fundor, është planifikuar blerja e energjisë me dy lote si më poshtë:
Lot 1, ($00^{00}$ deri $24^{00}$), për sasinë 72000 MẀh.
Lot 2, ($07^{00}$ deri $23^{00}$), për sasinë 38400 MẀh.
Komisioni i blerjes së ënërgjisë është ngritur me Urdhër nr. 2530/1 prot., datë 30.08.2021, me përbërje znj. E D, z. Th A dhe znj. E. S. Ftesa për pjesëmarrje është bërë me nr. 2530 prot., datë 30.08.2021. Nga ana e Komisionit është bërë dy herë ftesë për optimizim dhe raportet e sistemit

janë printuar me të dhënat përkatëse. Njoftimi i fituesve, sipas sasive dhe çmimeve të raportit të sistemit elektronik, është bërë me nr. 2530/11 prot., datë 30.08.2021.
Në këtë procedurë është plotësuar sasia për lot 1, por jo për lot 2. Për lot nuk janë pranuar të gjitha aplikimet, pasi 3 ofertues kanë paraqitur çmime relativisht të larta, krahasuar me ofertuesit e tjerë. Janë refuzuar oferta me çmim 167.88, 168.89 dhe 171.17 Euro/MẀh.
Për plotësimin e sasisë, komisioni ka bërë njoftimin për paraqitjen e ofertave për sëasinë 23040 MẀh ,e afat deri në orën 18$^{00}$. Në përmbyllje të procedurës, çmimi më i lartë i pranuar për furnizimin me energji elektrike është 163.37 Euro/MẀh, ose 4.5 Euro më pak nga oferta më e ulët e skualifikuar në procedurën e mëparshme.
Bazuar në raportet e paraqitura, sasia e energjisë e lëvruar nga OSHEE është e njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën dhe anekset përkatëse të nënshkruara.

2. Për periudhën nga data 13.09.2021 deri datë 19.09.2021.
Nga ana e KESH, për periudhën nga data 13.09.2021 deri datë 19.09.2021, është konfirmuar furnizimi me energji elektrike në sasinë 6000 MẀh në ditë. Bazuar në sasinë e nevojshme për furnizimin e klientit fundor, është planifikuar blerja e energjisë me dy lote si më poshtë:
Lot 1, (00$^{00}$ deri 24$^{00}$), për sasinë 43680 MẀh.
Lot 2, (07$^{00}$ deri 23$^{00}$), për sasinë 24640 MẀh.
Komisioni i blerjes së ënërgjisë është ngritur me Urdhër nr. 2672/1 prot., datë 09.09.2021, me përbërje znj. E D, z. V D dhe z. A Gj. Ftesa për pjesëmarrje është bërë me nr. 2672/2 prot., datë 09.09.2021. Nga ana e Komisionit është bërë dy herë ftesë për optimizim dhe raportet e sistemit janë printuar me të dhënat përkatëse. Njoftimi i fituesve, sipas sasive dhe çmimeve të raportit të sistemit elektronik, është bërë me nr. 2672/11 prot., datë 10.09.2021. Për lot 1, nuk është plotësuar sasia e energjisë, pasi janë skualifikuar dy dy oferta me çmim relativisht të lartë 172.59 dhe 175.38 Euro/MẀh. Urdhri për blerjen e energjisë së pa plotësuar mban urdhrin nr. 2697 prot., datë 10.09.2021. Komisioni i blerjes është me përbërje të njëjtë. Afati i paraqitjes së ofertave është vendosur ora 15$^{00}$ e datës 10.09.2021. Pas paraqitjes së ofertave është kërkuar optimizim, Është shpallur një ofertë fituese me çmim 163.75 Euro/MẀh, ofertë më e ulët se ofertat e refuzuara.
Bazuar në raportet e paraqitura, sasia e energjisë e lëvruar nga OSHEE është e njëjtë me atë të përcaktuar në kontratën dhe anekset përkatëse të nënshkruara.
Në procedurat e zhvilluara për muajin shtator 2021, konstatohet se në ofertën e parë ofertuesit paraqesin oferta për sasi të vogla, të cilat i rrisin, pas kërkesës për optimizim.

3. Për periudhën nga data 20.09.2021 deri datë 26.09.2021.
Nga ana e KESH, për periudhën nga data 20.09.2021 deri datë 26.09.2021, është konfirmuar furnizimi me energji elektrike në sasinë 6000 MẀh në ditë. Bazuar në sasinë e nevojshme për furnizimin e klientit fundor, është planifikuar blerja e energjisë me dy lote si më poshtë:
Lot 1, (00$^{00}$ deri 24$^{00}$), për sasinë 42480 MẀh.
Lot 2, (07$^{00}$ deri 23$^{00}$), për sasinë 20160 MẀh.
Komisioni i blerjes së ënërgjisë është ngritur me Urdhër nr. 2753/1 prot., datë 17.09.2021, me përbërje znj. E D, z. V D dhe z. A Gj. Ftesa për pjesëmarrje është bërë me nr. 2753/2 prot., datë 17.09.2021. Pas paraqitjes së ofertave, është bërë kërkesë për optimizim si për çmimin ashtu edhe për sasinë e energjisë elektrike, oferta të cilat janë paraqitur me ulje çmimi dhe rritje të sasisë. Njoftimi i fituesve është bërë me nr. 2573/11 prot., datë 17.09.2021.

Bazuar në çmimin ditor të bursës për muajin shtator 2021, çmimin ditor të blerjes nga OSHEE po për këtë muaj, si dhe sasisë së blerë rezulton si më poshtë:

| Data | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HUPX | 20.09 | 38.83 | 41.75 | 40.87 | 40.37 | 41.10 | 37.22 | 34.45 | 46.38 | 48.01 | 50.70 | 56.65 | 57.78 | 43.91 | 43.19 |
| OSHEE | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 47.59 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 | 48.74 |
| OSHEE | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4320 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 | 4800 |
| HUPX | 86772.6 | 167745.6 | 180360 | 176553 | 174387.6 | 177541.2 | 160779.6 | 165360 | 222638 | 230468 | 243366 | 271934 | 277336 | 210756 | 207334 |
| OSHEE | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 205588.8 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 | 233952 |
| Diferen. | 118816.2 | 37843.2 | 25228.8 | 29035.8 | 31201.2 | 28047.6 | 44809.2 | 68592 | 11314 | 3484 | -9414 | -37982 | -43384 | 23196 | 26618 |

| Data | 16 | 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| HUPX | 55.04 | 49.36 | 48.92 | 50.15 | 49.74 | 39.87 | 38.15 | 61.59 | 55.24 | 56.78 | 65.57 | 79.59 | 63.99 | 54.21 | 56.92 |
| OSHEE | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 52.31 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 | 62.18 |
| OSHEE | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 5520 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 | 6720 |
| HUPX | 303820.8 | 272464 | 270059 | 276821 | 274576.3 | 220084 | 210574 | 413898.8 | 371201 | 381558.8 | 440636 | 534814 | 430035 | 364271 | 382522 |
| OSHEE | 288751.2 | 288751 | 288751 | 288751 | 288751.2 | 288751 | 288751 | 417849.6 | 417849 | 417849.6 | 417849 | 417849.6 | 417849.6 | 417849.6 | 417849 |
| Diferen. | -15069.6 | 16287 | 18692 | 11930 | 14174.9 | 68667 | 78177 | 3950.8 | 46648 | 36290.8 | -22787 | -116964 | -12185.4 | 53578.6 | 35327 |

Burimi: FTL sh.a, përpunuar nga Grupi i Auditimit.

Sa më sipër rezulton se energjia e blerë nga ana e OSHEE ka referuar bursës HUPX, mbi bazën e profilit 24 orë kushton 8,100,671 Euro, ndërsa është blerë nga ana e OSHEE me vlerë 8,674,793 Euro, me një disferencë në rritje me vlerë 574,122.1 Euro. Theksojmë se në këtë vlerë përfshihet pagesa e transmetimit të energjisë elektrike dhe fitimi i kompanive të cilat tregëtojnë energjinë elektrike, duke qenë se OSHEE nuk ka akses të drejtpërdrejtë në bursë.

**c. Mbi blerjen e energjisë elektrike për vitin 2022.**

Departamenti i Furnizimit pas analizës së klientëve TM 35 kV të cilët nuk kanë siguruar furnizues në tregun e lirë dhe për t'iu ofruar një çmim të shitjes së energjisë, të sigurohet në treg të pa rregulluar sasia e energjisë elektrike për periudhën total viti 2022, për sasinë 17,520 MẀh, në orar $00^{00}$ deri $24^{00}$, nga e hëna në të djelë.

Urdhri për blerjen e energjisë elektrike mban nr. 3941 prot., datë 30.12.2021. Komisioni i blerjes së energjisë elektrike përbëhet nga z. R B, znj. V D z. A Gj. Ftesa për ofertë është bërë më nr. 3941/2 prot., datë 31.12.2021.

Kanë paraqitur oferta 3 subjekte. Mesatarja e çmimit të paraqitur është 240 Euro/MẀh. Është kontraktuar çmimi më i ulët për gjithë sasinë 229.91 Euro/MẀh. Për këtë periudhë është kontraktuar energji në sasinë 17,520 MẀh, me vlerë 4,028,023.2 Euro. Bazuar në të dhënat e HUPX për vitin 2022, rezulton se çmimi i blerjes së energjisë elektrike i kontraktuar është më i ulët se mesatarja e vitit 2022 e tregtuar në bursën përkatëse.

Kontrata e furnizimit është nënshkruar me nr. 3941/11 prot., datë 30.12.2021. Bazuar në dokumentacionin në dispozicion, lëvrimi i sasive është bërë sipas përcaktimeve në kontratën e furnizimit (periudha e konsoliduar janar-tetor 2022).

Bazuar në VKM nr. 620, datë 22.10.2021 "Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për për përballimin e parandalimin e saj", plotësimi i nevojave pë furnizim me energji elektrike bëhet nga KESH SHA.

**Auditim mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike nga subjektet PPE që ushtrojnë aktivitet të prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike,** bazuar në:

- Ligjin Nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*",
- Ligjin Nr. 138/2013 "*Për burimet e energjisë së rinovueshme*"
- Ligjin nr. 7/2017 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*"
- VKM Nr. 822, datë 7.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*", i ndryshuar
- Vendimi i ERRE NR.120, Datë 27.07.2017 "*Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 mŵ dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 mŵ*".
- VKM Nr. 369, datë 26.4.2017 "*Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era*".
- VKM Nr. 244, datë 30.3.2016 "*Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*", i ndryshuar.

-VKM nr. 883, datë 27.12.2019 "*Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*".

-Sistemit të Informacionit Gjeografik Fotovoltaik të Komisionit Evropian (PVGIS), i cili përdor të dhëna të rrezatimit diellor me cilësi të lartë të marra nga imazhet satelitore, si dhe temperaturën e ambientit dhe shpejtësinë e erës nga modelet e rianalizimit të klimës. Modeli i rendimentit të energjisë është vërtetuar nga matjet e kryera në modulet komerciale në Instalimin Evropian të Testit Diellor të JRC (ESTI). ESTI është një laborator kalibrues fotovoltaik i akredituar sipas ISO 17025 për të gjitha materialet fotovoltaike. https://commission.europa.eu/index_en. PVGIS ofron një akses të lirë dhe të hapur në internet në të dhënat e rrezatimit diellor dhe të temperaturës dhe në mjetet e vlerësimit të performancës PV për çdo vend në Evropë dhe Afrikŵ, si dhe një pjesë të madhe të Azisë dhe Amerikŵs. Dokumentacioni PVGIS është vendosur në qendrën shkencore të BE-së.

- Kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjketeve PPE.

Nga auditimi u konstatuan mangësi e shkelje si më poshtë:

**1.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Financim, projektim, ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i* ***Centralit Fotovoltaik Topojë"***, me mbajtësin e miratimit shoqëria ***"S"shpk***, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. E K sipas Autorizimit të Ministrit nr. 5585/8 prot. datë 13.09.2017 dhe mbajtësi i miratimit nr. ***5585/5 prot. Datë 11.09.2017***, shoqëria "S" shpk me Nipt L......C, njësia Administrative Topojë, përfaqësuar nga Znj. I Ç, nënshkruajnë kontratën me nr. 2278 Rep, nr. 1052/3 Kol, datë 12.10.2017, me objekt "*Financim, projektim, ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit* ***Fotovoltaik Topojë".*** Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "S" shpk nr. 5585/5 prot. datë 11.09.2017, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues **1,998 Kŵ**.

Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier*" janë:
Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me kŵto koordinata:
X= 4517118.218 X= 4517196.550
Y= 4364267.519 Y= 4364111.74
X= 4517244.682 X= 4517323.403
Y= 4364331.202 Y= 4364174.623, në Bashkinë Fier. Sipërfaqa totale e mësipërme është 144,000 $m^2$, nën administrimin e shoqërisë "A G E" sha, me nr pasurie 55, në zonën kadastrale 3308, Fier, sipas "Certifikatës për dhënie me qira", lëshuar nga zyra e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier datë 30.06.2015. Parametrat teknik dhe energjitikŵ të centralit do të jenë:
-Fuqia e Instaluar (Kŵ) N = 1,998 Kŵ
-Energjia mesatare vjetore (kŴh) E = 3,000,000 kŴh/vit
Referuar nenit 4 të kontratës "*Kohëzgjatja e kontratës*", është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERRE nr. 118, datë 04.06.2018, i jepet licensa subjektit "S" shpk, për veprimetarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 1,998 kŴ me 8,400 njësi gjeneruese.
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë "S"shpk, është nënshkruar me nr. 22809/1 prot. Datë 15.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sha. dhe shitësit energjisëshoqërisë "S"shpk, nga data e lidhje 17.12.2018 deri 16.12.2033, me cmim **100 Euro/MŴH.**
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL sha dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë "S"shpk, është nënshkruar me nr. 227/114 prot. Datë 23.01.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisëshoqërisë "S"shpk, sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar të vëna në dispozicion nga FTL sh.a mbi prodhimin e energjisë elektrike nga ky central fotovoltaik, nga përllogaritjet e bëra nga Grupi i Auditimit, si dhe nga të dhënat e sistemit PVGIS, rezulton si më poshtë:

| **Nr** | | **Parashikim i 2021** | **Parashiki mi 2022** | **Realizimi 2020** | **Realizimi 2021** | **Realizimi 2022** | Prodhimi PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prodhimi mujor (kŵh)** | **Janar** | 270,200 | 186,220 | 214,130 | 165,410 | 232,330 | 191,881 |
| | **Shkurt** | 194,110 | 229,680 | 273,490 | 240,100 | 272,370 | 195,117 |
| | **Mars** | 374,360 | 337,370 | 332,360 | 367,780 | 353,430 | 269,646 |
| | **Prill** | 350,840 | 366,080 | 387,800 | 367,850 | 396,130 | 290,433 |
| | **Maj** | 380,450 | 446,380 | 412,790 | 463,540 | 463,190 | 318,770 |
| | **Qershor** | 438,690 | 473,880 | 477,330 | 479,990 | 461,370 | 327,658 |
| | **Korrik** | 449,680 | 496,540 | 503,580 | 484,750 | 507,010 | 352,158 |
| | **Gusht** | 450,310 | 460,460 | 463,960 | 443,730 | 443,940 | 343,974 |
| | **Shtator** | 338,170 | 356,730 | 355,670 | 371,140 | 373,590 | 292,372 |
| | **Tetor** | 305,760 | 277,750 | 287,420 | 292,110 | 317,520 | 256,078 |
| | **Nentor** | 153,020 | 193,710 | 244,790 | 154,910 | 177,240 | 188,419 |
| | **Dhjetor** | 156,730 | 158,180 | 141,610 | 169,400 | 164,794 | 178,058 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 3,862,320 | 3,982,980 | 4,094,930 | 4,000,710 | 4,162,914 | **3,204,564** |
| **PVGIS - Progresivin (kW/h)** | | | | -890,366 | -796,146 | -958,350 | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h)** | | | | **89,037** | **79,614** | **95,835** | **264,486 Euro** |

- Nga sa pasqyrohet në tabelën e mësipërme, nga përllogaritja vjetore, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin në 3.204.564 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka**

**prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,162,914 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrohet përllogaritja vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem:







__**Sa më sipër**__, referuar programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali, fuqisë së instaluar sipas kontratës me MIE, nga operatori ekonomik për periudhën objekt auditimi është prodhuar më tepër me një efekt ekonomik në vlerën prej __**264,486 Euro.**__

**2.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Per ndërtim ,shfrytëzimin dhe administrimin e* ***Centralit Fotovoltaik Tren – Bilisht*****"**, me mbajtësin e miratimit shoqëria *"R"shpk*, konstatohet:
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. E K sipas Autorizimit të Ministrit nr. 11823 prot. datë 19.09.2018 dhe mbajtësi i miratimit, shoqëria "R" shpk me Nipt L.....U, Bilisht, Korcë përfaqësuar nga përfaqëuesi ligjor Z. S R, nënshkruajnë kontratën me nr. 2156 Rep, nr. 1152/1 Kol, datë 08.10.2018, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim, dhe administrim të centralit fotovoltaik Tren-Bilisht, Korcë*"**.** Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "R" shpk, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik ***Tren – Bilisht***, me kapacitet prodhues **2MŴ.**

Referuar nenit 3 të kontratës “*Të dhënat të përgjithshme Centralit Fotovoltaik Tren – Bilisht”,* janë:

Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me kŵto koordinata:

X= 497545.709 Y= 4501062.2014
Y= 497845.9 Y= 4501079.57
X= 497660.42 Y= 4501256.83
Y= 497477.33 Y= 4501080.45, në Bashkinë Korce. Sipërfaqja totale nuk paraqitet në të dhënat e dosjes. Parametrat teknik dhe energjitikë të centralit do të jenë:

- Fuqia e Instaluar (kŵ) - N = 2000 kŵ
- Energjia mesatare vjetore (kŵh) - E = 3,000,000 kŵh/vit

Referuar nenit 4 të kontratës “*Kohëzgjatja e kontratës*”, është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 13 datë 31.01.2019, i jepet licensa subjektit “R” shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŵ me 17 njësi gjeneruese.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL sha dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë “R”shpk, është nënshkruar me nr. 224/1 prot. Datë 28.02.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisë shoqërisë “R”shpk, me ëmim **100 Euro/MŴH**, sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| **Nr** | | **Parashikimi 2021** | **Parashikimi 2022** | **Realizimi 2020** | **Realizimi 2021** | **Realizimi 2022** | **PVGIS** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prodhimi mujor (kŵh)** | **Janar** | 160,000 | 160,000 | | 164,276 | 250,544 | 123,558 |
| | **Shkurt** | 250,000 | 250,000 | | 258,748 | 247,352 | 146,206 |
| | **Mars** | 330,000 | 330,000 | 317,436 | 328,244 | 324,828 | 229,658 |
| | **Prill** | 400,000 | 400,000 | 296,632 | 332,556 | 349,272 | 266,418 |
| | **Maj** | 400,000 | 400,000 | 393,176 | 413,840 | 429,996 | 287,031 |
| | **Qershor** | 400,000 | 400,000 | 363,384 | 401,576 | 406,168 | 299,399 |
| | **Korrik** | 400,000 | 400,000 | 416,052 | 423,136 | 443,828 | 329,079 |
| | **Gusht** | 400,000 | 400,000 | 407,540 | 426,132 | 373,716 | 323,613 |
| | **Shtator** | 320,000 | 320,000 | 350,420 | 322,140 | 353,836 | 267,782 |
| | **Tetor** | 250,000 | 250,000 | 308,784 | 257,740 | 358,764 | 222,712 |
| | **Nentor** | 250,000 | 250,000 | 252,168 | 152,460 | 195,356 | 156,593 |
| | **Dhjetor** | 150,000 | 150,000 | 121,996 | 187,488 | 165,200 | 120288 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 3,710,000 | 3,710,000 | 3,227,588 | 3,668,336 | 3,898,860 | 2,772,337 |
| PVGIS - Progresivi (kW/h) | | | | -455,251 | -895,999 | -1,126,523 | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h)** | | | | **45,525** | **89,599** | **112,652** | **247,776** |

- Nga sa pasqyrohet në tabelën e mësipërme, nga përllogaritja vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin në 2,772,337 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 3898,860 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrojmë përllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV







**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke u referuar dhe vendodhjes gjeografike ku shtrihet centrali, rezulton se nga Operatori ekonomik, është prodhuar më tepër me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>247,776 Euro.</u>**

**3.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i* ***Centralit Fotovoltaik Plug*****"**, me mbajtësin e miratimit shoqëria ***"AEE"shpk***, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. E K sipas Autorizimit të Ministrit nr. 3867/8 prot. datë 13.09.2017 dhe mbajtësi i miratimit nr. ***3867/7 prot. Datë 25.08.2017***, shoqëria "A. S." shpk me Nipt K......D, Qarku Fier, përfaqësuar nga Z. B L, nënshkruajnë kontratën me nr. 2280 Rep, nr. 1053/3 Kol, datë 13.10.2017, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit Fotovoltaik Plug, me kapacitet prodhues 2000 kŵ në Bashkinë Lushnjë, Qarku Fier*".

Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria “AEE” shpk nr. 3867/7 prot. datë 25.08.2017, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik Plug, me kapacitet prodhues **2000kŵ**.
Referuar nenit 3 të kontratës “***Centralit Fotovoltaik Plug***” janë:
Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me kŵto koordinata:
X= 40 57 46.2 X= 40 57 49
Y= 19 37 15.9 Y= 19 37 22.1
X= 40 57 40.9 X= 40 57 43.8
Y=19 37 20.1 Y= 19 37 26.2, në Bashkinë Lushnje. Numri i pasurisë21/1 dhe 21/2, në zonën kadastrale 2999, Fier. Parametrat teknik dhe energjitik të centralit do të jenë:
- Fuqia e Instaluar (kŵ) - N = 2000 kŵ
- Energjia mesatare vjetore (kŵh) -E = 3,000,000 kŵh/vit.

Referuar nenit 4 të kontratës “*Kohëzgjatja e kontratës*”, është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 209 datë 27.09.2018, i jepet licensa subjektit “AEE” shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŵ me njësi gjeneruese të pa përcaktuara.
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë “AEE” shpk, është nënshkruar me nr. 9572/1 prot. Datë 29.05.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE SH.A. dhe shitësit energjisë shoqërisë “AEE” shpk, nga data e lidhje 29.05.2019 deri 28.05.2034, me cmim **100 Euro/MẀH**. Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL SH.A dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë “AEE” shpk, është nënshkruar me nr. 227/124 prot. Datë 23.01.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisëshoqërisë “AEE” shpk, sipas legjislacionit në fuqi.
Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| **Nr** | | **Parashikimi 2021** | **Parashikimi 2022** | **Realizimi 2020** | **Realizimi 2021** | **Realizimi 2022** | **PVGIS** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Prodhimi mujor (kŵh)** | **Janar** | 177,000 | 191,000 | 177,000 | 191,700 | 251,700 | 186,664 |
| | **Shkurt** | 224,000 | 239,000 | 224,100 | 239,100 | 341,100 | 191,516 |
| | **Mars** | 289,000 | 362,000 | 289,200 | 362,400 | 362,400 | 262,069 |
| | **Prill** | 360,000 | 471,000 | 360,600 | 471,300 | 398,100 | 281,779 |
| | **Maj** | 390,000 | 520,000 | 390,000 | 543,000 | 510,000 | 311,010 |
| | **Qershor** | 458,000 | 520,000 | 457,800 | 489,300 | 514,500 | 322,400 |
| | **Korrik** | 520,300 | 530,000 | 520,200 | 519,300 | 563,100 | 348,361 |
| | **Gusht** | 470,200 | 520,000 | 470,100 | 565,500 | 466,500 | 338,993 |
| | **Shtator** | 367,500 | 430,000 | 367,800 | 407,400 | 426,900 | 287,871 |
| | **Tetor** | 287,500 | 380,000 | 287,700 | 340,800 | 353,400 | 252,983 |
| | **Nentor** | 145,000 | 280,000 | 211,800 | 161,700 | 181,200 | 187,647 |
| | **Dhjetor** | 157,000 | 244,000 | 189,900 | 177,300 | 146,100 | 176837 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 3,845,500 | 4,687,000 | 3,545,100 | 4,470,821 | 4,515,000 | 3,148,130 |
| **PVGIS - Progresivi (kW/h)** | | | | **-396,970** | **-1,322,691** | **-1,366,870** | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h)** | | | | **39,697** | **132,269** | **136,687** | **308,653** |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,148,130 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,515,000 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrojmë përllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV.






**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali, fuqisë së instaluar sipas kontratës me MIE, nga operatori ekonomik për periudhën objekt auditimi është është prodhuar më tepër me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>308,653 Euro.</u>**

**4.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i **Centralit Fotovoltaik Topojë**"*, me mbajtësin e miratimit shoqëria ***"A S" shpk***, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. E K sipas Autorizimit të Ministrit nr. 5789/5 prot. datë 13.09.2017 dhe mbajtësi i miratimit, shoqëria "A S" shpk me Nipt L.........Q, njësia Administrative Topojë, përfaqësuar nga Z. B Ll, nënshkruajnë kontratën me nr. 2277 Rep, nr. 1051/3 Kol, datë 12.10.2017, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit **Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues 1998 kŵ**"*. Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "A S" shpk, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues **1,998 k**ŵ. Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier*" janë:

Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me kŵto koordinata:

X= 4517249.148 X= 4517327.882

Y= 4364333.451 Y= 4364176.845

X= 4517374.986 X= 4517454.108
Y= 4364396.819 Y= 4364239.443, në Bashkinë Fier. Sipërfaqa totale nuk është përcaktuar në dosje. Parametrat teknik dhe energjitik të centralit do të jenë:

- Fuqia e Instaluar (kŵ) - N = 1,998 kŵ
- Energjia mesatare vjetore (kŵh) - E = 3,000,000 kŵh/vit

Referuar nenit 4 të kontratës "*Kohëzgjatja e kontratës*", është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 85 datë 20.04.2018, i jepet licensa subjektit "A S" shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 1,998 kŵ me 8,400 njësi gjeneruese.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë "A S"shpk, është nënshkruar me nr. 22719/1 prot. Datë 15.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sha. dhe shitësit energjisëshoqërisë "A S"shpk, nga data e lidhje 17.12.2018 deri 16.12.2033, me cmim **100 Euro/MŴH**. Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL sha dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë "A S" shpk, është nënshkruar me nr. 227/12 prot., datë 23.01.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisë shoqërisë "A S"shpk, sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| Nr | | Parashikimi 2021 | Parashikimi 2022 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi mujor (kŵh) | Janar | 186,220 | 186,220 | 221,410 | 164,080 | 230,650 | 191,881 |
| | Shkurt | 229,680 | 229,680 | 274,260 | 238,980 | 271,040 | 195,117 |
| | Mars | 337,370 | 337,370 | 331,030 | 364,840 | 351,960 | 269,646 |
| | Prill | 366,080 | 366,080 | 388,290 | 366,870 | 395,500 | 290,433 |
| | Maj | 446,380 | 446,380 | 414,330 | 462,420 | 463,260 | 318,770 |
| | Qershor | 473,880 | 473,880 | 475,370 | 478,310 | 461,160 | 327,658 |
| | Korrik | 496,540 | 496,540 | 505,610 | 485,310 | 506,940 | 352,158 |
| | Gusht | 460,460 | 460,460 | 464,310 | 444,150 | 444,010 | 343,974 |
| | Shtator | 356,730 | 356,730 | 353,430 | 371,140 | 374,150 | 292,372 |
| | Tetor | 277,750 | 277,750 | 287,210 | 291,830 | 316,890 | 256,078 |
| | Nentor | 193,710 | 193,710 | 243,950 | 154,140 | 176,540 | 188,419 |
| | Dhjetor | 158,180 | 158,180 | 140,490 | 168,141 | 163,765 | 178058 |
| Progresivi (kŵh) | | 3,982,980 | 3,982,980 | 3,604,020 | 3,990,211 | 4,155,865 | 3,204,564 |
| PVGIS - Progresivi (kW/h) | | | | **-399,456** | **-785,647** | **-951,301** | |
| Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h) | | | | **39,945** | **78,564** | **95,130** | **213,639** |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,204,564 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,155,865 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrojme perllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilen është vendosur Centrali, kendin si dhe humbjet që ka ky central PV.







**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali, fuqisë së instaluar sipas kontratës me MIE, nga operatori ekonomik për periudhën objekt auditimi është prodhuar më tepër, me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>213,639 Euro.</u>**

**5.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i* ***Centralit Fotovoltaik në zonën Sheq Marinas*****"**, me mbajtësin e miratimit shoqëria *"O E"shpk*, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. A Dh sipas Autorizimit të Ministrit nr. 3887/4 prot. datë 29.12.2017 dhe mbajtësi i miratimit, shoqëria "O E" shpk me Nipt L.....E, zona Sheq Marinas, përfaqësuar nga Z. H A, nënshkruajnë kontratën me nr. 1163 Rep, nr. 376 Kol, datë 29.12.2017, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit "S", me kapacitet prodhues 2000 kŵ në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier*".

Me shkresën Nr.3245/1 Prot., datë 20.04.2018 është miratuar transeferimi i të drejtave dhe detyrimeve që shoqëria "O E" shpk disponon në respekt të Miratimit përfundimtar Nr.3887/2 prot., datë 23.12.2017 "për ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit "S", me kapacitet prodhues 2000 kŵ në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier, në favor të shoqërisë "S S" shpk.

Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "S S" shpk, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik Sheq Marinas, me kapacitet prodhues **2000 k**ŵ.

Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik në zonën Sheq Marinas, Qarku Fier*" janë:

Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me këto koordinata:

X= 4517111.223 Y= 4363824.672

X= 4517025.013 Y= 4363988.357
X= 4517164.885 Y= 4364058.03
Y= 4517250.799 Y= 4363894.908, në Bashkinë Fier. Sipërfaqa totale e mësipërme është 100,000 $m^2$, nën administrimin e shoqërisë "O E" Sh.p.k., me nr. pasurie 556/2, në zonën kadastrale 3358, Fier, sipas "Certifikatës së pronësisë", lëshuar nga zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier datë 21.12.2017. Parametrat teknik dhe energjitikë të centralit do të jenë:
- Fuqia e Instaluar (kŵ), - N = 2000 kŵ,
- Energjia mesatare vjetore (kŵh) - E = 2,540,104 kŵh/vit.

Referuar nenit 4 të kontratës "*Kohëzgjatja e kontratës*", është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 113, datë 14.04.2018, dhe Vendimin e ERE nr. 193, datë 30.08.2018 për transferimin e licenës i jepet licensa subjektit "S S" shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŵ me 8,000 njësi gjeneruese.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë "S S" SHPK, është nënshkruar me nr. 1565/1 prot., datë 29.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sha. dhe shitësit energjisë shoqërisë "S S"shpk, nga data e lidhje 24.01.2019 deri 23.01.2034, me çmim **100 Euro/MŴH**.
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL SH.A. dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë "S S" shpk, është nënshkruar me nr. 227/116 prot. Datë 23.01.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisë shoqërisë "S S"shpk, sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| Nr | | Parashikimi 2021 | Parashikimi 2022 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi mujor (kŵh) | Janar | 170,400 | 200,000 | 250,180 | 174,090 | 247,730 | 191,881 |
| | Shkurt | 280,000 | 250,000 | 283,220 | 245,490 | 283,010 | 195,117 |
| | Mars | 300,000 | 340,000 | 323,190 | 366,380 | 357,560 | 269,646 |
| | Prill | 380,000 | 370,000 | 381,430 | 358,820 | 394,380 | 290,433 |
| | Maj | 390,000 | 410,000 | 395,920 | 446,740 | 447,650 | 318,770 |
| | Qershor | 450,000 | 450,000 | 454,720 | 454,650 | 436,940 | 327,658 |
| | Korrik | 480,000 | 460,000 | 479,290 | 461,580 | 482,860 | 352,158 |
| | Gusht | 450,000 | 450,000 | 452,270 | 432,320 | 426,930 | 343,974 |
| | Shtator | 350,000 | 350,000 | 353,780 | 368,270 | 364,560 | 292,372 |
| | Tetor | 290,000 | 310,000 | 294,210 | 298,620 | 324,240 | 256,078 |
| | Nentor | 260,000 | 230,000 | 259,840 | 160,440 | 184,870 | 188,419 |
| | Dhjetor | 160,000 | 170,000 | 150,850 | 182,630 | 176,533 | 178058 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 3,960,400 | 3,990,000 | 3,545,500 | 3,950,030 | 4,127,263 | 3,204,564 |
| **PVGIS - Progresivi (kW/h)** | | | | **-340,936** | **-745,466** | **-922,699** | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h)** | | | | **34,093** | **74,456** | **92,269** | **200,818** |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,204.564 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,127,263 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrojme perllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilen është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV.







**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali, fuqisë së instaluar sipas kontratës me MIE, nga operatori ekonomik për periudhën objekt auditimi është prodhuar më tepër, me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>200,818 Euro.</u>**

**6.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i* ***Centralit Fotovoltaik në zonën Sheq Marinas*****"**, me mbajtësin e miratimit shoqëria *"S S"shpk*, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. A Dh sipas Autorizimit të Ministrit nr. 3888/4 prot. datë 29.12.2017 dhe mbajtësi i miratimit, shoqëria "S S" shpk me Nipt L.......M, zona Sheq Marinas, përfaqësuar nga Z. A K, nënshkruajnë kontratën me nr. 1172 Rep, nr. 380 Kol, datë 29.12.2017, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit* ***"S S", me kapacitet prodhues 2000 kŵ në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier*****".**

Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "S S" shpk, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik Sheq Marinas, me kapacitet prodhues **2000 k**ŵ.

Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik Sheq Marinas"* janë:

Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me kŵto koordinata:

X= 4517111.223 Y= 4363824.672
X= 4517025.013 Y= 4363988.357
X= 4517164.885 Y= 4364058.03
Y= 4517250.799 Y= 4363894.908, në Bashkinë Fier. Sipërfaqa totale e mësipërme është 100,000 $m^2$, nën administrimin e shoqërisë "O E" Sh.p.k., me nr pasurie 556/2, në zonën kadastrale 3358, Fier, sipas "Certifikatës së pronësisë", lëshuar nga zyra e Regjistrimit të pasurive të paluajtshme Fier datë 21.12.2017. Parametrat teknik dhe energjitikŵ të centralit do të jenë:

- Fuqia e Instaluar (kŵ) - N = 2000 kŵ

- Energjia mesatare vjetore (kŵh) - E = 2,540,104 kŵh/vit

Referuar nenit 4 të kontratës "*Kohëzgjatja e kontratës*", është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 114 datë 14.05.2018, i jepet licensa subjektit "S S" shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŵ me 8,400 njësi gjeneruese.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë "S S" shpk, është nënshkruar me nr. 22827/1 prot., datë 15.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sha. dhe shitësit energjisëshoqërisë "S S"shpk, nga data e lidhje 17.12.2018 deri 16.12.2033, me çmim **100 Euro/MŴH**.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL SH.A. dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë "S S" shpk, është nënshkruar me nr. 227/115 prot. Datë 23.01.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisë shoqërisë "S S"shpk, sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| Nr | | Parashiki mi 2021 | Parashiki mi 2022 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi mujor (kŵh) | Janar | 186,220 | 186,220 | 212,030 | 166,250 | 234,220 | 191,936 |
| | Shkurt | 229,680 | 229,680 | 274,400 | 241,150 | 273,490 | 195,152 |
| | Mars | 337,370 | 337,370 | 333,550 | 364,910 | 353,080 | 269,677 |
| | Prill | 366,080 | 366,080 | 387,170 | 368,200 | 397,740 | 290,459 |
| | Maj | 446,380 | 446,380 | 414,540 | 465,360 | 465,850 | 318,800 |
| | Qershor | 473,880 | 473,880 | 483,280 | 482,930 | 463,890 | 327,682 |
| | Korrik | 496,540 | 496,540 | 510,230 | 489,580 | 510,720 | 352,196 |
| | Gusht | 460,460 | 460,460 | 468,720 | 447,650 | 446,600 | 344,009 |
| | Shtator | 356,730 | 356,730 | 357,560 | 372,610 | 372,120 | 292,404 |
| | Tetor | 277,750 | 277,750 | 288,890 | 294,910 | 316,890 | 256,110 |
| | Nentor | 193,710 | 193,710 | 245,840 | 156,730 | 178,430 | 186,464 |
| | Dhjetor | 158,180 | 158,180 | 142,310 | 171,150 | 166,131 | 176113 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 3,982,980 | 3,982,980 | 3,632,090 | 4,021,430 | 4,179,161 | 3,201,002 |
| **PVGIS - Progresivi (kW/h)** | | | | **-431,088** | **-820,428** | **-978,159** | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro/MŴH** | | | | **43,108** | **82,042** | **97,815** | **222,965** |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,201,002 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe i ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,179,161 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrojme përllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV.







**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali, fuqisë së instaluar sipas kontratës me MIE, nga operatori ekonomik për periudhën objekt auditimi është prodhuar më tepër, me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>222,965 Euro.</u>**

**7.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i* ***Centralit Fotovoltaik Topojë*****"**, me mbajtësin e miratimit shoqëria *"S S"shpk*, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. A Dh sipas Autorizimit të Ministrit nr. 4115/5 prot. datë 18.12.2017 dhe mbajtësi i miratimit, shoqëria "S S" shpk me Nipt K...........P, njësia Administrative Topojë, përfaqësuar nga Z. S Ll, nënshkruajnë kontratën me nr. 6299 Rep, nr. 1598 Kol, datë 29.12.2017, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit* ***Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues 2000 kŵ*****".**

Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "S S" shpk, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues **2000 k**ŵ.

Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier*" janë:

Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me këto koordinata:

X= 4517509.042 Y= 4364464.326

X= 4517588.576 Y= 4364306.130

X= 4517633.630 Y= 4364527.064
X= 4517713.548 Y= 4364368.103, në Bashkinë Fier. Sipërfaqa totale e mësipërme është 144,000 $m^2$, nën administrimin e shoqërisë “A G E” sha, me nr pasurie 55, në zonën kadastrale 3358, Fier, sipas “Certifikatës për dhënie me qira”. Parametrat teknik dhe energjitik të centralit do të jenë:

- Fuqia e Instaluar (kŵ) - N = 2000 kŵ
- Energjia mesatare vjetore (kŵh) - E = 3,000,000 kŵh/vit

Referuar nenit 4 të kontratës “*Kohëzgjatja e kontratës*”, është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 86 datë 20.04.2018, i jepet licensa subjektit “*S S*” shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŵ me 8,400 njësi gjeneruese.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë “S S” shpk, është nënshkruar me nr. 22718/1 prot., datë 18.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sha. dhe shitësit energjisë shoqërisë “S S”shpk, nga data e lidhjes 17.12.2018 deri 16.12.2033, me çmim **100 Euro/MŴH**.
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL SH.A. dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë “S S” shpk, është nënshkruar me nr. 227/111 prot. Datë 23.01.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisë shoqërisë “S S”shpk, sipas legjislacionit në fuqi. Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| Nr | | Parashikimi 2021 | Parashikimi 2022 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi mujor (kŵh) | Janar | 186,220 | 186,220 | 218,470 | 167,370 | 247,380 | 191,881 |
| | Shkurt | 229,680 | 229,680 | 278,110 | 242,830 | 290,010 | 195,117 |
| | Mars | 337,370 | 337,370 | 333,620 | 369,670 | 371,630 | 269,646 |
| | Prill | 366,080 | 366,080 | 391,020 | 370,790 | 415,870 | 290,433 |
| | Maj | 446,380 | 446,380 | 417,830 | 466,760 | 486,430 | 318,770 |
| | Qershor | 473,880 | 473,880 | 480,620 | 482,790 | 482,300 | 327,658 |
| | Korrik | 496,540 | 496,540 | 493,710 | 488,670 | 526,960 | 352,158 |
| | Gusht | 460,460 | 460,460 | 468,580 | 448,210 | 465,150 | 343,974 |
| | Shtator | 356,730 | 356,730 | 357,490 | 374,570 | 395,850 | 292,372 |
| | Tetor | 277,750 | 277,750 | 290,430 | 298,200 | 337,750 | 256,078 |
| | Nentor | 193,710 | 193,710 | 250,670 | 161,490 | 189,140 | 188,419 |
| | Dhjetor | 158,180 | 158,180 | 143,850 | 177,940 | 174,965 | 176058 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 3,982,980 | 3,982,980 | 3,627,820 | 4,049,290 | 4,383,435 | 3,202,564 |
| **PVGIS - Progresivi (kW/h)** | | | | **-425,256** | **-846,726** | **-1,180,871** | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h)** | | | | **42,525** | **84,672** | **118,087** | **245,284** |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,202, 564 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,383,435 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrojme perllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilen është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV.







**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali, fuqisë së instaluar sipas kontratës me MIE, nga operatori ekonomik për periudhën objekt auditimi është prodhuar më tepër, me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>245,284 Euro.</u>**

**8.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Financim, projektim, ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi,* me mbajtësin e miratimit shoqëria *"S ŵ"shpk, konstatohet:*

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar me autorizimin e ministrit Nr. 5864/14 datë 27.12.2018, nga z. A B shtetas shqiptarë lindur më 14.071953 në Gjirokastër banues në Tiranë, mbajtës të letërnjoftimit me ID F.........V, madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe Mbajtësit të Miratimit, Shoqeria S ŵ sh.p.k e regjistruar si person juridik në QKB me nipt L.....B, date regjistrimi 17.11.2017, me seli në Tiranë, Adresa: Bulevardi Zogu i I, Pallati Kirchberger, K.8, Ap 29 përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor z. E B, shtetas shqiptar, i lindur në Tiranë, më 26.08.1985 dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me Nr. 027482509, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar lidhin kontratën me nr. 6380 Rep, nr. 2756 Kol, datë 31.12.2018, me objekt "*Financim, projektim, ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit* ***Fotovoltaik S ŵ*"**.

Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "S ŵ" shpk nr. 5864/11 prot. datë 14.11.2018, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik S ŵ, me kapacitet prodhues **2000 kŵ.**

Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik S ŵ,zona Sheq Marinas, Topoje Fier*" janë:
Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me këto koordinata:
X=363779.699 Y= 4517353.355
X= 364738.814 Y= 4518147.105
Vëndi sipas kordinatave të më siperme ku do të ndërtohet Centrali Fotovoltaik S.ŵ Shpk është tokë e regjistruar në regjistrin hipotekor me Nr 1480063, dt.07.12.2017 me numër pasurie 556/1, ndodhet në zonën kadastrale Nr. 3358, sipas "Certifikatës për dhënie me Qera" lëshuar nga Zyra e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme Fier më datë 24.05.2018.
Parametrat teknik dhe energjitik të centralit do të jenë:
- Fuqia e Instaluar (Kŵ ) N= 2000 Kŵ
- Energjia mesatare vjetore (kŴh) - E = 3,136,000 kŴh/vit

Referuar nenit 4 të kontratës "*Kohëzgjatja e kontratës*", është përcaktuar për një afat 49 vjetësh me të drejtë përseritje sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni.
Me vendimin e ERE nr. 72 datë 26.03.2018, i jepet licensa subjektit "S.ŵ" shpk, për veprimtarinë e tregtimit, dhe vendimit me nr. 72, datë 10.05.2019 për prodhimin e energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŴ.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë "S.ŵ"shpk, është nënshkruar me nr. 932/3 prot., datë 01.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sha. dhe shitësit energjisëshoqërisë "S.ŵ"shpk, nga data e lidhje 17.12.2020 deri 16.12.2035, me cmim **100 Euro/MŴH.**
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL sha dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë "S.ŵ "shpk, është nënshkruar me nr. 324/1 prot., datë 27.02.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL dhe shitësit energjisë shoqërisë "S.ŵ"shpk, sipas legjislacionit në fuqi.

Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| Nr | | Parashikimi 2022 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi mujor (kŵh) | Janar | 187,550 | | 187,548 | 273,823 | 211,602 |
| | Shkurt | 271,440 | | 271,443 | 310,188 | 215,170 |
| | Mars | 410,940 | | 410,935 | 392,858 | 297,360 |
| | Prill | 382,690 | | 382,690 | 432,477 | 320,283 |
| | Maj | 473,930 | | 473,393 | 491,820 | 351,532 |
| | Qershor | 475,200 | | 487,795 | 482,492 | 361,334 |
| | Korrik | 489,200 | | 502,250 | 528,675 | 388,353 |
| | Gusht | 457,800 | | 466,638 | 468,090 | 379,327 |
| | Shtator | 404,900 | | 397,285 | 406,560 | 322,422 |
| | Tetor | 324,800 | | 327,898 | 356,300 | 282,397 |
| | Nentor | 226,200 | 78,488 | 177,275 | 202,808 | 207,784 |
| | Dhjetor | 194,200 | 164,553 | 203,543 | 192,920 | 196358 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 4,298,850 | 243,041 | 4,288,693 | 4,539,010 | 3,533,922 |
| **PVGIS - Progresivi (kW/h)** | | | | **-754,771** | **-1,005,088** | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h)** | | | | **75,477** | **100,508** | **175,985** |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,533,922 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,539,010 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e**

**instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Ndërkohë në mënyre analitike prodhimi vjetor mesatar duke u bazuar në të dhënat teknike të paisjeve (paneleve dhe inverterave) si dhe këndit të rrezatimit per koordinat ku shtrihet centrali fotovoltaik llogariten si më poshtë:

| **Formule Llogaritese :** | | **E = A * r * H * PR** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| E = Energjia e prodhuar nga sistemi (kŵh) | | | | | | | 3523014 | kŵh/an |
| A =Siperfaqa totale (m²) | | | | | | | 16500 | m² |
| r = Rendimenti I panelit (%) | | | | | | | 18% | |
| H = Rrezatimi mesatar vjetor (Hijet nuk perfshihen)* | | | | | | | 1977 | kŵh/m².an |
| PR = Raporti I performances, koificenti humbjeve | | | | | | | 0.60 | |
| | | | | | | | | |
| | | | | | | Fuqia totale e sistemit | 2000.0 | Kŵp |




- Më poshtë po pasqyrojme perllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilen është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV.






**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke u referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali dhe llogaritjeve analitike me anë të formulës së prodhimit të energjisë nga centrali, rezulton se për periudhën objekt auditimi nga operatori ekonomik është prodhuar më tepër, me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>175,985 Euro.</u>**

**9.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *“Financim, projektim, ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi,* me mbajtësin e miratimit shoqëria *“L”shpk*, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar me autorizimin e ministrit Nr. 9310/4 Prot.. datë 21.12.2018, nga Znj. E K, shtetase shqiptare, lindur më 29.03.1972 në Vlore, banuese në Tiranë, mbajtës të letërnjoftimit me ID H.......H dhe nr. Letërnjoftimi 028001010, madhorë me zotësi të plotë juridike për të vepruar dhe Mbajtësit të Miratimit, Subjekti "E Xh" e regjistruar si person fizik në QKB me Nipt K.....I, datë regjistrimi 09.05.2000, me seli në Tiranë, Rruga Mihal Duri, Shqipëri, përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor Znj. E Xh, shtetase shqiptare, lindur në Gramsh, më 04.07.1966, mbajtës i Letërnjoftimit ID, me Nr personal G.....J dhe nr. Letërnjoftimit 0.....2, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, lidhin kontratën me nr. 6583Rep, nr. 2075 Kol, datë 29.12.2018, me objekt “*Financim, projektim, ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit Fotovoltaik "**L**”***.

MIE me Miratimin Perfundimtar Nr. 9310/2 prot., datë 19.12.2018 "Për ndërtimin e një burimi të ri gjenerues të energjisë elektrike centralit Fotovoltaik "L", në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, ka miratuar ndërtimin e centralit Fotovoltaik "L" me

kapacitet prodhues 2 MŴ në favor të subjektit "E Xh" me kordinata sipas përcaktimit të dhënë në nenin 3 të kësaj kontrate.
Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik "L",zona Sheq Marinas, Topoje Fier*" janë:
Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me këto koordinata:
Pika 1: X= 4516047.0955 Y= 364199.1001
Pika 2: X= 4515964.9752 Y= 364361.9031
Pika 3: X= 4515655.3755 Y= 364001.5106
Pika 4: X= 4515573.2537 Y= 354164.3165

Vëndi sipas kordinatave të më siperme ku do të ndërtohet Centrali Fotovoltaik "L" është tokë e regjistruar në regjistrin hipotekor me numër pasurie 556/1, ndodhet në zonën kadastrale Nr. 3358, Bashkia Fier, Qarku Fier.
Parametrat teknik dhe energjitike të centralit do të jenë:
- Fuqia e Instaluar (Kŵ ) N= 2000 Kŵ
- Energjia mesatare vjetore (kŴh) - E = 3,000,000 kŴh/vit

Referuar nenit 4 të kontratës "*Kohëzgjatja e kontratës*", është përcaktuar për një afat 49 vjetësh me të drejtë ripërsëritje sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni.
Me vendimin e ERE nr. 87 datë 31.05.2019, i jepet licensa subjektit "E. Xh." shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŴ
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe shoqërisë "L"shpk, është nënshkruar me nr. 932/1 prot., datë 15.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sha. dhe shitësit energjisë shoqërisë "L"shpk, me çmim **100 Euro/MŴH.**
- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL sha dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë "L"shpk, është nënshkruar me nr. 323/2 prot., datë 27.02.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL sh.a dhe shitësit të energjisë shoqërisë "L, sipas legjislacionit në fuqi.
Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| Nr | | Parashikimi 2022 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi mujor (kŵh) | Janar | 188,090 | | 188,090 | 274,313 | 190,571 |
| | Shkurt | 271,500 | | 271,495 | 312,060 | 197,618 |
| | Mars | 414,100 | | 414,103 | 395,273 | 280,784 |
| | Prill | 385,010 | | 385,018 | 435,278 | 311,986 |
| | Maj | 475,800 | | 475,825 | 496,020 | 352,739 |
| | Qershor | 486,500 | | 488,233 | 484,033 | 370,485 |
| | Korrik | 491,300 | | 504,560 | 531,108 | 398,664 |
| | Gusht | 457,900 | | 470,663 | 470,015 | 380,306 |
| | Shtator | 405,100 | | 399,403 | 408,678 | 307,891 |
| | Tetor | 324,900 | | 329,473 | 356,440 | 262,906 |
| | Nentor | 226,300 | 78,365 | 178,185 | 203,648 | 191,206 |
| | Dhjetor | 194,300 | 165,498 | 199,395 | 193,060 | 176,341 |
| Progresivi (kŵh) | | 4,320,800 | 243,863 | 4,304,443 | 4,559,923 | 3,421,497 |
| PVGIS - Progresivi (kW/h) | | | | -882,946 | -1,138,426 | |
| Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h | | | | 88,294 | 113,842 | 202,136 |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, kŵndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,421,497 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur**

**FTL sh.a sasinë deri në 4,559,923 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Në mënyre analitike prodhimi vjetor mesatar duke u bazuar në të dhënat teknike të pajisjeve (paneleve dhe inverterave) si dhe këndit të rrezatimit për koordinat ku shtrihet centrali Fotovoltaik llogariten si më poshtë:

**Formule Llogaritese:** $E = A * r * H * PR$

| | | |
|---|---|---|
| E = Energjia e prodhuar nga sistemi (kŵh) | 3419658 | kŵh/an |
| A =Siperfaqa totale ($m^2$) | 16500 | $m^2$ |
| r = Rendimenti I panelit (%) | 18% | |
| H = Rrezatimi mesatar vjetor (Hijet nuk perfshihen)* | 1919 | kŵh/$m^2$.an |
| PR = Raporti I performances, koificenti humbjeve | 0.60 | |
| Fuqia totale e sistemit | 2000.0 | Kŵp |




- Më poshtë po pasqyrojme perllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilen është vendosur Centrali, kendin si dhe humbjet që ka ky central PV.







PVGIS-5 estimates of solar electricity generation:

**Provided inputs:**

| | |
|---|---|
| Latitude/Longitude: | 40.725,19.558 |
| Horizon: | Calculated |
| Database used: | PVGIS-SARAH2 |
| PV technology: | Crystalline silicon |
| PV installed: | 2000 kWp |
| System loss: | 0.75 % |

**Simulation outputs**

| | |
|---|---|
| Slope angle: | 25 ° |
| Azimuth angle: | 0 ° |
| Yearly PV energy production: | 3421602.79 kWh |
| Yearly in-plane irradiation: | 1919.81 kWh/m² |
| Year-to-year variability: | 127334.36 kWh |
| Changes in output due to: | |
| Angle of incidence: | -2.71 % |
| Spectral effects: | 0.78 % |
| Temperature and low irradiance: | -8.42 % |
| Total loss: | -10.89 % |

**Outline of horizon at chosen location:**

**Monthly PV energy and solar irradiation**

| Month | E_m H(i)_m | SD_m |
|---|---|---|
| January | 190671.99.0 | 29129.3 |
| February | 197618.004.0 | 36058.6 |
| March | 280784.851.8 | 40588.8 |
| April | 311986.774.1 | 32728.0 |
| May | 352739.200.6 | 19156.2 |
| June | 370485.915.5 | 17938.8 |
| July | 398664.935.0 | 8620.2 |
| August | 380306.223.7 | 15347.0 |
| September | 307891.576.3 | 17599.6 |
| October | 262906.445.4 | 31774.8 |
| November | 191206.302.4 | 26771.8 |
| December | 176341.92.0 | 31917.7 |

E_m: Average monthly electricity production from the defined system [kWh].
H(i)_m: Average monthly sum of global irradiation per square meter received by the modules of the given system [kWh/m²].
SD_m: Standard deviation of the monthly electricity production due to year-to-year variation [kWh].

PVGIS ©European Union, 2001-2023.
Reproduction is authorised, provided the source is acknowledged, save where otherwise stated.

Report generated on 2023/02/23

**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke u referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali dhe llogaritjeve analitike me anë të formulës së prodhimit të energjisë nga centrali, rezulton se për periudhën objekt auditimi nga operatori ekonomik është prodhuar më tepër, me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>202,136 Euro.</u>**

**10.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i* ***Centralit Fotovoltaik Topojë*"**, me mbajtësin e miratimit shoqëria *"A S"shpk*, konstatohet:

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Koncesioneve, Znj. E K sipas Autorizimit të Ministrit nr. 5786/8 prot., datë 13.09.2017 dhe mbajtësi i miratimit, shoqëria **"A S"** shpk me Nipt H............H, Qarku Fier, përfaqësuar nga Z. E K, nënshkruajnë kontratën me nr. 2608 Rep, nr. 1227/3 Kol, datë 17.11.2017, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit* ***Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues 1998 kŵ në Bashkinë Fier, Qarku Fier*".**

Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqërisë "A S" shpk, është miratuar ndërtimi Centralit Fotovoltaik Topojë, me kapacitet prodhues **1,998 kŵ**.

Referuar nenit 3 të kontratës “*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik Topojë, Fier*” janë: Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me këto koordinata:

X= 4517379.452 X= 4517458.587
Y= 4364399.068 Y= 4364241.655
X= 4517504.576 X= 4517584.096
Y= 4364462.077 Y= 4364303.908, në Bashkinë Fier. Sipërfaqa totale e mësipërme është 144,000 $m^2$, nën administrimin e shoqërisë “A G E” SH.A, me nr. pasurie 55, në zonën kadastrale 3358, Fier, sipas “Certifikatës për dhënie me qira”, lëshuar nga zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Fier, datë 30.06.2015. Parametrat teknik dhe energjitik të centralit do të jenë:

- Fuqia e Instaluar (kŵ)
- N = 1,998 kŵ,
- Energjia mesatare vjetore (kŵh)
- E = 3,000,000 kŵh/vit.

Referuar nenit 4 të kontratës “*Kohëzgjatja e kontratës*”, është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 125, datë 04.06.2018, i jepet licenca subjektit “A S” shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 1,998 kŵ me 8,400 njësi gjeneruese. Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe shoqërisë “A S” shpk, është nënshkruar me nr. 22808/1 prot., datë 15.01.2019, përfaqësuar nga Administratori OSHEE sh.a. dhe shitësit të energjisë shoqërisë “A S” shpk, nga data e lidhjes 17.01.2018 deri 16.12.2033, me çmim **100 Euro/MŴH.** Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL SH.A dhe prodhuesve me përparësi shoqërisë “A S” shpk, është nënshkruar me nr. 227/113 prot., datë 23.01.2020, përfaqësuar nga Administratori FTL sh.a dhe shitësit të energjisë shoqërisë “A S” shpk, sipas legjislacionit në fuqi. Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| Nr | | Parashikimi 2021 | Parashikimi 2022 | Realizimi 2020 | Realizimi 2021 | Realizimi 2022 | PVGIS |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Prodhimi mujor (kŵh) | Janar | 270,200 | 186,220 | 216,930 | 165,060 | 239,260 | 191,881 |
| | Shkurt | 194,110 | 229,680 | 273,420 | 238,840 | 280,490 | 195,117 |
| | Mars | 374,360 | 337,370 | 330,260 | 429,660 | 362,880 | 269,646 |
| | Prill | 350,840 | 366,080 | 387,100 | 304,360 | 406,630 | 290,433 |
| | Maj | 380,450 | 446,380 | 413,280 | 462,910 | 474,810 | 318,770 |
| | Qershor | 438,690 | 473,880 | 475,440 | 478,030 | 472,920 | 327,658 |
| | Korrik | 449,680 | 496,540 | 502,670 | 484,470 | 519,610 | 352,158 |
| | Gusht | 450,310 | 460,460 | 462,770 | 442,960 | 454,930 | 343,974 |
| | Shtator | 338,170 | 356,730 | 354,060 | 370,230 | 383,600 | 292,372 |
| | Tetor | 305,760 | 277,750 | 286,720 | 292,040 | 326,620 | 256,078 |
| | Nentor | 153,020 | 193,710 | 243,600 | 157,220 | 183,190 | 188,419 |
| | Dhjetor | 156,730 | 158,180 | 141,470 | 175,070 | 170,079 | 178058 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 3,862,320 | 3,982,980 | 4,087,720 | 4,000,850 | 4,275,019 | 3,204,564 |
| **PVGIS - Progresivi (kW/h)** | | | | **-883,156** | **-796,286** | **-1,070,455** | |
| **Vlera e prodhuar dhe shitur më tepër (çmimi 100 Euro /MW/h)** | | | | **88,315** | **79,628** | **107,045** | **274,988** |

- Nga të dhënat e tabelës së mësipërme, duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky sistem, nga ku ka rezultuar se prodhimi maksimal për periudhën nën auditim arrin deri në 3,204,564 **kŵh në vit, ndërsa subjekti PPE (Prodhues me Përparësi i Energjisë) ka prodhuar dhe ka shitur FTL sh.a sasinë deri në 4,275,019 kŵh në vit, arrijmë në përfundimin se prodhimi dhe shitja e energjisë nga ky subjekt në sasinë e raportuar nga FTL sh.a, nuk justifikohet me fuqinë e**

**instaluar të këtij centrali, referuar parametrave të përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE.**

- Më poshtë po pasqyrojme perllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në të cilën është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV.







**<u>Sa më sipër</u>**, referuar programit PVGis, duke u referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali dhe llogaritjeve analitike me anë të formulës së prodhimit të energjisë nga centrali, rezulton se për periudhën objekt auditimi nga operatori ekonomik është prodhuar më tepër, me një efekt ekonomik për shoqërinë në vlerën prej **<u>274,988 Euro.</u>**

*Grupit të Auditimit i është referuar nga ana e FTL sh.a mënyra/forma e rakordimit dhe verifikimit të matësave për blerjen e energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike çdo muaj si më poshtë:*







Fotografimi i matësave nga përfaqësuesit e FTL sh.a, si një mënyrë dokumentimi:

**11.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për centralin fotovoltaik me objekt: *"Kontratat e zhvillimit të projektit***"**, me mbajtësin e miratimit shoqëria*"S R A"shpk*, konstatohet:
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), përfaqësuar nga Z. I B sipas Autorizimit të Ministrit nr. 9625/4 prot., datë 19.12.2019 dhe mbajtësi i miratimit shoqëria "S R A" shpk me Nipt L......C njësia Bashkia Cërrik, përfaqësuar nga Z.T K L dhe z. R S nënshkruajnë kontratën me nr. 6077 Rep, nr. 1657 Kol, datë 19.12.2019, me objekt "*Ndërtim, shfrytëzim dhe administrimi, i centralit* ***Fotovoltaik ludrues mbi rezervuarin e Banjës, Bashkia Cërrik me kapacitet të instaluar 2 MŴ".***

Sipas kontratës dhe miratimit përfundimtar me shoqëria "S R A" shpk, është miratuar ndërtimi i Centralit Fotovoltaik lundrues mbi rezervuarin e Banjës, Bashkia Cërrik, me kapacitet prodhues **2000kŵ**.

Referuar nenit 3 të kontratës "*Të dhënat të përgjithshme të Centralit Fotovoltaik ludrues mbi rezervuarin e Banjës*" janë:

Centrali Fotovoltaik do të shfrytëzojë energjinë diellore në zonën me këto koordinata:
X= 4534749.87 X= 4536695.386
Y= 421530.378 Y= 505685.33
X= 4534834.723 X= 4536780.275
Y= 421615.231 Y= 4421714.603, në Bashkinë Cërrik. Parametrat teknik dhe energjitike të centralit do të jenë:

- Fuqia e Instaluar (kŵ)-N = 2000 kŵ

-Energjia mesatare vjetore (kŵh) - E = 2,700,000 kŵh/vit

Referuar nenit 4 të kontratës "*Kohëzgjatja e kontratës*", është përcaktuar për një afat 49 vjetësh model NSHA (Ndërtim, Shfrytëzim dhe Administrim). Me vendimin e ERE nr. 121, datë 17.07.2020, i jepet licenca subjektit "S R A" shpk, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për kapacitet të instaluar 2000 kŵ me 4 njësi gjeneruese.

- Kontrata e Shit-Blerjes të energjisë elektrike ndërmjet FTL sh.a dhe prodhuesit me përparësi shoqërisë "S R A"shpk, është nënshkruar me nr. 1176/2 prot., datë 04.06.2021, përfaqësuar nga Administratori FTL sh.a dhe shitësit të energjisë, sipas legjislacionit në fuqi me çmim **100,025 Euro/MŴH.**

Referuar të dhënave të prodhimit të realizuar si më poshtë:

| **Nr** | | **Realizimi 2020** | **Realizimi 2021** | **Realizimi 2022** | **PVGIS** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Prodhimi mujor (kŵh)** | **Janar** | | | 0 | 172388 |
| | **Shkurt** | | | 0 | 173236 |
| | **Mars** | | | 0 | 237560 |
| | **Prill** | | | 51,527 | 257,144 |
| | **Maj** | | | 75,901 | 281,609 |
| | **Qershor** | | 13,398 | 84,987 | 297,069 |
| | **Korrik** | | 0 | 93,142 | 330,125 |
| | **Gusht** | | 0 | 70,252 | 322,297 |
| | **Shtator** | | 0 | 54,397 | 268,846 |
| | **Tetor** | | 0 | 38,934 | 236,654 |
| | **Nentor** | 78,488 | 0 | 18,172 | 177,255 |
| | **Dhjetor** | 164,553 | - | | 164285 |
| **Progresivi (kŵh)** | | 243,041 | 13,398 | 487,312 | 2,918,468 |
| **PVGIS - Progresivi (kW/h)** | | | | | |

- Më poshtë po pasqyrojme perllogaritjen vjetore duke u bazuar në programin PVGIS, i cili bazohet në koordinatat e zonës në te cilen është vendosur Centrali, këndin si dhe humbjet që ka ky central PV.







<u>**Sa më sipër**</u>, referuar programit PVGis, duke u referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali dhe të prodhimit të operatorit ekonomik, konstatohet se nuk ka patur prodhim të vazhdueshëm vjetor dhe nuk mund të arrihet në një konkluzion të saktë.

**Referuar sa më sipër, mbështetur në kushtet kontraktore dhe matjes me anë të sistemit PVGIS, arrijmë në përfundimin se, subjektet Prodhues me Përparësi të Energjisë kanë prodhuar më tepër energji elektrike se sa kapaciteti 2MẀ, përcaktuar në kushtet kontraktore, gjithsej në sasinë 23,568,327kŵh, me efekte financiare për shoqërinë në shumën 2,356,730 Euro (<u>264,486 + 247,776 + 308,653 + 213,639 + 200,818 + 222,965 + 245,284 + 175,985 + 202,136 + 274,988).</u>**

Për sa trajtohet në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar me shkresën nr. 4230/26, datë 30.05.2023, të protokolluar në KLSH me nr. 826/7, datë 31.05.2023, janë paraqitur observacione nga përfaqësuesi i FTL sh.a, znj. E R, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë "Komente e shpjegime mbi Projekt Raportin...", si më poshtë:

<u>**Pretendimi i subjektit:**</u>
Në zbatim të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 2.3.2022 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë" të ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është përgjegjëse, ndër të tjera, për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese, fuqizimin e rrjeteve, zbatimin e politikave dhe programeve të zhvillimit të sektorit energjetik.
Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 547, datë 09.08.2006 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar, dhe kontratave për "Ndërtimin, të energjisë elektrike, që nuk

janë objekt koncesioni”, i ndryshuar, dhe kontratave për “Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike” të lidhura ndërmjet këtyre subjekteve në cilësinë e Mbajtësve të Miratimit dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), rezulton se është kompetencë e MIE-s dhe AKBN-së monitorimi i kontratave për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centraleve prodhuese, si dhe kolaudimin i këtyre veprave në përputhje me përcaktimet kontraktore dhe projektet e miratuara.

“Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. është krijuar bazuar në Urdhrin nr. 157, datë 12.02.2018 të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, me aksionar të vetëm shoqërinë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group” SH.A., ndërkohë që “OSHEE Group” SH.A. ka si aksionar të vetëm Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. “Furnizuesi i Tregut të Lirë” Sh.A. në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, është ngarkuar me detyrimin e blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë (PPE) me kontratë dhe çmim të rregulluar, të miratuar nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, është shfuqizuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016 “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar, i cili ka rregulluar këtë marrëdhënie për periudhën 2016-2022.
Në përputhje me objektin e saj të aktivitetit dhe të parashikimeve kontraktore “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. ka ushtruar kontrolle periodike në sistemet përkatëse të matjeve të energjisë gjatë operimit të këtyre centraleve dhe në asnjë rast nuk janë konstatuar parregullsi në këto sisteme matje. Gjithashtu, në zbatim të rekomandimit 14.3, nga 19-26 Maj 2023, “OSHEE Group” SH.A./”Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. ushtroi kontroll për verifikimin në terren të sistemeve të matjes të këtyre centraleve prodhuese, nga ku ka rezultuar se nuk ka parregullsi në matjen dhe regjistrimin e energjisë elektrike të livruar nga këto centrale prodhuese.
Për sa i përket rekomandimeve 14.2 dhe 14.3, të cilat ngarkojnë OSHEE SH.A., MIE dhe AKBN të evidentojnë nëse, shkaqet e përfitimit më tepër nga secili subjekt i licencuar, janë pasojë e ndërtimit dhe instalimit të një kapaciteti prodhues më të madh se kapaciteti i licencuar (2 MW), shprehemi se kjo pjesë e rekomandimeve nuk i përket fushës së përgjegjësisë së shoqërisë aksionare publike “OSHEE Group” SH.A./ “Furnizuesi i Tregut të Lirë” Sh.A.
Në këtë kuadër, në vijim të procesit të auditimit, “OSHEE Group” SH.A. me shkresën nr. 3994 Prot, datë 23.05.2023 ka përcjellë në MIE, ndër të tjera, gjetjet dhe rekomandimet në lidhje me prodhimin e energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike.
Sikurse, shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A. ka argumentuar në shkresën nr. 2000/47, datë 20.03.2023 me lëndë “Mbi akt konstatimin nr. 37, datë 10.03.2023 të Kontrollit të Lartë të Shtetit”, risjellim në vëmendje se audituesit për vlerësimin e energjisë elektrike të prodhuar nga centralet fotovoltaike kanë përdorur programin PVGIS Online Tool. Ky program ofron një përqasje të përafërt të rrezatimit diellor në një pikë të caktuar të terrenit, si dhe një parashikim të energjisë mujore të prodhuar nga një central fotovoltaik me fuqi të caktuar (e dhënë e cila vendoset manualisht). Për sa kohë kemi të bëjmë me parashikim të prodhimit të energjisë elektrike në asnjë rast vlerat e parashikuara nuk janë të barabarta me sasitë faktike të energjisë elektrike të prodhuar.
**Risjellim në vëmendjen Tuaj se legjislacione në fuqi në Republikën e Shqipërisë, konkretisht ligji organik nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, aktet rregullatore të tilla si Kodi i Matjes i miratuar me Vendimin nr. 101, datë 26.08.2008 të Entit Rregullator të Energjisë dhe kontrata tip shitblerjes së energjisë elektrike me prodhuesit me përparësi, e miratuar me vendimin nr. 101, datë 23.06.2016, të ndryshuar të Entit Rregullator të Energjisë, nuk parashikon dhe as referon metodologjinë e përdorur nga audituesit PVGIS Online Tool.**
Shoqëria “Furnizuesi i Tregut të Lirë” SH.A./“OSHEE Group” SH.A., në cilësinë e të licencuarit nga Enti Rregullator i Energjisë dhe të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme, kryen aktivitetin e saj në përputhje me përcaktimet e ligjit Nr. 43/2015 “Për

sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, Kodi i Matjes, Kodit të Shpërndarjes, dhe të kontratës tip shitblerjes së energjisë elektrike me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (PPEE) miratuar me vendim të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë Nr. 101, datë 23.06.2016, të ndryshuar.
Asnjë akt ligjor dhe nënligjor i detyrueshëm për t'u zbatuar nga shoqëria "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A. nuk përcakton përdorimin e programit PVGIS Online Tool për parashikimin e prodhimit të energjisë elektrike. Për më tepër, programet dhe modelet e parashikimit të prodhimit të energjisë elektrike kanë si qëllim të ndihmojnë në planifikimin në terma afatshkurtër dhe afatmesëm, por nuk mund të shërbejnë si bazë për pagesë përvecse kur parashikohet ndryshe nga aktet përkatëse. Konkretisht, në pikën 5 të nenit 6 "Matja e energjisë elektrike të livruar", të kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike me prodhuesit me përparësi të energjisë, përcaktohet se :
"5. Në ditën e caktuar nga Palët në Kontratë (ose në ditën e fundit të Muajit përkatës), përfaqësuesit e autorizuar të Shitësit dhe Blerësit do të takohen për të lexuar aparatin matës të Energjisë Elektrike/ ose do të lexojnë online nga sisteme të aksesueshme nga të dyja palët sasinë Mujore të Energjisë se livruar nga Shitësi te Blerësi cdo muaj…"
Për sa më sipër, sasia e energjisë elektrike e matur nga strukturat përkatëse të shoqërisë "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A. dhe e regjistruar në fund të muajit përkatës, korrespondon me sasinë faktike të energjisë elektrike të prodhuar dhe livruar ne rrjetin e shpërndarjes nga prodhuesit me përparësi të energjisë. Bazuar në të dhënat e matjes të muajit përkatës, "Furnizuesi i Tregut të Lirë" SH.A. në cilësinë e Blerësit kryen rakordimin e sasisë së energjisë elektrike të prodhuar e livruar, dhe në vijim kryen pagesën e saj. Theksojmë se procesi i matjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike kryhet nga shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" SH.A.
Gjithashtu, vihet re se në Akt-Konstatimin nr. 37, datë 10.03.2023 ashtu edhe në projekt-raportin, metodologjia e përdorur për vlerësimin e kapacitetit të licencuar nuk është e njëjta për të gjitha subjektet e audituara. Pra, rezulton se për të gjitha subjektet (dhjetë PPEE) metodologjia e përdorur është program PVGIS Online Tool, ndërsa për dz nga këto subjekte është përdorur edhe një metodologji llogaritëse shtesë, pa evidentuar qëllimin e ndryshimit të metodologjive.

**<u>Qëndrimi i Grupit të Auditimit:</u>** Pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura nga përfaqësuesit e subjektit, sqarojmë se:
- Lidhur me verifikimin e matësve të energjisë të prodhuar nga centralet fotovoltaike, Grupi i Auditimit merr në konsideratë komentet e subjektit lidhur me rekomandimet e lëna në Projektraportin e Auditimit dhe i pasqyron në këtë material.
- Grupi i Auditimit ka arritur në konkluzionin se këto subjekte kanë prodhuar më tepër dhe duke shkelur kushtet kontraktore, pasi referuar fuqisë së instaluar sipas kontratës me MIE, është e pamunduar realizimi i kësaj energjie të hedhur në sistem, pa marrë në konsideratë këtu që këto centrale kanë dhe kosto amortizimi.
- Lidhur me pretendimin se metodologjia e përdorur PVGIS nuk përfshihet në legjslacionin e RSH dhe se veprimtaria e FTL sh.a mbështetet në këtë legjislacion e ndër të tjera dhe Kodit të Matjes i miratuar në vitin 2008 (pra shumë më parë se sa ligji për energjinë e rinovueshme), sqarojmë se kjo metodologji është dhe mundet të jetë plotësisht e përdorshme edhe nga ana juaj në planifikimin e energjisë, aq më shumë kur legjslacioni në fushën e energjisë është i përafruar me Direktivën e BE, ashtu sikurse ju referoni, pavarësisht se nuk keni ndonjë dispozitë detyruese. Referuar të dhënave të këtij sistemi të njohur nga BE (linku përkatës), duke i ballafaquar me energjinë e livruar nga PPE dhe kushteve kontraktore të centraleve të sanksionuar me MIE, referuar vendndodhjes gjeografike ku shtrihet centrali dhe në dy raste edhe të kordinatave të sakta të vendndodhjes së centralit, kemi arritun në konkluzionet se subjektet kanë prodhuar më tepër nga fuqia e deklaruar prej tyre.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Mangësi në blerjen e energjisë elektrike nga Prodhues me Përparësi të Energjisë, të cilët kanë prodhuar më tepër energji elektrike se sa kapaciteti 2MẀ, përcaktuar në kushtet kontraktore, gjithsej në sasinë 23,568,327kŵh, me efekte financiare për shoqërinë në shumën 2,356,730 Euro. |
| **Situata:** | Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2MẀ, miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor (dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a (FTL sh.a) dhe sipas treguesve të programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet këto centrale e prodhimit të operatorit ekonomik, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2MẀ, gjithsej në sasinë 23,568,327kŵh, me vlerë **2,356,730 Euro**, përkatësisht nga: Subjekti "S" shpk në shumën 264,486 Euro; R shpk për 247,776 Euro, "A" shpk për 308,653 Euro; "A S" shpk për 213,639 Euro; "S S" shpk për 200,818Euro; "S S" shpk për 222,965 Euro; "S S" shpk për 245,284Euro; "S ŵ" shpk 175,985 Euro; "L" 202,136 Euro dhe "A S" shpk 274,988 Euro. |
| **Kriteri:** | - Ligji nr. 43/2015 "*Për sektorin e energjisë elektrike*",<br>- Ligji nr. 138/2013 "*Për burimet e energjisë së rinovueshme*"<br>- Ligji nr. 7/2017 "*Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme*"<br>- VKM nr. 822, datë 7.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*", i ndryshuar.<br>- Vendimi i ERE nr. 120, datë 27.07.2017 "*Mbi përcaktimin e çmimeve të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla gjeneruese fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 MŴ dhe eolike me kapacitet të instaluar deri në 3 MŴ*".<br>- VKM nr. 369, datë 26.4.2017 "*Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era*".<br>- VKM nr. 244, datë 30.3.2016 "*Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*", i ndryshuar.<br>- VKM nr. 883, datë 27.12.2019 "*Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*".<br>- Sistemit të Informacionit Gjeografik Fotovoltaik të Komisionit Evropian (PVGIS https://commission.europa.eu/index_en).<br>- Kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjekteve PPE. |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi/Efekti**: | Si pasojë e mangësive të mësipërme, është përfituar padrejtësisht nga subjektet PPE. |
| **Shkaku:** | Mos ndjekja dhe zbatimi korrekt i kushteve të kontratës për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike. |
| **Rëndësia**: | I lartë. |
| **Rekomandimi 1**: | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), si institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për "Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike", të ushtrojnë në mënyrë të menjëhershme kontrollin fizik dhe teknik të secilit stacion fotovoltaik, duke evidentuar të gjitha shkeljet e lejeve dhe licencave për prodhimin e energjisë deri në 2 MẀ, nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, në drejtim të fuqisë së instaluar dhe sasisë së prodhuar e shitur, si dhe evidentimin e shkaqeve për lëvrimin e një sasie prodhimi më të madhe se ajo e licencuar. |
| **Rekomandimi 2:** | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), pas përcaktimit të shkaqeve të përfitimit më tepër, nga secili subjekt i licencuar, pasojë e ndërtimit dhe instalimit të një fuqie prodhuese më të madhe se ajo e lejuar/miratuar e licencuar (2MẀ), të marrë masa të menjëhershme ndaj tyre, duke i propozuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përjashtimin e subjekteve nga lista e Prodhuesve me Përparësi të Energjisë, si dhe aplikimin e sanksioneve ligjore përkatëse, subjekte për të cilët OSHEE GROUP sh.a me shkresën nr. 8410/3, datë 30.05.2023, pas kontrolleve të ushtruara dhe verifikimit në terren të sistemeve të matjes të këtyre centraleve prodhuese, ka saktësuar se nuk ka parregullsi në matjen dhe regjistrimin e energjisë së livruar nga këto centrale fotovoltaike. |
| **Rekomandimi 3:** | Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit për rezultatet e kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të kushteve kontraktore nga subjektet që kanë ndërtuar centrale fotovoltaike dhe masat e marra për zgjidhjen e problematikës. |
| **Rekomandimi 4:** | OSHEE GROUP sh.a/FTL sh.a në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN), si institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për "Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike", të ndjekin me korrektësi zbatimin e kushteve kontraktore në drejtim të prodhimit të energjisë elektrike jo vetëm nga këto centrale fotovoltaike që aktualisht janë në prodhim, por dhe të tjerë të tillë që do të hyjnë në shfrytëzim në të ardhmen. |

**2. 8. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.**

Qiramarrja në OSHEE SHA kryhet për të siguruar ambiente për akomodimin e punonjësve kryesisht të qendrave të kujdesit ndaj klientit, punonjësit e administratës qendrore dhe lokale të drejtorive rajonale dhe njësive përkatëse, por edhe ambiente për të magazinuar materialet e mirëmbajtjes dhe të investimeve. Në fund të vitit 2022 kanë qenë aktive 148 kontrata qiramarrje

me vlerë totale vjetore 351,420 mijë lëkë, ndërsa janë lidhur 4 kontrata qiradhënie të cilat realizojnë të ardhura në shumën 3.913 mijë lekë.

| **Titulli i Gjetjes** | Mangësi në procedurat e qiramarrjes dhe qiradhënies |
|---|---|
| **Situata:** | Qiramarrja në OSHEE SHA kryhet për të siguruar ambiente për akomodimin e punonjësve kryesisht të qendrave të kujdesit ndaj klientit, punonjësit e administratës qendrore dhe lokale të drejtorive rajonale dhe njësive përkatëse, por edhe ambiente për të magazinuar materialet e mirëmbajtjes dhe të investimeve.<br>-Nga auditimi i kontratave të qirasë konstatohet se në kontratat e qiramarrjes, parashikohet në nenin 5.3 mbajtja e penalitetit, konkretisht: "*nëse ndonjë nga pagesat e qerasë mujore ose ndonjë pagesë tjetër sipas kësaj kontrate mbetet e papaguar pas 15 ditësh nga afati i pagesës së saj, ndaj qiramarrësit do të aplikohet një penalitet në masën 0.05% të shumës së prapambetur. Penaliteti do të fillojë aplikohet pas ditës të 15-të nga momenti i përfundimit të afatit të pagesës.*". Në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet një nen i tillë, dhe për pasojë shoqëria OSHEE SHA nuk mund të mbajë penalitete lidhur me vonesat në pagesë të cilat shkojnë në vlerën ***338,959 lekë.***<br>**-**Në kontratat e qiradhënies neni 1, pika 1 parashikohet se "*...qiramarrësi nuk ka kryer pagesën brenda një muaji nga data e pagesës së përcaktuar...*", por kjo pikë nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e OSHEE SHA.<br>-Nga auditimi i procedurave të qirave, rezulton se OSHEE SHA nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo me buletine në gazetat kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negocimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj.<br>-Shoqëria OSHEE SHA shpenzon mesatarisht në muaj ***28,358,125.3 lekë*** dhe në vit ***340,237,624 lekë***.për pagesat e qirave, një shumë kjo e konsiderueshme, nisur dhe nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj. |
| **Kriteri:** | Kontratat e qirasë të lidhura me subjektet. |
| **Ndikimi/Efekti**: | Mos zbatimi i neneve të kontratave të qirave sjell vonesa dhe parregullsi në pagesat e detyrimeve nga ana e qiramarrësve. |
| **Shkaku:** | Mos zbatimi i përcaktimeve dhe parashikime të kontratave të qiradhënies. |
| **Rëndësia**: | E lartë. |
| **Rekomandimi**: | - Administratori i OSHEE SHA Group në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse, të analizojnë situatën mbi mundësinë e reduktimit të kostove lidhur me ambjentet e marra me qera, duke u nisur nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj. |

| | |
|---|---|
| | **-** Departamenti Ligjor në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për shtimin e penaliteteve në kontratat e qiradhënies dhe sanksionimin e subjekteve debitore nga kontratat e shmangien e krijimit te detyrimeve.<br>-Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për publikimin e procedurave të marrjes me qira në buletinin e APP, në gazetat kombëtare apo mediat e shkruara, për marrjen e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmime konkurruese. |

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**
1) Z.A G, me detyrë teknik specialist ekspert me detyrë konsulence, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për vlerësimin e ambienteve me qira.
2) Z.L M, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e kryetarit të grupit të punës për vlerësimin e ambienteve me qira.
3) Z.I H, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për vlerësimin e ambienteve me qira.
4) Z.G P, në cilësinë e anëtarit të grupit të punës për vlerësimin e ambienteve me qira.

**2.9. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.**
Në zbatim të kësaj pike të Programit të Auditimit, u shqyrtua dokumentacioni:
-Pyetësori i vetëvlerësimit të MFK;
-Raporte vjetore të shoqërisë;
-Raporte vjetore të AB
Nga grupi i auditimit të KLSH-së në zbatim të ligjit të MFK-së nr.10296, datë 8.07.2010, i është përcjellë me email pyetësori për vetëvlerësimin të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në OSHEE GROUP sh.a, Drejtorit Ekonomik dhe Drejtorit të Departamentit të Zhvillimit të Biznesit nga ku është konstatuar se në zbatim të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", Urdhërit i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Standartit ISO 31000 për administrimin e riskut, Sektori i Administrimit të Riskut Operacional, në Drejtorinë e Qeverisjes së Korporatës pranë Departamentit të Zhvillimit të Biznesit, nga Administratori me urdhrin nr. 2578, datë 15.03.2022 është miratuar Strategjia e Riskut për OSHEE Group sh.a, Shoqëria ka miratuar në organet drejtuese strukturën organizative të OSHEE GROUP sh.a dhe 3 shoqërive: OSSH sh.a, FTL sha, FSHU sha, si dhe përshkrimet e punës për secilin pozicion.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Për periudhën objekt auditimi shoqëria OSHEE sh.a dhe tre shoqëritë e kontrolluara prej saj, kanë funksionuar pa rregullore të brendshme, si dhe nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik. |
| **Situata:** | -Referuar përgjigjeve në pyetësorin e MFK nga Grupi i KLSH-së, drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit në OSHEE GROUP sh.a referuar pyetjes se a është përcaktuar përgjegjshmëria dhe përgjegjësia e menaxherëve për objektivat strategjike, kjo strukturë jep përgjigjen: *" Në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë, rregulloret e shoqërive janë në proces hartimi, duke marrë në* |

| | |
|---|---|
| | *konsideratë zhvillimet praktike të proceseve në ndjekje". Pra* OSHEE GROUP sh.a dhe tre shoqëritë e reja të krijuara kanë funksionuar *për gjithë periudhën e auditimit pa rregullore të brendshme, e për rrjedhojë nuk janë unifikuar pozicionet sipas funksioneve që mbulojnë dhe kompetencave.* Gjithashtu, referuar faktit se shoqëria është në proces strukturimi nuk është e qartë si ka ndikuar ky fakt në kuadrin rregullator të shoqërisë referuar unifikimit të kompetencave dhe hartimit të gjurmës audituese.<br>-Lidhur me krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) të njësisë publike me pozicione dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, sipas kuadrit ligjor, në rregulloren përkatëse, shoqëria shpjegon se*: "Në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë, ky grup po ridimensionohet në kuadër të kërkesave të reformimit të sektorit të energjisë" dhe se* "*Në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë, puna dhe mënyra e operimit të këtij grupi po ridimensionohet në kuadër të kërkesave të reformimit të sektorit të energjisë".* |
| **Kriteri:** | - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, neni 4, pika 19 "Gjurma e auditimit";<br>- Urdhëri i Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 "Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin". |
| **Ndikimi/Efekti**: | Në mos identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike. |
| **Shkaku:** | Mosvlerësimi i duhur në nivel menaxherial i shoqërisë për evidentimin e problematikave që rrjedhin si pasojë e mos hartimit të kuadrit rregullator. |
| **Rëndësia:** | I lartë |
| **Rekomandime:** | Nga shoqëria OSHEE sh.a, të merren masa që të përditësohet kuadri rregullator (rregulloret e funksionimit) për proceset kryesore të punës Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qëndër referuar ndryshimeve strukturore që ka pësuar shoqëria nga ndarja e saj në shoqëri (mëma dhe bija), sipas detyrave funksionale.<br>Nga strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit, të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Financiar, si një organ përgjegjës për hartimin e politikave dhe monitorimin e zbatimit të tyre. |

### 2.10. Mbi organizimin dhe funksionimin e auditit të brendshëm

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni:
- Planet strategjike të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm;
- Planet vjetore të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm;
- Dosjet e Auditimit.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për periudhën objekt auditimi u konstatua:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të "OSHEE GROUP" sh.a, është krijuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.12, datë 06.02.2015, e organizuar në rang Drejtorie. Për periudhën 01.07.2020 deri më 28.07.2022 ka funksionuar nga katër sektorë përkatësht, Sektori i sigurimit të cilësisë së auditimit dhe trajnimeve, Sektori ekonomik, Sektori i ekspertizës teknike dhe Sektori i auditimit të performancës dhe operacioneve mbështetëse. Ndërsa me vendimin qarkullues të Këshillit Mbikëqyrës nr. 23, datë 28.07.2022 kjo drejtori është organizuar me tre sektorë, përkatësisht: Sektori Ekonoimk i Auditimit, Sektori Juridik i Auditimit dhe Sektori Performancës

dhe Proceseve Teknike, si dhe një specilait i Teknologjisë dhe Informacionit.
DAB është në varësi të Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE GROUP sh.a dhe aktualisht ka në strukturën e saj 23 punonjës (1 Drejtor + 22 punonjës).
Karta e Auditimit të Brendshëm dhe Rregullorja e brendshme e funksionimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në OSHEE GROUP sh.a, janë dy dokumentet bazë që rregullojnë veprimtarinë e DAB, të cilat janë miratuar nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë me vendimin nr. 27, datë 07.07.2016. Këto dokumente janë amenduar me vendimin nr. 24, datë 02.07.2020 të Këshillit Mbikqyrës dhe vendimin nr. 26, datë 29.09.2022 dhe që kanë të bëjnë me kryerjen e procesit të sigurimit të cilësisë së auditimit.

Sruktura e DAB ka në organikën e saj 23 punonjës, nga të cilët janë të certifikuar 18 punonjës 2 punonjës janë në proces certifikim dhe 3 punonjë janë të pa certifikuar.
Në përberjen e njësisë së auditimit janë 12 ekonomistë, 7 juristë, 3 inxhinier, 1 inxhinier i matematikës & informatikës, etj. Audituesit kanë një vjetërsi pune në profesion që varion nga 1 deri 35 vjet dhe në auditim mbi 16 vjet.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE GROUP” sh.a, ka hartuar planet vjetore dhe planin strategjik për përiudhën objekt auditimi, të objekteve për tu audituar në OSHEE GROUP sh.a dhe tre shoqërive bija OSSH sh.a, FTL sh.a dhe FSHU sh.a, të cilët janë miratuar në Këshillin Mbikqyrës.
Llojet e auditimeve të planifikuara për periudhën 2020-2022 nga DAB janë:
Angazhime auditimi për shërbimet e sigurisë nga të cilat, Auditime përputhshmërie, Auditime financiare, Auditim performance dhe Auditime të kombinuara.

| | |
|---|---|
| **Titulli i Gjetjes** | Mosrealizimi i auditimeve nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të “OSHEE” sh.a, sipas planeve të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës i shoqërisë. |
| **Situata:** | Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në OSHEE sh.a për periudhën 1.07.2020-31.12.2021 është konstatuar se, nuk është realizuar plani i auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në planin strategjik 2020-2022, planit strategjik 2021-2023 dhe planet vjetore të auditimit, pasi disa nga auditimet e planifikuara nga DAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar (DEK, Drejtoria Ligjore, njësia PIU, etj.).<br>-Nga auditimi mbi kryerjen e angazhimeve të auditimit, referuar dokumentacionit të dosjeve të auditimit, u konstatua se nga në 6 angazhime të përzgjedhura për periudhën objekt auditimi janë tejkaluar afatet e hartimit të Projekt Raportit dhe të Raportit Final, duke tejkaluar afatin 10 ditor për hartimin e tyre, konkretisht: Angazhim auditimi në FSHU sh.a - Departamenti i Shitjeve; angazhim auditimi në OSHEE GROUP sh.a - Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse; angazhim auditimi në DEK; angazhim auditimi në DTL, angazhim auditimi në FTL sh.a dhe angazhim auditimi në OSSH sh.a - Departamenti i Leximit, Menaxhimit të Matjes dhe Bilancit Energjitik. |
| **Kriteri:** | - Manuali i Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, Kapitulli IV dhe VII;<br>- Karta e Auditimit të Brendshëm dhe Rregullorja e brendshme e funksionimit të DAB në OSHEE sh.a |

| | |
|---|---|
| **Ndikimi/Efekti**: | Mosrealizimi i plotë i planit të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm sipas planeve të miratuara nga Këshilli Mbikqyrës të shoqërisë, ndikon në mungesën e pasqyrimit objektiv, transparent i të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë për arritjen e objektivave dhe në përmirësimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike GROUP sh.a. |
| **Shkaku:** | Mosplanifikimi i duhur i faktorit kohë dhe mosidentifikimi i risqeve të trashëguara vit pas viti në planifikim dhe auditim nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në OSHEE SHA, në aspektin e shkaqeve dhe arsyeve që kanë sjellë mosrealizimin e auditimeve të mbartura vit pas viti. |
| **Rëndësia:** | I lartë. |
| **Rekomandimi:** | Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të planit të auditimit pas miratimit në organet drejtuese të shoqërisë, sipas afateve të përcaktuara me qëllim pasqyrimin objektiv, transparent të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë OSHEE sh.a. |

**2.11 Auditim në Njësitë e varësisë së OSHEE sh.a**
Në këto njësi është ushtruar auditim për çështje të veçanta, të cilat janë përfshirë në drejtimin 2.6 faqe 85-200.
Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen masave të mëposhtme:

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Këshillit Mbikëqyrës për periudhën 01.07.2020 deri më 31.12.2022 konstatohet se, këshilli ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar lidhur me shpërblimin e punonjësve, ndërkohë që shoqëria rezulton me humbje të konsiderueshme dhe me kapital negativ, kështu: Me vendimin nr. 5, datë 22.02.2021 është miratuar dhënia e një page shpërblim për punonjësit e angazhuar në kuadër të planit të gatishmërisë së shoqërisë OSSH sh.a.
-Me vendimin qarkullues nr. 22, datë 29.12.2021 është miratuar dhënia e një shpërblim të veçantë mbi pagë për punonjësit e OSHEE GROUP sh.a, OSSH sh.a, FTL sh.a dhe FSHU sh.a, në masën 20,000 lekë, me propozim të vetë Këshillit Mbikëqyrës, e kjo bazuar në performancën e shoqërisë, në një kohë që shoqëria prej disa vitesh radhazi paraqitet me humbje e me kapital negativ.
Dhënia e këtij shpërblimi, pavarësisht së është miratuar dhe nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit, është në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6 "Kompetencat e organeve kolegjiale", Pika 2 ku përcaktohet se: *"Për ndërmarrjet shtetërore, veprimtaria e të cilave është me humbje, ose që subvencionohen nga shteti, Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përkatës dhe të Ministrit të Financave, miraton, me akte të veçanta, nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të punonjësve të tyre".*
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>1.1.Rekomandimi:</u>** Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE GROUP sh.a, në të ardhmen t'i kushtojë vëmendje të shtuar vendimmarrjeve të veçanta me efekte financiare për shoqërinë, referencës së tyre ligjore dhe bazuar në raporte e analiza të hollësishme mbi situatën financiare të shoqërisë.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë vendime jo në përputhje me legjislacionin shqiptar, vendimmarrje e cila nuk respekton rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe të funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë, si dhe ka marrë vendime të cilat nuk gjejnë mbështetje në legjislacionin për shoqëritë tregtare", konkretisht:

**1.** Me vendimin nr. 27, datë 30.09.2022 është miratuar një ndryshim në strukturën organizative të shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, ku në pikë 1, ka zvogëluar numrin e punonjësve në Departamentin e Kontrollit e Rikuperimit të Humbjeve më 83 punonjës dhe në Pikën 2 përcakton: " Në varësi të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë "OSHEE GROUP sh.a, krijohet Task Forca e Energjisë". Ky vendim është në vijim të vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 6859, datë 14.09.2022, i cili ka miratuar një ndryshim në Statutin e shoqërisë, nenin 13.2, duke shtuar një pikë më përmbajtjen: " Me qëllim mbarëvajtjen dhe arritjen e objektivave të shoqërisë, të ketë në varësi të drejtpërdrejtë dhe në drejtimin e saj struktura të caktuara të shoqërisë OSHEE GROUP sh.a...".

**2.** Me vendimin qarkullues nr. 30, datë 13.10.2022, në Pikën 2 ka miratuar pagat e strukturës së Task Forcës së Energjisë, ... *"brenda kufijve të fondit të miratuar të pagave të shoqërisë OSSH sh.a"*, kjo në kundërshtim dhe me legjislacionin për përcaktimin e pagave dhe VKM nr. 574, datë 03.08.2016 "Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA". Kjo vendimmarrje mbështetet dhe në Aktin Normativ nr. 14, datë 5.10.2022 "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin e energjisë elektrike" ku në nenin 3, pika 2 përcaktohet: "Task-Forca e Energjisë" është struktura e posaçme e ngritur me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE Group, sh.a". Ndërsa në Rregulloret e kësaj strukture të miratuar nga Aksionari me nr. 8201, datë 27.10.2022, në nenin 1 përcaktohet se është e pavarur nga OSHEE GROUP sh.a dhe raporton direkt te Këshilli Mbikëqyrës; Në nenin 4, pika 7 dhe nenin 10 pika 10.5 përcaktohet se emërimi dhe lirimi nga detyra i punonjësve të Task Forcës bëhet nga Administratori i OSSH sh.a me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm të Task Forcës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenet 135 deri 153, nenet 154 deri 165 dhe nenet 166 deri 167; ligjin nr. 10405, datë 24.3.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6 dhe VKM nr. 574, datë 03.08.2016 "Për miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA".

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës të marrë masa, të rishqyrtojë dhe rishikojë vendimet e marra për ngritjen e strukturave paralele të kontrollit të energjisë (të organizuara si njësi Task-Forcë), të cilësuar si të pabazuara dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe që nuk respektojnë rregullin e përgjithshëm për ndarjen e kompetencave dhe funksioneve ndërmjet organeve drejtuese të shoqërisë.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatua se, për periudhën gjashtëmujori i dytë të vitit 2020 deri më 31.12.2022, Këshilli Mbikëqyrës ka marrë 39 vendime qarkulluese, ose 34 % e nivelit të vendim-marrjes, për çështje me rëndësi jetike për veprimtarinë e OSHEE GROUP sh.a, si ato miratim të rinovimit të limitit të linjës së kredisë në vitin 2020; për miratim të ndryshimeve të investime në planin e konsoliduar financiar në vitin 2021; për miratimin e kredive të reja, owerdraftet gjatë viteve 2021-2022; ndryshime në strukturat organizative të shoqërive, apo të

emërimit të administratorëve, etj., pa u diskutuar, shqyrtuar, analizuar dhe votuar në mbledhje nga anëtarët e këshillit mbikëqyrës. Një veprimtari e tillë është në kundërshtim me VKM nr. 570, datë 3.10.2018 "Për këshillat mbikëqyrës të shoqërive aksionare shtetërore", pika 9, pasi Këshilli Mbikëqyrës e zhvillon veprimtarinë e tij nëpërmjet mbledhjeve dhe jo me vendime qarkulluese pa u mbledhur.

Për më tepër, referuar Statutit të shoqërisë, në nenin 18 është përcaktuar procesi vendim-marrës i këshillit mbikëqyrës, me vendin e zhvillimit të mbledhjeve, mënyrën e thirrjes me çështjet kryesore të rendit të ditës, si dhe procesverbalet e mbledhjeve.

Gjithashtu, marrja e vendimeve qarkulluese e Këshillit Mbikëqyrës pa u mbledhur, është në kundërshtim me nenin 8, të ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", i cili përcakton: *"Organi kolegjial merr vendime vetëm për çështje të cilat janë përfshirë në rendin e ditës së mbledhjes...",* si dhe vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve që marrin pjesë në mbledhje dhe kanë të drejtën e votës (neni 14, pika 1).

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE GROUP sh.a të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim ndjekjen në vijimësi të situatës financiare të shoqërisë, si dhe të veprimtarisë së saj.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi hartimin e miratimin e strategjive dhe planeve financiare të shoqërisë, konstatohet se aprovimet dhe miratimi final nga Asambleja e Ortakëve janë bërë përtej afateve të përcaktuara në dispozita nënligjore, pra bëhen me vonesë dhe pasi ka filluar viti ushtrimor, si dhe shoqërohen me ndryshime të mëtejshme përgjatë vitit. Mos hartimi në kohë nga administratorët dhe aprovimet nga Këshillat Mbikëqyrës, si dhe Asambleja e Ortakëve, vështirëson zhvillimin e veprimtarisë tregtare të shoqërisë, mos arritjen e objektivave të vendosura, realizimin e investimeve strategjike, veprime këto në kundërshtim me nenin 13 dhe nenin 20, pika 7, të Statutit të Shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, miratuar me Vendimin nr. 7551/1, datë 01.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të marrin masa për hartimin në kohë, si dhe aprovimet përkatëse të strategjive dhe planeve financiare të periudhave të ardhshme, pasi të kenë analizuar më parë mos realizimet në periudhën e mëparshme, për të siguruar zhvillimin e veprimtarisë tregtare dhe arritjen e objektivave të vendosura.

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a., nuk ka dërguar për miratim në Entin Rregullator të Energjisë (ERE) planet e investimeve që kryhen nga shoqëria, për periudhat 2021 dhe 2022, veprime në kundërshtim me nenet 20 germa "e"; 60 pika 9 dhe 75 pika 8 të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Rregulloren "Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 135, datë 06.09.2017. neni 7.

Mos paraqitja në kohë e planeve ndikon në vlerësimin dhe analizën e kritereve të aplikueshme dhe miratimin e tyre (ose rishikimin) nga ERE, për të siguruar që planet e investimit të jenë në

përputhje me parimet e planifikimit me kosto më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit, si dhe kërkesat e ENTSO-E lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>5.1 Rekomandimi</u>:** Nga organet drejtuese të OSSH sh.a., të merren masa për të paraqitur në ERE në afatet e kërkuara planet e investimeve, për të bërë të mundur analizën e kritereve të aplikueshme dhe për të siguruar që planet e investimeve janë në përputhje me parimet e planifikimit dhe kosto sa më të ulët, rregullat dhe kërkesat e zbatueshme për sigurinë e operimit të rrjetit, cilësinë e shërbimit dhe sigurinë e furnizimit, si dhe kërkesat e ENTSO-E lidhur me planifikimin e zhvillimit të rrjetit.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, rezultat financiar i shoqërisë OSSH sh.a., për periudhën 2021 shënoi një humbje prej 2,672 milion lekë. Megjithë përmirësimet në drejtim të reduktimit të mëtejshëm të humbjeve, të rritjes së nivelit të arkëtimeve në krahasim me atë të planifikuar, si dhe mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme, rezultati financiar ishte negativ kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë, rrjedhojë e rritjes së çmimit në treg sikurse u parashikua në rishikimin e planit financiar të shoqërisë. Si rrjedhojë e mungesës së furnizimit të plotë të energjisë nga HEC-et private për vitin 2021, OSSH sh.a u furnizua për mbulimin e humbjeve për një sasi prej rreth 215.46 Gwh në tregun e parregulluar. Rritja e çmimit të energjisë në tregun e parregulluar mesatarisht prej rreth 20.75 Lekë/Kwh për nga 8.05 Lekë/Kwh që ishte parashikuar në fillim të vitit, rriti shpenzimet e blerjes së energjisë për OSSH sh.a, duke ulur performancën financiare dhe vendosur në pozitë të vështirë likuiditetet e shoqërisë. Me VKM nr. 584, datë 8.10.2021 "Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike", u vendos që OSSH sh.a të ndërpriste investimet e parashikuara për përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes, me përjashtim të atyre të domosdoshme për furnizimin me energji të konsumatorëve.
Realizimi i të ardhurave nga energjia është pothuajse i barabartë me planifikimin e të ardhurave, e arrin në vlerën prej 26,875 milion lekë. Ulja e humbjeve në rrjet në nivelin e 20.62 % bëri të mundur që të ulen efektet e kostos së blerjes së energjisë së vitit.
Shpenzimet për blerjen e energjisë dhe transmetim u realizuan në shumën 15.9 miliard lekë, me një rritje prej 1%, për shkak të rritjes së çmimit në tregun e lirë, si dhe të ndryshimit të strukturës së blerjes së energjisë. Të ardhura të tjera rezultuan me një ulje prej 8% , në krahasim me ato të planifikuara pas faturimit të penaliteteve, për mosplotësim të planit të furnizimit me energji elektrike për vitin 2021 sipas kushteve të kontraktimit. Shpenzimet operative për 2021 ishin 14 % më të ulëta se ato të planifikuara, ose 1,653 milion lekë. Të gjitha zërat e shpenzimeve u realizuan sipas planifikimit, me përjashtim të penaliteteve. Humbjet në rrjet në vitin 2021 ishin rreth 20.62 % ose rreth 0.12% më të ulta se ato të planifikuara prej 20.49%. Plani i investimeve për vitin 2021 për rreth 13.4 miliard lekë është realizuar në vlerën 11 miliard lekë, pavarësisht se nga OSSH sh.a prej muajit Tetor me vendim të Qeverisë së Shqipërisë, investimet në rrjet u ndërprenë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>6.1 Rekomandimi</u>:** Strukturat drejtuese të OSSH sh.a dhe të OSHEE GROUP sh.a, duke analizuar me kujdes situatën debitore të shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave, si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive.

**Menjëherë e në vijimësi**

**7. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, rezultati financiar i shoqërisë FSHU sh.a, për periudhën 2021 shënoi një humbje prej 11,367 milion lekë. Me gjithë përpjekjet dhe përmirësimet e punës operacionale në drejtim të arritjes së arkëtimeve, mbajtjes së shpenzimeve operative në nivele minimale të mundshme dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit, performanca negative është rrjedhojë e rritjes së shpenzimeve për blerjen e energjisë si pasojë e rritjes së çmimit të energjisë së blerë në tregun e lirë. Kështu, të ardhurat nga shitja e energjisë ishin rreth 1% më të ulta, ku pjesa më e madhe e uljes vjen nga konsumatorët privatë, ose rreth 1.2 miliard lekë më pak. Të ardhurat nga konsumatorët familjarë janë 2% më të larta, në krahasim me planifikimin e vitit 2021, për shkak të rritjes së sasisë së energjisë së blerë. Të ardhurat nga kamatëvonesat ishin 6.7% më të ulta se ato të planifikuara të vitit 2021, ose rreth 66 milion lekë, për shkak të fillimit të përmirësimit të pasojave të situatës pandemike e Covid-19 dhe ndikimit të saj në ekonominë e vendit.
Shpenzimet në vitin 2021 u rritën me 8%, ose rreth 4.8 miliard lekë, në krahasim me ato të planifikuara, kryesisht për shkak të rritjes së shpenzimeve të energjisë, si rezultat i rritjes së çmimit të blerjes në tregun e lirë gjatë gjysmës së dytë të vitit. Rritje të shpenzimeve kishte edhe në zërin shpenzime operative, ku rritjen më të madhe e kanë shpenzimet për penalitete, gjoba e dëmshpërblime, si dhe në shpenzimet financiare.
Në 6-mujorin e dytë të vitit 2021, kur sasia e energjisë së furnizuar nga KESH sh.a ishte 21% më e ulët se ajo e 6-mujorit të parë të vitit, sasia e energjisë së blerë në tregun e lirë ishte rreth 897 Gwh, e cila për shkak të rritjes së çmimit, u ble me çmim mesatar prej rreth 26.03 Lekë/kah, me një kosto totale prej rreth 23.4 miliard lekë, nga 2.03 miliard lekë që ishin shpenzuar në vitin 2020 për të njëjtën periudhë.
Shpenzimet për tarifën e shpërndarjes dhe të transmetimit, si rezultati i rritjes së energjisë së shitur ishin 10% më të larta se ato të planifikuara, ose respektivisht 1.9 dhe 0.8 miliard lekë më të larta dhe po kështu edhe shpenzimet për energjinë reaktive, të cilat u rritën 11% në krahasim me planifikimin e vitit 2021.
Shpenzimet për disbalancat, pavarësisht se sasia e disbalancuar ishte brenda normave të planifikuara për më pak se 2% të sasisë së energjisë, për shkak të rritjes së çmimit të energjisë u rritën 96%, duke qenë 359 milion lekë më të larta se sa planifikimi i vitit 2021.
Shpenzimet operative u rritën 7%, ose 242 milion lekë në krahasim me ato të planifikuara. Rritja e ndjeshme e shpenzimeve operative lidhet kryesisht me rritjen e shpenzimeve për penalitete, gjoba dhe dëmshpërblime, të cilat janë rritur me 816 milion lekë në krahasim me planifikimin e vitit 2021. Shpenzimet për të punësuarit, postare, konsulenca, auditim dhe të tjera janë më të ulta se ato të parashikuara në planin financiar, ndonëse janë më të larta se ato të realizuara në vitin 2020. Shpenzimet financiare janë rritur me rreth 41 milion lekë, në krahasim me planifikimin e 2021. Rritja e këtyre shpenzimeve është rrjedhojë e kostove të interesave të kredive të reja të marra në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare për kalimin e krizës së likuiditetit në kushtet e rritjes së jashtëzakonshme të çmimit të energjisë në tregun e energjisë.
Marrja e kredive afatshkurtra nga bankat e nivelit të dytë, ka përkeqësuar situatën financiare të shoqërive kontrolluara nga OSHEE Group sh.a dhe të vetë asaj. Rritja e detyrimeve financiare afatshkurtra dhe afatgjata rrit kostot e shoqërive si dhe cënon investimet për rritjen e performancës dhe uljet e humbjeve në rrjet.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet nr. 30-53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>7.1 Rekomandimi</u>:** Strukturat drejtuese të FSHU sh.a dhe të OSHEE GROUP sh.a, duke analizuar me kujdes situatën debitore të shoqërisë, të hartojnë plane financiare për përmirësimin e tyre, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit për ristrukturimin e huave, si dhe mundësitë e shtimit të kapitalit të shoqërive.

**Menjëherë e në vijimësi**

**8. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i pagesave të kryera për periudhën e audituar, u konstatua se në kontratën e lidhur me operatorin ekonomik "E S sh.p.k." dhe OSSH sh.a, Drejtoria Rajonale Burrel, me datë 17.06.2021, me vlerë 123,310,827 lekë, si dhe në kontratën e lidhur më datë 19.08.2021, mes Drejtorisë Rajonale të OSSH sh.a. dhe FSHU sh.a. Berat, dhe operatorit ekonomik "M.-Security sh.p.k.", me vlerë kontrate 85,963,221 lekë, kontraktuesit duhet të paraqesin sigurim kontrate në shumën 10 % të vlerës së kontratës në formën e një garancie sigurimi, lëshuar nga një institucion financiar. Kontratat janë formuluar duke iu referuar kontratave të formatuara për furnizime tipike të procedurave të tenderimit, pa reflektuar specifikat e shërbimit të sigurisë fizike.
Operatorët ekonomikë nuk kanë siguruar riskun e mos realizimit të shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve e aseteve të shoqërisë. Në një kontratë me një operator tjetër ekonomik që ofron shërbim të njëjtë, kjo pikë është përcaktuar me marrjen e një siguracioni të përgjegjësisë profesionale, sipas rregullave dhe praktikave të njohura për të zhdëmtuar Autoritetin Kontraktor për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimit.
-Mos sigurimi i riskut për mos realizimin e shërbimit të ruajtjes së sigurisë fizike të objekteve e aseteve të shoqërisë, mund të sjellë pasoja me dëme të rëndësishme për shoqërinë. Siguracioni për përgjegjësinë profesionale, sipas rregullave dhe praktikave të njohura për të zhdëmtuar Autoritetin Kontraktor për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë në kryerjen e shërbimit, ul riskun e zvogëlimit të aseteve të shoqërisë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>8.1 Rekomandimi</u>:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa që, në kontratat e ardhshme të shërbimit të sigurisë fizike detyrimet financiare mes palëve në rastet e shkaktimit të dëmeve të përcaktohen qartë dhe duke detajuar asetet përkatëse që OE do marrë përsipër për sigurinë fizike. Duke u nisur nga fakti që vlera e aseteve që i lihen për ruajtje është më e lartë se vlera e kontratës së shërbimit, garancia prej 10% e kontratës së shërbimit nuk mbulon dëmin që mund të shkaktohet në rast të moskryerjes së shërbimit. AK duhet të kërkojë garanci nga OE se do dëmshpërblehet në rast të shkaktimit të dëmeve nga moskryerja e ruajtjes së sigurisë fizike.

**Në vijimësi**

**9. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i shpenzimeve të kryera nga OSHEE GROUP sh.a, u konstatua se në kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë "E Ssh.p.k." dhe "M.-Security sh.p.k.", termat mes palëve nuk janë formuluar sipas parakushteve të paracaktuar në nenin 18 "Kontrata ndërmjet palëve" të ligjit nr. 75/2014 "Për Shërbimin privat të sigurisë fizike", udhëzimit nr. 130, datë 05.03.2018, "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike", Kreu V, Menaxhimi i shërbimeve të SHPSF-së, Organizimi dhe drejtimi i SHPSF-së.
Në lidhje me zbatimin e kontratës, nga Autoriteti Kontraktor nuk janë kërkuar deklarimet e pagesave të sigurimeve shoqërore për punonjësit të përcaktuar për të kryer shërbimin e kontraktuar. Duke u nisur nga fakti që në ofertat ekonomike të OE pjesëmarrës në procedura, pjesa më e madhe e kostos së shërbimit përbëhet nga pagat e punonjësve, pagë kjo e përcaktuar që të jetë minimalisht 50% më e madhe se paga minimale e përcaktuar me VKM-në përkatëse, si dhe shtesat që do të bëhen në pagën e punonjësve për turnin e II, III, ditët e festave, dhe sigurimet

shoqërore, Autoriteti Kontraktor nuk mund të kryejë verifikimet nëse fondet e kaluara ndaj operatorit ekonomik janë përfituar në përputhje me ofertat ekonomike të kryera në procesin e prokurimit.
-Formulimi i kontratës mes palëve pa përfshirë dhe përcaktimet e udhëzimit në lidhje pikën 2, ka si pasojë rritjen e riskut për mos kryerjen e shërbimit me personelin e parashikuar dhe zvogëlimin e mundësive të AK për verifikimet përkatëse.
Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 130, datë 05.03.2018, "Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike", Kreu V, pika 2, ka përcaktuar qartë trajtimin financiar të punonjësit të shërbimit sa është dhe se duhet të kryhet me bankë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>9.1 Rekomandimi</u>:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa për hartimin e kontratave në përputhje të parakushteve të përcaktuara në udhëzime dhe të ndjekë zbatimin e tyre nga OE fitues, si dhe të bëjë verifikimet përkatëse lidhur me pagesat e punonjësve.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pagesave të kryera për shlyerjen e detyrimeve kontraktore ndaj një pjese furnitorësh, bashkime operatorësh ekonomikë, u konstatua se pagesat e shërbimeve dhe mallrave janë faturuar nga një prej operatorëve ekonomikë dhe jo nga të gjithë pjesëmarrësit e bashkimit ekonomik, sipas përqindjes së dakordësuar në dokumentet e tenderit. Këto bashkime operatorësh ekonomikë nuk kanë përmbushur detyrimet mbi bazën e të cilave janë shpallur fitues dhe kanë nënshkruar kontratat. Në këto raste, kemi të bëjmë me deklarime të pasakta pranë organeve tatimore, pasi shoqëritë kanë deklaruar një shumë për të cilën nuk ka lidhur kontratë. Gjithashtu, këto fatura tatimore mund të përdoren në procedura prokurimi si kontrata e ngjashme me një vlerë të pasaktë.
Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 88 "Bashkimi i operatorëve ekonomikë", pikat 1,2,5 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 6, datë 30.01.2015, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", neni 32.2.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>10.1 Rekomandimi</u>:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa në të ardhmen që, me shpalljen fitues të procedurës së tenderimit, BOE të firmosin kontratën për furnizim mallrash ose shërbime, dhe duke ofruar shërbimet në përqindjet e rëna dakord dhe duke i shoqëruar me faturat tatimore përkatëse.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, nga shoqëria për vitin 2020 janë shpenzuar 42,073,200 lekë dhe për vitin 2021 janë shpenzuar 97,372,800 lekë për audituesit ligjorë për shërbimin e auditivit të pasqyrave financiare, por nga Asambleja e Aksionarit përzgjedhja e audituesit është kryer me miratim, pa u zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
-Nga auditimi i pagesave të bankës për periudhën objekt auditimi u konstatua se shoqëria ka lidhur kontratë për kolaudimin e matësve me shoqëritë 3 G sh.p.k, VME sh.p.k. dhe HTT sh.p.k. pa zhvilluar procedura prokurimi, në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.
Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me nenin 4, të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar. Për qëllim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1. "Autoritet kontraktor" është çdo ent që i nënshtrohet këtij ligji për zbatimin e kontratave të tij

publike. 9. “Fondet publike” janë: ç) të ardhurat nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>11.1 Rekomandimi:</u>** Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve në zbatim të funksionit ligjor për zgjedhjen e audituesve ligjorë për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë, duhet të kryejë procedurat e prokurimit për këtë proces. Megjithëse tarifa orare është e caktuar me rregullore të brendshme nga IEKA, sasia e orëve të punës për angazhimet audituese mund të ndryshojë në varësi të eksperiencës së tyre, njohjes së mëparshme të subjekteve, kapaciteteve të tyre pa e ulur cilësinë e auditimit.

**Në vijimësi**

**12. Gjetje nga Auditimi:** Gjatë vitit 2022, Komisioni i Blerjeve me Vlera të Vogla, ka kryer procedurat me objekt “Blerje ndriçues zyre për godinën qendrore të OSHEE GROUP sh.a” me vlerë 950,000 lekë pa TVSH, me urdhër prokurimi nr. 7469/2, datë 29.07.2022, ku është kërkuar malli ndriçues zyre, copë 300, dhe “Blerje materiale elektrike dhe hidraulike për mirëmbajtjen e godinës qendrore” me vlerë 750,000 lekë pa TVSH, me urdhër prokurimi nr. 7462/1, datë 28.07.2022. Nga auditimi i këtyre procedurave konstatohet se, Autoriteti Kontraktor për vitin 2022 ka copëzuar fondin limit, në kundërshtim me nenin 34 pika 2 të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, me ndryshimet vijuese të tij.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqet nr. 60-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>12.1 Rekomandimi</u>:** Autoriteti Kontraktor të marrë masa për trajnimin e punonjësve që kryejnë procedurat e prokurimit, duke ndikuar në rritjen e kapaciteteve të brendshme për menaxhimin e fondeve publike me efikasitet dhe ekonomicitet.

**Në vijimësi**

**13. Gjetje nga Auditimi:** Konstatohet se, OSHEE GROUP sh.a, ka depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, QKB, brenda afatit vetëm deklaratën e tatim fitimit për periudhën 2020, ndërsa të gjitha deklarimet e tjera janë bërë me vonesë. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e OSHEE GROUP sh.a., nuk i ka miratuar pasqyrat financiare të periudhës 2020 dhe 2021. Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a), përveç deklaratës së tatim fitimit të kryer më 31.03.2021, të gjithë dorëzimet e tjera i ka kryer me vonesë. Operatori i Sistemit të Shërbimit sh.a. (OSSH.) përveç deklaratës së tatim fitimit të kryer më 31.03.2021, të gjithë dorëzimet e tjera i ka kryer me vonesë.
Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, neni 29 “Deklarimi tatimor dhe llogaritja përfundimtare e detyrimit”. Asambleja e Ortakëve ka detyrimin për të aprovuar pasqyrat financiare të shoqërisë në afatin e caktuar nga ligji nr. 8483 datë 28.12.1998, i ndryshuar “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33/1. Mos depozitimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), si dhe kryerjet jashtë afateve ligjore janë në kundërshtim me ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, i ndryshuar, neni 43, Regjistrimet e tjera të detyrueshme dhe neni 46.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>13.1 Rekomandimi</u>:** Nga titullarët e shoqërive të merren masa që në të ardhmen, pasqyrat financiare të hartohen, depozitohen dhe të aprovohen brenda afateve ligjore, duke mundësuar vlerësimin e gjendjes financiare të shoqërisë, vlerësimin e performancës ekonomike lidhur me vendim-marrjet që duhet të marrin palët e interesuara, si asambleja e ortakëve, institute kredidhënie, etj.

**Në vijimësi**

**14. Gjetje nga Auditimi:** Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve e OSHEE GROUP sh.a., nuk ka miratuar pasqyrat financiare të periudhave 2020 dhe 2021, me arsyetimin e mos aprovimit nga refuzimi i dhënies së opinionit nga audituesit ligjorë, duke vendosur ri auditim nga auditues të tjerë për verifikimin e mos përputhjeve të gjetura në refuzimin e opinionit.
Me datë 28.06.2021, audituesit ligjor në raportin e tyre janë shprehur për "Refuzim opinioni", bazuar në konstatimet se shoqëria nuk ka finalizuar regjistrin e aseteve si dhe nuk ka marrë titujt e pronësisë për pronat e paluajtshme që ka në përdorim.
Më datë 14.04.2022, drejtimi i shoqërisë OSHEE i ka kërkuar Aksionarit të shoqërisë, emërimin e audituesve ligjor për "Auditimin e pasqyrës së veçantë dhe të konsoliduar të lëvizjes së aktiveve të qëndrueshme të shoqërisë OSHEE Group sh.a.".
Më datë 13.05.2022, Aksionari i shoqërisë, me shkresën nr. 3235/1 ka vendosur për caktimin e audituesve ligjor L K, E H, I D dhe V Ç për dhënien e opinionit të auditimit për pasqyrat financiare të konsolidurara për vitin e mbyllur më 31.12.2020, pas regjistrimit të rezultateve të inventarizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale dhe Jomateriale në këto pasqyra, për shoqërinë OSHEE Group sh.a.
Vendim-marrja e Asamblesë së Ortakëve për një ri-auditim të pasqyrave financiare të periudhës ushtrimore 2020, pasi të ishin reflektuar *rezultatet e inventarizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, rivlerësimi i tyre dhe sistemimi i diferencave* për të mos pasur mbartje në vitin 2021 me refuzim opinioni nuk ka mbështetje në ligjin nr. 10 091, datë 5.03.2009, "Për Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të Miratuar", i ndryshuar si dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Nëse refuzimi i ekspertëve të mëparshëm kishte lidhje me inventarizimin dhe rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale dhe sistemimin e diferencave, nuk kishte arsye për dhënie opinioni përsëri për pjesët e tjera të pasqyrave financiare. Organet drejtuese të shoqërisë të merrnin masa për korrigjimin e situatës dhe diferencat të reflektoheshin në periudhën pasardhëse.
Veprimet e Asamblesë së Ortakëve kanë sjellë vonesa jo të justifikuara duke kërkuar auditim sërish për pasqyrat financiare të OSHEE Group sh.a.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>14.1 Rekomandimi</u>:** Drejtimi i shoqërisë të marrë masa që, në të ardhmen aprovimi i pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrit rregullator përkatës dhe që kanë si objektiv dhënien e informacionit rreth pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, e që janë të dobishme për vendimmarrjen ekonomike të një grupi të gjerë përdoruesish, përveç anës formale të jetë i orientuar në pjesën thelbësore të problematikave dhe zgjidhjen e tyre.

**Në vijimësi**

**15. Gjetje nga auditimi:** Shoqëria OSSH sh.a nuk ka plotësuar regjistrin e aktiveve që ka në pronësi apo posedim, me kërkesat minimale që duhet të përmbajë ky regjistër.
-Nga auditimi i kontabilizimeve të aktiveve të blera u konstatua se emërtimet me të cilat regjistrohej në sistemin SIP, sistemi që përdor financa, emërtimi nuk përfshinte markën, shpjegime më të qarta duke e bërë të vështirë identifikimin në periudhat e mëpasshme për inventarizimet periodike. Sa më sipër është në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 30.

Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj. Mos plotësimi i regjistrit të aktiveve sjell risk i lartë për shpërdorime materiale të pasurisë së shoqërisë, si humbje, vjedhje, shkatërrime dhe mos përditësim i aktiveve që ka në dispozicion.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**15.1 Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimeve vjetore të aktiveve fizike të shoqërisë, si dhe për plotësimin e regjistrit të aktiveve që shoqëria zotëron me të gjitha kërkesat e formatit të aprovuar për të ulur riskun e shpërdorimeve materiale të pasurisë së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre.

**Në vijimësi**

**16. Gjetje nga Auditimi:** OSHEE Group sh.a. nuk ka kryer inventarizimin e plotë të detyrimeve për periudhat 2021 e 2022, duke mos kryer verifikimin e ekzistencës fizike, si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, si të detyrimeve dhe të drejtave e dokumentacionit mbështetës përkatës. Këto veprime janë bërë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018, i ndryshuar, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 15, "nventari i aktiveve dhe detyrimeve". Ekzistenca dhe gjendja në të cilën ndodhen aktivet fizike është një pjesë e rëndësishme në vlerësimin e riskut për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe vazhdimësinë e saj.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**16.1 Rekomandimi:** Administratori i shoqërisë dhe Nëpunësi Zbatues, për të ulur riskun e zvogëlimit të aseteve së shoqërisë dhe mirë menaxhimin e tyre, duhet të marrin masa për kryerjen e inventarizimit të plotë të detyrimeve për periudhat, vitet 2021 dhe 2022, duke kryer verifikimin e ekzistencës fizike si dhe vlerësimin e gjendjes së tyre, të detyrimeve, të drejtave dhe dokumentacionit mbështetës përkatës, procedura rakordimi dhe dakordësimi për saldot vjetore, shoqëruar me relacionet përkatëse.

**Në vijimësi**

**17. Gjetje nga Auditimi:** Në auditimin e faturimeve të shërbimit të ofrimit të energjisë elektrike, të kryera nga Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., kamatëvonesat e akumuluara nuk pasqyrohen në faturat që i dërgohen përdoruesve. Shoqëria i evidenton vetëm në momentin e arkëtimit, duke zbatuar dhe parimin e sigurisë dhe duke mos i deklaruar si të ardhura në momentin që maturohen. Ndërsa, kjo është një praktikë e mirë për të mos deklaruar të ardhura që nuk kanë siguri se do të arkëtohen, kur vlerat janë materiale dhe përfituesit e shërbimit janë shoqëri private biznesi ose publike shtetërore që kanë detyrimin ligjor për të zbatuar SNK ose SKK, mos pasja e vlerave të kamatëvonesave në faturë si detyrim për tu paguar sjell vështirësi për paraqitjen e tyre si provizione në pasqyrat financiare. Ky problem është me rëndësi materiale për shumë shoqëri publike shtetërore, të cilat ka detyrime të konsiderueshme ndaj FSHU sh.a., dhe paraqesin në pasqyra detyrimin vetëm për principalin.
Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, janë miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 15, datë 10.01.2018, neni 10, "Çmimi i Energjisë Elektrike" pika 10.1. Në bazë të legjislacionit në fuqi që rregullon sektorin e energjisë elektrike, çmimi i energjisë elektrike përcaktohet nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE). Çmimi, përbërësit e tij, struktura tarifore orare, apo sipas nivelit të konsumit, i bëhen të ditur Klientit në faturën e konsumit të energjisë elektrike. Mos paraqitja e kamatëvonesave për tu paguar dëmton paraqitjen me saktësi dhe siguri të pasqyrave financiare përkatëse.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>17.1 Rekomandimi</u>:** Shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a., të marrë masa që kamatëvonesat e akumuluara të pasqyrohen në faturat që i dërgohen përdoruesve, duke rritur transparencën në marrëdhëniet me konsumatorët, si dhe duke reflektuar më saktë detyrimet aktuale të përdoruesve.

**Në vijimësi**

**18. Gjetje nga Auditimi:** Shoqëria OSHEE GROUP sh.a nuk ka përfunduar procesin e kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, të iniciuara me VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 "Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a.". Shoqëria nuk ka zbatuar plotësisht VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 "Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a." pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" , i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45. VKM nr. 1108, datë 30.07.2008 "Për miratimin e listës së Inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat kalojnë në pronësi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes sh.a." pikat 1,2,3, për regjistrimin e pasurive në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" , i ndryshuar me ligjin nr. 9/2016, datë 11.02.2016, për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, neni 45. Mos përfundimi i këtij procesi rrit riskun, që objektet që nuk kanë të përfunduar procesin mund të tjetërsohen nga palë të treta.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>18.1 Rekomandimi</u>:** Nga drejtimi i shoqërive të merren masa që në të ardhmen, të ndiqet me përgjegjshmëri përfundimi i procesit të kalimit të pronësisë nga Inventari i pronave të paluajtshme shtetërore, në shoqërinë OSHEE sh.a, ose në tre shoqëritë bija sipas raporteve respektive të ndarjes.

**Në vijimësi**

**19. Gjetje nga Auditimi:** Në raportet e ecurisë së veprimtarisë së shoqërisë dhe dokumenteve shpjegues, mungonte deklarata e miradministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj si dhe profili i administratorëve dhe anëtarëve të këshillave, ku të shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria.

Këto veprime zvogëlojnë transparencën e menaxhimit të shoqërisë si dhe janë në kundërshtim me nenin 134, të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>19.1 Rekomandimi</u>:** Administratorët e shoqërive të marrin masa për plotësimin e deklaratave të miradministrimit të shoqërisë, praktikat e ndjekura prej saj, si dhe profilet e administratorëve dhe anëtarëve të këshillave, ku të shpjegohen elementët dhe faktet që i kualifikojnë për kryerjen e detyrave të caktuara nga shoqëria, për të rritur transparencën e menaxhimit të shoqërisë.

**Në vijimësi**

**20. Gjetje nga Auditimi:** Në shënimet shpjeguese, nga drejtimi i shoqërisë nuk janë paraqitur informacione sqaruese lidhur me vlerësimet dhe arsyet e përcaktimit të jetës së dobishme së AAM-ve, pra për normat e amortizimit të aplikuara në pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore në kundërshtim me pikat 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).

-Në lidhje me përllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, shoqëria përdor norma menaxheriale si dhe normat fiskale, duke paraqitur diferencën në shpenzimet e pazbritshme, të rezultatit të

periudhës ushtrimore. Normat menaxheriale dhe ato fiskale të përdorura kanë mbetur të pandryshuara nga periudha e ish CEZ. Jetëgjatësia e aktiveve është rishikuar nga vlerësimi i kryer nga grupi i ekspertëve vlerësues dhe kontabël, që me urdhrin nr. 1460, datë 20.02.2015, i ndryshuar të ministrit të MZHETTS si dhe bazuar në kontratën nr. 23318 prot., datë 31.12.2015 "Për rivlerësimin e aktiveve afatgjatë materialë të shoqërisë Oshee SHA".
-Shoqëria nuk ka shqyrtuar në fund të periudhës ushtrimore vlerën e mbetur dhe jetën e dobishme të AAM-ve me vlera materiale të cilat ndikojnë në rezultatin e shoqërisë, veprime në kundërshtim me pikën 51, të SNK 16, dhe pikës 75 të Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16, Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje).
Këto veprime janë në kundërshtim me pikën 23, shkronja d, e Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.
Duke mos përdorur norma menaxheriale të mirëargumentuara nga specialistët përkatës dhe duke mos e përcaktuar me fleksibilitet jetëgjatësinë e aktiveve, duke vlerësuar dhe zhvillimin e teknologjisë, shoqëria rrezikon të mos kryej me sukses planifikimin në avancë për zëvendësimin e aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>20.1 Rekomandimi</u>:** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për vlerësimin e jetëgjatësisë së aktiveve, duke përdorur fleksibilitet dhe relacione të mirë argumentuara nga specialistët përkatës, për klasa specifike të aktiveve dhe jo të përgjithshme, për planifikimin në kohë të zëvendësimit të aktiveve që janë në përfundim të ciklit të jetës së tyre.

**Në vijimësi**

**21. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i kryer në librat e blerjes për deklarimet e faturave të blerjes, u konstatua se kishte fatura që i përkisnin periudhave ushtrimore të mëparshme ose të lëshuara nga subjektet disa muaj më parë dhe që departamentit të financës, u ishin vënë në dispozicion në muajin e deklaruar. Këto veprime sjellin efekte në kontabilizimin e aktiveve dhe përcaktimin e datës së hyrjes në përdorim. Në Standardin Ndërkombëtar i Kontabilitetit 16 "*Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)", neni 55,* përcaktohet se amortizimi fillon kur aktivi është i disponueshëm për përdorim, pra pasi aktivi është marrë në dorëzim dhe është bërë pjesë e sistemeve përkatëse. Ky veprim sjell shtrembërime në llogaritjen e saktë të amortizimit të aktiveve të shoqërisë duke ndikuar në rezultatin e shoqërisë.
Vonesat në mos likuidimin e faturave, krijojnë mundësinë e krijimit të penaliteteve nga Operatori Ekonomik, i cili ka kryer objektin e investimit, dhe në bazë të neneve të kontratës dhe ligjit nr. 48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", nenit 4, OE i lind e drejta për të kërkuar kamatëvonesa. Veprimet e mësipërme sjellin efekte dhe në raportin e TVSH-së kreditore dhe debitore, duke mos pasqyruar detyrimet e sakta në kohë të shoqërisë, për pagesat e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>21.1 Rekomandimi</u>:** Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për kryerjen me përgjegjshmëri dhe brenda afateve përkatëse të procesit të nënshkrimit të faturave tatimore nga personat e autorizuar, si një dokument zyrtar i shoqërisë i pranimit të marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve.

**Në vijimësi**

**22. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të konsoliduara u konstatua se, nuk është kryer zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë sipas metodologjisë të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim. Për periudhat e mëparshme shoqëria ka përdorur metodologjinë

e përcaktuar në raportin e audituesit ligjor "B. T. A. Shpk", e miratuar me Vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 39, datë 20.07.2017, ku në raportin e paraqitur nga audituesi ligjor janë kryer supozime hipotetike nga pika 5.5.17 C dhe 5.5.19 për maksimumin e periudhës kontraktuale pa vlerësuar të dhënat aktuale që disponon shoqëria. Raporti paraqet metodologjinë e zhvlerësimit të llogarive të arkëtueshme sipas standardit të raportimit SNRF 9.
Shoqëria OSHEE nuk duhet të marrë parasysh veç metodologjinë e standardit, por edhe ligjet kombëtare bashkë me ligjet e faljes së detyrimeve, të cilat janë të parat që duhen reflektuar në pasqyrat financiare dhe më pas në programin ekonomik.
Gjithashtu Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 15 "Të ardhurat nga Kontratat me Klientët", "Kontratat me klientët", Paragrafi 113. Ky informacion nuk ka shpjegimet përkatëse të cilat e bëjnë të përshtatshëm për tu përdorur nga palët e treta, si dhe drejtimi i shoqërisë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**22.1 Rekomandimi:** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i shoqërisë të merren masa për kryer zhvlerësimin i llogarive të arkëtueshme të shoqërisë sipas metodologjisë të zhvlerësimit të kërkesave tregtare për arkëtim, duke u nisur nga të dhënat aktuale që disponon shoqëria për të pasur një situatë sa më të besueshme dhe reale.

**Në vijimësi**

**23. Gjetje nga Auditimi:** Gjatë procesit të inventarizimit fizik të vlerave materiale në magazinat e OSSH-së, nga komisionet përkatëse, për periudhën 2021, në relacionin përfundimtar në zbatim të Urdhrit nr. 13037 prot., datë 06.12.2021, u evidentuan artikuj me qarkullim të ngadalshëm në këto magazina, **me vlerë totale në 257,303,138 lekë**, artikuj të bërë hyrje në periudha të mëparshme dhe në ato të fundit.
Në relacionin teknik drejtuar Drejtorisë Ekonomike, për nevojat e shoqërisë për bazë materiale për mirëmbajtje, nga Divizionit të Shpërndarjes, janë hartuar dhe përllogaritur në Planin e Mirëmbajtjes, sasitë vjetore të parashikuara. Nga kjo drejtori nuk janë kryer me saktësi llogaritjet për sasitë e artikujve të kërkuar për buxhetin e viteve 2020, 2021, duke krijuar materiale stok, që përveç se ka impenjuar fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë.
Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 1 dhe 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar. Përllogaritja jo e saktë e sasive të artikujve të kërkuar për tu blerë, sjell riskun e krijimit të materialit stok, që përveç se impenjon fonde financiare të shoqërisë, ka dhe riskun që për arsye të zhvillimeve teknologjike të bëhen të papërdorshëm në periudhat e ardhshme, duke sjellë zvogëlim të aktiveve të shoqërisë dhe një përdorim jo efektiv dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**23.1 Rekomandimi:** Nga administratori i shoqërisë të merren masa që në të ardhmen, strukturat e ngarkuara për planifikimin e bazës materiale për mirëmbajtje, të kryejnë kërkesat e tyre të bazuara në raporte të mirë argumentuara, të specifikuara dhe të detajuara, për shmangien e krijimit të materialeve stok dhe një menaxhim me efektivitet dhe efiçient të burimeve financiare të shoqërisë.

**Në vijimësi**

**24. Gjetje nga Auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mbajtur për inventarët e datës 31.12.2021 u konstatua se, shoqëria ka gjendje pjesë materiale e artikuj të ndryshëm, të vlerësuar si jashtë përdorimit me vlerë kontabël të mbetur 197,492,859 lekë.
Nga administratori i shoqërisë janë iniciuar procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit pas

vlerësimit të komisioneve të ngritura. Më datë 04.06.2018, eksperti i vlerësimit i caktuar nga MIE, ka dorëzuar raportin e vlerësimit, për shkarkimin nga librat kontabël vlerën e inventarit prej 179,436,025 lekë, dhe më datë 18.10.2018, me vendimin nr. 29, Këshilli Mbikëqyrës ka aprovuar raportin, si dhe ka miratuar vlerën e inventarit 108,7843,007 lekë të vlerësuar për tu shitur si skrap, sasinë 495,137 kg në vlerën 30,956,459 lekë, si dhe miratimin e vlerës së inventarit 70,593,018 lekë për tu asgjësuar.
Shoqëria, deri në përfundim të datës së auditimit, nuk ka iniciuar procedurat për hapjen e ankandit publik veprime që ngarkojnë me përgjegjësi administratorin e shoqërisë.
-Gjatë investimeve të ndryshme në linja të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar asetin për vlerën kontabël të mbetur konform kërkesave të Udhëzimit nr. 30, për vlerësimin e tyre, pika 103.
Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 108 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë publike", i ndryshuar. Mos kryerja në kohë e ankandit sjell vështirësi logjistike, duke bllokuar hapësira magazinuese si dhe rrit rriskun për dëmtime dhe zhvlerësime të mëtejshme të vlerës së aktiveve të vendosura për tu shitur.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>24.1 Rekomandimi</u>:** Administratori i shoqërisë të marrë masa për vlerësimin e gjendjes aktuale të materialeve skrap, testimin real të tregut, hapjen e procedurës së ankandit publik për shitjen e materialeve dhe duke proceduar më pas në vijimësi sipas situatës.

**Në vijimësi**

**25. Gjetje nga Auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, situata debitore e OSHEE Group në fund të periudhës 2022 është përkeqësuar në krahasim me vitin 2020, **duke u rritur me 13,997,171 mijë lekë dhe që arrin në një total prej 139,653,687 mijë lekë.** Në strukturën e detyrimeve që ka shoqëria, një pjesë e madhe përbëhet nga detyrimet ndaj Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare sh.a. për blerje energjie, hua dhe interesa dhe për periudhën 2021-2022, janë rritur në vlerën 4,387,945 mijë lekë, dhe detyrimi total është në vlerën 65,743,270 mijë lekë. Mes shoqërive është rënë dakord për balancën e detyrimeve që OSHEE ka ndaj KESH më datë 31.12.2020, vlera 48,910,915 mijë lekë. Kjo vlerë do të paguhet me këste, duke filluar në vitin 2021 deri në vitin 2046. Detyrimet e OSHEE ndaj OST për transmetim energjie, hua dhe interesa për periudhën 2021-2022, ku OSHEE i detyrohet OST detyrime në vlerën 15.268,646 mijë lekë deri në 31.12.2022, detyrimet e OSHEE ndaj OST deri në vitin 2022 janë rritur me vlerën 3,557,129 mijë lekë. OSHEE ka lidhur një marrëveshje me OST datë 15.04.2021 për pagesën e detyrimeve të prapambetura. Shoqëria ka rritje të detyrimit për energji elektrike ndaj HEC-eve në vlerën 2,746,462 mijë lekë si dhe ka ulur me 8,961,484 mijë lekë detyrimin për energji elektrike nga importi.
Gjatë periudhës 2022 janë rritur huatë afatgjata me 6,026,538 mijë lekë, me pjesën më të madhe në 5,497,318 mijë lekë nga EBRD. Huatë ndaj Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE) përbëhen nga: - Hua afatgjatë të financuar nga Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për financimin e projektit për rimëkëmbjen e sektorit të energjisë elektrike, miratuar me ligjin nr. 170/2014, datë 11.12.2014. Për zbatimin e projektit, Shoqëria dhe MFE kanë nënshkruar marrëveshjen e nënhuasë më 31.12.2014, të ndryshuar më 19.01.2018, me vlerë 69,679 mijë Euro.
- Huatë buxhetore nga MFE, detyrimi i përket huasë afatgjatë në vlerën 1.5 miliard lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017 me interes 0.25% për tu ripaguar brenda vitit 2019 dhe huasë afat shkurtër në vlerën 1 miliard lekë. Kjo hua është marrë në vitin 2017 me interes 0.25 % për tu ripaguar brenda vitit 2018, por që mbetet në detyrimet e shoqërisë.

Në periudhën e fundvitit 2021 dhe në 2022, shoqëria ka rritur borxhin afatshkurtër në vlerën 17,060,882 mijë lekë, duke pasur një rritje në 9,579,154 mijë lek në hua afatshkurtra (Owerdrafte) nga bankat e nivelit të dytë.
Detyrimet ndaj Tatimeve janë ulur në vlerën 1,151,068 mijë lekë dhe vlera e fund vitit 2022 5,279,056 mijë lekë përbëhet nga detyrimet për tatimin mbi fitimin kur 1,146,452 mijë lekë është principal, 2,805,637 mijë lekë gjoba dhe 1,269,529 mijë lekë janë interesa.
Vështirësitë e shkaktuara në sistemin energjetik për arsye klimaterike, mungesa e reshjeve gjatë viteve 2017 dhe 2019 si dhe rritja e pa parashikuar e çmimeve në import në 6-mujorin e dytë të 2021, dhe në vitin 2022, detyroi OSHEE të blinte energji elektrike në tregun e jashtëm me çmime jo të favorshme, duke kërkuar një pjesë e rëndësishme e arkëtimeve të shoqërisë.
OSHEE ka hasur vështirësi me likuiditetin gjë që shkaktoi rritjen e detyrimeve për blerjen e materialeve për investimet me kontrata të lidhura në proces. Rritja e detyrimeve afatshkurtra dhe afatgjata shton barrën financiare, duke kufizuar aftësitë e shoqërisë për investime të mëtejshme. Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", pika 2, neni 12.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqet nr. 66-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**25.1 Rekomandimi:** Strukturat drejtuese të shoqërisë duhet të marrin masa në përmirësimin e situatës debitore të shoqërisë duke rritur të ardhurat kryesore, mbledhjen e llogarive të pagueshme nga klientët, uljen e kostove, negocimin e kushteve më të mira me institucionet e kreditit, si dhe shtimin e kapitalit të shoqërisë.

**Në vijimësi**

**26. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 11 (Njëmbëdhjetë) procedurave të prokurimit "Punë dhe Mallra", në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a me objekt: 1-*"Rikonstruksion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore"; 2-" Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III "*, 3- "*Blerja e PDA dhe tablet, si dhe monitorimi i punonjësve", 4- "Fiderat e rinj 20 KV të Nënstacionit Vorë*", *5- "Bazë materiale për nyjet kritike", 6- "Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II", 7- "Ndërtim i disa kabinave te reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabull me vetëpërmbajtje ABC në kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 të N/St Gramsh", 8- "Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III", 9- "Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht", 10- "Rikonstruksion dhe ndërtim kabinash muraturë në Korçë", 11- "Rikonstruksione të rrjetit TM, TU në zonat e përgjegjësisë në agjencinë Bilisht. Rikonstruksion kabinash tip murature në Agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr 6 N/St Bilisht. Rikonstruksion rrjeti TM 10kV fideri 8 ndërtim kabine BOX"*, janë konstatuar se në mënyrë të gabuar nga ana e njësive të prokurimit, jo të gjithë kriteret e pjesëmarrjes janë argumentuar teknikisht në një procesverbal në referim të grafikut, volumeve, natyrës së punës apo zërave të preventivit të cilat do të justifikonin dhe ligjëronin vendosjen e secilit kriter. Janë konstatuar mangësi në kategori licencash, mangësi në stafin drejtues, mangësi përcaktimin e specialistëve, mangësi në makineri e pajisje, mangësi përcaktimet e kushteve të bashkimit të operatorëve, mangësi në certifikatat dhe standarde, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 61. Janë konstatuar shkelje të nenin 46, të LPP. Kriteret kualifikuese nuk kanë nxitur pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe nuk është stimuluar pjesëmarrjen e tyre.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**26.1Rekomandimi:** OSHEE, të marrë masa për trajnimin në mënyrë të vazhdueshme të punonjësve që angazhohen me realizimin e procedurave të prokurimit, me synim prokurimin e

punëve, mallrave dhe shërbimeve në mënyrë sa më efeciente.
**<u>26.2Rekomandimi</u>:** AK (grupi i punës, njësia e prokurimit apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe llojin e kontratës për punë, mallra, shërbime. Vendosja e çdo kriteri duhet të jetë e argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, duke i dokumentuar në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

**Në vijimësi**

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 2(dy) procedurave të prokurimit "Punë dhe Mallra", në Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nuk janë zbatuar aktet ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave si më poshtë:
Në procedurën e prokurimit me objekt "*Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të N/stacioneve elektrike të shpërndarjes",* dhe në procedurën e prokurimit *"Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacione",* nga verifikimi në SPE për dokumentacionin e operatorëve ekonomik dhe vlerësimit të ofertave konstatohet se operatori fitues "E", ka disa mangësi në plotësimin e Dokumenteve të tenderit. Kontratat Individuale të Punës, me Ing. Mekanik dhe Ing. Elektronik, nuk janë në përputhje me Kodin e Punës i RSH, neni 21, pika 3. Disa nga Test raportet e lëshuar nga prodhuesit, janë përkthyer nga punonjësja e operatorit fitues e cila nuk është në listën e përkthyesve të njohur nga Ministria e Drejtësisë dhe vërtetimi i përkthimit është i pavlefshëm.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>27.1Rekomandimi</u>:** AK (grupi i punës apo komisioni përkatës), në lidhje me procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë vlerësimit të ofertave, duhet të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore të LPP si dhe me qëllimin e këtij të fundit. Konkretisht, KVO-ja, përpara së të kryejë një s'kualifikim, në interes të AK, duhet të konsiderojë faktin nëse mangësia e konstatuar në përmbushjen e kriterit përkatës përbën një devijim të vogël, të argumentuar, i cili nuk ndryshon thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

**Në vijimësi**

**28. Gjetje nga auditimi:** Sipas procedurës së prokurimit "Blerja e PDA dhe tableta, si dhe monitorimi i punonjësve", për përcaktimin e çmimit është aplikuar studimi i tregut nëpërmjet ofertave të 5 OE dhe konkretisht: "B", Prishtinë, me vlerë 161,000,000 lekë, "A T" SHPK, me vlerë 160,000,000 lekë. "I" SHPK, me vlerë 154,000,000 lekë, "P.I." SHPK, me vlerë 156,000,000 lekë, "BSS" SHPK, me vlerë 186,000,000 lekë. Fondi limit është përcaktuar me vlerë 157,200,000 lekë. Nga auditimi rezulton se OE "I" SHPK dhe OE "P I" SHPK, nuk kanë të regjistruar në QKB aktivitet programimi. OE "BSS" SHPK, nuk ka të regjistruar asnjë objekt në lidhje me prokurimin, si për ofrimin e pajisjeve elektronike, ashtu dhe programimin. Sa më sipër arrihet në konkluzionin se përllogaritja e fondit limit duke pranuar oferta nga OE që nuk ushtrojnë aktivitet të fushës, plotësisht apo pjesërisht, nuk është e argumentuar. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i shfuqizuar), neni 59.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>28.1.Rekomandimi:</u>** OSHEE sh.a të marrë masa të vazhdueshme për përcaktimin e vlerës paraprake të kontratave, si duke bërë studimin real të tregut, por duke përdorur edhe metoda të tjera, në mënyrë që ta blejë punën, mallrat apo shërbimet me sa më ekonomicitet.

**Në vijimësi**

**29. Gjetje nga auditimi:** Në shtyllat e vendosura sipas kontratës "Rikonstruksion rrjeti TU me kabell ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabine e re shtyllore", por dhe kontrata të tjera mungon:
- Etiketa e identifikimit të prodhuesit, në të cilën përcaktohen: Emri i prodhuesit, data, muaji dhe viti i prodhimit, numri i strukturës, gjatësia e shtyllës, kapaciteti (momenti) ne sipërfaqen e tokës, ose pika e fiksimit, logo e blerësit/OSHEE etj.
- Etiketa e identifikimit të shtyllës, në të cilën përcaktohen: Emri i pikës së transformimit, emri i linjës dalëse TU, lloji i shtyllës, ndërmjetëse/ankerore ose ankerore fundore, numri i shtyllës. Etiketa duhet të jetë më sfond ngjyrë gri, korniza ngjyrë e gjelbër me trashësi 10 mm, me dimensione 210 x140 mm.
- Etiketa paralajmëruese e sigurimit teknik.
Veprim në kundërshtim me specifikimet teknike "Shtylla beton arme të centrifuguara", pika 8.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>29.1.Rekomandimi:</u>** OSSH sh.a, të marrë masa që për projektet e realizuara, në proces apo në vazhdimësi, të parashikojë dhe kërkojë vendosjen e etiketave të identifikimit të prodhuesit, identifikimit të shtyllës dhe etiketës paralajmëruese të sigurimit teknike, në të gjitha shtyllat si betonarme, ashtu metalike apo material tjetër.

**Në vijimësi**

**30. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i materialeve të furnizuara sipas kontratës "Blerje bokse individuale dhe aksesorë për sistemin e matjes", rezulton se sipas zërit 1 "Bokse individual të integruar për matës statik 1 fazor me automat 1 P 230 V 25 A, pa matës", bokset janë dorëzuar pa asnjë shenjë dalluese të prodhuesit, të ndonjë specifikimi të llojit apo specifikim tjetër. Po ashtu, bazamenti i boxeve ishte transparent, nga ku vërtetohet që bazamenti nuk është i përforcuar me fibra xhami, pasi është i njëjti material me kapakun. Në ambalazhin e boxeve është paraqitur se boxet plotësojnë standardin IP 41-54, ndërkohë që standardi i kërkuar është jo më i vogël se 54. Mbulesa e përparme është përcaktuar me copë litari me shkumë poliuratani, ndërkohë që në specifikime teknike përcaktohet që *kapaku do të jetë transparent, i pathyeshëm, rezistente ndaj temperaturës së lartë dhe rrezeve ultraviolet (UV), si dhe i bërë nga polikarbonat rezistent*".
Vendosja e diapazonit nga 41 deri 54, nuk garanton në çdo rast specifikimin e kërkuar.
Sa i takon bokseve për matës 3 fazorë, boksi ka të stampuar vetëm markën "YAVUZ" dhe në ambalazh nuk ka të përcaktuar asnjë specifikim teknik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", (i ndryshuar) pikat 45, 46, 47, si dhe specifikimet teknike, Pika 7.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>30.1.Rekomandimi:</u>** OSHEE sh.a, të marrë masa që për kontrata në vazhdimësi të verifikojë me korrektësi përputhshmërinë e specifikimeve teknike të materialeve të furnizuara me ato të parashikuara në procedurat e prokurimit, me qëllim garantimin e cilësisë së materialeve dhe jetëgjatësinë e tyre.

**Në vijimësi**

**31. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit: "*F.V dhe Instalim të sistemit të Matjes Inteligjente në Kabinat Elektrike të OSSH sh.a, softŵare-t dhe integrimet e tyre në platformën MDMS (Mater data mangement system)"* nuk janë kërkuar kapacitete teknike për realizimin dhe përgatitjen e infrastrukturës për LV Smart Grid (Rrjetin inteligjent në TU) dhe të gjitha modulet për operacionet e saj. Nga auditimi në SPE dhe dosjen e prokurimit, konstatohet se në tenderin e

zhvilluar më datë 01.09.2022 për F.V dhe Instalimin e sistemit të Matjes Inteligjente, në DST dhe relacion teknik pika 2.3.4, nuk është *kërkuar Inxh. Elektronikë, Inxh. Mekatronik apo Inxh. Informatike,* që autoriteti kontraktor të sigurohet për realizimin e sofŵarëve apo Upgradimin i sistemit HES. Në dokumentet e hedhura në tender nuk kërkohet asnjë kontratë me specialist të fushës së programimeve apo kompani për bashkëpunim për mirëmbajtje programesh në lidhje me specifikimet e projektit, sipas nenit 39 "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike" të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Pika 2, Pika 4. dhe *nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve*". Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 5 operatorë ekonomik, ku operatori fitues disponon vetëm 26 punonjës kryesisht elektricistë, 4 Inxh elektrik, 1 Inxh elektroenergjitik dhe 1 Inxhinier Ndërtimi. Referuar zërave të ofertës fituese Upgrade i sistemit HES në vlerën 45,000,000 lekë, Training Packege në vlerën 8,500,000 lekë, Test dhe Inspektimi në vlerën 3,350,000 lekë, Komisionim dhe operimi në vlerën 3,350,000 lekë, në total prej 60,200,000 lekë pa TVSH, nga AK OSHEE sh.a, *realizimi i tyre paraqitet me risk bazuar në kapacitetit teknik të OE fitues*.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>31.1.Rekomandimi:</u>** Autoriteti Kontraktor, OSHEE Group sh.a, në procedurat e prokurimit që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që kriteret kualifikuese të jenë në përputhje e të lidhura ngushtë me natyrën dhe përmasën e kontratës, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

**Në vijimësi**

**32. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit: "*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht"* është konstatuar pasaktësi në përllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës. Përllogaritja e fondit limit është bërë e përgjithshme për punimet që do të realizohen, por në dokumentet e tenderit preventivi është konceptuar me çelësa në dorë. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë *subjekt i aprovimit nga Investitorit*. Investitori ka të drejtën ti kërkoje kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontratës. Ofertuesi duhet të ofroje sasitë në përputhje me formularin e çmimeve. *Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara ne projekt idenë paraprake.* Verifikimi i sasive nga Drejtoria e Tensionit të Lartë do të bëhej gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe janë subjekt i miratimit nga Investitorit. Kontraktori duhet të vendose sasitë e nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. *Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës prej 249,996,339 lekë pa TVSH.* Parashikimi i projektimit për realizim nga kontraktori, si dhe përcaktimi kontratë me çelësa në dorë ndërkohë që projektimi duhet të prokurohej nga autoriteti kontraktor, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 1.b. Në preventivin e punimeve është përfshirë pagesë për realizimin e projektit të zbatimit. Nga ana e Kontraktorit është parashikuar për projektimin vlera 9,650,000 lekë pa TVSH.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>32.1.Rekomandimi:</u>** Nga AK, të merren masa që në të ardhmen të bëhen analiza kosto përfitim për kontratat e parashikuara. Projekt zbatimi dhe preventivi i punimeve duhen realizuar para hapjes së procedurës së prokurimit, duke stimuluar konkurrencën e operatorëve ekonomikë.

**Në vijimësi**

**33. Gjetje nga auditimi:** Nga zbatimi i kontratës "Blerje bokse individuale dhe aksesorë për sistemin e matjes", rezulton se megjithëse ka kaluar një periudhë e konsiderueshme afro 3 vite nga realizimi i furnizimit, një pjesë e konsiderueshme e materialeve nuk janë vënë në përdorim. Nëse u referohemi zërave të veçantë, boxet për matësit 3 fazorë janë vënë shumë pak në përdorim, nga 13550 copë të blerë, janë vendosur 5120 copë, ose 37 % e sasisë. Theksojmë faktin se, boxet e blera nuk janë vënë në përdorim vetëm në rajonin e Fierit, por edhe në rajone të tjera, të cilat kanë patur nevojë, nëpërmjet transferimit. Rezulton se nuk janë bërë parashikime të sakta në lidhje me nevojën për materiale, duke krijuar stok të pa nevojshëm (mallra me qarkullim të ngadaltë), sidomos sa i takon bokseve për matës 3 fazorë. Është vepruar në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", (i ndryshuar), pika 18.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>33.1. Rekomandimi:</u>** OSHEE, të planifikojë në mënyrë sa më të saktë nevojat për blerjen e materialeve, në mënyrë që të shmanget blerja përtej nevojave, duke krijuar stok dhe qarkullim të ngadaltë të tyre.

**Në vjimësi**

**34. Gjetje nga auditimi:** Nga grupi i auditimit konstatohet se, sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP sh.a për vitin **2020**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7,138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2020 është realizuar 6,420 punonjës. Fondi i pagave është 3,258,029,500 lekë, pra 359,374,326 lekë më pak se programi.
Sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP për vitin **2021**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7,138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2021 është realizuar 6,564 punonjës. Fondi i pagave është 6,536,253,000 lekë, pra 420,424,852 lekë më pak se programi.
Sipas programit ekonomik në OSHEE GROUP për vitin **2022**, numri mesatar i punonjësve ka qenë programuar 7138 punonjës gjithsej, ndërsa sipas statistikave të punës rezulton se numri mesatar i të punësuarve në të vitit 2022 është realizuar 6,156 punonjës. Fondi i pagave është 6,359,574,212 lekë, pra 921,310,438 lekë më pak se programi. Mosplotësimi i vendeve të planifikuara të punës cënon performancën e shoqërisë.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**<u>34.1. Rekomandim:</u>** Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të merren masa për plotësimin e nevojave për punonjës të shoqërisë, referuar parashikimeve të programit ekonomik.

**Në vijiimësi**

**35. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi konstatohet se në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE SHA: Nuk është hartuar Rregullorja e Brendshme; Është hartuar "Procedura e lëvizjeve të stafit", "Kodi i sjelljes", dhe "Udhëzimet operative në sektorin e planifikimeve, trajnimeve dhe vlerësimet e performancës"; Nuk është bëre për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve; Për mënyrën e përzgjedhjes së kandidatëve për punë, nga Burimet Njerëzore, pranë OSHEE sh.a nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura.

-Po ashtu procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente, sepse nuk ka të dokumentuar asnjë nga hapat që duhet të ndiqen për rekrutimin e punonjësve të rinj.
-Nga auditimi konstatohet se gjatë periudhës objekt auditimi në total janë dhënë 86 masa disiplinore, në Drejtorinë e Përgjithshme të OSHEE sh.a, nga këto 14 "Vërejtje me shkrim",3 masa "Vërejtje me shkrim, paralajmërim për largim nga puna"dhe 69 masa "Pushim nga puna". Janë audituar 35 nga këto procedura, pra 40%. Nga auditimi i procedurës së dhënies së masave disiplinore konstatohet se nuk ka procedura transparente, si dhe nuk ka komision apelimi.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**35.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i shoqërisë dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj, dhe hartimin dhe miratimin e rregullores së brendshme të shoqërisë OSHEE SHA.
Nga Administratori dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi dhe transparencë të procedurave të dhënies të masave disiplinore, si dhe ngritjen e komisionit të apelimit lidhur me masat disiplinore në shoqërinë OSHEE sh.a.

**Në vijimësi**

**36. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, niveli i pagave është përcaktuar me VKM nr. 574, datë 03.08.2016 "Miratimin e trajtimit financiar të personave përgjegjës për menaxhimin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes SHA".
Niveli i klasave në këtë vendim është bërë në 4 grupe, nga 1 më i ulëti te 4 më i larti, por në këtë klasifikim nuk janë përcaktuar kriteret që i diferencojnë qartë këto klasa. *Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, nuk ka kritere të përcaktuara qartë dhe praktika e krijuar ka qenë klasifikimi nga 1, si shkalla me e ulët në 4, si shkalla më e lartë, duke ju lenë në dorë drejtuesve në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore (duke ruajtur fondin e pagave), sipas aftësive dhe përgjegjësive, detyrave dhe shkallës së vështirësisë në kryerjen e tyre, si dhe volumit të punës që punonjësit kanë.* Nga sa më sipër rezulton se, nivelet e pagave për vitet 2020, 2021 dhe 2022, duhet të ishin miratuar nga organet kolegjiale drejtuese (Këshilli Mbikëqyrës) të shoqërisë tregtare, me kapital mbi 50 % shtetëror, brenda kufirit minimal e maksimal të pagës të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive financiare të OSHEE sh.a, në bazë të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", neni 6, pika 1, shkronja *(a), ku citohet se organe kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërorë dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë: a) nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga ministri përkatës.*
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**36.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të marrin masat e duhura, lidhur me miratimin e pagave dhe përcaktimin e kritereve për klasifikimin e tyre sipas secilit nivel.

**Menjëherë**

**37. Gjetje nga auditimi:** OSHEE GROUP sha, merr ambiente me qira për të siguruar kushte për akomodimin e punonjësve, kryesisht të qendrave të kujdesit ndaj klientit, punonjësit e administratës qendrore dhe lokale të drejtorive rajonale dhe njësive përkatëse, por edhe ambiente për të magazinuar materialet e mirëmbajtjes dhe të investimeve. Shoqëria për pagesat e qirave,

shpenzon mesatarisht në muaj ***28,358,125.3 lekë*** në dhe në vit arrin vlerën prej ***340,237,624 lekë***, shumë kjo e konsiderueshme.
-Nga auditimi i kontratave të qirasë konstatohet se në kontratat e qiramarrjes, parashikohet në nenin 5.3 mbajtja e penalitetit, konkretisht: "*nëse ndonjë nga pagesat e qerasë mujore ose ndonjë pagesë tjetër sipas kësaj kontrate mbetet e papaguar pas 15 ditësh nga afati i pagesës së saj, ndaj qiramarrësit do të aplikohet një penalitet në masën 0.05% të shumës së prapambetur. Penaliteti do të fillojë aplikohet pas ditës të 15-të nga momenti i përfundimit të afatit të pagesës.*" Në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet një nen i tillë, dhe për pasojë shoqëria OSHEE sh.a nuk mund të mbajë penalitete lidhur me vonesat në pagesë të cilat shkojnë në vlerën ***338,959 lekë.***
**-**Në kontratat e qiradhënies neni 1, pika 1 parashikohet se "*...qiramarrësi nuk ka kryer pagesën brenda një muaji nga data e pagesës së përcaktuar...*", por kjo pikë nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e OSHEE sh.a.
-Nga auditimi i procedurave të marrjes së ambienteve me qira, rezulton se OSHEE sh.a nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo publikime në buletine, në gazetat kombëtare apo mediat e shkruara, për marrjen e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmime konkurruese, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negocimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj. , nisur dhe nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqet nr. 229-230 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>37.1.Rekomandimi:</u>** Administratori i OSHEE SHA Group sh.a në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse, të analizojnë situatën mbi mundësinë e reduktimit të kostove lidhur me ambientet e marra me qira, duke u nisur nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.
**-** Departamenti Ligjor në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse të marrin masa për shtimin e penaliteteve në kontratat e qiradhënies dhe sanksionimin e subjekteve debitore nga kontratat e shmangien e krijimit të detyrimeve.
-Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për publikimin e procedurave të marrjes me qira në buletinin e APP, në gazetat kombëtare apo mediat e shkruara, për marrjen e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmime konkurruese.

**Menjëherë.**

**38. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi shoqëria OSHEE GROUP sh.a dhe shoqëritë e kontrolluara prej saj, kanë funksionuar pa rregullore të brendshme, si dhe nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, referuar përgjigjeve të pyetësorit e MFK, drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit të Biznesit, me argumentin se: "*... në kuadër të procesit të ndarjes së shoqërisë, rregulloret e shoqërive janë në proces hartimi, duke marrë në konsideratë zhvillimet praktike të proceseve në ndjekje". Pra,* OSHEE GROUP sh.a dhe tre shoqëritë e reja të krijuara kanë funksionuar për gjithë periudhën e auditimit pa rregullore të brendshme, e për rrjedhojë nuk janë unifikuar pozicionet sipas funksioneve që mbulojnë dhe kompetencave.
Lidhur me krijimin e Grupit për Menaxhimin Strategjik (GMS) të njësisë publike me pozicione dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë, sipas kuadrit ligjor, në rregulloren përkatëse, konstatohet se, ky grup nuk funksionon, kjo me argumentin e procesit të ndarjes së shoqërisë dhe se ky grup po ridimensionohet në kuadër të kërkesave të reformimit të sektorit të energjisë, edhe pse këto shoqëri kanë dy vite që funksionojnë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë

08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 4, pika 19 "Gjurma e auditimit" dhe me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 “Për miratimin e manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.9 faqet nr. 230-232 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**38.1 Rekomandimi:** Nga Administratori i shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, të merren masa që të përditësohet kuadri rregullator (rregulloret e funksionimit) për proceset kryesore të punës Drejtorive/Njësive në vartësi të shoqërisë dhe në qendër referuar ndryshimeve strukturore që ka pësuar shoqëria nga ndarja e saj në shoqëri (mëma dhe bija), sipas detyrave funksionale. Nga strukturat drejtuese dhe Drejtoria e Zhvillimit të Biznesit, të merren masa për ngritjen e Grupit të Menaxhimit, si një organ përgjegjës për hartimin e politikave dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

**Në vijimësi**

**39. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në OSHEE GROUP sh.a për periudhën 1.07.2020-31.12.2021 është konstatuar se, nuk është realizuar plani i auditimeve sipas periudhës së përcaktuar në planin strategjik 2020-2022, planit strategjik 2021-2023 dhe planet vjetore të auditimit, pasi disa nga auditimet e planifikuara nga DAB për çdo vit të mbetura pa u audituar janë mbartur në vitin pasardhës, ose nuk janë realizuar (DEK, Drejtoria Ligjore, njësia PIU, etj.),. Mosrealizimi i plotë i planit të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm sipas planeve të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë, ndikon në mungesën e pasqyrimit objektiv, transparent i të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë për arritjen e objektivave dhe në përmirësimin e aktivitetit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, si shoqëri mëmë, por dhe të shoqërive të kontrolluara prej saj.
Nga auditimi mbi kryerjen e angazhimeve të auditimit, referuar dokumentacionit të dosjeve të auditimit, u konstatua se në 6 angazhime të përzgjedhura për periudhën objekt auditimi janë tejkaluar afatet e hartimit të Projekt Raportit dhe të Raportit Final, duke tejkaluar afatin 10 ditor për hartimin e tyre, konkretisht: Angazhim auditimi në FSHU sh.a, Departamenti i Shitjeve; angazhim auditimi në OSHEE GROUP sh.a, Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse; angazhim auditimi në DEK; angazhim auditimi në DTL, angazhim auditimi në FTL sh.a dhe angazhim auditimi në OSSH sh.a, Departamenti i Leximit, Menaxhimit të Matjes dhe Bilancit Energjetik.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, datë 25.10.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 4, datë 10.01.2020, Kapitulli IV dhe VII, si dhe me Kartën e Auditimit të Brendshëm dhe Rregulloren e brendshme e funksionimit të DAB në OSHEE sh.a.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.10 faqe 232-233 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**39.1Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të planit të auditimit pas miratimit në organet drejtuese të shoqërisë, sipas afateve të përcaktuara me qëllim pasqyrimin objektiv, transparent të të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e shoqërisë OSHEE GROUP sh.a, si dhe të tre shoqërive të kontrolluara prej saj.

**Në vijimësi**

**40. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2MẀ, miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor (dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a (FTL sh.a) dhe sipas treguesve të programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihet këto centrale e prodhimit të operatorit

ekonomik, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2MẀ, gjithsej në sasinë 23,568,327 kŵh, me vlerë **2,356,730 Euro**, përkatësisht nga: Subjekti "S" shpk në shumën 264,486 Euro; R shpk për 247,776 Euro, "A" shpk për 308,653 Euro; "A S" shpk për 213,639 Euro; "S S" shpk për 200,818Euro; "S S" shpk për 222,965 Euro; "S S" shpk për 245,284Euro; "S ŵ" shpk 175,985 Euro; "L" 202,136 Euro dhe "A S" shpk 274,988 Euro. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 822, datë 7.10.2015 "*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*", i ndryshuar dhe me kushtet kontraktore përcaktuar me kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjekteve PPE. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 193-229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**40.1Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), si institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për "*Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike*", të ushtrojnë në mënyrë të menjëhershme kontrollin fizik dhe teknik të secilit stacion fotovoltaik, nga burime të rinovueshme të energjisë elektrike, në drejtim të fuqisë së instaluar dhe sasisë së prodhuar e shitur.
**40.2Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), pas kontrollit të secilit subjekt prodhues, dhe në rast të përcaktimit të shkaqeve të prodhimit më tepër, nga secili subjekt i licencuar, pasojë e ndërtimit dhe instalimit të një fuqie prodhuese më të madhe se ajo e lejuar/miratuar e licencuar (2MẀ), të marrë masa të menjëhershme ndaj tyre, duke i propozuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përjashtimin e subjekteve nga lista e Prodhuesve me Përparësi të Energjisë, si dhe aplikimin e sanksioneve ligjore përkatëse, subjekte për të cilët OSHEE GROUP sh.a me shkresën nr. 8410/3, datë 30.05.2023, pas kontrolleve të ushtruara dhe verifikimit në terren të sistemeve të matjes të këtyre centraleve prodhuese, ka saktësuar se nuk ka parregullsi në matjen dhe regjistrimin e energjisë së livruar nga këto centrale fotovoltaike.
**40.3Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), të njoftojë Kontrollin e Lartë të Shtetit për rezultatet e kontrollit dhe monitorimit të zbatimit të kushteve kontraktore nga subjektet që kanë ndërtuar centrale fotovoltaike dhe masat e marra për zgjidhjen e problematikës.

**Menjëherë**

## B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*" neni 15, germat b) dhe c) "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*" dhe mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 "*Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë*", pikën 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", nga ana e Titullarit të njësisë publike (Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike), të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në mënyrë të menjëhershme për të shmangur tejkalimin e afateve dhe parashkrimin e të drejtës për të kërkuar shumën monetare gjyqësisht, si dhe të ndiqet procesi, me qëllim shpërblimin e dëmit ***në vlerën 9,831,919 lekë,*** si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës "Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC", u konstatua se në situacionin nr. 2, janë përfshirë

punime kanali edhe për urën 60 m, ndërkohë që në këtë urë, kabullat kalojnë të inkastruar në anë të urës të futur në tuba plastikë dhe çeliku. Nga përllogaritjet e volumit të prerjes së asfaltit me disk, prishje shtresë çakulli, shtresë rëre dhe transport, rezultojnë diferenca me vlerë 166,691 lekë, përfituar më tepër nga Kontraktori "E P" SHPK. Ndër zërat e punimeve të përfshirë në fondin rezervë është edhe "F.V hekur betoni periodik Ø 6 mm deri Ø 10 mm (zgarë 10 x 10 cm), në sasinë 0.64 ton. Sasia e betonit respektive është 0.2 m3, që i përgjigjet zgarës në sasinë 0.04 ton. Vlera 67,215 lekë (0.6 ton x 112,025 lekë/ton), është përfituar më tepër nga Kontraktori "E P" SHPK. Nga verifikimi i punimeve në objekt, u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve prej betoni të shtyllave 9/15 kV dhe 9/6 kV. Themelet nuk janë ndërtuar në të gjithë thellësinë me beton por vetëm në sipërfaqe me një trashësi 30 cm, kjo e dallueshme lehtësisht pothuajse në të gjitha shtyllat e verifikuara. Si pasojë e mos zbatimit të kushteve teknike sa më sipër, në 3 shtylla devijimi nga vertikaliteti është i dukshëm. Nga përllogaritjet e përafërta rezulton se për shtyllat 9/15 kV dhe 9/15 kV është hedhur sasia 0.3 m3 beton (100 cm x 100 cm x 30 cm). Nga verifikimi i librezës së masave dhe situacionit përfundimtar, për këto dy kabina janë certifikuar të vendosura 52 shtylla, me sasi totale betoni 83.3 m3. Sasia e vendosur rezulton 15.6 m3 (52 shtylla x 0.3 m3), nga ku rezulton diferenca 67.7 m3. Vlera 571,360 lekë (67.7 m3 x 8439.6 lekë/m3), është përfituar më tepër nga Kontraktori "E P" SHPK. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**1.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **805,266 lekë**, nga Kontraktori "E P" SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës "Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime", kryesisht për kabinat në zonën e Shtërmen (Kabina 1, 2,6,8) dhe Gostimë (1,2,3), u konstatua se nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i takon bazamentit të shtyllave prej betoni, si për shtyllat 9/6 kN, ashtu dhe për shtyllat 9/16 kN. Në disa raste të verifikuara shtresa e betonit ndërtohet sipas dimensioneve vetëm në sipërfaqe për trashësi afërsisht 30 cm, por në thellësi nuk respektohen dimensionet e përcaktuara në librezën e masave. Për shtylla 9/6 kN, konsiderohet i realizuar seksioni 0.6 x 0.6 m (për thellësinë 1.3 m). Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 0.7 m3. Për shtylla 9/15 kN, është konsideruar i realizuar seksioni 0.8 x 0.8 (për thellësinë 1.7 m). Për shtyllat 9/15, rezulton se në shumicën e shtyllave, dimensioni i kokës së betonit të realizuar është mesatarisht 1 x 1 m. Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 1.72 m3. Nga përllogaritjet rezulton se për këtë kontratë, është certifikuar më shumë sasia 136.2 m3 beton me vlerë 1,021,425 lekë. Mangësi në përllogaritjen e volumit të punimeve. Nga verifikimi i punimeve sipas Kontratës "Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime", kryesisht për kabinat në zonën e Shtërmen (Kabina 1, 2,6,8) dhe Gostimë (1,2,3), u konstatua se nuk janë respektuar specifikimet teknike sa i takon bazamentit të shtyllave prej betoni, si për shtyllat 9/6 kN, ashtu dhe për shtyllat 9/16 kN. Në disa raste të verifikuara shtresa e betonit ndërtohet sipas dimensioneve vetëm në sipërfaqe për trashësi afërsisht 30 cm, por në thellësi nuk respektohen dimensionet e përcaktuara në librezën e masave. Për shtylla 9/6 kN, konsiderohet i realizuar seksioni 0.6 x 0.6 m (për thellësinë 1.3 m). Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 0.7 m3. Për shtylla 9/15 kN,

është konsideruar i realizuar seksioni 0.8 x 0.8 (për thellësinë 1.7 m). Për shtyllat 9/15, rezulton se në shumicën e shtyllave, dimensioni i kokës së betonit të realizuar është mesatarisht 1 x 1 m. Në këto kushte sasia e betonit që konsiderohet e realizuar është në masën 1.72 m3. Nga përllogaritjet rezulton se për këtë kontratë, është certifikuar më shumë sasia 136.2 m3 beton me vlerë 1,021,425 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**2.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **1,021,425 lekë**, nga Kontraktori **"**E" Shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të dosjes teknike sipas kontratës "Zgjatim i fiderit 12 me kabina dhe rrjet të ri TU, nënstacioni 110/20 Sallmone, Lot I" u konstatuan mangësitë si më poshtë:
-Në situacionin nr. 7, II "Rrjeti ajror 20 kV me shtylla betoni", sipas zërit B 5 "Punime montimi" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 18.74 $m^3$ me çmim çmim 8,308 lekë/$m^3$. Po për bazamentet e shtyllave është certifikuar sipas zërit B 6 "Punime civile" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) sasia 12.74 $m^3$, me çmim 8,392 lekë/$m^3$, pa detajim dhe përcaktim përmasash. Sasia 12.74 $m^3$, me vlerë 106,914 lekë (12.74 $m^3$ x 8,392 lekë/$m^3$, është certifikuar padrejtësisht për punime të pa realizuara. Në situacionin 7, I "Rrjeti ajror 20 kV me shtylla betoni", sipas zërit B 5 "Punime montimi" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 139 $m^3$ me çmim 8,309 lekë/$m^3$. Sipas këtij zëri, në librezën e masave është përllogaritur sasia 232 $m^3$. Në situacionin 7,I, zëri B 6 "Punime civile" – Shtresë betoni C 16/20 (bazamenti i shtyllës) është certifikuar sasia 93.7 $m^3$ me Çmim 8,474 lekë/$m^3$. Për të njëjtin zë punimesh janë certifikuar sasi në dy raste. Sasia 93.7 $m^3$ me vlerë 794,013 lekë (93.7 $m^3$ x 8,474 lekë/$m^3$), është certifikuar padrejtësisht. Po ashtu sasia 93 $m^3$ (232 $m^3$ – 139 $m^3$), duhet të përfshihej në situacion me diferencë në vlerë 13,345 lekë [93 $m^3$ (8,474 – 8,309)]. Sa më sipër, nga ana e Kontraktorit BOE "E P SHPK dhe A I G CSHPK", është përfituar më tepër vlera 916,272 lekë (106,914 lekë + 794,013 lekë + 13,345 lekë). Sipas situacionit nr. 7 dhe përfundimtar, janë certifikuar volumet e shtresave asfaltike volumi i të cilave nuk përputhet me atë të realizuar në fakt. Këto shtresa janë paraqitur në librezën e masave nga piketa 3 deri piketë 4, në distancë 802 m dhe gjerësi 0.8 m. Në fakt gjatësia e realizuar është 410 m, me gjerësi mesatare 0.7 m, kjo për faktin se një pjesë e linjës është shtruar në bankinë dhe jo në trupin e rrugës. Për pjesën e realizuar në trupin e rrugës, prerja e asfaltit është bërë vetëm në një anë. Është certifikuar më shumë "Prerje asfalt me disk" me vlerë 295,240 lekë, "Shtresë stabilizant" me vlerë 105,356 lekë, "Shtresë binderi" me vlerë 427,502 lekë dhe "Shtresë asfaltobetoni me vlerë 256,951 lekë. Nga verifikimi i punimeve për realizimin e linjave të tensionit të mesëm ajror dhe tensionit të ulët, rezultuan mangësi në lidhje me realizimin e bazamentit të shtyllave. Sa i takon linjës së tensionit të mesëm u konstatua së në 30 shtylla betoni i bazamentit nuk është vendosur sipas specifikimeve, me një diferencë prej afërsisht 1 $m^3$ beton për shtyllë, në total 30 $m^3$ beton të certifikuar më tepër. Po ashtu në linjat e tensionit të ulët u konstatuan mangësi në realizimin e bazamentit të shtyllave për 35 shtylla, me një diferencë afërsisht 0.9 $m^3$ beton për shtyllë, në total 31.5 $m^3$ beton të certifikuar më tepër. Vlera 510,634 lekë [(30 $m^3$ + 31.5 $m^3$) x 8,303 lekë/$m^3$] është përfituar më tepër nga BOE "E P SHPK dhe A I G CSHPK". Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998

“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**3.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **2,511,955 lekë**, nga Kontraktori **“**BOE “E P SHPK dhe A I G CSHPK”, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Librezat e masave sipas kontratës “Rikonstruksion i rrjetit TM dhe TU në lagjet 4, 5 dhe 6, Bashkia Kukës”, janë hartuar vetëm me volumet dhe jo me detaje, apo përmasa. Në këto kushte nuk mund të përcaktohen saktë volumet e realizuara. Krahas këtij investimi po në këtë lagje është realizuar investim edhe nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit për rikonstruksion si të infrastrukturës ashtu dhe fasadave të pallateve. Theksojmë se kontratat sipas dy investimeve janë realizuar nga i njëjti kontraktor. Nuk ka një ndarje të qartë të investimeve të realizuara nëpërmjet dy kontratave sa i takon kryesisht punimeve për shtresa rrugore apo trotuare. Nëse për trotuaret nevojitet një rakordim me punimet e realizuara nëpërmjet kontratës me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, në lidhje me sasinë e binderit, ato nuk rezultojnë të kryera, pasi nuk ka qenë i nevojshëm prishja dhe rindërtimi i tyre, në kuadrin e rikonstruksionit të plotë të infrastrukturës, sipas të cilit janë realizuar shtresa të reja rrugore. Vlera e punimeve certifikuar për shtresa binderi është 149,350 lekë (103 $m^2$ x 1,450 lekë/$m^2$), përfituar më tepër nga Kontraktori “M” SHPK. Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu III, pika 4.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**4.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **149,350 lekë**, nga Kontraktori “M” SHPK, për punime të certifikuara por të pa realizuara.
**4.2. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë bashkëpunim me Fondin Shqiptar i Zhvillimit, në lidhje me investimin e realizuar nga ana e tyre, duke bërë rakordimet përkatëse të volumeve të realizuara nga dy kontratat dhe zbritjen e vlerës, për punime të cilat mund të jenë raportuar të realizuara në të dy kontratat.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës Ndërtim i rrjetit TM 20 kV, Fideri F 6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/Stacioni i Lalëzit”, sa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Në këto themele kryesisht ndërtohet shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendi. Në disa shtylla është konstatuar se janë vendosur tombino betoni, të cilat nuk janë urdhëruar, apo miratuar për vendosje. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, shtyllat kanë pësuar devijim dhe rrezikojnë rënien e tyre, duke shkaktuar dëme jo vetëm për shtyllën përkatëse, por dhe të tjerat, si pasojë e forcës së tërheqjes së kabllove të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për disa shtylla 9/15 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.72 $m^2$, ndërkohë që është certifikuar sasia 2.59 $m^3$, me një diferencë 1.12 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për disa shtylla 9/6 kN, sasia e realizuar afërsisht për

shtyllë është 0.56 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 1 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë 0.44 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 24.6 $m^3$ (10 + 14.6), me vlerë 196,800 lekë (24.6 $m^3$ x 8,000 lekë/$m^3$), është përfituar më tepër nga Kontraktori BOE "K K & E" SHPK. Është vepruar në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**5.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **196,800 lekë**, nga Kontraktori BOE "K K & E" SHPK, për punime të certifikuara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i punimeve sipas kontratës "Rikonstruksion i rrjetit TU dhe kabinave Tresh 7, Zejmen 7, Spiten 2, Ded Alija, Pllanë 2, Gajush 3, Gjush 1, Markatomaj 9, Markatomaj 3, Markatomaj 2, Fideri 10 Zejmen, N/Stacioni Lezhë", u konstatuan mangësi në lidhje me sasinë e betonit C 16/20 të vendosur në fakt, krahasuar me atë të përshkruar në librezën e masave dhe situacionin përfundimtar. Verifikimi i punimeve u përqendrua në kabinat "Markatomaj 2", "Markatomaj 4", "Zejmen 7" dhe "Tresh 7". Nga bazamentet e verifikuara rezulton se janë realizuar me përmasa mesatare 0.9 m x 0.9 m, duke konsideruar thellësinë 1.7 m të njëjtë me atë të certifikuar, ose në sasinë 1.38 $m^3$. Nga përllogaritjet rezulton se është certifikuar më tepër sasia 62.6 $m^3$ beton, me vlerë 532,600 lekë. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, si dhe Udhëzimin e KM nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", Kreu III, pika 4.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**6.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **532,600 lekë**, nga Kontraktori BOE "P SHPK & N SHPK", për punime të certifikuara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Ndërtim i kabinave të reja dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabull ABC në Njësinë Lushnje*", njësia rajonale Berat viti 2020, konstatohet se objekti është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 1476/16prot., datë 30.04.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor OSSH, Berat dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "A" shpk, & "E N" shpk. Përfaqësuesi i BOE është operatori "A" shpk, sipas prokurës së posaçme nr. 555 datë 03.02.2021. Vlera e kontratës është 209,318,891 lekë me TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Zëri nr. 4, me Nr. Anali. 3.25/a "*Gërmim me krahë seksion detyruar me gjerësi b<1 m, H=1.5m, tokë e fortë"*. Në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 1,731 $m^3$ të zërit "*Gërmim me krahë seksion detyruar me gjerësi b<1 m, H=1.5m, tokë e fortë"*. Librezat e masave rezulton në sasinë prej 1,731 $m^3$, ku është llogaritur thellësia e gërmimit H = 1.2 m. Nga verifikimi i Librezave të masave janë konstatuar disa piketa të janë mbivendosur 2 herë dhe të likuiduara edhe në zërin nr. 3, me Nr. Anali. 3.89/a "*Gërmim dheu me eskavator me goma 0.25 $m^3$ në kanale me gjerësi deri 2m, prani uji katg. III*", me po të njëjtën lartësi H=1.2 m. Sipërmarrësi ka përfituar volum më të tepër punimesh prej 339.84 $m^3$, në zërin nr. 4 me nr. anal. 3.25/a " *Gërmim me krahë seksion detyruar me gjerësi b<1 m,*

*H=1.5m, tokë e fortë",* me çmimin përkatës të ofertuar prej 2,409 lek / $m^3$, rezulton vlera prej 818,674 lekë pa TVSH. Zëri nr. 5, me Nr. Anali. 2.19/a "*Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, katg IV".* Referuar Llogaritjeve mbi volumin total të gërmimit, sipas situacionit përfundimtar dhe librezave të masave ka rezultuar Volumi total prej 5,805.72 $m^3$ (1. Gërmim me eskavator 4,074.6 $m^3$ + 2. Gërmim me krahë 1,731.12 $m^3$). Ky volum i dalë nga gërmimet është ndarë sipas përllogaritjeve në 2 zëra. a. "*Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, katg IV",* me volum prej 2,493 $m^3$ dhe b. *"Transport dheu me auto deri 5km"* me volum prej 3,312 $m^3$. Pra (2,493 $m^3$ + 3,312 $m^3$= 5,805 $m^3$). Volumi i transportit ka dalë si rezultat i diferencës së nxjerrë nga llogaritjet e hedhjes dhe rrafshimit të dheut. Nga sa më sipër konstatuar volumi i gërmimit rezultoi me llogaritje jo të saktë me diferencë 339.84 $m^3$ dhe rrjedhimisht kjo sasi duhet ti zbritet edhe zërit "*Hedhje, rrafshim, mbushje dheu me krah, katg IV",* me çmimin përkatës të ofertuar prej 241 lek / $m^3$, rezulton vlera prej 81,901 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezultoi se nuk argumentohet apo justifikohet **vlera prej 900,575 lekë pa tvsh** (818,674 + 81,901), e përfituar më tepër nga sipërmarrësi**,** për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>7.1. Rekomandimi:</u>** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **900,575 lekë** nga kontraktori BOE "A" shpk & "E N" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Rikonstruksion i N/Stacionit Vorës 35/20/6 KV*", njësia rajonale DTL viti 2021, konstatohet se objekti është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 335/17 prot. datë 18.06.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Tensionit të Lartë DTL dhe Operatorit Ekonomik "4" shpk. Vlera e kontratës është 207,215,336 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Zëri nr. 2.5, në pajisjet 35 kv " F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)", në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 426 ml të zërit " *F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)".* Librezat e masave rezulton në sasinë prej 426 ml, ku është llogaritur Ura Tr 35/20/6kv nr. 1, Ura Tr 35/20/6kv nr. 2, linja e ajrore N/st Shijak – N/st vore dhe cela 35kv e seksionimit. Në librezën e masave nuk janë bashkëlidhur distancat e kabllove të projektit të zbatuar. Nga verifikimi i projektit të Azhurnuar, verifikimeve në terren dhe observacioneve përkatëse, janë konstatuar disa pasaktësi në sasi ku në total rezulton sasia prej 411 ml. Referuar projektit të azhurnuar kablli me linjën kabllore 35 kv është kabëll 3 (1 x 95 mm), sipërmarrësi ka përfituar volum më tepër punimesh prej 15 ml (426 ml – 411 ml), në zërin nr. 2.5 në pajisjet 35 kv *" F.V kabëll 35 kv XLPE Cu (1x300mm2)*", me çmimin përkatës të ofertuar prej 20,000 lek/$m^3$, rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **300,000 lekë** pa tvsh, e përfituar më tepër sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**<u>8.1. Rekomandimi:</u>** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **300,000 lekë** nga kontraktori OE "4" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Ndërtimi i rrjetit TM 20 kV, fideri F6, kabinave dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Lot II*", njësia rajonale Durrës viti 2021, konstatohet se objekti është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 3161/18 prot. datë 05.01.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Durrës, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "I" shpk & "4" shpk. Vlera e kontratës është 159,477,902 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Linja e tensionit të ulët u konstatua mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendësi të gropës së shtyllës. Në disa raste, janë konstatuar se mbushja e betoneve me tulla dhe jo me beton dhe në disa raste janë konstatuar thyerje të betoneve. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, shtyllat kanë pësuar devijime dhe rrezikojnë rënien e tyre, duke shkaktuar jo vetëm dëme për shtyllën përkatëse, por edhe shtyllave të tjerat si pasojë e forcës tërheqëse së kabllove të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në përllogaritjet, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.55 $m^3$, ndërkohë që është certifikuar sasia 0.65 $m^3$, me një diferencë 0.1 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsish 1.2 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 1.27 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë 0.07 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Sasia e betonit e certifikuar më tepër është në masën 27.16 $m^3$ (25.2 + 1.96). Vlera 231,539 lekë (27.16 $m^3$ x 8,525 lekë/$m^3$) e zërit "*Shtresë betoni c16/20*", e përfituar padrejtësisht Kontraktori BOE "I & 4" shpk. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **231,539 lekë** pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**9.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **231,539 lekë** nga kontraktori BOE "I & 4" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt "*Rikonstruksioni i N/Stacionit Salmone 110/20 kV*", Drejtoria e Tensionit të Lartë viti 2021, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 347/20 prot., datë 01.07.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë së Tensionit të Lartë dhe operatorit ekonomik "L" shpk. Vlera e kontratës është 158,333,665 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Kabllot e kontrollit, sinjalizimit, mbrojtjes, nga auditimi i librezave të masave të fondit rezervë, nuk rezulton të jetë e argumentuar apo justifikuar sasia e cila ka rezultuar më tepër, pasi nuk disponohen AS-built mbi lidhjet dhe gjatësitë e kabllove. Në librezat e masave të fondit rezervë nuk disponohen përllogaritje të përmasave por vetëm sasi fikse të cilat kanë mbuluar fondin rezervë. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet **vlera prej 355,700 lekë** pa TVSH e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për mos llogaritje dhe argumentime nga fakti i punës së realizuar.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **355,700 lekë** nga kontraktori OE "L" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Ndërtimi i Fiderit 20 kV për përdorimin dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes në zonën e Bypassit (Rotondo) Fier si dhe furnizim me energji elektrike të përdoruesve të kësaj zone*", njësia rajonale Fier viti 2021, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 225/24 prot., datë 30.06.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Fier dhe operatorit ekonomik "A" shpk. Vlera e kontratës është 78,061,609 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Furnizim me Fider të ri të dedikuar nga Nënstacioni ekzistues 110/20 kV. Zëri nr. 1, *"Prerje Asfalti me disk*", në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 11,223 ml të zërit "*Prerje Asfalti me disk".* Librezat e masave rezulton në sasinë prej 12,681.8 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga auditimi i librezave të masave konstatohet pasaktësi dhe përllogaritje e gabuar në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në fakt janë realizuar prerje në 3 (tre) anë të kanalit. Sipërmarrësi "A" shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "*Prerje Asfalti me disk*", në sasinë 4,882 ml ( 11,223 ml situacionuar – 9,511 ml fakti = 1,712 ml), me çmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezulton vlera prej 342,400 lekë pa TVSH. Rrjeti TM nga kabina Celigrad dhe parafabrikat 7 deri në Spital. Zëri nr. 1, *"Prerje Asfalti me disk*", në situacionin përfundimtar është likuiduar sasia prej 4,280 ml të zërit "*Prerje Asfalti me disk".* Librezat e masave rezulton në sasinë prej 7,702 ml, ku janë llogaritur seksionet e prerjeve sipas piketave të projektit të azhurnuar. Nga auditimi i librezave të masave konstatohet pasaktësi dhe përllogaritje e gabuar në prerjen e asfaltit, pasi në gjatësinë e rrugës së prerë me asfalt janë llogaritur 4 (katër) anë prerje, kur në fakt janë realizuar prerje në 2 (dy) anë të kanalit. Sipërmarrësi "A" shpk, ka përfituar sasi më tepër të zërit "*Prerje Asfalti me disk*", në sasinë 429 ml (4,280 ml situacionuar – 3,851 ml fakti), me çmimin përkatës të ofertuar prej 200 lekë/ml, rezulton vlera prej 85,800 lekë pa TVSH. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **428,200 lekë** (342,400 + 85,800) lekë pa tvsh, e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **428,200 lekë** nga kontraktori OE "A" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Rikonstruksioni i kabinave Vajkan 1 dhe Vërri 2 dhe sistemim i rrjetit TU të tyre dhe sistemimi i rrjetit TU për Kallm i Vogël 1, 2, 3, 4 dhe Kallm i Madh, Nënstacioni 35/6 Jagodinë*", njësia rajonale Fier viti 2021, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 716/21 prot., datë 05.01.2021, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Fier dhe operatorit ekonomik "G" shpk. Vlera e kontratës është

24,689,395 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Rrjeti TU me përcjellës ABC, u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi 20 deri 30 cm, por jo në brendësi të gropës së shtyllës. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime*. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë, në trotuare apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.28 $m^3$ (0.9m gjerësi x 0.9m gjatësi x 0.35 m thellësi), ndërkohë që është certifikuar sasia 0.78 $m^3$ ( 0.7m gjerësi x 0.7m gjatësi x 1.6m thellësi), me një diferencë 0.5 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsish 0.38 $m^3$ (1.05m gjerësi x 0.9m gjatësi x 0.35 m thellësi), ndërsa sasia e certifikuar është 1.45 $m^3$ për shtyllë (0.9m gjerësi x 1.05m gjatësi x 1.8m thellësi), me një diferencë 1.07 $m^3$ për shtyllë të verifikuar. Sasia e certifikuar më tepër e betonit në masën 41.77 m3 (30 + 11.77). Vlera **342,388 lekë** (41.77 m3 x 8,197 lekë/m3) e zërit "*Shtresë betoni c16/20*", është përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **342,388 lekë** nga kontraktori OE "G" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "*Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korçë*", njësia rajonale Korçë viti 2020, konstatohet se objekti i kontratës është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 445/12 prot. datë 01.12.2020, të lidhur midis Autoritetit Kontraktor Drejtorisë Rajonale OSSH Korçë, dhe bashkimit të operatorëve ekonomik "M" shpk & "A" shpk & "E" shpk. Referuar Akt Marrëveshjes datë 16.10.2020, mbi bashkimin e përkohshëm të shoqërive, është përcaktuar se shoqëria "M" LTD, si udhëheqëse dhe autorizuese për kryerjen e të gjitha veprimeve në emër të BOE. Vlera e kontratës është 119,739,951 lekë pa TVSH. Nga verifikimi i pagesës në situacionin përfundimtar, librezës së masave, projektit azhurnuar (As-Build) dhe verifikimit në terren, u konstatuan disa pasaktësi. Përsa i takon linjave të tensionit të ulët u konstatuan mangësi në lidhje me ndërtimin e themeleve të shtyllave të betonit. Themelet kryesisht janë ndërtuar me shtresë betoni në sipërfaqe me trashësi deri 20 cm por jo në brendësi të gropës së shtyllës dhe *në shumë raste nuk ishte hedhur beton*. Në disa raste, janë konstatuar se mbushja e betoneve me tulla dhe jo me beton dhe në disa raste janë konstatuar thyerje të betoneve. Punimet e betonit në shtylla, janë realizuar jashtë kushtit teknik dhe nuk mund të pranohej si zë punimi i realizuar. Në disa raste, si pasojë e mos realizimit të themeleve sipas specifikimeve teknike dhe sasisë së betonit të parashikuar, *shtyllat kanë pësuar devijime dhe rrezikojnë rënien e tyre*, duke shkaktuar jo vetëm dëme për shtyllën përkatëse, por edhe shtyllave të tjerat si pasojë e forcës tërheqëse së kabllove të vendosur në to. Nga ana e grupit të auditimit u verifikuan shtyllat për të cilat ishte e mundur (pasi një pjesë e tyre janë vendosur në pronë private, në trotuar, apo me themele të mbuluara nga bimësia). Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN dhe 9/15 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.1 $m^3$ për shtyllë të verifikuar (*ku në shumë raste nuk ekziston betoni*). Ndërkohë që është certifikuar sasia më tepër në librezën e masave ndërsa në situacionin përfundimtar është ruajtur e

njëjta sasi me preventivin fillestar. Një pjesë e shtyllave thjesht janë hedhur 2-3 lopata beton të cilat nuk konsiderohen si të realizuara. Bazuar në verifikimin në terren, për shtyllat 9/6 kN, është realizuar afërsisht sasia 0.1 $m^3$, ndërkohë që është certifikuar sasia 0.78 $m^3$, me një diferencë 0.68 $m^3$ (0.78 – 0.1) për shtyllë të verifikuar. Për shtyllat 9/15 kN, sasia e realizuar gjithashtu për shtyllë është afërsish 0.1 $m^3$, ndërsa sasia e certifikuar është 0.87 $m^3$ për shtyllë, me një diferencë 0.77 $m^3$ (0.87 – 0.1) për shtyllë të verifikuar. Sa më sipër është certifikuar më tepër sasia e betonit në masën 248.63 m3 (169.32 + 79.31). Vlera 2,055,921 lekë ( 248.63 $m^3$ x 8,269 lekë/$m^3$ ) e zërit "*Shtresë betoni c16/20*", është përfituar padrejtësisht Kontraktori BOE "M" shpk & "A" shpk & "E" shpk. Për këtë investim rezulton se nuk argumentohet apo justifikohet vlera prej **2,055,921 lekë** pa tvsh e përfituar më tepër nga sipërmarrësi, për llogaritje të gabuara nga fakti i punës së realizuar.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**13.1. Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës masa për arkëtimin e vlerës prej **2,055,921 lekë** nga kontraktori BOE "M" shpk & "A" shpk & "E" shpk, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

**Menjëherë**

## B. 2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi zbatimin e kërkesave ligjore dhe nënligjore për blerjen e energjisë elektrike është konstatuar se, nga 10 subjektet e Prodhimit me Përparësi të Energjisë (PPE) të cilët prodhojnë energji elektrike të rinovueshme nga centralet fotovoltaike, bazuar në kapacitetin 2MẀ, miratuar në kushtet kontraktore me Autoritetin Kontraktor (dokumentacionit financiar nga shoqëria OSHEE GROUP sh.a (FTL sh.a) dhe sipas treguesve të programit PVGis, duke ju referuar dhe vendndodhjes gjeografike ku shtrihen këto centrale e prodhimit të operatorëve ekonomike, rezulton se këta subjekte kanë prodhuar me tepër energji se sa është kapaciteti i tyre prej 2MẀ, përcaktuar në kushtet kontraktore, gjithsej në sasinë 23,568,327kŵh, me efekte financiare për shoqërinë në shumën 2,356,730 Euro, përkatësisht nga: Subjekti "S" shpk në shumën 264,486 Euro; R shpk për 247,776 Euro, "A" shpk për 308,653 Euro; "A S" shpk për 213,639 Euro; "S S" shpk për 200,818Euro; "S S" shpk për 222,965 Euro; "S S" shpk për 245,284Euro; "S ŵ" shpk 175,985 Euro; "L" 202,136 Euro dhe "A S" shpk 274,988 Euro. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 822, datë 7.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar dhe me kushtet kontraktore përcaktuar me kontratat për ndërtimin e Centraleve Fotovoltaike lidhur ndërmjet MIE dhe subjekteve PPE.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqet nr. 193—229 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).
**1.1. Rekomandimi:** Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN) në bashkëpunim me OSHEE GROUP sh.a/FTL sh.a, si institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e kontratave për "Ndërtimin, Shfrytëzimin dhe Administrimin e Centraleve Fotovoltaike", të ndjekin me korrektësi zbatimin e kushteve

kontraktore në drejtim të prodhimit të energjisë elektrike jo vetëm nga këto centrale fotovoltaike që aktualisht janë në prodhim, por dhe të tjerë të tillë që do të hyjnë në shfrytëzim në të ardhmen.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të listë pagesave për periudhën e audituar rezultoi se, punonjësit e OSHEE Group sh.a trajtohen me dietë një vakt në ditë, por duke u shpërblyer me 500 lekë në ditë, kur në fakt duhet të shpërblehen me 300 lekë në ditë, referuar përcaktimeve të VKM nr. 68, datë 07.02.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetorë", pika 2, germa a), *kjo dietë është caktuar deri në masën 300 lekë në vakt dhe deri në 500 lekë kur trajtohet me më shumë se një vakt për ditë pune*. Konstatohet se, nga ana e Administratorit të Shoqërisë, Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore nuk janë marrë masat për reflektimin e ndryshimeve ligjore për caktimin e dietës ushqimore në përputhje me legjislacionin e sipërpërmendur, fenomen i konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme të KLSH për të cilin janë dhënë rekomandimet përkatëse, por përsëri rezultojnë të pazbatuara. Nga përllogaritjet e bëra sipas listëpagesave të periudhës korrik 2020 – dhjetor 2022 rezulton se, janë përfituar gjithsej nga punonjësit shuma 1,878,988,532 lekë, nga vlera 1,127,393,119 lekë që duhej të ishte, pra është paguar më tepër shuma prej ***751,595,412.8 lekë,*** *e cila konsiderohet* ***efekt financiar negativ*** për buxhetin e shoqërisë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me VKM nr. 68, datë 07.02.2018 "Për kufijtë dhe kriteret e përcaktimit të shpërblimit që i përgjigjet pagës së përfituar në natyrë dhe që i shtohet pagës për pushimet vjetore", pika 2, germa a).
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1 Rekomandimi:** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë situatën dhe të marrin masat e duhura për personat përgjegjës për mos azhurnimin e legjislacionit, si dhe të ndiqen procedurat administrative ndaj tyre konform kërkesave të Kodit të Punës. Administratori i Shoqërisë, Departamenti Ligjor të marrin masat e duhura dhe të kryejnë ndryshimet përkatëse në kontratën kolektive, duke nxjerrë aktet përkatëse për mos vazhdimin e dietës ushqimore më tepër nga sa përcaktimet ligjore.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se në lidhje me proceset gjyqësore në të cilat shoqëria është palë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se, për periudhën objekt auditimi janë humbur 81 çështje gjyqësore në apel, duke e detyruar institucionin të paguajë vlerën **18,796,671 lekë,** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Për periudhën objekt auditimi, janë humbur dhe janë në proces gjykimi 56 çështje gjyqësore në Gjykatën e Shkallës së Parë, në vlerën **63,843,433 lekë,** si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës dhe shpenzime përmbarimore. Në total, për periudhën objekt auditimi është paguar si dëmshpërblim për ndërprerje të paligjshme të marrëdhënieve të punës vlera ***82,640,104 lekë,*** *e* ***cila konsiderohet efekt financiar negativ*** për buxhetin e shoqërisë.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1. Rekomandimi:** Nga Administratori, Departamenti Ligjor dhe Departamenti i Burimeve Njerëzore të shoqërisë, të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave të shkëputjes së marrëdhënieve të punës me punonjësit e saj, dhe të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se: Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 2123/1 prot, datë 14.04.2022 "Mbi dhënien e një page shpërblim për punonjësit e angazhuar në kuadër të Planit të Gatishmërisë së shoqërisë OSSH sh.a", janë shpërblyer 1211 punonjës me vlerën **60,925,595 lekë.**
-Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit nr. 9423 prot., datë 30.12.2021 "Mbi dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë për punonjësit e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a, FTL sh.a, OSSH sh.a dhe FSHU sh.a", janë dhënë shpërblime në vlerën **128,240,000 lekë.**
Duke qenë se shoqëria rezulton me rezultat financiar negativ (pra me humbje), dhe shpërblimi për një kategori punonjësish është dhënë 2 herë brenda një viti, vlera ***189,165,595 lekë konsiderohet efekt financiar negativ*** për buxhetin e shoqërisë.
Sa më sipër veprimet bien në kundërshtim me nenin 34 të Kontratës Kolektive *"Për një kategori të caktuar punonjësish, në përputhje me interesat e shoqërisë dhe me performancën e saj ekonomike, Administratori mund të japë një shpërblim ekstra në vit me motivacion realizimin e objektivave të ngarkuara".*
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqet nr. 25-30 dhe pika 2.3 faqet nr. 54-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**<u>4.1. Rekomandimi:</u>** Asambleja e Aksionarit dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë situatën dhe të marrin masa lidhur me dhënien e shpërblimeve konform rezultateve financiare të shoqërisë.
**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit: "*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht"* është konstatuar pasaktësi në përllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës. Përllogaritja e fondit limit është bërë e përgjithshme për punimet që do të realizohen, por në dokumentet e tenderit preventivi është konceptuar me çelësa në dorë. Të gjitha projektet dhe detajet do të jenë <u>*subjekt i aprovimit nga Investitorit.*</u> Investitori ka të drejtën ti kërkojë kontraktorit, pa kosto shtesë, për çdo ndryshim në projekt dhe detaje, të nevojshme për ta realizuar objektin konform kushteve të kontratës. Ofertuesi duhet të ofroje sasitë në përputhje me formularin e çmimeve. Këto sasi janë vlerësuar për qëllime tenderimi, të bazuara ne projekt idenë paraprake. Verifikimi i sasive nga Drejtoria e Tensionit të Lartë do të bëhej gjatë fazës së projektimit të detajuar dhe janë subjekt i miratimit nga Investitorit. Kontraktori duhet të vendose sasitë e nevojshme bazuar në projektin e tij final të miratuar. Referuar sa më sipër, konstatohet se nga AK është hartuar një projekt ide, duke mos përcaktuar saktë fondin limit të kontratës. Parashikimi i projektimit për realizim nga kontraktori, si dhe përcaktimi kontratë me çelësa në dorë ndërkohë që projektimi duhet të prokurohej nga autoriteti kontraktor, është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, neni 26, pika 1.b. Në preventivin e punimeve është përfshirë pagesë për realizimin e projektit të zbatimit. Nga ana e Kontraktorit është parashikuar për projektimin vlera **9,650,000 lekë,** e cila nuk disponon analizë bazuar VKM 354 datë 11.05.2016 "*Miratimi i manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim*". Projektit të detajuar inxhinierik në vlerën 9,650,000 lekë pa TVSH **vlerësohet si efekt negativ ekonomik** dhe jo në përputhje me parimet e eficencës, ekonomicitetit dhe efektivitetit, pasi nga OSSH sha, për projektin mund të shfrytëzoheshin kapacitetet inxhinierike e profesionale të specialistëve të *"Sektorit të Projekteve",* të cilët kanë detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara konform rregullores së brendshme të

institucionit, ku deri më periudhën aktuale projektet hartoheshin pikërisht nga specialistët e zyrës së projektimit.
(*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqet nr. 83-193 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)
**5.1.Rekomandimi:** OSHEE sh.a, të marrë masa që në të ardhmen projektet inxhinierike në sektorin e energjisë, të hartohen nga specialistët, me profesione në fushat inxhinierike që disponon Sektori i Projektimit të shoqërisë, duke ulur në këtë mënyrë shpenzimet e tepërta në kontratat publike.

**Në vijimësi**

## C. MASA DISIPLINORE.

Bazuar në Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në Kontratën Kolektive të Punës nr. 8336prot., datë 16.12.2019 dhe kontratën individuale të punës, i rekomandohet Administratorit të OSHEE GROUP sh.a, vlerësimin e problematikave dhe shkeljeve të përshkruara në këtë Raport Përfundimtar Auditimi dhe dhënia e masave disiplinore nga "Vërejtje" deri në "Largim nga puna" për të gjithë punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si më poshtë:
**1. D M**
**2. E M**
**3. Zh B,** në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit**, për arsye se:**
Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Fiderat e rinj 20 KV te Nënstacionit Vorë*", në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.
**4. R S**
**5. A P**
**6. T Gj,** në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit**, për arsye se:**
- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Bazë materiale për nyjet kritike*", në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.
- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Rikonstruksion i linjës 35kV Korçë - Bilisht*", në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurrim, pasaktësi në përllogaritjen e fondit limit dhe mangësi në përzgjedhjen e llojit të kontratës.
**7. J B**
**8. E B**
**9. A M,** në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit**, për arsye se:**
Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Ndërtim i disa kabinave te reja si dhe zhvillimi i rrjetit TU me kabëll me vetëpërmbajtje ABC ne kabinat e fiderave 3,4 dhe 6 te N/St Gramsh*", në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.
**10. A N**
**11. A Gj**
**12. A Rr,** në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, **për arsye se:**
- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Kabëll dhe aksesorë për rrjetin shpërndarës",* gjatë vlerësimit të ofertave nuk kanë mbajtur në konsideratë një ofertë të vlefshme me devijime të vogla,

të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet, duke mos rritur efiçencën dhe efikasitetit në procedurën e prokurimit.

**13. D Xh**

**14. Z K**

**15. Dh Gj,** në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave**, për arsye se:**

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Elemente të qarqeve primare për mirëmbajtje të Nënstacioneve elektrike të shpërndarjes",* gjatë vlerësimit të ofertave nuk kanë vlerësuar drejtë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.
- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Elemente për mirëmbajtje të qarqeve sekondare për N/stacioneve",* gjatë vlerësimit të ofertave nuk kanë vlerësuar drejtë operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

**16. E Dh**

**17. R K**

**18. A D,** në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit**, për arsye se:**

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Rikonstruksion dhe ndërtim kabinash murature në Korçë*", në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.
- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Rikonstruksione te rrjetit TM, TU ne zonat e përgjegjësisë në agjencinë Bilisht. Rikonstruksion kabinash tip murature në agj. Bilisht. Spostim i fiderit Nr. 5, N/St Bilisht tek Fideri Nr. 6 N/St Bilisht. Rikonstruksion rrjeti TM 10kV fideri nr. 8 ndërtim kabine BOX*", në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

**19. z. A G**

**20. znj. G Gj**

**21. z. F G**, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit**, për arsye se:**

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "*Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, fideri F6, kabinave përkatëse dhe rrjetit TU me përcjellës ABC, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III*", kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit *"Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti II"*, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.
- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit *"Ndërtimi i rrjetit TM 20kV, Fideri 1, N/ST Gjiri i Lalëzit, Loti III"*, në hartimin e kërkesave kualifikuese nuk ka argumentuar vendosjen e çdo kriteri duke mos nxitur pjesëmarrje në konkurim.

**22. znj. M G**

**23. z. Xh H**

**24. z. E T,** në cilësinë e komisionit të marrjes në dorëzim të materialeve**, për arsye se:**

Nga verifikimi i zbatimit të kontratës së furnizimit *"Blerje bokse individuale dhe aksesorë për sistemin e matjes",* është konstatuar se janë marrë në dorëzim materiale për të cilat nuk mund të garantohet se plotësojnë kërkesat e dokumenteve të tenderit dhe specifikimet teknike.

**25. znj. V K**

**26**. **z. A Gj**

**27. z. D M**, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit**, për arsye se:**

Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit *"Rikonstruksion rrjeti TU me ABC njësia Elbasan 1 dhe një kabinë e re shtyllore",* kanë hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe

volumin e kontratës.
**28. z. Z Dh**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, **për arsye se:**
Gjatë auditimit të kontratës "*Zgjatim i fiderit A 1, N/stacioni Burdullias dhe rikonstruksion i rrjetit TU me kabëll ABC*", janë konstatuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me certifikim të punimeve më tepër nga ato të realizuara me vlerë 2,511,955 lekë.
**29. z. V G**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve**, për arsye se:**
Gjatë auditimit të kontratës "*Ndërtim i rrjetit TU me ABC për 23 kabina Cërrik-Gostime*", janë konstatuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me certifikim të punimeve më tepër nga ato të realizuara me vlerë 1,021,425 lekë.
**30. z. K K,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve**, për arsye se:**
Gjatë auditimit të kontratës "*Rikonstruksion rrjeti TU me kabëll ABC Rajoni Korçë*", janë konstatuar mangësi të cilat kanë të bëjnë me certifikim të punimeve më tepër nga ato të realizuara me vlerë 2,055,921 lekë.

-Për mbikëqyrësit e punimeve z. A Gj, z. A A, znj. F D, znj. A Q, z. A M, z. G K dhe z. A H, mendojmë të mos rekomandojmë masë disiplinore, për arsye se shkeljet e konstatuara janë të një niveli jo të konsiderueshëm dhe jo të përhapura.

## E. MASA ADMINISTRATIVE

Bazuar në Ligjin nr. 44, datë 30.04.2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", nenet 98-102, në Ligjin nr. 7, datë 02.02.2017 'Për nxitjen e përdorimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme", në VKM nr. 822, datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", i ndryshuar, neni 29, si dhe në Kontratat Tip të lidhura ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe subjekteve Prodhues me Përparësi të Energjisë (PPE), neni 11 "Zgjidhja e kontratës", ***i rekomandojmë*** Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, që pas kontrollit nga AKBN dhe saktësimit të shkaqeve të prodhimit më tepër se fuqia e licencuar, të veprojë për zgjidhjen e menjëhershme të kontratave "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik" me Prodhuesit me Përparësi të Energjisë, të cilët kanë përfituar më tepër, si pasojë e ndërtimit dhe instalimit të një fuqie prodhuese më të madhe se ajo e lejuar/miratuar e licencuar.
-Nga Administratori i OSHEE GROUP sh.a në bashkëpunim me Administratorin e FTL sh.a, në rast se MIE nxjerrë akte administrative për zgjidhjen e kontratave me subjektet PPE, "Për shit-blerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe Prodhuesve me Përparësi të Energjisë Elektrike", për subjektet: "S" shpk, R shpk, "A" shpk, "A S" shpk, "S S" shpk, "S S" shpk, "S S" shpk, "S ŵ" shpk, "L" dhe "A S", të vijojnë procedurat për ndërprerjen e kontratave të blerjes së energjisë.
- MIE në bashkëpunime me ERE, OSHEE GROUP sh.a dhe FTL sh.a., të fillojë procedurat ligjore për përditësimin dhe ndryshimin e kushteve të sanksionuara në kontratën që OSHEE dhe FTL sh.a. nënshkruajnë me secilin Prodhues me Përparësi të Energjisë (PPE), si dhe MIE të përditësoj kushtet e kontratës për "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit fotovoltaik" me Prodhuesit me Përparësi të Energjisë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

**ANEKSI I**
**Situata financiare e shoqërisë**

***Situata kreditore e shoqërisë***
Totali i detyrimeve në sistemin e FSHU ndahen në:
-23,000,000 mijë lekë nga faturat e palikujduara, ose 30% e detyrimit total, të cilat i përkasin kontratave të kategorisë Buxhetore dhe JoBuxhetore, që ndiqen me anë të rakordimeve me institucionet përkatëse ose ministritë e linjës. Këto abonentë përfitojnë nga skemat e marrveshjeve për shlyerje me këste të detyrimit (Albpetrol, Hekurudha Shqiptare, Ujësjellësa etj) Gjithashtu disa subjekte janë ndjekur dhe me anë të procedurave ligjore duke kërkuar nga gjykatat përkatëse lëshimin e titullit ekzekutive dhe ndjekjen më pas të detyrimit me anë të përmbarimit.
-14,000,000 mijë lekë fatura të palikujduara të kategorisë familjare dhe private ose 18% e detyrimit total, të cilat janë perfshirë në skemat e marrveshjeve për likujdim me këste dhe paguahen cdo muaj nga debitorët.
-13,000,000 mijë lekë fatura të palikujduara të kategorisë familjare dhe private ose 16% e detyrimit total, të cilave u është ndërprerë energjia elektrike dhe trajtohen ose me përfshirjen në skemat e marrveshjeve ose duke kaluar në procesin e gjykatës dhe përmbarimit.
-11,000,000 mijë lekë, ose 14% të detyrimit total, u përkasin kontratave debitore të cilave u është ndërprerë energjia dhe po ndiqen me anë te leshimit te titullit ekzekutive nga gjykate dhe ndjekjes se metejshme me ane te permbarimit. Jane të përjashtuara nga faturime dhe përfaqësojnë kryesisht detyrime të vjetra dhe objekte të braktisura.
-1,300,000 mijë lekë fatura të palikujduara të kategorisë familjare dhe private ose 2% e detyrimit total, që u perkasin abonenteve te cilet nuk kanë respektuar marrveshjet për likujdim me këste të detyrimit. Janë abonentë që kanë disa keste vonese dhe qe trajtohen me ane te nderprerjes se energjise elektrike.
-1,700,000 mijë lekë fatura të palikujduara të kategorisë familjare dhe private ose 2% e detyrimit total, që; u perkasin abonentëve që kanë pa likujduar vetëm një fature debitore dhe që trajtohen me anë të njoftimit ose që kanë ankesa përkatëse.
-14,000,000 mijë lekë, fatura të palikujduara të kategorisë familjare dhe private ose 18% e detyrimit total, u përkasin debitoreve kronike të cilet konsumojne energji dhe nuk janë në skema marrveshjeve për likujdimin me këste të detyrimit. Planet mujore të kontrolleve dhe ndërprerjeve bazohen në këtë kategori abonentësh. pasi realizohet ndërprerja këto debitore kalojnë për trajtim me anë të gjykates dhe permbarimit.

Detyrimet e mësipërme për faturat e palikujduara kanë krijuar kamatëvonesa të cilat kanë arritur në vlerën prej 53,000,000 mijë lekësh.

## Situata debitore e shoqërisë

| Nr | Përshkrimi i detyrimit | Detyrimet më 31.12.2016 | Detyrimet më 31.12.2017 | Detyrimet më 31.12.2018 | Detyrimet më 31.12.2019 | Detyrimet më 31.12.2020 | Detyrimet më 31.12.2021 | Detyrimet më 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Shuma e Detyrimit ndaj KESH sha** | **56,080,890** | **57,298,391** | **62,827,922** | **63,772,039** | **67,024,681** | **61,355,325** | **65,743,270** |
| | Detyrim për transferim Asete KESH | 17,400 | 17,400 | 17,400 | 17,400 | 17,400 | - | - |
| | Për energjinë elektrike | 32,320,767 | 46,659,995 | 52,682,333 | 53,591,345 | 56,868,680 | 2,441,155 | 6,782,772 |
| | Për energjinë elektrike (fatura të papranuara) | 12,454,259 | 23,302 | - | - | - | - | - |
| | Per fatura të pa ardhura | | | | | | | 603,520 |
| | Kredi Afatgjatë | 11,288,463 | 10,597,693 | 10,128,189 | 10,163,294 | 10,138,601 | 10,003,255 | 9,446,062 |
| | Detyrim AfGjate KESH | - | - | - | - | - | 48,910,915 | 48,910,915 |
| 2 | **Shuma e Detyrimit ndaj OST sha** | **10,914,928** | **9,130,232** | **10,647,523** | **11,401,148** | **11,711,517** | **13,048,070** | **15,268,646** |
| | Transmetime energji elektrike | 8,062,972 | 9,130,232 | 10,647,523 | 11,401,148 | 11,711,517 | 3,448,841 | 5,939,417 |
| | Transmetime energji elektrike (fatura të papranuar) | 498,180 | - | - | - | - | - | - |
| | Penalitete për moslikujdim fature | 2,353,776 | - | - | - | | | |
| | Detyrim AfGjate OST | | | | | | 9,599,229 | 9,329,229 |
| 3 | **Furnitorë për energji HEC** | **890,748** | **2,022,810** | **1,469,740** | **2,931,001** | **1,307,503** | **2,746,686** | **4,053,965** |
| | Për fatura të pranuara | 890,748 | 891,966 | 674,477 | 1,311,320 | 1,307,503 | 2,673,306 | 3,873,297 |
| | Per fatura të pa ardhura | - | 1,130,844 | 795,263 | 1,619,681 | - | 73,381 | 180,668 |
| 4 | **Furnitorë për import energjie** | **866,497** | **11,715,803** | **8,384,696** | **9,131,531** | **10,381,043** | **13,586,031** | **283,816** |
| | Për fatura të pranuara | 866,497 | 8,339,225 | 6,446,454 | 9,130,939 | 9,245,300 | 13,586,031 | 283,816 |
| | Per fatura të pa ardhura | - | 3,376,578 | 1,938,242 | 592 | 1,135,743 | - | - |
| 5 | **Detyrim ndaj CEZ AS (Marrevëshja)** | **5,463,511** | **2,737,129** | - | - | - | - | - |
| 6 | **Kredi Banka Botërore (Hua Afatgjatë IBRD Pr. RE)** | **992,083** | **2,910,662** | **4,591,034** | **4,837,262** | **5,120,775** | **4,830,506** | **5,488,936** |
| 7 | **Kredi afgjate Banka Evropiane per Rind e Zhvillim (EBRD)** | | | | | | **66,418** | **5,497,318** |
| 8 | **Kredi afgjate KfW (Frankfurt am Main)** | | | | | | **12,614** | **67,616** |
| 9 | **Hua Ministria e Financave** | - | **2,500,000** | **2,500,000** | **2,500,000** | **2,593,797** | **2,640,446** | **2,687,240** |
| | Hua Afatgjatë Ministria e Financave nr.14394 | - | 1,000,000 | 1,000,000 | 1,000,000 | - | - | - |
| | Pjesa afatshkurter e Huase MF nr.14394 | - | 500,000 | 500,000 | 500,000 | 1,550,598 | 1,578,346 | 1,606,179 |
| | Hua Afatshkurtër Ministria e Financave nr.14394.1 | - | 1,000,000 | 1,000,000 | 1,000,000 | 1,043,199 | 1,062,100 | 1,081,061 |
| 10 | OVD | - | - | 2,532,542 | 7,078,820 | **7,827,201** | **16,070,814** | **17,406,355** |
| 11 | **Shuma e Detyrimit ndaj Posta Shqiptare sha** | **1,102,030** | **168,376** | **169,324** | **205,143** | **183,798** | **277,513** | **337,587** |
| | Posta - Detyrim për Fatura të pranuara | 769,984 | 126,335 | 128,710 | 189,492 | 183,798 | 277,513 | 337,587 |
| | Posta -Fatura të Përllogaritura | 332,046 | 42,041 | 40,614 | 15,651 | - | - | - |
| 12 | **Detyrime të tjera** | **7,524,870** | **12,860,482** | **9,202,241** | **12,069,520** | **12,597,077** | **24,944,138** | **17,060,882** |
| 13 | **Detyrime ndaj Tatimeve** | **13,661,116** | **8,529,192** | **7,743,392** | **5,771,467** | **6,909,124** | **7,180,866** | **5,758,056** |
| **TOTAL** | | **97,496,671** | **109,873,081** | **110,068,414** | **119,697,931** | **125,656,516** | **146,759,428** | **139,653,687** |

### Viti 2021

| Nr | Përshkrimi | Vlera e faturave të papaguara | Kamatëvonesa | Totali i Detyrimeve |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| **B** | **DETYRIME TE KATEGORISE FAMILJARE DHE PRIVATE** | **54,828,924,963** | **32,482,749,076** | **87,311,674,039** |
| | FAMILJARE | **45,256,906,231.07** | **24,974,022,376.35** | **70,230,928,607.82** |
| | PRIVATE | **9,572,018,732.48** | **7,508,726,700.62** | **17,080,745,432.67** |
| **2** | **Detyrime të institucioneve jo-buxhetore ndaj OSHEE** | **17,078,805,604** | **14,333,314,068** | **31,412,119,672** |
| | Ujësjellës Kanalizime | **11,617,858,905** | **9,665,775,618** | **21,283,634,523** |
| | Të tjerë jobuxhetorë | **5,460,946,699** | **4,667,538,450** | **10,128,485,149** |

## Viti 2022

| Nr | Përshkrimi | | Vlera e faturave të papaguara | Kamatëvonesa | Totali i Detyrimeve |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | |
| **A** | **DETYRIME TE KATEGORISE FAMILJARE DHE PRIVATE** | | **52,891,967,528** | **32,649,695,277** | **85,541,662,807** |
| | | FAMILJARE | **44,726,994,020.74** | **26,032,604,074.18** | **70,759,598,095.31** |
| | | PRIVATE | **8,164,973,508.97** | **6,617,091,203.59** | **14,782,064,712.34** |
| **2** | **Detyrime të institucioneve jo-buxhetore ndaj OSHEE** | | **20,116,601,877** | **16,799,054,622** | **36,915,656,499** |
| | | Ujësjellës Kanalizime | **14,299,256,051** | **11,960.710,692** | **26,259,966,743** |
| | | Të tjerë jobuxhetorë | **5,817,345,826** | **4,838,343,930** | **10,655,689,756** |
| **Vlera neto (A-B)** | | | | | |

## Viti 2021

| Nr | Përshkrimi | | Vlera e faturave të papaguara | Kamatëvonesa | Totali i Detyrimeve |
|---|---|---|---|---|---|
| **A** | **Detyrimet e OSHEE ndaj Tatimeve** | | | | |
| **B** | **DETYRIME TE INSTITUCIONEVE NDAJ OSHEE (1+2)** | | **20,071,461,880** | **16,688,953,327** | **36,760,415,207** |
| **1** | **Detyrimet e institucioneve buxhetore ndaj OSHEE** | | **2,983,833,473** | **2,313,043,088** | **5,296,876,561** |
| | | Bashkitë | **2,296,923.080** | **1,803,356,920** | **4,100,280,000** |
| | | Të tjerë buxhetorë | **2,990,359,353** | **552,282,339** | **3,542,641,692** |
| **2** | **Detyrime të institucioneve jo-buxhetore ndaj OSHEE** | | **17,078,805,604** | **14,333,314,068** | **31,412,119,672** |
| | | Ujësjellës Kanalizime | **11,617,858,905** | **9,665,775,618** | **21,283,634,523** |
| | | Të tjerë jobuxhetorë | **5,460,946,699** | **4,667,538,450** | **10,128,485,149** |
| **Vlera neto (A-B)** | | | | | |

## Viti 2022

| Nr | Përshkrimi | | Vlera e faturave të papaguara | Kamatëvonesa | Totali i Detyrimeve |
|---|---|---|---|---|---|
| **A** | **Detyrimet e OSHEE ndaj Tatimeve** | | | | |
| **B** | **DETYRIME TE INSTITUCIONEVE NDAJ OSHEE (1+2)** | | **23,194,578,590** | **19,365,353,694** | **42,559,932,284** |
| **1** | **Detyrimet e institucioneve buxhetore ndaj OSHEE** | | **3,077,976,713** | **2,566,299,072** | **5,644,275,785** |
| | | Bashkitë | **2,482,180,421** | **2,142,597,990** | **4,624,778,411** |
| | | Të tjerë buxhetorë | **595,796,292** | **423,701,082** | **1,019,497,374** |
| **2** | **Detyrime të institucioneve jo-buxhetore ndaj OSHEE** | | **20,116,601,877** | **16,799,054,622** | **36,915,656,499** |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | Ujësjellës Kanalizime | **14,299,256,051** | **11,960,710,692** | **26,259,966,743** |
| | | Të tjerë jobuxhetorë | **5,817,345,826** | **4,838,343,930** | **10,655,689,756** |
| **Vlera neto (A-B)** | | | | | |

## Linjat e kredive marrë nga bankat e nivelit te dyte

| Nr. | Linjat e Kredive afatgjata | Gjendja me 31.12.2019 | Linjat e Kredive afatgjata | Gjendja me 30.09.2022 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | I.S. FSHU | - | I. S. FSHU Garanci Sovrane | € (19,998,081.16) |
| 2 | R. B.OSHEE | (2,138,432,259.41) | R.B.OSHEE | (145,937,809.18) |
| | | | R.B. FSHU | (1,997,583,405.30) |
| | | | R.B. OSSH | (178,967,136.86) |
| | | | R. B. FSHU GS | € (14,995,210.81) |
| | | | R.B. OSSH GS | € (16,495,986.79) |
| 3 | T. Bank OSHEE | € (2,997,244.23) | T.B.OSHEE | (11,891,025.14) |
| | | | T.B.FSHU | (1,011,762,071.15) |
| | | (600,224,334.89) | T.B. FSHU | € (3,015,594.42) |
| | | | T.B.OSSH | (294,018,488.49) |
| 4 | O.Bank (Societe Generale) OSHEE | (617,131,517.14) | O.B. FSHU | (93,607,559.09) |
| | | | O. B. OSSH | (499,972,711.89) |
| | | | O. B. FSHU GS | €(19,998,304.20) |
| 5 | B. OSHEE | (1,319,097,325.90) | B. OSHEE | (99,486,245.98) |
| | | | B. FSHU | (870,768,791.86) |
| | | | B. OSSH | (299,858,626.69) |
| | | | B. FTL | (76,414,283.49) |
| 7 | U.B. FSHU | - | U. B. FSHU | (64,074,685.31) |
| 8 | C.B. OSHEE | (821,260,536.69) | C. B. OSHEE | (150,324,772.10) |
| | | | C. B. FSHU | (348,353,477.04) |
| | | | C. B.OSSH | (254,692,637.40) |
| | | | C.B. FTL | (194,282,343.53) |
| 9 | A. B.OSHEE | € (10,000,000.00) | A.B. OSHEE | (49,990,011.75) |
| | | | A. Bank FSHU | (1,056,119,805.99) |
| | | | A.B.OSSH | (149,612,297.08) |
| | | | A. B. FSHU Garanci Sovrane | € (9,998,543.32) |
| Total i linjave në Lek | | (5,496,145,974.03) | | (8,200,120,549.24) |
| Total i linjave në euro | | € (12,997,244.23) | | (81,486,126.28) |
| kurset e fund vitit lek/eur | | 121.77 | | 116.86 |
| Totali Në lekë | | **(7,078,820,403.92)** | | **(17,722,589,266.32)** |

| Nr. | Linjat e Kredive afatgjata | Linjat e Kredive afatgjata | Gjendja me 30.06.2022 | Gjendja me 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | I. S. | I.S. FSHU Garanci Sovrane | € (19,998,538.45) | € (19,998,773.55) |
| 2 | R. Bank | R. Bank OSHEE | (146,609,238.73) | (146,925,710.86) |
| | | R. Bank FSHU | (2,050,042,574.95) | (2,037,023,286.50) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | R. Bank OSSH | (178,879,635.66) | (179,425,848.02) |
| | | R.Bank FSHU GS | € (14,995,431.28) | € (14,997,464.33) |
| | | R. Bank OSSH GS | € (16,496,597.19) | € (16,497,802.74) |
| **3** | T. Bank | T. Bank OSHEE | (13,896,774.61) | (12,891,917.09) |
| | | T.Bank FSHU | (1,013,602,318.13) | (964,818,936.96) |
| | | T.Bank FSHU | € (3,016,052.33) | € (3,015,765.14) |
| | | T.Bank OSSH | (293,921,054.14) | (277,494,179.41) |
| **4** | O. Bank (Societe Generale) | O.. Bank FSHU | (108,672,357.23) | (106,779,586.77) |
| | | O. Bank OSSH | (499,802,822.15) | (498,121,869.56) |
| | | O. Bank FSHU GS | € (19,997,439.71) | € (19,991,328.96) |
| **5** | BKT | B.OSHEE | (99,042,846.27) | (91,536,560.70) |
| | | B. FSHU | (908,655,175.84) | (925,858,421.45) |
| | | B. OSSH | (296,059,053.54) | (299,207,538.96) |
| | | B.FTL | (100,160,516.99) | (82,602,599.09) |
| **7** | U. Bank | U. Bank FSHU | (64,219,150.29) | (64,640,467.56) |
| **8** | C. Bank | C.Bank OSHEE | (144,787,372.93) | (141,825,072.92) |
| | | C. Bank FSHU | (359,034,238.80) | (295,952,746.65) |
| | | C. Bank OSSH | (244,920,546.63) | (249,235,620.10) |
| | | C. Bank FTL | (199,906,157.82) | (196,081,038.47) |
| **9** | Abi Bank | A. Bank OSHEE | (49,976,168.58) | (49,940,261.95) |
| | | A.Bank FSHU | (1,054,160,635.25) | (995,763,819.66) |
| | | A. Bank OSSH | (149,792,151.19) | (149,910,712.02) |
| | | A. Bank FSHU Garanci Sovrane | € (9,998,532.09) | (9,989,424.86) |
| Total i linjave në Lek | | | (8,335,443,103.80) | (8,110,527,046.64) |
| Total i linjave në euro | | | (81,486,538.72) | (81,474,794.44) |
| kurset e fund vitit lek/eur | | | 119.13 | 114.23 |
| Totali Në lekë | | | **(18,042,934,461.52)** | **(17,417,392,815.52)** |

**Garancia sovrane**

| Overdraftet banka R.FSHU datë 01.07.2020-31.12.2022 | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| **Nr** | **Koha marrjes së OD** | **Shuma totale e OD valutë dhe në lek 000** | **Norma** | **Penaliteti për vonesën në pagese** | **Afati mbarimit të OD** | **Pagesat e kryera nga Oshee interesat 31.12.2022** | **Detyrimi i mbetur 31.12.22** |
| 1 | 09.12.2021 | €15,000,000.00 | EUR 12M+ 2.3 % ( Min 2.3 %) | 3% | 09.12.2022 | €345,438.83 | €(14,997,464.33) |
| 2 | Ne proces rinovimi | €15,000,000.00 | EUR 12M+ 1 % ( Min 4.1 %) | 3% | | | |
| | | | | | | | |
| Overdraftet banka O. FSHU datë 01.07.2020-31.12.2022 | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| **Nr** | **Koha marrjes së OD** | **Shuma totale e OD valutë dhe në lek 000** | **Norma** | **Penaliteti për vonesën në pagese** | **Afati mbarimit të OD** | **Pagesat e kryera nga Oshee interesat 31.12.2022** | **Detyrimi i mbetur 31.12.22** |
| 1 | 18.11.2021 | €20,000,000.00 | 2.10% | 3% | 18.11.2022 | €508,726.96 | €(19,991,328.96) |
| 2 | Ne proces rinovimi | €20,000,000.00 | EUR 3M+ 1.9 % ( Min 4.2 %) | 3% | | | |
| **Nr** | **Koha marrjes së OVD** | **Shuma totale e OVD valutë dhe në lek 000** | **Norma** | **Penaliteti për vonesën në pagese** | **Afati mbarimit të OVD** | **Pagesat e kryera nga Oshee interesat 15.12.2022** | **Detyrimi i mbetur 31.12.2022** |
| 1 | 18.11.2021 | €10,000,000.00 | EUR 12M+ 2 % ( Min 2.2%) | 2% | 18.11.2022 | €242,294.86 | € (9,989,424.86) |
| 2 | 14.12.2022 | €10,000,000.00 | EUR 12M+ 1 % ( Min 4.1%) e rishikueshme cdo 3 muaj | 2% | 21.11.2023 | | |
| **Nr** | **Koha marrjes së OVD** | **Shuma totale e OVD valutë dhe në lek 000** | **Norma** | **Penaliteti për vonesën në pagese** | **Afati mbarimit të OVD** | **Pagesat e kryera nga Oshee interesat 31.12.22** | **Detyrimi i mbetur 31.12.22** |
| 1 | 10.12.2021 | €20,000,000.00 | EUR 12M+ 1.85 % ( Min 1.85%) | 2% | 10.12.2022 | €387,303.27 | €(19,998,773.55) |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| 2 | Ne proces rinovimi | €20,000,000.00 | EUR 3M+ 1.85 % ( Min 4.1%) | 2% | | | |
| Overdraftet Banka R. OSSH datë 01.07.2020-31.12.2022 | | | | | | | |
| | | | | | | | |
| **Nr** | **Koha marrjes së OD** | **Shuma totale e OD valutë dhe në lek 000** | **Norma** | **Penaliteti për vonesën në pagese** | **Afati mbarimit të OD** | **Pagesat e kryera nga Oshee interesat 31.12.22** | **Detyrimi i mbetur 31.12.22** |
| 1 | 09.12.2021 | €16,500,000.00 | EUR 12M+ 2.3 % ( Min 2.3 %) | 3% | 09.12.2022 | €398,551.61 | €(16,497,802.74) |
| 2 | Ne proces rinovimi | €16,500,000.00 | EUR 12M+ 1 % ( Min 4.1 %) | 3% | | | |

## ANEKSI II

### Mbi dhënien dhe marrjen me qira të ambienteve.

OSHEE SHA është një shoqëri me kapital 100% shtetëror. Detyra kryesore e saj është shpërndarja e energjisë për konsumatorët, si dhe sigurimi i energjisë për mbulim humbjesh në zbatim të Vendimit të ERE. Për realizimin e aktivitetit të saj, shpërndarjen e energjisë, si dhe ofrimin e shërbimeve abonentëve (1,270,494 abonentë të regjistruar), shoqërisë i lind nevoja për ofrimin e shërbimit ndaj klientëve sipas rretheve, qyteteve dhe zonave të caktuara. Për ofrimin e shërbimit, nisur nga mungesa e aseteve të saj, shoqëria ka operuar me kontrata qiraje për ambiente zyrash, magazina, kujdes klienti, etj. Procedurat e kontratave të qirasë nisin nga kërkesa e përgjegjësve të zonave për ofrimin e shërbimit klientëve ku është më e nevojshme, ndërkohë që procedura e qiramarrjes ndiqet në drejtorinë qendrore.

***<u>Procesi i qiramarrjes/dhënies në OSHEE SHA</u>***

Procesi i sipër përmendur kalon në këto hapa :

-Evidentohet nevoja e qiramarrjes/dhënies në strukturat e OSHEE SHA. Mënyra e evidentimit mund të jetë e ndryshme, si p.sh.: me shkresë zyrtare, me email, me njoftim nga strukturat e ndryshme në shoqëri.

-Në shumicën e rasteve bashkë me kërkesën nga Drejtoritë Rajonale apo strukturat përkatëse, vjen dhe një propozim bashkëlidhur shkresës/kërkesës/njoftimit, propozim për të cilin DR/DTL ka marrë të gjitha të dhënat ligjore dhe fizike të pronës së propozuar dhe i përcjell këto të dhëna në dispozicion të strukturës të Drejtorisë të Shërbimeve Mbështetëse (më poshtë DSHM) në qendër.

-Propozimi i strukturave merret në shqyrtim nga strukturat e DSHM dhe komisioni i ngritur për këtë me Urdhrin të Brendshëm të Administratorit nr.25 prot, datë 04.01.2016 për "Ngritjen e grupit të punës për vlerësimin e ambienteve me qira", i përbërë nga L M në pozicionin e kryetarit, A G dhe I H në pozicionin e anëtarëve. Komisioni aktualisht përbëhet nga Drejtori i Departamentit të

Shërbimeve Mbështetëse-Jurist, Shefi i Sektorit të Shërbimeve të Brendshme – Ekonomist/vlerësues i pasurive te paluajtshme, Specialist në DSHM-jurist.

-Nëse propozimi i ardhur vlerësohet nga komisioni se përmbush parametrat e kërkuara nga DR/DTL, por dhe parametrat ligjorë atëherë kalohet në etapën e negocimit, nëse jo DSHM kthen propozimin për rishqyrtim ose zhvillon një site visit me specialistet e saj në terren për të parë opsione të tjera që mund të adaptohen me nevojat e OSHEE SHA.

-Pasi përcaktohet objekti që do të merret me qira dhe përmbush të gjitha kushtet fizike/juridike si gjendja, sipërfaqja, vizibiliteti i pronës në raport me objektet e tjera të rëndësishme në zonë etj, pronari/rët e objektit thërriten në zyrat qendrore për të negociuar kushtet e përgjithshme të kontratës si vlera afati punimet e nevojshme etj. Duke qenë se OSHEE SHA ka një nevojë të lartë qiramarrje, si dhe një numër të lartë kontratash qiramarrje, kjo ka bërë që të ketë një data bazë të mirëfilltë kontratash me të dhëna për çdo rreth të Shqipërisë me vlera, çmime etj. Në procesin e negocimit Grupi Negociator bazohet në këto referenca për të negociuar çmimin përfundimtar të kontratës së qirasë. Nëse shihet e nevojshme mund te merren edhe oferta nga njësi te tjera tregtare për te ndihmuar ne proces. Rol të veçantë në negocimin e çmimit përfundimtar të kontratës luajnë kërkesat specifike që OSHEE SHA mund të këtë për përshtatjen e objektit sipas kërkesave të saj. Kjo nënkupton që të gjitha punimet infrastrukturore, sistemi elektrik, sistemi hidraulik, sistemet e aspirim/kondicionimit, në disa raste edhe shpenzimet e mobilimit etj, do të kryhen dhe përballohen me shpenzimet e qiradhënësit. OSHEE do të kryejë vetëm procesin e brandimit sipas Brand Manualit të saj të miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.50, datë 16.07.2015 “Standardet e markës OSHEE SHA, Manuali i Përdorimit” dhe pajisjen e posteve të punës me infrastrukturën teknologjike si kompjuterë, printerë, kasa fiskale etj.

-Pasi palët bien dakord për kushtet e kontratës si vlera afati dhe punimet që do të bëhen në objekt, Grupi negociator firmos një Proces Verbal në të cilin evidentohen të gjitha termat e dakordësuar për hartimin e kontratës. Ky procesverbal bëhet pjesë integrale e çdo kontrate.

-Hartohet kontrata e qirasë e cila përmban të gjitha elementët e nevojshëm të një kontrate bazuar në Kodin Civil të Republikë së Shqipërisë, si dhe kushtet e dakordësuara në pikën 6, përpilohet në katër kopje nga DSHM dhe dërgohet për firme te Administratori i secilës shoqëri (duke filluar 01.01.2020), dhe pastaj firmoset nga qiradhënesi. Efektet financiare të kontratës fillojnë me dorëzimin nga pronari të objektit të punimeve të përcaktuara në procesverbalin e negocimit.

-Për pranimin e punimeve në përfundim të tyre dhe me fillimin e efekteve financiare të kontratës hartohet procesverbali i dorëzimit të objektit i cili përcakton : datën e dorëzimit të objektit, datë e cila përkon dhe me fillimin e marrëdhënies financiare të qirasë; leximet e aparateve matës të energjisë dhe të ujit të pijshëm; çdo pikë tjetër që specifikohet në kontratë.

-Me plotësimin e setit të dokumenteve, kontrata përcillet në DEK për kontabilizim dhe njohjen e detyrimit. Pas kontabilizimit, kontrata i përcillet DR/strukturave për ndjekje dhe hartim te auto faturave tatimore. Respektimi i kushteve te kontratës së qiramarrjes gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj ndiqet nga strukturat respektive në DSHM qendër dhe DR/strukturat përkatëse.

1. Qiramarrja në OSHEE Group SHA kryhet për të siguruar ambiente për akomodimin e punonjësve kryesisht të qendrave të kujdesit ndaj klientit, punonjësit e administratës qendrore dhe lokale, të drejtorive rajonale dhe njësive përkatëse, por edhe ambiente për të magazinuar materialet e mirëmbajtjes dhe të investimeve. Si më poshtë paraqiten të dhëna lidhur me shpenzimet e qiramarrjes për periudhën Korrik 2020 - Dhjetor 2022.

| Viti | Numri i kontratave të qirave | Vlera e kontratave | Shuma e paguar | Diferenca (2-1) |
|---|---|---|---|---|
| | | -1 | -2 | |
| Korrik - Dhjetor 2020 | 135 | 147,656,247 | 147,656,247 | - |
| Janar - Dhjetor 2021 | 146 | 340,237,625 | 340,237,625 | - |
| Janar - Dhjetor 2022 | 148 | 351,419,758 | 294,927,041 | (56,492,717) |
| **Totali** | | **839,313,629** | **782,820,913** | **(56,492,717)** |

***Burimi i të dhënave:*** *Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, përpunoi grupi i auditimit.*

Në periudhën Korrik - Dhjetor 2020 kanë qenë aktive 135 kontrata qiraje me një vlerë të përgjithshme vjetore prej **147,656,247 lekësh.** Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e numrit të këtyre kontratave sipas Drejtorive Rajonale dhe shoqërive të OSHEE Group SHA. Viti 2020 ka nisur me 139 kontrata aktive dhe është mbyllur me 135 duke ndërprere 4 kontrata qiraje me një vlerë vjetore prej **11,663,040 lekësh**.

*Pasqyra nr.2: Shpërndarja e numrit të këtyre kontratave sipas Drejtorive Rajonale dhe shoqërive të OSHEE Group SHA*

| Drejtoria | FSHU SHA | | OSHEE G SHA | | OSSH SHA | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Korrik - Dhjetor 2020 | | Korrik - Dhjetor 2020 | | Korrik - Dhjetor 2020 | |
| | Numër kontratash | Vlera | Numër kontratash | Vlera | Numër kontratash | Vlera |
| **Berat** | 9 | 5,434,934 | | | 3 | 3,060,000 |
| **Burrel** | 10 | 2,740,632 | | | 4 | 2,772,960 |
| **Durrës** | 8 | 5,577,720 | | | 10 | 5,709,755 |
| **Elbasan** | 6 | 4,367,871 | | | 1 | 4,033,262 |
| **Fier** | 4 | 2,323,002 | | | 6 | 11,877,540 |
| **Gjirokastër** | 6 | 3,205,806 | | | 2 | 1,290,000 |
| **Korçë** | 5 | 2,526,000 | | | 1 | 660,000 |
| **Kukës** | 4 | 2,513,057 | | | 1 | 180,000 |
| **Shkodër** | 9 | 8,128,972 | | | 6 | 10,803,540 |
| **Tiranë** | 18 | 20,353,126 | 3 | 19,560,180 | 13 | 26,378,690 |
| **Vlorë** | 5 | 3,565,200 | | | 1 | 594,000 |
| **Total** | **84** | **60,736,320** | **3** | **19,560,180** | **48** | **67,359,747** |

***Burimi i të dhënave:*** *Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, përpunoi grupi i auditimit*

Përgjatë vitit 2021 numri i kontratave të qirasë ka qenë 146 dhe vlera e tyre është **340,237,625 lekë**. Gjatë këtij viti kanë përfunduar 5 kontrata qiraje dhe janë lidhur 17 kontrata të reja në shumicën e tyre për shoqërinë OSSH SHA për nevojat e saj ne sipërfaqe magazinimi, zyra te grupeve operative dhe zyra administrate. Me përzgjedhje rastësore janë audituar 10 kontrata qiramarrje (pra 58% e kontratave). Tabela me poshtë tregon shpërndarjen e numrit të këtyre kontratave sipas Drejtorive Rajonale dhe shoqërive te OSHEE Group SHA.

*Pasqyra nr.3: Shpërndarja e numrit të këtyre kontratave sipas Drejtorive Rajonale dhe shoqërive të OSHEE Group SHA*

| Drejtoria | FSHU SHA | | OSHEE G SHA | | OSSH SHA | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Janar -Dhjetor 2021 | | Janar -Dhjetor 2021 | | Janar -Dhjetor 2021 | |
| | Numër kontratash | Vlera | Numër kontratash | Vlera | Numër kontratash | Vlera |
| **Berat** | 10 | 11,430,634 | | | 3 | 6,120,000 |
| **Burrel** | 9 | 5,429,328 | | | 5 | 7,626,565 |
| **Durrës** | 9 | 11,604,860 | | | 13 | 29,090,978 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Elbasan | 6 | 9,048,000 | | | 1 | 8,264,640 |
| Fier | 4 | 4,646,004 | | | 8 | 35,304,830 |
| Gjirokastër | 5 | 7,176,000 | | | 2 | 2,580,000 |
| Korçë | 5 | 5,011,167 | | | 3 | 4,971,800 |
| Kukës | 4 | 5,012,238 | | | 1 | 495,000 |
| Shkodër | 9 | 17,298,982 | | | 6 | 23,563,080 |
| Tiranë | 19 | 41,401,658 | 3 | 39,120,360 | 15 | 56,723,100 |
| Vlorë | 5 | 7,130,400 | | | 1 | 1,188,000 |
| **Total** | **85** | **125,189,271** | **3** | **39,120,360** | **58** | **175,927,993** |

***Burimi i të dhënave:*** *Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, përpunoi grupi i auditimit*

Përgjatë vitit 2022 numri i kontratave të qirase ka qenë 148 duke pasur një shtese prej 2 kontratash, me vlerë totale **351,419,758 Leke**. Gjatë këtij viti kanë përfunduar 5 kontrata qiraje dhe janë lidhur 7 kontrata të reja. Me përzgjedhje rastësore janë audituar 3 kontrata qiramarrje (pra 42% e kontratave). Në vlerën totale te kostos se qiramarrjes ka pasur një rritje në vlerë vjetore prej 10,5 milionë lekësh. Tabela më poshtë tregon shpërndarjen e numrit të këtyre kontratave sipas Drejtorive Rajonale dhe shoqërive te OSHEE Group SHA.

*Pasqyra nr.4: Shpërndarja e numrit të këtyre kontratave sipas Drejtorive Rajonale dhe shoqërive të OSHEE Group SHA*

| Drejtoria | FSHU SHA | | OSHEE G SHA | | OSSH SHA | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Janar -Dhjetor 2022 | | Janar -Dhjetor 2022 | | Janar -Dhjetor 2022 | |
| | Numër kontratash | Vlera | Numër kontratash | Vlera | Numër kontratash | Vlera |
| Berat | 9 | 10,984,470 | | | 3 | 5,170,000 |
| Burrel | 9 | 5,429,328 | | | 5 | 7,325,920 |
| Durrës | 9 | 11,993,340 | | | 13 | 38,552,251 |
| Elbasan | 6 | 9,048,000 | | | 1 | 8,264,640 |
| Fier | 4 | 4,646,004 | | | 8 | 38,552,251 |
| Gjirokastër | 5 | 7,422,133 | | | 2 | 2,580,000 |
| Korçë | 4 | 4,896,000 | | | 3 | 5,770,999 |
| Kukës | 4 | 4,976,282 | | | 1 | 540,000 |
| Shkodër | 9 | 17,188,129 | | | 6 | 23,563,080 |
| Tiranë | 19 | 41,992,718 | 3 | 34,236,027 | 18 | 60,655,386 |
| Vlorë | 6 | 6,185,488 | | | 1 | 1,188,000 |
| **Total** | **84** | **125,189,271** | **3** | **39,120,360** | **58** | **175,927,993** |

***Burimi i të dhënave:*** *Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, përpunoi grupi i auditimit*

2. Qiradhënia në OSHEE Group SHA është e kufizuar dhe përbëhet vetëm nga 4 kontrata aktive deri në Dhjetor 2022. Në këto kontrata bëjnë pjesë:

a.Një kontrate qiradhënie ne qytetin e Elbasanit për një ambient "arkë", me sipërfaqe 32 m2 kontratë e cila është hartuar në kohën kur shoqëria administrohej nga Cez Shpërndarje në vitin 2012, dhe vlerë vjetore 3,864 Euro.

b.Dy kontrata të hartuara dhe të lidhura midis OSHEE Group SHA dhe V SHA në vitin 2020, dhe një kontratë për të njëjtin objekt me shoqërinë T SHA, për përdorimin e një sipërfaqe prej 10 m2 secila shoqëri për vendosjen e antenave të telefonisë celulare në tarracën e objektit " Zyra të N/S të Tensionit të Lartë Tiranë" me adresë Stadiumi Qemal Stafa. Këto kontrata janë lidhur për një periudhë një vjeçare me rinovim automatik. Vlera e këtyre kontratave është respektivisht 450,000 Lekë/vit, dhe 470,000 Lekë/vit.

c.-Me urdhërin e Administratorit të OSHEE Group SHA nr. 5074/1 prot, datë 24.05.2022 për "Ngritjen e Komisionit të Dhënies me Qira", për fillimin e procedurës të dhënies me qira të ambientit me sipërfaqe 211,5 $m^2$ me destinacion njësi shërbimi (lokal), ambientet e godinës së Administratës Qëndrore të OSHEE Group SHA. Komisioni përbëhet nga: L M (Kryetar), A G (anëtar) dhe E B (anëtar).
-Me urdhërin e Administratorit të OSHEE Group SHA nr. 5074/2 prot, datë 30.06.2022 për "Zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Dhënies me Qira", zëvendësohet E B me G P.
-Nga Komisioni i Dhënies me Qira është hartuar procesverbali me nr. 5074/3 prot, datë 30.06.2022 për "Zhvillimin e konkurimit", referuar të cilit rezulton se ka patur vetëm një ofertues, shoqëria "Il F SHPK".
-Nga Komisioni i Dhënies me Qira është hartuar informacioni për Administratorin me nr. 5074/4 prot, datë 30.06.2022 lidhur me procedurën e qiradhënies.
-Me shkresën e Administratorit të OSHEE Group SHA nr. 5074/5 prot, datë 04.07.2022 "Njoftim për shpalljen e fituesit", është shpallur fitues Il Fiadone SHPK, me ofertën 68,526 lekë në muaj.
- Me shkresën e Administratorit të OSHEE Group SHA nr. 5074/6 prot, datë 05.07.2022 është informuar Agjensia e Prokurimeve Publike , për shpalljen e fituesit.
-Me shkresën nr. 5074/7 prot, atë 18.07.2022 "Kontratë Qiraje" është lidhur kontrata e qirasë midis OSHEE Group SHA me përfaqësues Administratorin z. A Ç dhe I F SHPK me përfaqësues Administratorin z. E P. Kjo kontratë është lidhur për një periudhë 5 vjeçare dhe ka një vlerë vjetore prej 822,312 Lekësh.

*Pasqyra nr.5: Qiradhënia*

| Viti | Nr.kontratave të qirave | Vlera e kontratave total 1 | Shuma e paguar - 2 | Diferenca (2-1) |
|---|---|---|---|---|
| Korrik - Dhjetor 2020 | 3 | 652,180 | 119,742 | 532,438 |
| Janar - Dhjetor 2021 | 4 | 1,567,640 | 1,403,867 | 163,774 |
| Janar - Dhjetor 2022 | 4 | 1,693,545 | 2,050,797 | (357,252) |
| **Totali** | | **3,913,365** | **3,574,406** | **338,959** |

***Burimi i të dhënave:*** *Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, përpunoi grupi i auditimit*

*Pasqyra nr.6: Kontratat e audituara*

| **Qiradhënësi** | **Venddodhja** | **Shoqëria** | **Sipërfaqa në $m^2$** | **Vlera në Lekë** | **Numri i protokollit të kontratës të qirasë** | **Data e lidhjes të kontratës të qirasë** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| P F | Tiranë | FSHU SHA | 310.0 | 336,000 | nr. 3833 prot | 23.05.2022 |
| Gj M | Tiranë | OSSH SHA | 2,700.0 | 585,900 | nr. 8800 prot | 16.09.2022 |
| L Q | Tiranë | FSHU SHA | 188.3 | 250,000 | nr. 1114/4 prot | 02.02.2021 |
| A | Tiranë | OSSH SHA | 92.6 | 80,000 | nr. 9052 prot | 12.10.2021 |
| | | | | | nr. 10361 prot | 27.10.2022 |
| A K | Durrës | OSSH SHA | 3,000.0 | 355,275 | nr. 3521 prot | 13.04.2021 |
| XhSHPK | Durrës | FSHU SHA | 230.0 | 366,000 | nr. 28/28 prot | 06.01.2021 |
| A Sh | Fier | FSHU SHA | 139.0 | 147,400 | nr. 152 prot | 11.01.2021 |
| | | | | | nr. 1353 prot | 02.03.2022 |
| A shpk | Fier | OSSH SHA | 230.0 | 200,000 | nr. 9052/2 prot | 12.10.2021 |
| L shpk | Vlorë | FSHU SHA | 148.5 | 177,600 | nr. 7447 prot | 19.10.2022 |
| Gshpk | Lushnje | FSHU SHA | 134.5 | 198,253 | nr. 3816 prot | 06.04.2021 |
| N/M Sh | Shkodër | FSHU SHA | 355.0 | 302,840 | nr.2118 prot | 02.03.2021 |
| K G | Kukës | FSHU SHA | 135.0 | 108,540 | nr. 3685 prot | 16.05.2022 |
| A C | Elbasan | FSHU SHA | 195.5 | 360,000 | nr. 3541/1 prot | 29.03.2021 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| K P | Milot | FSHU SHA | 172.9 | 138,320 | nr. 4058 prot | 26.06.2020 |
| D S | Tepelenë | FSHU SHA | 115.2 | 150,000 | nr.3179 prot | 27.04.2022 |

***Burimi i të dhënave:*** *Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, përpunoi grupi i auditimit*

***<u>Konkluzione:</u>***

-Qiramarrja në OSHEE SHA kryhet për të siguruar ambiente për akomodimin e punonjësve kryesisht të qendrave të kujdesit ndaj klientit, punonjësit e administratës qendrore dhe lokale të drejtorive rajonale dhe njësive përkatëse, por edhe ambiente për të magazinuar materialet e mirëmbajtjes dhe të investimeve.

-Nga auditimi i kontratave të qirasë konstatohet se në kontratat e qiramarrjes, parashikohet në nenin 5.3 mbajtja e penalitetit, konkretisht: "*nëse ndonjë nga pagesat e qerasë mujore ose ndonjë pagesë tjetër sipas kësaj kontrate mbetet e papaguar pas 15 ditësh nga afati i pagesës së saj, ndaj qiramarrësit do të aplikohet një penalitet në masën 0.05% të shumës së prapambetur. Penaliteti do të fillojë aplikohet pas ditës të 15-të nga momenti i përfundimit të afatit të pagesës.*". Në kontratën e qiradhënies nuk parashikohet një nen i tillë, dhe për pasojë shoqëria OSHEE SHA nuk mund të mbajë penalitete lidhur me vonesat në pagesë të cilat shkojnë në vlerën ***338,959 lekë.***

**-**Në kontratat e qiradhënies neni 1, pika 1 parashikohet se "*...qiramarrësi nuk ka kryer pagesën brenda një muaji nga data e pagesës së përcaktuar...*", por kjo pikë nuk është zbatuar asnjëherë nga ana e OSHEE SHA.

-Nga auditimi i procedurave të qirave, rezulton se OSHEE SHA nuk ka ndjekur ndonjë procedurë të hapur apo me buletine në gazetat kombëtare apo mediat e shkruara, për ofrimin e ambienteve sa më të përshtatshme dhe me çmim konkurrues, por është nisur dhe ka vazhduar procedurat me propozimet e ardhura nga njësitë respektive sipas rretheve, më tej ka ndjekur një procedurë negocimi çmimi, sipërfaqeje, kushtet e duhura, etj.

-Shoqëria OSHEE SHA shpenzon mesatarisht në muaj ***28,358,125.3 lekë*** për pagesat e qirave, një shumë kjo e konsiderueshme, nisur dhe nga fakti se shërbimin e arkëtimit për shoqërinë, prej disa vitesh e ofrojnë edhe bankat e nivelit të dytë, shoqëritë e licencuara për operacione financiare, etj.

-Ky shpenzim në vit kap vlerën prej ***340,237,624 lekë***.

-Nga auditimi i praktikave të ndjekura për marrje me qira të ambienteve, çmimet e lidhjes së kontratave në proporcion me sipërfaqen dhe krahasimi me çmimet e tregut në faqet web të agjencive imobiliare apo gazetat që operojnë në këtë fushë, u konstatua se çmimet e negociuara nga OSHEE SHA për lidhje kontratash qiraje, janë më të larta se çmimet e tregut.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**